



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

**RAPORT I AUDITIMIT**  
**(Auditim i Përputhshmërisë)**

**“AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR”**  
**TIRANË**

**TETOR 2019**



**RAPORT AUDITIMI  
(Auditim Përputhshmërie)**

**“Autoriteti Rrugor Shqiptar”**

<i>Nr</i>	<i>Përmbajta</i>	<i>Faqe</i>
<b>I.</b>	<b>HYRJA (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)</b>	
a.	Objektivat dhe qëllimi.....	3-4
b.	Identifikimi i çështjes.....	4-4
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	4-4
d.	Përgjegjësitë e audituesve.....	4-5
e.	Kriteret e vlerësimit.....	5-5
f.	Standardet e auditimit.....	<b>5-6</b>
•	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	6-7
•	<b>DREJTIMET E AUDITIMIT</b> .....	7-151
I.	Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit .....	7-53
II.	-Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale monetare .....	54-65
III.	Prokurimet e fondeve publike.....	65-125
IV.	Zbatimi i kontratave.....	125-151
V.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.....	1151
VI.	Opinionin e auditimit.....	152
VII.	Gjetje Rekomandimi .....	1152-172
•	<b>DOKUMENTESHOQËRUESE</b> .....	172-1177



## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi u konstatua:

-Gjatë vitit 2018 në kundërshtim me Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, janë dhënë shpërblime punonjësve të ARRSH-së, me arsyetimin e ndryshimit të statusit të tyre nga nëpunës civil, në punonjës që marrëdhëniet juridike që rregullohen në bazë të Kodit të Punës. Vlera e këtyre shpërblimeve në dëm të buxhetit të shtetit është **51,239 mijë lekë**;

- Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi, janë paguar nga buxheti i shtetit për vitin 2018 shuma prej 350,000 mijë lekë, vlerë kjo të cilës i është shtuar edhe kosto e përmarimit në shumën rreth **31,745 mijë lekë**. Meqenëse shlyerja këtyre detyrimeve nuk është bërë në mënyrë vullnetare, ka sjellë efekt negativ për buxhetin e shtetit pasi këto fonde buxhetore nuk janë menaxhuar, me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

-Në procedura e prokurimit për “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja (Unaza e Re)” e ndarë në 3 lote se, është zhvilluar në kushte të mungesës së konkurrencës, pasi kontratat për realizimin e projektit, nuk është lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit, por është lidhur drejtpërdrejtë me projektuesin, i cili ka marrë përsipër të hartojë projektin dhe preventivin e zbatimit në formë dhurimi, pra falas

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës për vitin 2018”, me vlerë 98,120 mijë lekë, u konstatua se llogaritja e fondit limit nuk është e mirë argumentuar sepse, nuk janë analizuar çmimet për njësi të shërbimeve të kryera në fakt të kontratave të shërbimeve që ka pasur në zbatim ARRSH të viteve të mëparshme, por i është referuar vetëm vlerës përfundimtare të këtyre kontratave, pa bërë më parë një analizë të çmimeve të zërave të shërbimeve të paguara në fakt.

-Në disa procedura prokurimi janë bërë skualifikime të operatorëve ekonomik me oferta me të ulta se fituesit që shkojnë në vlerën totale rreth **394,894 mijë lekë**. Skualifikimet nga procedurat e prokurimeve të këtyre operatorëve janë bërë për disa mangësi në dokumentacionet e paraqitura për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kërkuara në dokumentet e tenderit, mangësi të cilat AK edhe mundë ti konsideronte si devijime të vogla, kështu këto fonde buxhetore do të menaxhoheshin, më me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

- Në disa kontrata për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, gjatë zbatimit të punimeve janë konstatuar punime të kryera nga kontraktorët dhe të paguara nga ARRSH, në vlerën totale rreth **223,747 lekë**. Por këto punime janë të pa rakorduar me dokumentacionin justifikues teknik si, librezat masash, fatura, analiza laboratorike të materialeve, etj dhe për pasojë, kemi menaxhim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të këtyre fondeve.



-Përgjithësisht nuk ka përcaktuar mekanizma të mirë organizuar dhe funksionale të procesit të menaxhimit të riskut, efekt që pasqyrohet edhe në rezultatet e treguesve të performancës së buxhetit dhe thesarit duke shfaqur mangësi, gjatë zbatimit të kontratave për punë dhe shërbime dhe rezerva në planifikimin e buxheteve dhe në parashikimin e nevojave për likuiditete, çka ka çuar në rritjen e nivelit dhe të stokut të detyrimeve të prapambetura. Kështu në çdo fund vit pasardhës, ARRSH vazhdon të trashëgoj të njëjtin borxh që shkon nga **3 miliard lekë në 4 miliard lekë**.

• **HYRJA**

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 363/1 datë 29.05.2019, i ndryshuar, në Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) nga data 01.06.2019-09.08.2019, për periudhën nga 01.01.2017 deri në 31.07.2019, u krye auditimi i përputhshmërisë në ARRSH, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. B. A., përgjegjës Grupi,
2. E. Ll., Audituese
3. F. Z’, Auditues
4. A. K, Auditues
5. K. F., Audituese
6. I. D, Auditues
- 7.E. S, Audituese
- 8.A. T, Auditues
- 9.Gj. P, Auditues

**a) Titulli:**

Projektraporti i Auditimit të Përputhshmërisë në Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH) .

**b) Marrësi:**

Ky Projektraport i adresohet Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së, Zj. S. Q.

**c) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

**Objekti i këtij auditimi** është përputhshmëria e veprimitarisë të kryera nga ana e subjektit Autoriteti Rrugor Shqiptar përgjatë periudhës 01.01.2017 deri më 31.07.2019, nëse nga strukturat përkatëse të këtij institucioni:

- janë zbatuar drejt aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi mbi bazën e të cilave funksionon veprimtaria e këtij institucioni,
- fondet e akorduara nga buxheti i shtetit në funksion të kësaj veprimtarie, janë përdorur konform akteve ligjore në fuqi dhe në mënyrë efektive.
- dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve, që ARRSH u ka bërë fondeve të çelura, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullshmërinë, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimitarisë së tij dhe planeve strategjike të miratuara nga strukturat përkatëse



**Qëllimi i auditimit** është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale.

Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare, prokurimet e fondeve publike, etj.

**d) Identifikimi i çështjes:**

Funksioni i ARRSH është të përgatisë dhe zbatojë masa të administrimit të rrjetit rrugor shtetëror, me theks të veçantë mbi interesin publik në përputhje me Kodin Rrugor dhe Ligjin “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”. Autoriteti, nëse do të konsiderohet e domosdoshme, mund të përmbushë funksionet e tij në bashkëpunim me institucionet e tjera pjesëmarrëse në sektorin e transportit publik rrugor. Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është administrimi i rrjetit rrugor shtetëror në përputhje me përcaktimet e Kodit Rrugor dhe Ligjit “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”. Autoriteti, nëse do të konsiderohet e domosdoshme, mund të përmbushë funksionet e tij në bashkëpunim me institucionet e tjera pjesëmarrëse në sektorin e transportit publik rrugor.

Misioni i kësaj drejtorie është organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, riveshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar. ARRSH, si një institucion i akredituar për administrimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit si dhe nga donatorë të huaj si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim, Banka Evropiane e Investimeve, Qeveria Italiane, Qeveria Kuvajtiane, Banka Islamike etj, ka realizuar disa objekte të rëndësishme në rrjetin rrugor nacional duke kontribuar kështu për një standard më të mirë të jetës së të gjithë qytetarëve nëpërmjet një rrjeti rrugor të besueshëm.

Grupi i auditimit është fokusuar në detyrat kryesore të administrimit të Fondeve të buxhetit të shtetit, si dhe investimet e realizuar nga këto fonde.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit 363/1, datë 29.05.2019, i ndryshuar.

**e) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Drejtimi i ARRSH-së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafit menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

**f) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**



Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ARRSH-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

#### **g) Kriteret e vlerësimit:**

- Ligji nr. 10164, datë 15.10.2009 “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”.
- Rregullorja e Brendshme e ARRSH-së, “Mbi miratimin e rregullores së brendshme të Autoritetit Rrugor Shqiptar ” miratuar me Vendim nr.10, datë 04.09.2018.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.
- Ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”
- Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”
- Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;
- Udhëzimit të MF nr. 10 datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018 – 2020”
- VKM nr. 128 datë 07.03.2018 “ Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2019-2021”
- Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 “ Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”
- Udhëzimi plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 “Për buxhetin e vitit 2017”
- Udhëzimi nr. 24, datë 28.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”
- Udhëzimi nr. 2, datë 19.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
- Udhëzimi nr.8, datë 17.02.2003 “Për evidencimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj”.
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”, Udhëzimi i APP-së nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik”,



- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

### **h) Standardet e Auditimit**

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

- ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

- ISSAI 4000 “Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë”

- ISSAI 4100 “Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë për auditime të performuara veçmas nga Auditimi i Pasqyrave Financiare”.

- ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etikës.

## **• PËSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. Informacion i përgjithshëm:**

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) u krijua me Ligjin Nr.10164, date 15/10/2009, “Per autoritetin rrugor shqiptar”. Qellimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij. Ky ligj beri shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar. Misioni i kësaj drejtorie ishte organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, riveshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar.

Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve është krijuar në vitin 1993 (V.K.M. Nr.614, date 29/12/1993 “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve” Organika dhe struktura e kësaj drejtorie gjatë viteve ka pësuar transformime. Numri i punonjësve ka pësuar ndryshime në vite duke filluar nga 800 punonjës deri në 169 punonjës.

Për periudhën në auditim , institucioni i ARRSH-së, ka pësuar dy ndryshime në strukturë dhe konkretisht:

-Sipas VKM-së nr .12, datë 11.01.2017 , organika e ARRSH-së është e organizuar :

Bordi i Menaxhimit dhe dhe Drejtori i Përgjithshëm si dhe dy zëvendës drejtorë.

Janë gjithsej 7 drejtori të brendshme që kanë varësi nga dy zv/drejtorët e përgjithshëm si dhe 3(tre) drejtori për rajonet : Drejtorja e Rajonit Qendror Tiranë, Drejtorja e Rajonit Verior Shkodër si dhe Drejtorja e Rajonit Jugor Gjirokastrë.

-Ndryshimi i dytë i strukturës është bërë sipas VKM nr.276, datë 16.05.2018 “Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, sipas të cilit marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit në nivel qendror dhe rajonal rregullohen në bazë të dispozitave të Ligjit 7961”Kodi i Punësi RSH”, datë 12.07.1995, i ndryshuar. Numri në plan i punonjësve është 169 dhe ka mbetur i pandryshuar edhe me ndryshimin e statusit .

Misioni i kësaj drejtorie është organizimi, zhvillimi, shfrytëzimi mirëmbajtja, riveshja dhe realizimi i programit të investimeve në rrjetin rrugor kombëtar. ARRSH, si një institucion i



akredituar për administrimin e fondeve nga Buxheti i Shtetit si dhe nga donatorë të huaj si: Banka Botërore, Banka Evropiane për Zhvillim dhe Ndërtim, Banka Evropiane e Investimeve, Qeveria Italiane, Qeveria Kuvajtiane, Banka Islamike etj, ka realizuar disa objekte të rëndësishme në rrjetin rrugor nacional.

Ngritja e një mjedisi pune eficient në bashkëpunim me partnerët e Autoritetit si dhe krijimin e një stafi profesional, të trajnuar dhe të kualifikuar me anë të strategjisë së menaxhimit të burimeve njerëzore.

## **2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:**

- Objekt i këtij auditimi është rregullshmëria dhe përputhshmëria e operacioneve financiare të ARRSH-së përgjatë vitit 2017-2018 dhe deri më 31.07.2019.

- Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ARRSH-së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit.

- Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të ARRSH-së me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2017 – 31.07.2019, ku janë mbuluar me auditim fondet e buxhetit të shtetit, si dhe janë audituar me përzgjedhje transaksionet e ndodhura në periudhën 01.01.2017 – 31.07.2019.

### **• DREJTIMET E AUDITIMIT:**

#### **I. MBI HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT**

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARSH.) u krijua me Ligjin Nr.10164, date 15/10/2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”. Qëllimi i Ligjit ishte krijimi i Autoritetit Rrugor Shqiptar me kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat e tij. Ky ligj bëri shndërrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar.

Autoriteti Rrugor shqiptar ushtron aktivitetin e vet në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me VKM 97, date 07/02/2012 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Rrugor Shqiptar”, të ndryshuar me VKM Nr.382 datë 06/06/2012 dhe VKM Nr.435 datë 13/07/2012 struktura e ARSH është e organizuar në këtë mënyrë: Autoriteti Rrugor Shqiptar në qendër (97 punonjës) dhe tre rajonet (Drejtoria e Rajonit Qendror Tirane(23 punonjës), Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër(23 punonjës) dhe Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë (23 punonjës)).

#### **1.a) Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2017 dhe 2018**

Për realizimin e këtij auditimi ka shërbyer si bazë vlerësimi:





Neni 11, i Ligjit nr.10164, datë 05.10.2009 “ Për Autoritetin Rrugor Shqiptar “, ku përcaktohet se Bordi i ARRSH, miraton programet e brendshme vjetore dhe të buxhetit të ARRSH.

Baza ligjore për auditimin e programimit dhe realizimit të treguesve buxhetorë: për vitet 2017-2018 dhe gjashtëmujori i parë 2019.

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

- Ligjit nr. 130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”

- Ligjit nr. 109/2017 “Për buxhetin e vitit 2018”

- Udhëzim nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”;

- Udhëzimit të MF nr. 10 datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e PBA 2018 – 2020”

- VKM nr. 128 datë 07.03.2018 “ Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve për PBA 2019-2021”

- Udhëzimi nr. 7/1 datë 28.02.2018 “ Për përgatitjen e programeve buxhetore afatmesëm 2019-2021”

- Udhëzimi plotësues nr. 8, datë 13.01.2017 “Për buxhetin e vitit 2017”

- Udhëzimi nr. 24, datë 28.12.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”

- Udhëzimi nr. 2, datë 19.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”

- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit

Mbështetur në Urdhrin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës me nr. 1527/4, datë 18.04.2017 “Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve për përgatitjen e PBA 2018-2019, Faza e I si dhe e-mailit të datës 04.05.2017 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë “Tavanet përgatitore të PBA-së 2018-2020, Faza e I”, ARRSH ka hartuar projekt buxhetin PBA 2018-2020. Faza I është dërguar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës me shkresën nr. 4235, datë 24.05.2017, brenda afateve ligjore të parashikuara. Faza e dytë është dërguar me shkresën nr.6886 prot, datë 31.08.2017, brenda afateve ligjore të parashikuara.

Projekt buxheti për vitin 2018-2020 është hartuar konform legjislacionit përkatës, në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive sektoriale e ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2018-2020, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “fondin e pagave & “sigurimeve shoqërore” (600 & 601), llogaritja e tyre është bazuar në nivelin e pagave të ndryshuar sipas VKM-së nr. 276, datë 16.05.2018, ndërsa për numrin e punonjësve është marrë numri sipas strukturës së miratuar për 2017 prej 123. Duhet shkruar vendimet përkatëse të ndryshimit të strukturës për periudhën 2017-2018-2019

Sipas artikujve tavanet e parashikuara me VKM nr. 197, datë 15.03.2017 “Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020” për vitin 2018 limitet e miratuara nga MTI , për fazën e parë janë në shumën 3,727,320 mijë lekë,



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Kërkesat buxhetore të paraqitura nga ARRSH në fazën e parë dhe të dytë pas rishikimit të tavaneve të akorduara .ARRSH-ja rezulton me rritje të theksuar të kërkesave të paraqitura në PBA-në 2018-2020, në raport me limitin e dhënë për shpenzimet e vitit 2018 për shpenzimet korrente 606, Investimet me financim të huaj, Investimet me financim të brendshëm.

Parashikimi i shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2018-2020.

#### ***Faza e parë viti 2017.***

***Tabela.1***

*Në mijë lekë*

Llog	Artikujt	2018	2019	2020
600	Paga	117,400	117,400	117,400
601	Sigurimet Shoqërore	19,190	19,190	19,190
602	Mallra dhe Shërbime	1,727,800	1,746,444	1,746,444
605	Transferta Korente te Brendshme	0	0	0
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind	0	0	0
231	Kosto Lokale te Investimeve te huaja	900,000	900,000	900,000
231	TVSH e T.D të Investimeve te Huaja	2,200,000	2,200,000	2,200,000
231	Kapitale të trupëzuara të brendshme	6,850,000	6,850,000	8,400,000
231	Kapitale të trupëzuara të huaja	11,578,989	11,167,880	11,167,880
<b>Totali</b>				

#### ***Faza e dytë***

***Tabela.2***

*Në mijë leke*

Llog	Artikujt	2018	2019	2020
600	Paga	117,400	117,400	117,400
601	Sigurimet Shoqërore	19,190	19,190	19,190
602	Mallra dhe Shërbime	1,727,800	1,746,444	1,746,444
605	Transferta Korente te Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind			
231	Kosto Lokale te Investimeve te huaja	900,000	900,000	900,000
231	TVSH e T.D te Investimeve te Huaja	2,200,000	2,200,000	2,200,000
231	Kapitale të trupëzuar të brendshme	6,850,000	6,850,000	8,400,000
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	11,578,989	11,167,880	11,167,880
<b>Totali</b>				

#### **Viti 2018**

Mbështetur në shkresën e MTI nr. 6605, datë 23.04.2018 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021” në zbatim të urdhrit nr. 7/1, datë 28.02.2018 të Ministrisë të Financës “Për përgatitjen e PBA-së 2019-2021”, ARRSH ka hartuar projekt buxhetin PBA 2019-2021, ku janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, Faza I e cila është dërguar në MTI me shkresën nr. 3768,



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

datë 04.05.2018 dhe faza e II-të e PBA-së është dërguar me shkresën nr. 8250, datë 24.09.2018 brenda afatit të përcaktuar.

Tabela 1: Parashikimi i shpenzimeve në të dy fazat e PBA 2019-2021.

#### Faza e parë

Tabela.3

Në mijë leke

Llog	Artikujt	2,019	2020	2021
600	Paga	146,157	150,541	155,057
601	Sigurimet Shoqërore	24,408	25,140	25,895
602	Mallra dhe Shërbime	2,308,735	2,403,619	2,498,348
605	Transferta Korente te Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind			
231	Kosto Lokale te Investimeve te huaja	900,000	900,000	1,000,000
231	TVSH e T.D te Investimeve te Huaja	2,200,000	2,200,000	2,000,000
231	Kapitale të trupëzuar te brendshme	11,347,601	10,103,839	15,583,839
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	10,368,132	10,368,132	10,368,132
<b>Totali</b>				

#### Faza e dytë

Tabela.4

Në mijë leke

Llog	Artikujt	2,019	2020	2021
600	Paga	142,579	142,579	142,579
601	Sigurimet Shoqërore	23,811	23,811	23,811
602	Mallra dhe Shërbime	1,762,610	1,862,610	1,962,610
605	Transferta Korente të Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind			
231	Kosto Lokale të Investimeve të huaja	900,000	700,000	500,000
231	TVSH e T.D të Investimeve të Huaja	2,000,000	1,900,000	1,600,000
231	Kapitale të trupëzuar te brendshme	9,175,000	8,896,000	7,995,500
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	8,308,132	8,308,132	8,308,132
<b>Totali</b>				

#### Viti 2019

Mbështetur në shkresën e MTI nr. 3612/1, datë 04.04.2018 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022” në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.8, datë 13.03.2019 “Për përgatitjen e PBA 2020-22, ARRSH ka hartuar projekt buxhetin PBA 2020-2022, ku janë mbajtur në konsideratë kërkesat e strategjive ndër sektoriale dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave me relacionin shpjegues, Faza I e cila është dërguar në MTI me shkresën nr. 5065, datë 24.05.2019.

Parashikimi i shpenzimeve në fazën e I PBA 2020-2022.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Faza e parë sipas nevojave të ARRSH-së për politikat ekzistuese.

Tabela.5

*Në mijë leke*

Llog	Artikujt	2,020	2021	2022
600	Paga	142,580	142,580	142,580
601	Sigurimet Shoqërore	23,811	23,811	23,811
602	Mallra dhe Shërbime	2,178,550	2,478,550	2,578,550
605	Transferta Korente te Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind			
231	Kosto Lokale te Investimeve te huaja	1,344,583	484,046	680
231	TVSH e T.D te Investimeve te Huaja	3,126,186	883,630	260,860
231	Kapitale të trupëzuar te brendshme	31,240,718	5,266,281	4,180,500
231	Kapitale të trupëzuar të huaja	16,533,523	4,044,458	2,505,030
<b>Totali</b>				

Faza e parë Sipas nevojave të ARRSH-SË për politika të reja.

Tabela.6

*Në mijë lekë*

Llog	Artikujt	2020	2021	2022
600	Paga			
601	Sigurimet Shoqërore			
602	Mallra dhe Shërbime			
605	Transferta Korente te Brendshme			
606	Transferta Buxhetor Fam & Ind			
231	Kosto Lokale te Investimeve te huaja	0	0	0
231	TVSH e T.D te Investimeve te Huaja	1,000	2,438,657	2,535,659
231	Kapitale të trupëzuara të brendshme	3,577,672	7,096,030	5,979,200
231	Kapitale të trupëzuara të huaja	5,000	12,193,282	12,678,291
<b>Totali</b>				

**1.b) Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore si dhe plani përfundimtar, për vitet 2017 – 2018-2019.**

Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas programit të miratuar, **nr. 04520, me emërtesë programi “Transporti Rrugor”.**

VITI 2017		
LEKE		
ARTIKULLI	SHUMA	KOMENTE



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

600	117,400,000	Shkresa e MIE nr.546/1 prot, date 10.02.2017 "Dergohet detajimi i planit te Buxhetit per shpenzime korrente (nr.1063 prot, date 10.02.2017 protokoll ARRSH).
	9,775,000	Shkresa e MIE nr.3018/1 prot, date 09.06.2017 "Dergohet detajimi shteses se fondeve per perballimin e efektit financiar te rritjes se pagave, per vitin 2017 (nr.4868 prot, date 12.06.2017 protokoll ARRSH).
	<b>127,175,000</b>	<b>TOTAL BUXHETI PAGAVE 2017</b>
601	19,190,000	Shkresa e MIE nr.546/1 prot, date 10.02.2017 "Dergohet detajimi i planit te Buxhetit per shpenzime korrente (nr.1063 prot, date 10.02.2017 protokoll ARRSH).
	1,989,000	Shkresa e MIE nr.3018/1 prot, date 09.06.2017 "Dergohet detajimi shteses se fondeve per perballimin e efektit financiar te rritjes se pagave, per vitin 2017 (nr.4868 prot, date 12.06.2017 protokoll ARRSH).
	<b>21,179,000</b>	<b>TOTAL BUXHETI SIGURIMEVE 2017</b>
602	1,630,000,000	Shkresa e MIE nr.546/1 prot, date 10.02.2017 "Dergohet detajimi i planit te Buxhetit per shpenzime korrente (nr.1063 prot, date 10.02.2017 protokoll ARRSH).
	200,000,000	Shkresa e MIE nr.2512/1 prot, date 11.12.2017 "Dergohet miratimi i detajimit te Aktit Normativ Nr.3, date 06.11.2017" (nr.9662/2 prot, date 11.12.2017 protokoll ARRSH).
	<b>1,830,000,000</b>	<b>TOTAL BUXHETI LLOG.602 2017</b>
<b>Financim i Brendshem 230+231</b>	9,927,781,000	Shkresa e MIE nr.1180 prot, date 27.02.2017 "Dergohet per zbatim buxheti I investimeve per vitin 2017, per programin transporti rrugore", (nr.1574 prot, date 28.02.2017 protokoll ARRSH).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

	959,000,000	Shkresa e MFE nr.11721/47 prot, date 07.09.2017 "Ne zbatim te Aktit Normativ nr.2, date 06.11.2017 (nr.9662 prot, date 04.12.2017 protokoll ARRSH).
	1,704,467,000	Shkresa e MIE nr.1870/7 prot, date 04.12.2017 "Dergohet per zbatim Aktit Normativ nr.3, date 06.11.2017 (nr.9662 prot, date 04.12.2017 protokoll ARRSH).
	<b>12,591,248,000</b>	<b>BUXHETI NE FUND TE VITIT 2017</b>
<b>Financim i Huaj 230+231</b>	7,238,358,000	Shkresa e MIE nr.1180 prot, date 27.02.2017 "Dergohet per zbatim buxheti I investimeve per vitin 2017, per programin transporti rrugore", (nr.1574 prot, date 28.02.2017 protokoll ARRSH).
	-262,948,000	Shkresa e MFE nr.11721/47 prot, date 07.09.2017 "Ne zbatim te Aktit Normativ nr.2, date 06.11.2017 (nr.9662 prot, date 04.12.2017 protokoll ARRSH).
	1,000,000,000	Shkresa e MIE nr.1870/7 prot, date 04.12.2017 "Dergohet per zbatim Aktit Normativ nr.3, date 06.11.2017 (nr.9662 prot, date 04.12.2017 protokoll ARRSH).
	<b>7,975,410,000</b>	<b>BUXHETI NE FUND TE VITIT 2017</b>

VITI 2018 LEKE		
ARTIKULLI	SHUMA	KOMENTE
<b>600</b>	141,900,000	Shkresa e MIE nr.57/3 prot, date 09.02.2018 "Dergohet miratimi pjesor te planit te buxhetit 2018-2020 (nr.1228 prot, date 13.02.2018 protokoll ARRSH).
	-3,000,000	Shkresa e MIE nr.10560/5 prot, date 23.08.2018 "Dergohet miratimi I detajimi I ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr.1, date 26.07.2018 (nr.7251 prot, date 24.08.2018 protokoll ARRSH).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

	-11,169,241	Shkresa e MIE nr.11171/1 prot, date 31.08.2018 "Dergohet miratimi I rialokimit te fondeve buxhetore per vitin 2018", (nr.6347/ prot, date 31.08.2018 prot ARRSH).
	-9,600,644	Shkresa e MIE nr.13613/5 prot, date 12.12.2018 "Dergohet miratimi I rialokimit te fondeve buxhetore per vitin 2018", (nr. 11214 prot, date 12.12.2018 prot ARRSH).
	<b>118,130,115</b>	<b>TOTAL BUXHETI PAGAVE 2018</b>
<b>601</b>	24,490,000	Shkresa e MIE nr.57/3 prot, date 09.02.2018 "Dergohet miratimi pjesor te planit te buxhetit 2018-2020 (nr.1228 prot, date 13.02.2018 protokoll ARRSH).
	-500,000	Shkresa e MIE nr.10560/5 prot, date 23.08.2018 "Dergohet miratimi I detajimi I ndryshimeve sipas Aktit Normativ nr.1, date 26.07.2018 (nr.7251 prot, date 24.08.2018 protokoll ARRSH).
	-1,379,706	Shkresa e MIE nr.11171/1 prot, datë 31.08.2018 "Dërgohet miratimi I rialokimit te fondeve buxhetore per vitin 2018", (nr.6347/3 prot, datë 31.08.2018 prot ARRSH).
	-2,501,514	Shkresa e MIE nr.13613/5 prot, date 12.12.2018 "Dërgohet miratimi I rialokimit të fondeve buxhetore për vitin 2018", (nr. 11214 prot, datë 12.12.2018 prot ARRSH).
	<b>20,108,780</b>	<b>TOTAL BUXHETI SIGURIMEVE 2018</b>
<b>602</b>	1,728,370,000	Shkresa e MIE nr.3238/1 prot, date 08.03.2018 "Dergohet miratimi i detajimi i planit te Buxhetit për shpenzime operative 2018-2020 (nr.1913 prot, date 09.03.2013 protokoll ARRSH).
	22,130,662	VKM nr.491, date 31.07.2018 "Nje shtese fondi ne buxhetin e vitit 2018, miratuar per MIE per pagesen e sherbimeve juridike per perfaqesimin dhe mbrojtjen ne gjykatën italiane (nr.7037 prot, date 14.08.2018 prot ARRSH)



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

	-26,587,662	Shkresa e MIE nr.13613/5 prot, date 12.12.2018 "Dërgohet miratimi I rialokimit të fondeve buxhetore për vitin 2018", (nr. 11214 prot, datë 12.12.2018. prot ARRSH).
	<b>1,723,913,000</b>	<b>TOTAL BUXHETI LLOG.602 2018</b>
606	12,548,947	Shkresa e MIE nr.11171/1 prot, date 31.08.2018 "Dërgohet miratimi i rialokimit te fondeve buxhetore për vitin 2018", (nr.6347/3 prot, datë 31.08.2018. prot ARRSH).
	38,689,820	Shkresa e MIE nr.13613/5 prot, date 12.12.2018 "Dërgohet miratimi I rialokimit te fondeve buxhetore per vitin 2018", (nr. 11214 prot, date 12.12.2018 prot ARRSH).
	<b>51,238,767</b>	<b>TOTAL SHTESA 606</b>
Financim i Brendshem 230+231	15,155,041,000	Shkresa MIE nr.3238/8 prot, date 23.03.2018 "Dërgohet për zbatim buxheti i shpenzimeve kapitale per vitet 2018-2020 (nr.2350 prot, datë 26.03.2018 prot i ARRSH-së).
	-4,000,000	Shkresa MIE nr.15273/6 prot, date 24.12.2018 "Dërgohet per zbatim Akti Normativ Nr.2,date 19.12.2018" (nr.15273/6 prot, date 24.12.2018 prot ARRSH).
	-1,000,000	Propozuar dhe Rialokuar nga vete MIE, per planifikimin e fondit 1,000,000 leke per supervizorin e ruges se Arberit. Kjo procedure eshte realizuar nga MIE.
	<b>15,150,041,000</b>	<b>BUXHETI NE FUND TE VITIT 2018</b>
Financim i Huaj 230+231	7,345,000,000	Shkresa MIE nr.3238/8 prot, date 23.03.2018 "Dërgohet per zbatim buxheti i shpenzimeve kapitale per vitet 2018-2020 (nr.2350 prot, date 26.03.2018 prot i ARRSH-se).
	-750,000,000	Shkresa MIE nr.10560/10 prot, date 13.09.2018 "Dërgohet per zbatim Akti Normativ Nr.1, date 26.07.2018 (nr.7964 prot, date 14.09.2018 prot ARRSH).
	-256,900,000	Shkresa MIE nr.15273/6 prot, date 24.12.2018 "Dërgohet per zbatim Akti Normativ Nr.2,date 19.12.2018" (nr.15273/6 prot, date 24.12.2018 prot ARRSH).





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

	6,338,100,000	BUXHETI NE FUND TE VITIT 2018
--	---------------	-------------------------------

VITI 2019		LEKE
ARTIKULLI	SHUMA	KOMENTE
600	142,579,000	Shkresa MIE nr.15803/4 prot, date 17.01.2019 "Dergohet detajimi i buxhetit te vitit 2019-2021 per shpenzimet korente". Celja e buxhetit te vitit 2019-2021.
601	23,811,000	Shkresa MIE nr.15803/4 prot, date 17.01.2019 "Dergohet detajimi I buxhetit te vitit 2019-2021 per shpenzimet korente". Celja e buxhetit te vitit 2019-2021.
602	1,691,880,000	Shkresa MIE nr.2309/3 prot, date 12.03.2019 (nr.1735/5 prot, date 15.03.2019 prot ARRSH). Celja e buxhetit te vitit 2019-2021.
Financim i Brendshem 230+231	11,359,600,000	Shkresa MIE nr.761/13 prot, date 27.03.2019 (nr.1735/9 prot, date 29.03.2019 prot ARRSH). Celja e buxhetit te vitit 2019-2021.
Financim i Huaj 230+231	6,308,132,000	Shkresa MIE nr.761/13 prot, date 27.03.2019 (nr.1735/9 prot, date 29.03.2019 prot ARRSH). Celja e buxhetit te vitit 2019-2021.

#### *1.c) Realizimi i planit të buxhetit*

Në udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, neni 43 parashikon se, NA i njësisë së qeverisjes qendrore i paraqet NPA sa herë i kërkohet informacion lidhur me buxhetin, por jo më pak se 3 herë në vit lidhur me raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar për çdo program.

#### **Për vitin 2017**

Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas programit të miratuar, **nr. 04520, me emërtesë programi “Transporti Rrugor”**.

Sipas Ligjit Nr. 130/2016, datë 15.12.2016 “Për Buxhetin e vitit 2017” dhe shkresën e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës **nr. 1180 datë 27.02.2017** është miratuar buxheti për Transportin Rrugor për vitin 2017, në vlerë 9,927,781,000 lekë, pra 9,9 mld lekë.

Ndryshimet e fondeve buxhetore të realizuara me aktet normative dhe udhëzimet gjatë vitit 2017.

*Në 000/lekë*

4250	4- mujori	8 mujor	12- mujor
600	117,400	127,175	127,175



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

601	19,190	21,179	21,179
602	1,630,000	1,630,000	1,830,000
606			228
	<b>1,766,590</b>	<b>1,778,354</b>	<b>1,978,582</b>

*Burimi: Sektori i Financës, ARRSH*

Buxheti i miratuar për Transportin Rrugor për vitin 2017 së bashku me kërkesat paraqitet si më poshtë:

*Në 000/lekë*

Nr	Emërtimi	Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2017	Buxheti i miratuar për vitin 2017 në fund të 2017	Diferenca	Realizimi	Në %
1	Shpenzime personeli	117,400	127,175	9,775	116,260	91.40%
2	Sigurime Shoqërore	19,190	21,179	1,989	19,293	91%
3	Transferta per Buxh.Fam & Individ		228	228	228	100%
2	Mallra dhe shërbime	1,630,000	1,830,000	200,000	1,824,639	99.70%
3	Investimet kapitale	9,927,781	12,591,248	2,663,467	12,134,169	96%
	Transferime			0		
4	<b>Totali i Buxhetit të Shtetit</b>			0		
5	Investimi huaj	7,238,358	7,975,410	737,052		
	<b>TOTALI</b>					

*Burimi i të dhënave: ARSH.*

-Pra sikurse konstatohet Shpenzime personeli janë realizuar në masën 91,4 % ose 10,195 mijë lekë më pak.

-*Sigurime Shoqërore* janë realizuar në vlerën 19,293 mijë lekë pra 91% ose 1,886 mijë lekë më pak nga buxheti i miratuar në fund të vitit 2017.

-*Transferrat për buxhet* për familjarë dhe individë janë realizuar në masën 100% pra sa janë planifikuar.

-*Mallra dhe shërbime* janë realizuar në vlerën 1,824,639 mijë lekë pra 99,7 % e buxhetit të miratuar prej 1,830,000 lekë.

-Investimet Kapitale janë realizuar në vlerën 12,134,169 mijë lekë pra 96 % e buxhetit të miratuar prej 12,591,248 lekë.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të ARRSH-së, programimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2017 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Fatura të papaguara ne fund të 2017	%
----	-----------	------	------	-------------------------------------	---



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

1	Paga	127,175	116,260	0	91.4 %
2	Sigurime shoqërore	21,179	19,293	0	91%
3	Shpenzime operative	1,830,000	1,824,639	1,167,453	99.7 %
4	Punime civile	7,706,016	7,560,702	1,282,787	98%
5	Kosto Lokale	958,928	815,294	494,398	85%
6	TVSH	2,105,383	1,970,821		94%
7	Studime projektme	511,503	511,220	249,764	100%
8	Fondi i ndihmës				
	<b>Totali</b>				

Burimi i të dhënave: *ARRSH.*

Programi nr. 04520 me emërtimin “Transporti Rrugor” për zërin investime viti 2017

Në 000/lekë

Artikulli Kodi	Emri	Buxheti Plan 2017 Fillim të vitit	Buxheti rishikuar Plan 2017	Fakti Plan 2017	Diferenca Plan 2017
<b>230</b>	<b>Kapitale të Patrupëzuara</b>				
	(Studim projektme)	383,000	511,503	511,220	283
<b>231</b>	<b>Kapitale të Trupëzuara në total</b>				
	Ndërtime rrugësh	3,296,582	4,110,695	3,985,516	125,179
	Sistemin asfaltime	2,378,717	3,497,425	3,488,125	9,300
	Rrëshqitje	97,404	97,896	87,061	10,835
	Ndërtim urash				
	Sinjalistika Rrugore	368,291	491,827	490,612	1,214
	Garanci objektsh	700	0	0	0
	Vendime gjyqësore	150,000	304,533	304,533	0
	Leje mjedisore	0	0	0	0
	Shpronësime	400,000	400,000	399,991	9
	Supervision	70,000	61,935	57,350	4,585
	Kosto Lokale	712,000	958,930	815,294	143,634
	TVSH	1,800,000	2,105,383	1,970,821	134,562
	Implementi i sistemit të menaxhimit të trafikut(Vazhdimi) dhe instalimi i sensoreve pesh per aks	<b>50,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Blerje pajisje kompjuterike për ARRSH (Fond Injire)	<b>37,000</b>	<b>26,697</b>	<b>15,222</b>	<b>11,475</b>
	Qendra e Monitorimit dhe Kontrollit te Trafikut Rrugor	<b>70,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Shtese kati ne zyrat e Drejtorise Rajonit Jugor Gjirokaster	<b>8,087</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Blerje pajisjesh per akreditimin e Laboratorit te ARRSH-se.	<b>6,000</b>	<b>6,000</b>	<b>0</b>	<b>6,000</b>
	<b>FOND EMERGJENCE</b>	<b>100,000</b>	<b>18,426</b>	<b>8,423</b>	<b>10,002</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

<b>Totali</b>	<b>TOTALI I INVESTIMEVE</b>	<b>9,927,781</b>	<b>12,591,248</b>	<b>12,134,169</b>	<b>457,079</b>

*Burimi i të dhënave: ARSH.*

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme, si dhe nga konfirmimet e marra nga degët e thesarit, shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, u realizuan në masën 12,134,169,027 lekë pra 12,1 mld lekë ose e shprehur në përqindje 96 % e planit të buxhetit të vitit 2017. Për vitin 2017 fondet e planifikuara janë 12,591,248,000 lekë pra 12,5 mld lekë dhe kanë mbetur pa u financuar 457,078,978 lekë ose 457 mln lekë.

Në terma të përqindjes kjo vlerë monetare e pashpenzuar 4 % nga buxheti total nuk është e konsiderueshme, por e trajtuar në vlerë monetare është e konsiderueshme për buxhetin e shtetit dhe për përdorimin e kësaj vlere në entitete të tjera apo në zëra të tjerë shpenzues brenda ARSSH.

#### **Për vitin 2017**

Nga të dhënat e Formatit 8 dhe 9 “Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve” rezulton se:

-Grupi i produktit “Ndërtim Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2017 është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 96 % (ose 10.31 km) dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 97 % ose 4,794,783,000 lekë.

-Për zërin “Ndërtim rruge” është akorduar fond për kontratat në vazhdim.

Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2017 është realizuar rreth 99.7 % ndaj planit vjetor të vitit 2017 (ose 37.56 km), dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 100 % ose 3,825,102,000 lekë.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tepëve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B’ me dy korsi dhe A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim) janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2017.

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, sipas konfirmimeve të marra nga degët e thesarit u realizuan në masën 12,134,169,027 lekë, ose e shprehur në përqindje 96 % e planit të buxhetit të vitit 2017.

Nga të dhënat e Formatit 8 dhe 9 “Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve”, rezulton se:

Grupi i produktit “Ndërtim Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2017 është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 96 % (ose 10.31 km) dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 97 % ose 4,794,783,000 lekë.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tepëve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1’ me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2017 konkretisht:

#### **Për 12- Mujorin**



PLANIFIKUAR	FINANCUAR
A2 - 1.77 km	1.7 km ose 96 %
A2' - 2.99 km	2.76 km ose 92 %
B1' - 1.93 km	1.91 km ose 99 %
C2 - 3.98 km	3.94 km ose 99 %
C2' - 0.08 km	0.00 km ose 0 %

Për zërin “Ndërtim rruge” është akorduar fond për kontratat në vazhdim.

Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2017 është realizuar rreth 99.7 % ndaj planit vjetor të vitit 2017 (ose 37.56 km), dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 100 % ose 3,825,102,000 lekë.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tepëve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B' me dy korsi dhe A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2017 konkretisht:

#### **Për 12- Mujorin**

PLANIFIKUAR	FINANCUAR
C2 - 37.67 km	37.56 km ose 99.7 %

Edhe për zërin “Rikonstruksion rruge” është akorduar fond për kontratat në vazhdim.

Më poshtë po rendisim komentet tona mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për 12-mujorin e vitit 2017:

#### **Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2):**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 482,404,000 lekë (10 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 1.77 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti janë në vlerën 454,357,000 leke (9 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) ose (94 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi 1.7 km ose 96 % të planit për këtë tip rruge. Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishëm si:

- “Ndërtim By pass Plepa-Kavajë-Rrogzhinë “ nga Loti 7 deri në Lotin 11.
- “Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti1, (V.Arti të mëdha) dublimi”.
- “Vendosja e mbikalimeve për këmbësorë në aksin Plepa-Kavajë-Rrogzhinë”.

#### **Ndërtim rruge tip A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 2,483,145,000 lekë (50 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 2.99 km.



Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produkti është 2,390,091,000 lekë (48 % ndaj planit vjetor Grupi i produktit “Ndërtim Rruge ) ose 96 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge, dhe në sasi janë realizuar 2.76 km ose 92 % të planit për këtë tip rruge.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Ndërtim Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit - Rruga e Kavajës.
- Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan).
- Ndërtim rruga e Porto Romanos, Durrës Loti 1,
- Rikonstrukcion segmenti rrugor Kodër-Kamëz Tapizë.
- Ndërtim Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit - Shk Teknologjike pjesa e mbetur km 0.00-0.640.
- Plotësimi dhe përfundimi i objektit - Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës , Komuna e Parisit - Shkolla Teknologjike,pjesa e mbetur km 0.00-km0.640.
- Ndërtim nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë, Rrëshen, Thumanë.
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1, Loti 2, Loti 3.
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1, Loti 2.

### **Ndërtim rruge tip B1’ me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 404,581,000 lekë (8 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 1.93 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 398,613,000 lekë (8 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (99 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 1.91 km ose 99 % të planit të këtij tipi rruge.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

- Ndërtim rruga Lushnje-Berat loti 2+ shtesë punimesh, loti 3 + shtesë punimesh.
- Ndërtim i rrugës së Arbërit (Dalja e urës së Vashës Bulqizë) Loti 2( shtesë punimesh)
- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 1, Loti 2, Loti 3,
- Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti3.

### **Ndërtim rruge tip C2 dhe C2’ me dy korsi:**

Për **tipin e rrugës C2** janë planifikuar fonde në vlerën 1,564,855,000 lekë ose 32 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 3.98 km.



Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është 1,551,722,000 lekë (31 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (99 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 3.94 km ose 99 % të planit të këtij tipi rruge.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjerësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore -vazhdimi Loti 1, Loti 2.
- Ndërtim rruga Kanali i Cukës-Butrint Loti 1.
- Ndërtim rruga Mbi ngritja e Viroit dhe hyrje e qytetit Gjirokastër (vazhdimi).
- Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë.
- Masa inxhinierie në segmentin rrugor Buzuq-Corovodë.
- Ndërtim rrugët paralele superstrada Tiranë-Vorë krahu i Majtë (vazhdimi)+ shtesë kontratë
- Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1,
- Ndërtim mbrojtja nga lumi km 16+200 aksi rrugor Elbasan-Librazhd + shtesë punimesh.
- Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500 rruga e re Milot-Skuraj.

Për **tipin e rrugës C2'** janë planifikuar 1,200,000 lekë ose 0 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 0.08 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2' është 0 lekë (0. % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (0 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 0 km.

-Ndërtim i rrugëve sekondare Vidhas-Kombinati Metalurgjik (shtesë kontrate).

#### **Rikonstruksion rruge tip C2 me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 3,835,096,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) dhe në sasi 37.67 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 3,825,102,000 lekë ( 100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) ose (100 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 37.56 km ose 100 % kundrejt planit të këtij tipi rruge.

Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rruge me gjerësi deri 8.5 metra tip C2.

Janë në proces ndërtimi objekte të rëndësishme si:

- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë Loti 1+ (shtesë punimesh), Loti 2 + shtesë punimesh, Loti 3+ (shtesë punimesh).
- Sistemim asfaltim rruga Tri Urat-Leskovik+ shtesë punimesh.
- Përmirësimi i shtresave rrugore dhe i sinjalistikës segmenti rrugor Fushë - Kruj – Thumanë + shtesë punimesh.
- Sistemim asfaltim masa inxhinierie nëKm.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec
- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21.
- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim rruga Përmet – Këlcyrë Loti 3+ shtesë punimesh.



## KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

- Sistemim asfaltim Rruga Librazhd-Qafë Stude Loti 3 (shtesë punimesh).
- Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja me rrugën ekzistuese të objektit Sistemim Asfaltim Rruga Korçë - Ersekë, Loti 1.
- Sistemim Asfaltim rruga Korçë - Ersekë loti1+ shtesë punimesh.
- Sistemim Asfaltim Rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara-Sarandë) Loti 1+shtesë punimesh.

Grupi i shpenzimeve për Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, garanci objekti, leje mjedisore dhe ura, të tjera të detajuara paraqiten si më poshtë:

Në 000/ lekë

Nr	Emërtimi	Planifikuar për vitin 2017	Realizuar për vitin 2017	Diferenca	Realizimi në %
1	Vendime Gjyqësore	304,533	304,533	0	100
2	Shpronësime	400,000	399,991	-9	100
3	Blerje pajisje kompjuterike	26,697	15,222	-11,475	57
4	Blerje pajisjesh për akreditimine laboratorit të ARRSH-së	6,000	0	-6,000	0
5	Fond emergjence	18,426	8,423	-10,003	46
	<b>TOTALI</b>				

Shpenzimet kapitale për **TVSH dhe Kosto Lokale** së bashku janë planifikuar fonde në vlerën 3,064,311,086 lekë ose (24 % ndaj planit vjetor) dhe janë financuar për 12 mujorin e vitit 2017 si më poshtë:

Në 000/ lekë

Nr	Emërtimi	Planifikuar për vitin 2017	Realizuar për vitin 2017	Diferenca	Realizimi në %
1	Kosto Lokale	958,928	815,294	-143,634	85
2	TVSH e TD	2,105,383	1,970,821	-134,562	94
	<b>TOTALI</b>	<b>3,064,311</b>	<b>2,786,115</b>	<b>-278,196</b>	91

#### Financimi i Huaj

Buxheti i financimit të huaj për vitin 2017 është 7,975,410,000 lekë ose 7,9 mld lekë. Në 12 mujorin e vitit 2017 ky buxhet është financuar në vlerën 9,204,682,000 lekë pra 9,2 mld lekë ose 1,229 mld lekë më shumë se buxheti.

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh janë planifikuar 7.4 km dhe janë realizuar 6.2 km ose 84 % të planit total të çelur të këtij zëri.





Për sa më sipër po japim të detajuara shifrat mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për vitin 2017:

**- Ndërtim Rruge Tip A**

Për tipin e rrugës A janë planifikuar fonde të huaja në vlerën 4,234,292,000 lekë (4,2 mld lekë) dhe në sasi 0.7 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A është 5,538,662,000 lekë (5,5 mld lekë) ose 131% e planit. Në sasi janë realizuar 0.9 km ose 0,2 km më shumë se planifikim.

**- Ndërtim Rruge Tip B**

Për tipin e rrugës B janë planifikuar fonde në vlerën 3,289,703,000 lekë (3,28 mld lekë) dhe në sasi 5.4 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës B është 3,569,730,000 lekë (3,56 mld lekë) ose 109 % e planit. Në sasi janë realizuar 5.9 km ose 0,5 km më shumë se planifikimi.

**- Ndërtim Rruge Tip C**

Për tipin e rrugës C janë planifikuar fonde në vlerën 426,214,000 lekë (426 mln lekë) dhe në sasi 1.3 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C është 28,616,000 lekë (28,6 mln lekë) ose 7 % e planit. Në sasi janë realizuar 0.1 km.

**Ndërtim Rruge Tip Kategori të Ndryshme**

Për tipin e rrugës Kategori të Ndryshme janë planifikuar fonde në vlerën 1,007,200,000 lekë (1 mld lekë) dhe në sasi 179 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A është 67,674,000 lekë (67,67 mln lekë) ose 7 % e planit. Në sasi janë realizuar 12 km.

Detyrimet e prapambetura deri më 31.12.2017

*Në lekë*

Zërat e shpenzimeve	Art.	Shuma e pa paguar deri më 31.12.2017	Shuma e faturës së deklaruar
Investime të brendshme	231	1,288,047,497	1,288,047,497
Studim projektive	230	249,763,598	249,763,598
Vendime gjyqësore	231	425,451,125	425,451,125
Tvsh dhe kosto lokale	231	494,398,116	494,398,116
Totali		<b>2,457,660,336</b>	<b>2,457,660,336</b>

*Burimi i të dhënave: ARRSH.*

✓ **Për vitin 2018**

Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas programit të miratuar, nr. 04520, me emërtesë programi “Transporti Rrugor”.

Sipas Ligjit Nr. 109/2017, datë 30.11.2017 “Për Buxhetin e vitit 2018” dhe shkresës së Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3238/8 datë 23.03.2018 është miratuar buxheti për Transportin Rrugor për vitin 2018, në vlerë 15,150,041,000 lekë pra 15,15 mld lekë.

Ndryshimet e fondeve buxhetore të realizuara me aktet normative dhe udhëzimet gjatë vitit 2018.

*Në mije lekë*

4250	4- mujori	8 mujor	12- mujor
600	141,900	130,731	118,130



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

601	24,490	23,110	20,109
602	1,728,370	1,728,370	1,723,913
606		4,952	51,341
	<b>1,894,760</b>	<b>1,887,163</b>	<b>1,913,493</b>

*Burimi i të dhënave: ARRSH.*

*Buxheti i miratuar për Transportin Rrugor për vitin 2018 së bashku me kërkesat paraqitet si më poshtë:*

**Tabela .1**

*Në 000/lekë*

Nr	Emërtimi	Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2018	Buxheti i miratuar për vitin 2018 në fund të 2018	Realizimi	Në %
1	Shpenzime personeli	141,900	118,130	116,518	98.6 %
2	Sigurime Shoqërore	24,490	20,109	19,316	96 %
3	Transferta per Buxh.Fam & Individ		51,341	51,341	100%
2	Mallra dhe shërbime	1,728,370	1,723,913	1,714,917	99.5 %
3	Investimet kapitale	15,155,041	15,150,041	15,030,221	99 %
	Transferime				
4	<b>Totali i Buxhetit të Shtetit</b>				
5	Investimi huaj	7,345,000	6,338,100	<b>6,309,100</b>	<b>99.5%</b>
	<b>TOTALI</b>				

*Burimi i të dhënave: ARSH.*

-Pra sikurse konstatohet Shpenzime personeli janë realizuar në masën 98,6 % ose 1,612 mijë lekë më pak.

-*Sigurime Shoqërore* janë realizuar në vlerën 19,316 mijë lekë pra 96% ose 793 mijë lekë më pak nga buxheti i miratuar në fund të vitit 2018.

-*Transferrat për buxhet* për familjarë dhe individë janë realizuar në masën 100% , të cilat nuk kanë qenë planifikuar në PBA.

-*Mallra dhe shërbime* janë realizuar në vlerën 1,714,917 mijë lekë pra 99,5 % e buxhetit të miratuar prej 1,723,913 mijë lekë.

-Investimet Kapitale janë realizuar në vlerën 15,030,221 mijë lekë pra 99 % e buxhetit të miratuar prej 15,150,041 lekë, pra me një diferencë prej 119,820 mijë lekë.

-*Investimi i huaj* është realizuar në vlerën 6,309,100 mijë lekë ose 99,5 % e miratimit përfundimtar të buxhetit prej 6,338,100 mijë lekë.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të ARRSH-së, programimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Fatura të papaguara ne fund të 2018	%
1	Paga	118,130	116,518	0	98.6 %
2	Sigurime shoqërore	20,109	19,316	0	96 %
3	Shpenzime operative	1,723,913	1,714,917	765,978	99.5%
4	Punime civile	11,226,501	11,168,947	1,360,246	99.5%
5	Kosto Lokale	983,027	976,641	215,680	99%
6	TVSH	1,835,401	1,781,090	17,390	97%
7	Studime projektme	400,914	399,514	15,600	100%
8	Fondi i ndihmës				
	<b>Totali</b>				

Burimi i të dhënave: ARSH..

### Programi nr. 04520 me emërtimin “Transporti Rrugor” për zërin investime viti 2018

Në 000/lekë

Artikulli Kodi	Emri	Buxheti Plan 2018 Fillim të vitit	Buxheti rishikuar Plan 2018	Fakti Plan 2018	Diferenca Plan 2018
<b>230</b>	<b>Kapitale të Patrupëzuara</b>				
	(Studim projektme)	300,000	400,914	399,514	1,400
<b>231</b>	<b>Kapitale të Trupëzuara në total</b>				
	Ndërtime rrugësh	8,429,233	8,178,685	8,125,659	53,026
	Sistemin asfaltime	1,922,294	2,164,801	2,164,801	0
	Rrëshqitje	218,472	480,393	480,393	0
	Ndërtim urash	0	0	0	0
	Sinjalistika Rrugore	203,944	278,942	278,935	7
	Garanci objektesh	700	0	0	0
	Vendime gjyqësore	200,000	350,000	350,000	0
	Leje mjedisore	0	0	0	0
	Shpronësime	451,000	300,000	300,000	0
	Supervision	105,300	123,680	119,159	4,521
	Kosto Lokale	900,000	983,027	976,641	6,386
	TVSH	2,200,000	1,835,401	1,781,090	54,311
	Implementi i sistemit të menaxhimit të trafikut(Vazhdimi) dhe instalimi i sensoreve pesh per aks	25,000	25,000	24,972	28
	Blerje pajisje kompiuterike për ARRSH.	17,563	17,563	17,522	40
	Sistemi i menaxhimit te kontratave, inspektimi dhe raportimi	6,000	6,000	6,000	0
	Rikonstruksion i godines se ARRSH-se	40,000	100	0	0
	<b>Blerje pajisjesh per akreditimin e Laboratorit te ARRSH-se.</b>	5,535	5,535	5,535	100
	<b>Fond Emergjence</b>	<b>130,000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

<b>Totali</b>	<b>TOTALI I INVESTIMEVE</b>	<b>15,155,041</b>	<b>15,150,041</b>	<b>15,030,221</b>	<b>119,819</b>
---------------	-----------------------------	-------------------	-------------------	-------------------	----------------

*Burimi i të dhënave: ARSH.*

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme, si dhe nga konfirmimet e marra nga degët e thesarit, shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, u realizuan në masën 15,030,221 mijë lekë, ose e shprehur në përqindje 99 % e planit të buxhetit të vitit 2018.

Për vitin 2018 fondet e planifikuara të rishikuara janë 15,150,041 mijë lekë dhe kanë mbetur pa u financuar **119,820 mijë lekë.**

Në terma të përqindjes kjo vlerë monetare e pashpenzuar, 1% nga buxheti total nuk është e konsiderueshme, por e trajtuar në vlerë monetare është e konsiderueshme për buxhetin e shtetit dhe për përdorimin e kësaj vlere në entitete të tjera apo në zëra të tjerë shpenzues brenda ARRSH.

#### **Për vitin 2018.**

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, sipas konfirmimeve të marra nga degët e thesarit u realizuan në masën 15,030,221,396 lekë, ose e shprehur në përqindje 99 % e planit të buxhetit të vitit 2018.

Realizimi i detajuar për çdo objekt rrugor, jepet në informacionin përkatës “Mbi realizimin e Investimeve Rrugore” (bashkëlidhur).

Me buxhetin e vitit 2018 në ARRSH u mbështetën me fonde buxhetore të gjithë kontratat në vazhdim dhe u lidhën dhe kontrata të reja. Me buxhetin e vitit 2018 u financuan totalisht 26 objekte të zërit Ndërtim dhe Sistemim Rrugësh, 8 objekte të zërit Studim Projektme dhe 2 objekte të zërit Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore. Me buxhetin e vitit 2018 janë likuiduar të gjithë detyrimet e prapambetura të zërit Ndërtim e Sistemim rrugësh, TVSH & Kosto Lokale, Supervizion Punimesh. Janë likuiduar 78% e detyrimeve të zërit Studim Projektme dhe pjesa tjetër e detyrimeve është likuiduar deri në fund të vitit si dhe janë likuiduar 68 % e detyrimeve të zërit Vendime Gjyqësore.

Gjatë vitit 2018 ARRSH-ja ka raportuar çdo 3 muaj dhe sa herë është kërkuar nga MIE, detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi në ARRSH. Për minimizimin e këtyre detyrimeve, ARRSH-ja ka bërë kërkesa në MIE për mbështetjen me fonde buxhetore shtesë, përkatësisht shkresat nr.5871 prot, datë 04.07.2018 dhe nr.5871/1 prot, datë 12.10.2018 “Mbi nevojat e ARRSH-së, për fonde buxhetore shtesë për vitin 2018, për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitin 2017-2018”. Me rishikimin e buxhetit gjatë vitit 2018, ARRSH-ja nuk ka pasur shtesë fondesh buxhetore si për zërin investime ashtu dhe për zërin shpenzime koherente, por vetëm pakësim të tyre në vlerën 5 milion lekë për investimet (1 milion lekë për Institutin e Transportit dhe 4 milion lekë në Aktin Normativ nr.2, datë 19.12.2018), gjë e cila ka ndikuar në rritjen e këtyre detyrimeve.

ARRSH-ja me fondet që nuk mund të përdoren deri në fund të vitit 2018, ka dërguar në MIE Vendimin e Bordit të Menaxhimit të ARRSH-së nr.11, datë 02.11.2018, mbi rialokimin e fondeve të buxhetit të vitit 2018, me rialokimin e të cilave do të likuidoheshin detyrime të prapambetura në vlerën 1,373,843,385 lekë, rialokim i cili nuk u miratua nga MIE dhe MFE, dhe kjo ndikoi në rritjen e këtyre detyrimeve në fund të vitit 2018. Detyrimet në fund të vitit 2018



janë në vlerën 2,547,679,738 lekë për zërin investime dhe 765,977,778 lekë për kontrata të mirëmbajtjes.

Buxheti i ARRSH-së në vitin 2018 për shpenzime korente ishte në vlerën 1,723,913,338 lekë dhe është realizuar 1,714,917,292 lekë ose 99.5 % e planit të përgjithshëm. Me buxhetin e vitit 2018 janë mbështetur me financim si kontratat e vjetra ashtu edhe kontrata e reja të lidhura në vitin 2018. Buxheti i vitit 2018 për këtë zë ka qenë shumë herë më i vogël se nevojat reale që ka ARRSH-ja për fonde buxhetore, gjë e cila ka ndikuar direkt në krijimin e këtyre detyrimeve të prapambetura në vitin 2018, pasi të gjitha kontratat e lidhura në vitin 2016 në ARRSH dhe tre Drejtoritë Rajonale kanë përfunduar në vitin 2018.

Me rialokimet e realizuara gjatë vitit 2018, ARRSH-ja ka likuiduar dhe detyrime të prapambetura që u krijuan gjatë vitit buxhetor 2018.

Nga të dhënat “Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve” rezulton se:

Grupi i produktit “Ndërtim Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2018 është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 99.8 % (ose 13.16 km) dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 99.4 % ose 9,045,018,000 lekë.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tepëve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1’ me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2018 konkretisht:

Nr	Emërtimi i rrugës	Planifikuar për vitin 2018/ km	Realizuar për vitin 2018/km	Diferenca	Realizimi në %
1	A 2	0,41	0,41	0	100
2	A	0	0	0	
3	A2’	3,81	3,78	0,03	99
4	B1’	6,71	6,71	0	100
5	C2	2,26	2,26	0	100
6	C2’	0	0		

Për zërin “Ndërtim rruge” është akorduar fond për kontratat në vazhdim dhe për kontrata e reja që janë çelur me buxhetin e vitit 2018.

Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge” i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2018 është realizuar rreth 100 % ndaj planit vjetor të vitit 2018 (ose 13.16 km), dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 100 % ose 2,243,677,000 lekë.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.

Produktet e shprehur në terma sasiore (km) sipas tepëve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B’ me dy korsi dhe A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2018 konkretisht:

## Për 12- Mujorin

**Planifikuar**

**Financuar**



C2 - 26.45 km 26.45 km ose 100 %

Edhe për zërin “Rikonstruksion rruge” është akorduar fond për të gjithë kontratat në vazhdim. Më poshtë po japim të detajuara shifrat mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për 12-mujorin e vitit 2018:

**Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2):**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,066,519,000 lekë (11.7 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0.41 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 1,063,697,000 leke (11.69 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) ose (99.7 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi 0.41 km ose 100 % të planit për këtë tip rruge. Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishëm si:

- “Ndërtim By pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë “ nga Loti 8 deri në Lotin 11;
- “Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi;
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti1, (V.Arta të mëdha) dublimi”;
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi (shtese punimesh);
- Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore ne viaduktet e aksit Kukës-Morinë;
- Vendosja e mbikalimeve ne aksin rrugor Thumane - Milot dhe Kukës – Morinë.

**Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standardeve të Reja:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 569,000 lekë (0.06 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 0 leke (0 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”). Përfshihen në këtë grup rruge:

- Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3.

**Ndërtim rruge tip A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 4,304,386,000 lekë (46.7 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 3.81 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 4,253,599,000 lekë (46.6% ndaj planit vjetor Grupi i produktit “Ndërtim Rruge ) ose 98.8 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 3.78 km ose 99.2 % të planit për këtë tip rruge.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjerësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Ndërtim nyja lidhëse e rrugës Milot-Lezhë, Rrëshen, Thumanë;
- Përfundim i Punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit;



- Ndërtim rruga Unaza e re Tiranës (segmenti Komuna e Parisit - rruga e re Tiranë - Elbasan);
- Rikonstruksion segmenti rrugor Kodër-Kamëz Tapizë+ shtesë punimesh ;
- Plotësimi dhe përfundimi i objektit - Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës , Komuna e Parisit - Shkolla Teknologjike, pjesa e mbetur km 0.00-km0.640+ shtesë punimesh;
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1+ shtesë punimesh, Loti 2, Loti ;
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3;
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh.

### **Ndërtim rruge tip B1’ me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,757,513,000 lekë (19.3 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 6.71 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 1,757,413,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (19.3 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 6.71 km ose 100 % të planit të këtij tipi rruge.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 1+ shtesë punimesh;
- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6;
- Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti 3.

### **Ndërtim rruge tip C2 dhe C2’ me dy korsi:**

Për **tipin e rrugës C2** janë planifikuar fonde në vlerën 1,971,316,000 lekë ose 22 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 2.26 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është 1,970,309,000 lekë (21.6 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) ose (99.9 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 2.26 km ose 100 % të planit të këtij tipi rruge.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjerësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1;
- Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1+ shtesë punimesh;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore -vazhdimi Loti 1;
- Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë;
- Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500 rruga e re Milot-Skuraj;
- Përmirësim i sigurisë rrugore në aksin Kashar – Rinas.

### **Rikonstruksion rruge tip C2 me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 2,243,677,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) dhe në sasi 26.45 km.





Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 2,243,677,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) ose (100 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 26.45 km ose 100 % kundrejt planit të këtij tipi rruge.

Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rruge me gjërësi deri 8.5 metra tip C2.

Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si:

- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë Loti 1 (shtesë punimesh), Loti 3+ (shtesë punimesh);
- Sistemim asfaltim rruga Tri Urat-Leskovik shtesë punimesh;
- Përmirësimi i shtresave rrugore dhe i sinjalistikës segmenti rrugor Fushë - Kruj – Thumanë shtesë punimesh;
- Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec + shtesë punimesh;
- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21;
- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim rruga Përmet – Këlcyrë Loti 3+ shtesë punimesh;
- Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja me rrugën ekzistuese të objektit Sistemim Asfaltim Rruga Korçë - Ersekë, Loti 1;
- Sistemim asfaltim Rruga Librazhd-Qafë Stude Loti 3 (shtesë punimesh);
- Sistemim Asfaltim Rrugët lidhëse me bregdetin (Llogara-Sarandë) Loti 1+shtesë punimesh.

#### **Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore.**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 263,301,717 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore) dhe në sasi 204 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 263,301,717 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore ) ose (100 % ndaj planifikimit për këtë tip rruge) dhe në sasi janë realizuar 204 km ose 100 % kundrejt planit të këtij tipi rruge.

Përfshihen objektet:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Qendror, Loti 2;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;
- Ndërtim nënkalmi hekurudhor Hd=10 m në unazën Librazhd.

Grupi i shpenzimeve për **Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, garanci objekti, leje mjedisore dhe ura, të tjera, të detajuara paraqiten në Tabelën :**

*Në 000/lekë*

Nr	Emërtimi	Planifikuar për vitin 2018	Realizuar për vitin 2018	Diferenca	Realizimi në %
1	Vendime Gjyqësore	350,000	350,000	0	100





## KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

2	Shpronësime	300,000	300,000	0	100
3	Blerje pajisje kompjuterike	17,563	17,522	-41	99
4	Blerje pajisjesh për akreditimine laboratorit të ARRSH-së	5,535	5,535	0	100
5	Implementimi i sistemit të menaxhimit të trafikut	25,000	24,972	-28	100
6	Sistemi i menaxhimit të kontratave , inspektimi dhe raportimit	6,000	6,000	0	100
7	Kosto lokale	983,027	976,641	6,386	99
8	TVSH e TD	1,835,401	1,781,090	-54,311	97
	<b>TOTALI</b>				

### **FINANCIMI I HUAJ**

Buxheti i financimit të huaj për vitin 2018 është 6,338,100,000 lekë ( 6,33 mld lekë) .Në 12 Mujorin e vitit 2018 ky buxhet është financuar në vlerën 6,338,100,000 lekë ose 100 % e planit. Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C edhe Kategori të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 4,648 km dhe janë realizuar 2,057.7 km ose 44 % krahasuar me planifikimin. Më poshtë po japim të detajuara shifrat mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për vitin 2018:

### **Ndërtim Rruge Tip B**

Për **tipin e rrugës B** janë planifikuar fonde në vlerën 5,210,024,000 lekë dhe në sasi 112 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës B për 8 Mujorin e Parë është 3,278,320,000 lekë ose 62.9 % e planit.

Në sasi janë realizuar 89 km të këtij tipi rruge.

### **Ndërtim Rruge Tip C**

Për **tipin e rrugës C** janë planifikuar fonde në vlerën 267,707,000 lekë dhenë sasi 16km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C është 205,217,000 lekë ose 76.7 % e planit.

Në sasi janë realizuar 12 km të këtij tipi rruge.

### **Ndërtim Rruge Tip Kategori të Ndryshme**

Për **tipin e rrugës Kategori të Ndryshme** janë planifikuar fonde në vlerën 4,431,975,000 lekë dhe në sasi 4,519 km. Realizimi i shpenzimeve është 2,825,563,000 lekë ose 63.8 % e planit.

Në sasi janë realizuar 1,957 km të këtyre kontratave.

Detyrimet e prapambetura deri më 31.12.2018:

### *Në lekë*

Zërat e shpenzimeve	Art.	Shuma e pa paguar deri më 31.12.2018	Shuma e faturës së deklaruar
Investime të brendshme	231	1,360,245,777	1,360,245,777
Studim projektive	230	15,600,000	15,600,000
Vendime gjyqësore	231	938,763,746	938,763,746
Tvsh dhe kosto lokale	231	233,070,215	233,070,215



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Totali		2,547,679,738	2,547,679,738
--------	--	---------------	---------------

Burimi i të dhënave: ARRSH.

#### ➤ **VITI 2019**

Në zbatim të Ligjit nr.99, datë 02.12.2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, Ministria e Transportit dhe Energjisë me shkresën nr.761/13 prot, datë 27.03.2019 “Dërgohet miratimi i buxhetit të investimeve kapitale, për vitet 2019-2021”, ka dërguar për zbatim buxhetin e ARRSH-së për vitet 2019-2021”.

Raportet e Monitorimit për 4- mujorin e parë të vitit 2019 dhe performanca e produkteve të programit “**Transporti rrugor**” paraqiten si më poshtë:

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, sipas konfirmimeve të marra nga degët e thesarit u realizuan në masën 590,376,135 lekë, ose e shprehur në përqindje 5 % e planit të buxhetit të vitit 2019.

Për 4 mujorin e parë të vitit 2019, fondet e planifikuara janë 11,359,600,000 lekë pra 11,3 mld lekë dhe realizimi për 4 mujorin e parë të vitit 2019 është 590,376,135 lekë ose 5 % .

Me buxhetin e vitit 2019 në ARRSH u mbështetën me fonde buxhetore të gjithë kontratat në vazhdim dhe u parashikuan fonde buxhetore dhe për hapjen e kontratave të reja.

Detyrimet e prapambetura në fund të vitit 2018 në ARRSH ishin në vlerën 2,547,679,738 lekë për zërin investime dhe 765,977,778 lekë për kontrata e mirëmbajtjes.

Me buxhetin e vitit 2019, Autoriteti Rrugor Shqiptar ka parashikuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 2,172,150,661 lekë ose 85 % të zërit investime dhe 386,090,377 lekë ose 50% të detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes.

Me buxhetin e vitit 2019 është parashikuar likuidimi i detyrimeve të investimeve si më poshtë:

EMERTIMI	Detyrime e prapambetura deri në 31.12.2018	Parashikuar për likuidim gjatë vitit 2019	Mbetet pa u likuiduar nga buxheti i 2019
Ndërtim e Sistemim Rruge	1,228,623,005	1,228,623,005	-
Sinjalistikë rrugore	126,769,530	126,769,530	-
Supervizion Punimesh	4,853,242	4,853,242	-
Studim Projektim	15,600,000	15,600,000	-
Vendime Gjyqësore	938,763,746	563,234,669	375,529,077
TVSH & Kosto Lokale	233,070,215	233,070,215	-
<b>TOTALI</b>	<b>2,547,679,738</b>	<b>2,172,150,661</b>	<b>375,529,077</b>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Siç shikohet dhe nga tabela, me buxhetin e vitit 2019 është parashikuar likuidimi 100% i të gjithë zërave të investimeve, përveç zërit Vendime Gjyqësore, i cili për mungesë fondesh buxhetore është parashikuar likuidimi i 60 % të vlerës së tyre .

Detyrimet e prapambetura të kontratave të mirëmbajtjes në fund të vitit 2018 janë në vlerën 765,977,778 lekë dhe me buxhetin e vitit 2019 është parashikuar likuidimi i detyrimeve të prapambetura në vlerën 389,090,377 lekë ose 50 % e tyre dhe mbeten pa u likuiduar detyrime në vlerën 379,844,976 lekë.

Me buxhetin e vitit 2019 është parashikuar likuidimi i detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes në ARRSH si më poshtë:

EMERTIMI I OBJEKTIT	Detyrimet prapambetura 31.12.2018	e deri	Parashikuar per Likuidim me buxhetin e vitit 2019	Mbetje pas Likuidimit te vitit 2019
<b>TOTALI GJITHSEJ</b>	<b>765,935,323</b>		<b>386,090,377</b>	<b>379,844,946</b>
ARRSH	214,914,329		118,526,535	96,387,794
D.R Qendror Tiranë	162,781,767		123,325,301	39,456,466
D.R. Verior Shkodër	388,239,227		144,238,541	244,000,686
D.R.Jugor Gjirokastrë	1,269,399		1,269,399	-

Në tre Drejtoritë Rajonale me buxhetin e vitit 2019 u parashikua likuidimi i të gjithë detyrimeve të prapambetura të vitit 2017.

Buxheti i ARRSH-së në vitin 2019 për shpenzime korente është në vlerën 1,691,880,000 lekë i përbërë nga 227,000,000 lekë për shpenzime administrative dhe 1,464,880,000 lekë për kontrata të mirëmbajtjes. Me fondet buxhetore të kontratave të mirëmbajtjes janë mbështetur me financim të gjitha kontratat e lidhura në vitin 2018 në tre Drejtoritë Rajonale dhe në ARRSH Qendër. Planifikimi i fondeve për këto kontrata është bërë që deri në fund të vitit 2019 të mos mbetet asnjë detyrim të prapambetur. Me fondet e tjera që mbeten nga ky planifikim u parashikua likuidimi i detyrimeve të prapambetura deri 31.12.2018.

Deri 30.04.2019 buxheti i llog.602 është realizuar në vlerën 537,020,562 lekë ose 32% e tij.

Buxheti në vlerë 1,464,880,000 lekë për kontrata e mirëmbajtjes është financuar deri 30.04.2019 në vlerën 502,756,190 lekë ose 34 % e buxhetit të kontratave të mirëmbajtjes. Deri 30.04.2019 janë likuiduar detyrimet e prapambetura nga viti 2018, në vlerën 271,281,452 lekë.

Nga të dhënat “Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve” rezulton se:

Grupi i produktit “Ndërtim Rruge” i shprehur në sasi (km) për 4 mujorin e parë të vitit 2019 është parashikuar 12.2 km dhe është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 0 % dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 0 lekë.



Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tepëve të ndërtimit të rrugëve (tip A2 me katër korsi, A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim, B1' me dy korsi, C2 dhe me dy korsi), janë planifikuar për 4 mujoirin e parë të vitit 2019 konkretisht:

#### **Për 4- Mujoirin I**

##### **PLANIFIKUAR**

##### **FINANCUAR**

A2 - 0.17 km 0 km

A2 me standardet e reja - 0.43 km.

A2' - 4.48 km

B1' - 6.13 km

C2 - 0.63 km

Për zërin "Ndërtim rruge" janë planifikuar fonde buxhetore për kontratat në vazhdim dhe për kontrata e reja që janë çelur me buxhetin e vitit 2018.

Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge" i shprehur në sasi (km) për 4 mujoirin e parë të vitit 2019 është parashikuar 2.1 km dhe është realizuar 0% i shpenzimeve faktike për këtë produkt.

Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.

Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tepëve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B' me dy korsi dhe A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim), janë planifikuar për 4 mujoirin e parë të vitit 2019 konkretisht:

#### **Për 4- Mujoirin I**

##### **PLANIFIKUAR**

C2 - 2.1 km

Edhe për zërin "Rikonstruksion rruge" është akorduar fond për të gjithë kontratat në vazhdim.

Më poshtë po rendisim komentet tona mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për 4-mujoirin e parë të vitit 2019:

#### **Ndërtim rruge tip A2 me katër korsi (2x2):**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 349,736,000 lekë (5% ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit "Ndërtim Rruge") dhe në sasi 0.17 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 0 lekë.

Përfshihen në këtë grup rrugë me katër korsi dhe gjerësi 20-25 m, me disa objekte të rëndësishëm si:

- "Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi;
- Ndërtim rruga Kukës-Morinë Loti2 (dy viadukte) dublimi (shtese punimesh);
- Plotësim, rakordim, masa mbrojtëse dhe siguri rrugore në viaduktet e aksit Kukës-Morinë;



-Vendosja e mbikalimeve ne aksin rrugor Thumane - Milot dhe Kukes – Morinë.

**Ndërtim rruge tip A me katër korsi (2x2) sipas Standarteve të Reja:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 1,190,095,000 lekë (17 % ndaj planit total vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”) dhe në sasi 0.43 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit janë në vlerën 0 leke (0 % ndaj planit vjetor “Grupi i produktit “Ndërtim Rruge”). Përfshihen në këtë grup rruge:

-Rehabilitim i segmentit rrugore mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3.

**Ndërtim rruge tip A2’ 2x2 me trotuare dhe ndriçim:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 2,157,287,000 lekë (31 % ndaj planit të përgjithshëm vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 4.84 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 0 lekë.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me katër korsi dhe gjërësi që varion nga 24-25 m, me disa objekte të rëndësishëm që janë në proces si:

- Përfundim i Punimeve të mbetura dhe plotësimi me rrugë dytësore nyja e Milotit;
- Ndërtim i unazës së Jashtme Tiranë pjesa verilindore (seg Kth Saukut-Bregu i lumit) Loti 1, Loti 2, Loti 3 ;
- Rikualifikim i akseve rrugore Unaza Lindore Loti 2 , Loti 3;
- Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Shkodër, Loti 1 + shtesë punimesh dhe Loti 2.

**Ndërtim rruge tip B1’ me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 2,191,676,000 lekë (31 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 6.13 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 0 lekë.

Në këtë produkt janë përfshirë kryesisht tip rruge me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 10-17 m, duke përmendur disa objekte të rëndësishme në të cilat punohet me ritme të parashikuara :

- Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4, Loti 5, Loti 6;
- Ndërtim rruga Milot - F. Krujë (dublimi i superstradës) Loti 3.

**Ndërtim rruge tip C2 dhe C2’ me dy korsi:**

Për tipin e rrugës C2 janë planifikuar fonde në vlerën 772,481,000 lekë ose 11 % ndaj planit vjetor (Grupi i produktit “Ndërtim Rruge) dhe në sasi 0.63 km.

Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C2 është 0 lekë.

Janë përfshirë kryesisht tip rruge C2 me dy korsi dhe gjërësi që varion nga 7.5-10 m.

Po punohet normalisht në objektet që janë në proces:

- Ndërtim By Pass Tepelenë Loti 1;
- Ndërtim i aksit Skrapar-Përmet Loti 1+ shtesë punimesh;
- Rikonstruksioni aksit rrugor ura e Gajdarit hyrja Sarandë;
- Ndërtim mure mbajtës dhe pritës në segmentin rrugor Kuben – Vasije.



### **Rikonstruksion rruge tip C2 me dy korsi:**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 272,296,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge) dhe në sasi 2.1 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 0 lekë ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit “Rikonstruksion Rruge).

Përfshihen kryesisht (Sistemim Asfaltim) rruge me gjërësi deri 8.5 metra tip C2.

Janë në proces ndërtimi disa objekte të rëndësishme si:

- Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, në rrugën Qafë Thanë Lin-Pogradec + shtesë punimesh;
- Sistemim asfaltim masa inxhinierike ne Km.21+050, ne rrugen Qafe Thane Lin-Pogradec+ Shtesë punimesh.
- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21;
- Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Elbasan- Banjë, Loti 3+ shtesë punimesh.

### **Sinjalistikë dhe Siguri Rrugore.**

Për këtë grup produkti janë planifikuar fonde në vlerë 336,233,000 lekë (100 % ndaj planit vjetor ( Grupi i produktit Sinjalistikë rrugore) dhe në sasi 251.74 km.

Realizimi i shpenzimeve të këtij grup produktit është 0 lekë ndaj planit vjetor.

Përfshihen objektet:

- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Verior, Loti 1;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore ne akset e Rajonit Qendror, Loti 2;
- Përmirësimi rifreskimi sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore në akset e Rajonit Jugor, Loti 3;
- Punime ndërtimi për eliminimin e pikave të zeza në rrugë ( bashkëfinancim IPA 2013, Siguria rrugore).

Grupi i shpenzimeve për **Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, garanci objekti, ura, të tjera i** detajuar paraqiten si më poshtë:

### **PLANIFIKUAR**

- a) Vendime gjyqësore 563,234,669 lekë
- b) Shpronësime 300,000,000 lekë
- c) Blerje pajisje kompjuterike për ARRSH,
- d) planifikuar 5,000,000 lekë
- e) Implementim i sistemit të menaxhimit të trafikut (Vazhdimi) dhe instalimi i sensorëve pesh
- f) për aks planifikuar 10,000,000 lekë.
- g) Sistemi i menaxhimit te kontratave, inspektimi dhe raportimi, planifikuar 9,576,000 lekë.



- h) Rikonstruksion godine (ARRSH dhe tre Drejtoritë Rajonale dhe blerje pajisje zyre) planifikuar fonde në vlerën 46,726,000 lekë.
- i) Shpenzimet kapitale për **TVSH dhe Kosto Lokale** së bashku janë planifikuar fonde në vlerën 2,900,000,000 lekë ose (25.5 % ndaj planit vjetor) dhe janë financuar për 4 mujorin e parë të vitit 2019 si më poshtë:
- |              |                    |                      |                |
|--------------|--------------------|----------------------|----------------|
| Kosto Lokale | 900,000,000 lekë   | 154,266,087 lekë ose | 17 % e planit  |
| TVSH e T.D   | 2,000,000,000 lekë | 436,110,048 lekë ose | 22 % e planit. |

### **FINANCIMI I HUAJ**

Buxheti i financimit të huaj për vitin 2019 është 6,308,132,000 lekë. Në 4 Mujorin e parë të vitit 2019 ky buxhet është financuar në vlerën 2,109,059,000 lekë ose 33.4 % e planit.

Në sasi në zërin ndërtim rrugësh Kategoria B, C edhe Kategori të ndryshme (Mirëmbajtja) janë planifikuar 6,252 km dhe janë realizuar 59 km.

Më poshtë po rendisim komentet tona mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për vitin 2019:

#### **Ndërtim Rruge Tip B**

Për **tipin e rrugës B** janë planifikuar fonde në vlerën 3,972,549,000 lekë dhe në sasi 43 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës B për 4 Mujorin e Parë është 1,726,354,000 lekë ose 43 % e planit.

Në sasi janë realizuar 8 km të këtij tipi rruge.

#### **Ndërtim Rruge Tip C**

Për **tipin e rrugës C** janë planifikuar fonde në vlerën 574,130,000 lekë dhenë sasi 14km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës C është 227,807,000 lekë ose 40% e planit.

Në sasi janë realizuar 1 km të këtij tipi rruge.

#### **Ndërtim Rruge Tip Kategori të Ndryshme**

Për **tipin e rrugës Kategori të Ndryshme** janë planifikuar fonde në vlerën 1,761,453,000 lekë dhe në sasi 6,195 km. Realizimi i shpenzimeve është 154,898,000 lekë ose 9 % e planit.

Në sasi janë realizuar 50 km të këtyre kontratave.

Nga auditimi i ushtruar në ARRSH , në Drejtorinë e Planifikimit të Buxhetit të Financës në në përputhje me aktet normative, ligji mbi zbatimin e buxhetit dhe korrespondencave shkresore me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, rezulton se Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit të Financës është përgjegjëse për çdo çështje që lidhet me planifikimin e buxhetit, monitorimin mujor dhe 4/mujor, rishikimin e kërkesave kundrejt burimeve me qëllim rialokimin e fondeve ose kërkimi i fondeve shtesë nëse do të jetë e nevojshme, për sigurimin e realizimit të duhur të aktiviteteve në raportimin periodik në MIE mbi zbatimin dhe gjendjen e planit të buxhetit. Kjo drejtori ka si qëllim planifikimin dhe menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të shpenzimeve publike si dhe përgatit materialin përmbledhës mbi detyrimet e prapambetura të krijuara në ARRSH.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

➤ **Ecuria e detyrimeve të prapambetura dhe likuidimi i tyre për periudhën në auditim.**

Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës është një nga pesë drejtoritë kryesore të ARRSH-së. Ajo ka në përbërje të saj dy sektorë:

- Sektori i Planifikimit të Buxhetit
- Sektori i Financës SF

Detyrat e Drejtorisë së Financës ndahen në:

- Procedura të Kontabilitetit;
- Procedura të borxhit;
- Ndjekja e zërave të shpenzimeve operative.
- Hartimi i menaxhimit të riskut për Drejtorinë.

Nisur nga rregullorja e Brendshme e ARRSH-së-së, Sektori i Planifikimit të buxhetit (SPB) përgatit materialin përmbledhës për detyrimet e prapambetura të krijuara në ARRSH.

Nga verifikimi dhe auditimi i dokumentacionit në lidhje me borxhin dhe detyrimet e krijuara rishtas , për periudhën në auditim, u konstatua se detyrime të prapambetura të deklaruara nga ARRSH, për një periudhë 5 vjeçare pra 2013-2018 janë në tabelën në vijim :

**Tabela 1.**

NR	EMERTIMI	NE FUND TE VITIT 2013	NE FUND TE VITIT 2014	NE FUND TE VITIT 2015	NE FUND TE VITIT 2016	NE FUND TE VITIT 2017	NE FUND TE VITI 2018
<b>I</b>	<b>INVESTIME</b>	<b>14,184,713,163</b>	<b>0</b>	<b>961,282,724</b>	<b>2,366,479,842</b>	<b>2,457,660,336</b>	<b>2,547,679,738</b>
1	Ndertim e Sistemim Rruge	11,407,990,640	0	48,751,506	1,095,696,379	1,282,787,305	1,228,623,005
2	Sinjalistikë rrugore	-	0		174,543,619	-	126,769,530
3	Supervizion Punimesh	33,632,825	0	314,305	2,593,216	5,260,192	4,853,242
4	Studim Projektim	410,570,411	0	8,522,214	148,945,132	249,763,598	15,600,000
5	Vendime Gjyqesore	-	0		282,790,401	425,451,125	938,763,746
6	TVSH & Kosto Lokale	1,027,060,762	0	88,408,243	346,132,574	494,398,116	233,070,215
7	Shpronetime	1,305,458,525	0	815,286,456	315,778,521		
<b>II</b>	<b>MIREMBAJTJE 602</b>	<b>770,378,023</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>607,642,536</b>	<b>1,167,453,159</b>	<b>765,977,778</b>
1	ARRSH Qender	22,265,046	0			154,316,082	213,687,385
2	D.R Qendror Tiranë	8,630,460	0		229,246,291	374,685,464	162,781,767
3	D.R.Verior Shkodër	188,223,952	0		305,876,190	577,094,220	388,239,227
4	D.R.Jugor Gjirokastër	6,182,517	0		72,520,055	61,357,393	1,269,399






## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

	TOTAL	14,955,091,186	0	961,282,724	2,974,122,378	3,625,113,495	3,313,657,516
--	-------	----------------	---	-------------	---------------	---------------	---------------

E japim edhe në mënyrë grafike:



Pra sikurse konstatohet në llogarinë “Investime “, në fund të vitit 2013, vlera e detyrimeve për tu likuiduar nga ARSH, për punime të deklaruara dhe përfunduara ka qenë 14,1 mld lekë, ku pjesën më të madhe ose rreth 80 % kanë qenë detyrime që i përkasin Ndërtim e Sistemim Rruge. Nga dokumentet e vëna në dispozicion rezulton se borxhi i mbartur nga viti 2013 është evidentuar dhe ka vazhduar për t’u likuiduar gjatë viti 2014 dhe 2015 me buxhet të veçantë, mbështetur në Udhëzim nr. 5, datë 27/02/2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Për vitin 2014 nuk ka pasur detyrime të reja të krijuara në zërin investime, për faktin se në këtë vit nuk ka pasur procedura të reja investimi.

Në datën 31.12.2015 detyrimet për investime të krijuara rishtazi në këtë vit kapin vlerën e **961 mln lekë**, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2016.

Në datën 31.12.2016 detyrimet për investime të krijuara rishtazi në këtë vit kapin vlerën e **2,366 mld lekë**, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2017.

Në datën 31.12.2017 detyrimet për investime të krijuara rishtazi në këtë vit kapin vlerën e **2,457 mld lekë**, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2018.

Në datën 31.12.2018 detyrimet për investime të krijuara rishtazi në këtë vit kapin vlerën e **2,547 mld lekë**, të cilat janë likuiduar në **vlerën 1,118 mld lekë** deri më 30.06.2019.

Për sa i përket llogarisë 602 e cila konsiston në Kontrata mirëmbajtje për tre drejtoritë rajonale Tiranë, Shkodër , Gjirokastrë , si dhe ARSSH Qendër për periudhën në auditim detyrime të mbartura nga viti 2016 në vitin 2017 janë 271,233,346 lekë dhe të krijuara rishtas gjatë vitit 2017




## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

në vlerën 896,219,813lekë, duke shkuar në total në fund të vitit 2017 në vlerën 1,167,453,159 lekë. Pra nuk ka një planifikim fondesh dhe menaxhim korrekt të kësaj llogarie nga drejtoritë rajonale në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Buxhetit në ARRSH.

E dhënë grafiksht si më poshtë:



Për periudhën në auditim e ndarë përkatësisht në vite, detyrime të prapambetura deri në 31.12.2017 janë:

**Tabela nr.2**

**2017**

Nr	Emërtimi I Objektivit	Viti 2016	6 mujori/Viti 2017	1 korrik-30 shtator	01.10.2017-31.12.2017	6-mujori i II/ 2017	Totali 31.12.2017
	Investime (230+231)						
1	Ndërtim e sistemim rruge	0	0	145,689,485	1,137,097,820	1,282,787,305	1,282,787,305
2	supervizion			1,134,546	4,125,646	5,260,192	5,260,192
3	Studim Projektim			11,040,066	238,723,532	249,763,598	249,763,598
4	Tvsh e Kosto lokale			109,020,298	385,377,818	494,398,116	494,398,116
5	Vendime Gjyqësore	38,383,615	146,886,346	48,238,037	191,943,127	240,181,164	425,451,125
	<b>Totali</b>	<b>38,383,615</b>	<b>146,886,346</b>	<b>315,122,432</b>	<b>1,957,267,943</b>	<b>2,272,390,375</b>	<b>2,457,660,336</b>
	<b>MIREMBAJTJE 602(Totali)</b>					<b>1,167,453,159</b>	
1	ARRSH Qender					154,316,082	
2	D.R Qendror Tiranë					374,685,464	
3	D.R. Verior Shkodër					577,094,220	
4	D.R.Jugor Gjirokastrë						




## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

					61,357,393	
<b>Totali</b>	<b>38,383,615</b>	<b>146,886,346</b>	<b>315,122,432</b>	<b>1,957,267,943</b>	<b>1,167,453,159</b>	<b>3,625,113,495</b>

E dhënë grafikisht, detyrimet dhe pesha specifike që zë secili nga zërat në llogarinë investime :



Pra sikurse vërehet në tabelën e mësipërme detyrimet në fund të vitit 2017 janë në total **3,625,113,495 lekë**, të cilat përbëhen nga detyrimet për investime (Llogaria 230+231) si dhe Detyrimet për kontratat e mirëmbajtës për katër drejtoritë (llogaria 602). Të detajuara po I shpjegojmë në vijim :

Detyrime në total të krijuara gjatë vitit 2017 për llogarinë Investime janë në vlerën **2,457,660,336 lekë** dhe për llogarinë Kontrata Mirëmbajtje janë **1,167,453,159 lekë**.

Detyrimet e llogarisë *Investime* përbëhen nga :

1-Detyrimi për *Ndërtim dhe sistemim rruge*, i përbërë si vlerë nga detyrimet e 18 subjekteve, deri më 31.12.2017 kap vlerën **1,282,787,305 lekë, ose 52 % e vlerës totale të detyrimeve për investime (230+231) të ARRSH-së**, dhe krijuar kryesisht në tremujorin e fundit të vitit 2017. Vlerën më të lartë për t'u likuiduar nga ARRSH e ka subjekti G.. në shumën 537,881,723 lekë.

2-Supervizion që përfshin 10 subjekte në vlerën **5,260,192 lekë** , krijuar kryesisht në tremujorin e fundit të vitit 2017. Vlerën më të lartë për tu likuiduar i përket subjektit E.. në shumën 1,465,784 lekë.

3- Studim Projektim në vlerën **249,763,598 lekë** , krijuar edhe ky në tremujorin e fundit të vitit 2017.

4-Tvsh e Kosto lokale u përket 6 objekteve në vlerën totale **494,398,116**, vlerë kjo për tu paguar nga ARRSH, si rezultat i investimeve të huaja .Vlerën më të lartë e kanë objektet :



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

-TVSH e ndërtimit të rrugës Qukë- Qafë Pllocë-Loti 2 në shumën 273,132,281 lekë si dhe TVSH për të njëjtën rrugë , Loti 3 në vlerën 162,587,673 lekë. Pra në total TVSH për këtë aks rrugor është 435,719,954 lekë ose e thënë ndryshe 89 % e vlerës totale të TVSH-së që ka ARRSH borxh deri më 31.12.2017.

5-Vendime Gjyqësore në vlerën **425,451,125 lekë** ose 17,3 % e borxhit total, nga të cilat **38,3 mln** lekë janë borxh i mbartur nga viti 2016, dhe vlera prej **387,067,510 lekë** borxh i krijuar në vitin 2017.


\*Përsa i përket llogarisë 602 (Zbatimi i kontratave dhe mirëmbajtja) detyrime të prapambetura në fund të vitit 2017 së bashku me detyrime të mbartura nga vitit 2016, janë në vlerën 1,167,453,159 lekë (**pra rreth 1,16 mld**) ku rreth 154 mln i përkasin ARSH/Qendër; 374,6 mln –Drejtoria e Tiranës, 577 mln –DR.Verior Shkodër; 61 mln –Dr Jugore Gjirokastrë. Të detajuara jepen në tabelën në vijim:

**Tabela nr.3**

Në lekë

Emërtimi i projektit	Viti 2016	1 Janar-30 Shtator	01 .10.2017-31.12.2017	TOTALI 31.12.2017
ARRSH	-	32,889,033	121,427,049	154,316,082
D.R Qendror Tiranë	38,100,256	180,466,773	156,118,435	374,685,464
D.R.Verior Shkodër	233,133,090	184,288,498	159,672,632	577,094,220
D.R.Jugor Gjirokastrë	-	6,744,516	54,612,877	61,357,393
<b>Totali</b>	<b>271,233,346</b>	<b>404,388,820</b>	<b>491,830,993</b>	<b>1,167,453,159</b>

E dhënë grafiksht, kjo situatë paraqitet:





Këto detyrime janë të mbartura nga vitet 2015-2016 dhe nuk janë likuiduar edhe gjatë vitit 2017 duke u kthyer në borxh real dhe dukë rënduar buxhetin e vitit pasardhës. Peshën më të madhe të këtij borxhi e ka Dr-Veriore Shkodër në vlerën 577 mln lekë ose 50% të borxhit total të llogarisë 602.

**Detyrime të krijuara gjatë vitit 2018 dhe gjendja e tyre në fund të vitit.**


**Tabela. Nr.4**

Nr	Emërtimi i Objektivit	Viti 2017	31.12.2018	Totali 31.12.2018
1	Ndërtim e sistemim rruge	0	1,228,623,005	1,228,623,005
2	Sinjalistikë Rrugore		126,769,530	126,769,530
3	Supervizion		4,853,242	4,853,242
4	Studim Projektim		15,600,000	15,600,000
5	Tvsh e Kosto lokale		233,070,215	233,070,215
6	Vendime Gjyqësore	95,284,856	843,478,890	938,763,746
	<b>Totali</b>	<b>95,284,856</b>	<b>2,452,394,882</b>	<b>2,547,679,738</b>
	<b>MIRËMBAJTJE 602</b>		<b>767,201,559</b>	
1	ARRSH Qender		214,914,329	
2	D.R Qendror Tiranë		162,781,767	
3	D.R. Verior Shkodër		388,236,064	
4	D.R.Jugor Gjirokastrë		1,269,399	
	<b>Totali</b>	<b>95,284,856</b>	<b>3,986,798,000</b>	<b>4,082,082,856</b>

*Burimi i të dhënave ARRSH, sipas shkresës me nr. prot 1370/1, datë 21.02.2018 e DPBF (Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës).*

Në lidhje me vitin 2018 konstatohet se detyrimet e krijuara deri në fund të vitit 2018 janë në total **4,082,082,856 lekë**, nga të cilat **95,284,856 lekë** janë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore të mbartura nga viti 2017 e të pashlyera ende, detyrimet prej **2,452,394,882 lekë** janë për Investimet dhe **767,201,559 lekë** janë detyrime të Kontratave të Mirëmbajtjes për katër drejtoritë.

E dhënë grafikisht, detyrimet në investime paraqiten:



Të detajuara detyrimet shpjegohen në vijim:

1-Ndërtim dhe sistemim rruge, i përbërë si vlerë për 16 subjekte, deri më 31.12.2018 kap vlerën **1,228,623,005 lekë, ose 50 % e vlerës totale të borxhit të ARRSH-së.** Vlerën më të lartë për t'u likuiduar nga ARRSH e përbëjnë tre subjekte, përkatësisht Gener 2 me objekt “Ndërtim I unazës së jashtme Tiranë, segmenti Kthesa e Saukut –Bregu i Lumit, me vlerë 343 mln lekë, subjekti Pevlaku me objekt “Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin rrugor Lin-Pogradec”, me vlerë 122,590,916 lekë si dhe subjekti Euroteorema me objekt “Përfundimi i punimeve të mbetura dhe plotësimi në rrugën dytësore nyja-Milot në vlerë 96,792,252 lekë.

2-Sinjalistikë rrugore në vlerë **126,769,530 lekë** përbërë nga dy objekte me vlera përkatëse 116,080,806 lekë dhe 10,688,724 lekë.

3-Supervizion punimesh që përfshin 12 subjekte në vlerën **4,853,242 lekë**.

4-Studim Projektim në vlerën **15,600,000 lekë**, i përbërë vetëm nga një objekt “Plotësimi i Bypass Shkodër pjesë e korridorit të veri-jug dhe lidhja me qytetin”, me subjekt Gjeokonsult & CO.

5-Tvsh e Kosto lokale u përket 10 objekteve në vlerën totale **233,070,215 lekë**, vlerë kjo për tu paguar nga ARRSH, si rezultat i investimeve të huaja .Vlerën më të lartë e ka **1** objekt :

-Kosto lokale RRSMS/CE/2015/2-Kontrata B (Projekt i Bankës Botërore)me vlerë **152,675,542 lekë** që përbën 65,5 % të vlerës totale të këtij zëri investimesh.

6-Detyrimet për Vendimet Gjyqësore janë në shumën **938,763,746 lekë, nga të cilat 843,478,890 lekë** ose 34 % të borxhit total të ARRSH-së, janë për vitin 2018 dhe **95,284,856 lekë janë për vitin 2017.** Pra konstatohet një vlerë në rritje nga viti në vit, gjë që tregon **një mos menaxhim dhe planifikim jo të saktë në fazat e projekt-buxhetit të vitit 2018.** Janë gjithsej 24 persona fizikë dhe juridikë me vendime gjyqësore të formës së prerë, ku vlerat më të larta për likuidim i kanë :

-Shoqëria A. T me vlerë për tu likuiduar 236,992,625 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

-E. B. me vlerë 221,468,355 lekë.

-E. K. me vlerë 176,091,769 lekë.

Pra konstatohet se vetëm tre subjekte kanë një vlerë 634,552,749 lekë, për t'u shlyer nga ARSH, ose **67,6 %** të gjithë vlerës totale të vendimeve gjyqësore për t'u shlyer.

Për sa më sipër në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe respektimin e radhës së tyre nga ARSSH, u konstatua se Drejtoria Juridike e ARSSH-së ka ndjekur *këtë proces dhe radhën e pagesave e ka përcaktuar kjo drejtori* ndërsa sektori I Financës ka bërë në mënyrë korrekte zbatimin e shkresave të ardhura pikërisht nga sektori juridik. Në lidhje me Drejtorinë Juridike me gjithë kërkesat e shumta të kryera nga grupi I auditimit të KLSH-së nuk na është vendosur në dispozicion asnjë e dhënë, për të cilën të konkludojmë në respektimin e radhës dhe rrugëve ligjore të ndjekura nga kjo drejtori, evidentimi I kërkesave për ekzekutim. etj, me justifikimin: *që ky proces pune është ndjekur nga ish-përgjegjësi i sektorit juridik dhe përputhshmërisë i larguar nga puna para një muaji dhe nuk mund të jepet.*

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 154/2014 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT”, Kreu IV, neni 26 E DREJTA E DISPONIMIT TË DOKUMENTEVE DHE INFORMACIONIT, pika 2, ku citohet se:

*2. Të gjitha subjektet e audituara janë të detyruara t'i sigurojnë Kontrollit të Lartë të Shtetit akses në dokumentet zyrtare sipas paragrafit të mësipërm. Në rast të hasjes së pengesave, veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me të drejtat e mësipërme, Kontrolli i Lartë i Shtetit i drejtohet, sipas rastit, organit më të lartë administrativ ose organeve të pushtetit gjyqësor.*

Si dhe janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ARSSH-së, **miratuar me Vendim nr.10, datë 04.09.2018, ku përcaktohet qartë funksioni dhe qëllimi i kësaj drejtorie , ku citohet se:**

*Drejtorja Juridike dhe e Përputhshmërisë së standardeve ka si qëllim kryerjen dhe rregullimin e të gjithë veprimtarisë juridike duke mbajtur të koordinuara dhe të përditësuara të gjitha drejtoritë e ARSSH-së në lidhje me legjislacionin në fuqi dhe shkallët e gjykimit të çështjeve gjyqësore që ndjek , duke shoqëruar njoftimin përkatës me interpretimin juridik të vendimeve gjyqësore, si dhe duke orientuar për fazën dhe momentin se kur këto vendime gjyqësore janë të zbatueshme.*

Për këtë mban përgjegjësi ish përgjegjësi i sektorit Juridik dhe Përputhshmërisë z.A. A. për vazhdimësinë dhe mos delegimin e informacionit tek z.A. P..

Në tabelën e vënë në dispozicion nga përgjegjësjja e sektorit të financës, në lidhje me ecurinë e pagesave të vendimeve gjyqësore, u konstatua se në total për vendimet gjyqësore janë shlyer shuma prej 738,049,989 lekë , për periudhën në auditim , sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë, dhënë e detajuar në tabelën nr.5:



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

**Tabela nr.5**

**Në lekë**

Nr	Kodi	Objekti i shpenzimit	Emri i përfituesit	Shuma e përfituar	Vlera e Vendimit	Tarifa Permbarimore	vendimi Gjyk.Adm .Apelit	Data e Likuidimit
1	M062991	Sh..	B...	2,051,630		2,051,630	Nr.2127 dt 13.10.15	01.03.17
2	M062991	E. S	A...	20,000,000	18,821,058	1,178,942	Nr.4467 dt 14.12.2016	08.03.17
3				7,879,799	7,879,799		Nr.4467 dt 14.12.2016	18.12.17
4				589,471	589,471		Nr.4467 dt 14.12.2016	02.05.18
5				M062991	F. C	B...	2,432,241	2,305,005
6	M062991	I...	E.K Permbarues Privat	20,910,134	20,044,224	865,910	Nr.791 dt 20.04.2016	09.03.17
7	M062991	Z.K	K..	1,858,875	1,528,125	330,750	Nr.269 dt 02.07.09	09.03.17
8	M062991	Tatim ne Burim Vendim Gjyqesor Qera Toke (Z. K)	Tatimet	5,034,375	5,034,375			16.03.17
9	M062991	N. P	A.....	60,000,000	57,341,018	2,658,982	Nr.2385 dt 21.07.2016	15.03.17
10				49,769,437	49,769,437		Nr.2385 dt 21.07.2016	18.12.17
11	M062991	F. P	E. G.	20,000,000	17,865,748	2,134,252	Nr.240 dt 31.01.2017	28.03.17
12				37,161,775	37,161,775		Nr.240 dt 31.01.2017	18.12.17
13				4,627,318	4,627,318		Nr.240 dt 31.01.2017	24.04.18
14	M062991	A. Z	A. Z	493,363	493,363		Nr.2766 dt 03.07.2014	28.03.17
15	M062991			100,020	100,020		Nr.2766 dt 03.07.2014	19.12.17
16	M062991	Sh. Gj	T.....	10,037,348	9,580,291	457,057	Nr.2669 dt 20.09.2016	28.03.17
17				205,589	205,589		Nr.2669 dt 20.09.2016	18.12.17
18	M062991	N. H. etj.	Y. H.	3,591,017	3,246,507	344,510	Nr.2352 dt 05.11.15	07.04.17
19	M062991	Q.Dh	H.M(Permb.)	3,591,017	3,152,487	438,530	Nr.386 dt 02.03.16	07.04.17
20				6,163,581	6,163,581		Nr.386 dt 02.03.16	18.12.17





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

21	6027400	F. C	K....	501,830			Nr.1471 01.06.16	dt	27.04.17
22	M062991	A. K	S. K. ( Me prokure )	13,481,418	13,481,418		Nr.2102 17.05.17	dt	19.12.17
23				1,159,582	1,159,582		Nr.2102 17.05.17	dt	26.04.2018
24	M062991	S.C	B. Sh (Permb.)	25,634,650	24,573,093	1,061,557	Nr.768 13.04.16	dt	19.12.17
25	M062991	B.R & N. L	B. S (Permb.)	13,312,364	12,702,668	609,696	Nr.2387 12.11.15	dt	19.12.17
26	M062991	F. C	S.....	824,458	731,690	92,768	Nr.2686 18.05.15 Gj.Shk.Pare Tr.	dt	21.12.17
27	M062991	Sh... shpk	3...	50,000,000	46,638,455	3,361,545	4947 dt.23.11.2017		23.04.2018
28				40,000,000	40,000,000		Nr.4947 23.11.2017	dt	27.12.2018
29				6,737,785	6,737,785		Nr.4947 23.11.2017	dt	16.05.19
30	M062991	Z. H	Z.....	13,536,630	13,536,630	879,003	2929 30.09.2016	dt	23.04.2018
31	M062991	J.C C	B. Sh	12,969,251	12,411,067	558,184	Nr.116 23.01.2017	dt	25.04.2018
32	M062991	M. Gj	S.....	10,000,000	7,363,703	2,636,297	Nr.2457 25.05.2017	dt	25.04.2018
33	M062991	A. P	K. B	48,640,105	45,725,291	2,914,814	NR.2814 DT.20.06.2017		25.04.2018
34	M062991	B. L. O	M E. G	48,020,799	45,134,350	2,886,449	Nr.4215 12.10.2017	dt	25.04.2018
35	M062991	A. M	A. S	7,759,889	6,048,169	1,711,720	Nr. 1451 06.04.2017	dt	26.04.2018
36	M062991	S.H	E. G.	2,696,955	2,460,725	236,230	Nr.2860 22.06.2017	dt	26.04.2018
37	M062991	Gj....	Gj....	110,000,000	110,000,000		Nr.2419 27.07.2016	dt	27.12.2018
38	M062991	E.K	R.....	42,166,289	40,235,009	1,931,280	Nr.1369 03.04.2018	dt	28.05.19
39	M062991	G.R	A. S.	15,008,882	14,000,823	1,008,059	Nr.2519 21.06.2018	dt	03.06.19
40	M062991	K.B	Z. M.	19,102,112	17,832,567	1,269,545	Nr.487 08.02.2018	dt	03.06.19
<b>Totali</b>				<b>738,049,989</b>	<b>706,682,216</b>	<b>31,744,946</b>			

*Burimi i të dhënave ARRSH,(Sektori i Financës ) sipas e-mailit zyrtar të datës 23 korrik 2019.*

#### **Proceset gjyqësore**

***Nga shqyrtimi me zgjedhje i dokumentacionit të urdhër-shpenzimeve për vitin 2017-2018-2019 u konstatua se, në urdhër shpenzimet e listuara më lart janë paguar gjyqe fituesit dhe subjektet përmbarese gjyqësore private për tarifën e shërbimit përmbarimor. Shumat e detyrimeve për***



vendimet gjyqësore të paguara nga buxheti i shtetit për vitin 2017 janë në shumën **305,034,921 lekë**, për vitin 2018 në shumën **350,000,000 lekë**, dhe për vitin 2019 deri në qershor në vlerën **83,015,068 lekë**. Për të gjitha këto vendime edhe pse kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga ARRSH, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat, duke rënduar buxhetin e shtetit me kosto shtesë në shumën prej **31,744,946 lekë** për tarifa përmbarimore.

Nga auditimi u konstatua se nga institucioni ndër vite nuk ka një fond të planifikuar për proceset gjyqësore të cilat nuk kanë marrë formën e prerë. Në PBA-në e institucionit nuk është planifikuar një fond për këto detyrime, veprime në kundërshtim me Ligjit Nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Spektori i financës ka bërë kontabilizimin dhe konstatimin e detyrimeve gjyqësore vetëm në momentin e likuidimit të personave me urdhër shpenzim kaluar nëpërmjet degës së thesarit, ndërsa detyrimet e lindura për tu paguar nuk janë të kontabilizuara në pasqyrën financiare, për faktin se nga Spektori Ligjor dhe i Prokurimeve nuk janë dërguar informacione në lidhje me proceset gjyqësore, por informojnë spektorin e financës vetëm kur duhet të bëhet pagesa në bankë në favor të gjyqë fituesit.

Nga institucioni duhet te krijohen provizionet për shpenzime gjyqësore pasi janë ngjarje të ndodhura dhe kanë probabilitet që do të sjellin detyrim për t’u paguar Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë. Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për provizionet bëhen si më poshtë:

a) Në momentin e njohjes së provizionit kryhen këto regjistrime:

- Debitohet llogaria 683, “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit”; dhe

- Kreditohet llogaria 150, “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime”.

*Në llogarinë 602 (Zbatimi i kontratave dhe mirëmbajtja), për vitin 2018, detyrime të prapambetura janë në vlerën **767,201,559 lekë**, ku rreth 213 mln i përkasin ARSH/Qendër; 162,7 mln –Drejtoria Qendrore TR, 388 mln –DR.Veriore Shkodër; 1,2 mln –Dr Jugore Gjirokastrë. Këto detyrime janë të mbartura nga vitet 2016-2017 dhe nuk janë likuiduar edhe gjatë vitit 2018 duke u kthyer në borxh si dhe duke u rritur në vitin e ardhshëm. Peshën më të madhe të këtij borxhi vazhdon ta ketë Dr-Veriore Shkodër në vlerën 388 mln lekë ose 50% të borxhit total të llogarisë 602. Pra sektori i planifikimit të buxhetit nuk ka kryer me korrektesë funksionin e tij pasi në asnjë parashikim të kryer nuk ka nxjerrë arsye konkrete dhe nuk ka bërë analizë që pse ky borxh i Drejtorisë Veriore Shkodër dhe në përgjithësi i gjithë detyrimi për kontratat e mirëmbajtjes nuk shlyhet Brenda vitit por mbartet duke rënduar buxhetin e vitit pasardhës.(e dhënë e detajuar në tabelën nr.5 ) si dhe në kundërshtim me ligjin Ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT


### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

**Tabela nr.5**

*Në lekë*

Llogaria	Autoriteti Kontraktor	Mbetje nga Viti 2017.	Krijuar deri 31.12.2018	SHUMA (Borxh) 31.12.2018.
602	D.R Qendror Tiranë	110,325,301	52,456,466	162,781,767
602	D.R.Verior Shkodër	131,238,541	257,000,686	388,239,227
602	D.R.Jugor Gjirokastrë	-	1,269,399	1,269,399
602	ARRSH	-	213,687,385	213,687,385
	<b>Totali</b>	<b>241,563,842</b>	<b>524,413,936</b>	<b>765,977,778</b>

E dhënë grafiksht si më poshtë:



**Tabela nr.6**

**Detyrime të prapambetura deri më 30.06.2019, në llogarinë Investime**

201  
9

*Në lekë*

Nr	Emërtimi i Objektiv	Mbetje deri në 31.12.2018	Parashikuar për likujdim me buxhetin e vitit 2019	Likujdim deri në 30 qershor 2019	Mbetje pas likujdimit
1	Ndërtim e sistemim rruge	1,228,623,005	1,228,623,005	841,705,731	
2	Sinjalistikë Rrugore	126,769,530	126,769,530	11,235,256	
2	supervizion	4,853,242	4,853,242	2,687,862	



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në "Autoritetin Rrugor Shqiptar"

3	Studim Projektim	15,600,000	15,600,000	0	
4	Tvsh e Kosto lokale	233,070,215	233,070,215	213,649,265	
5	Vendime Gjyqësore	938,763,746	563,234,669	48,904,074	375,529,077
	<b>Totali</b>	<b>2,547,679,738</b>	<b>2,172,150,661</b>	<b>1,118,182,188</b>	<b>375,529,077</b>

**Burimi i të dhënave ARRSH, sipas shkresës me nr.prot 1201/1 datë 11.02.2019 e DPBF (Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës).**

**1-Detyrimi për Ndërtim dhe sistemim rruge, i përbërë si vlerë për 16 subjekte, deri më 30.06.2019 është likuiduar në vlerën 841,705,731 lekë. Diferenca prej 386,917,274 lekë është planifikuar për t'u shlyer me buxhetin e vitit 2019.**

**2-Sinjalistikë rrugore, janë shlyer 11,235,256 lekë dhe mbeten 115,534,274 lekë.**

**3-Supervizion punimesh janë shlyer 2,687,862 lekë dhe mbeten 2,165,380 lekë.**

**4-Studim Projektim në vlerën 15,600,000 lekë deri më 30qershor 2019, nuk është kryer asnjë likuidim.**

**5-Tvsh e Kosto lokale janë shlyer 213,6 mln lekë dhe mbeten për t'u shlyer 19,4 mln lekë.**

**6-Vendime Gjyqësore janë shlyer 48,9 mln lekë nga 563,2 mln të planifikuara për t'u shlyer me buxhetin e vitit 2019. Diferenca prej 375,5 mln lekë nuk është planifikuar për t'u shlyer në vitin 2019 dhe do të mbartet për vitin 2020.**

### **Detyrime të prapambetura deri më 30.06.2019, në llogarinë 602 (Kontrata mirëmbajtje)**

**Tabela nr.7**

	Mbetje 31.12.2018	Parashikuar per Likujdim me buxhetin e vitit 2019	Likujduar deri me 30.06.2019	Mbetje pas Likujdimit
<b>ARRSH</b>	214,914,329	118,526,535	17,293,764	96,387,794
<b>D.R Qendror Tiranë</b>	162,781,767	123,325,301	123,322,301	39,456,466
<b>D.R.Verior Shkodër</b>	388,236,064	150,269,139	150,269,139	237,966,925
<b>D.R.Jugor Gjirokastrë</b>	1,269,399	1,269,399	1,269,399	-
<b>Totali</b>	<b>767,201,559</b>	<b>393,390,374</b>	<b>292,154,603</b>	<b>373,811,185</b>

**Burimi i të dhënave ARRSH, DPBF (Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës).**

Pra sikurse konstatohet janë parashikuar për tu likujduar me buxhetin e vitit 2019 vlera prej 393,390,374 lekë, të cilat janë detyrime për kontrata të përfunduara dhe është parashikuar mbulimi me fonde I gjithë kontratave të lidhura gjatë vitit 2018 për të mos krijuar detyrime të reja .

**Konkluzion:** Nga auditimi i evidencave të detyrimeve të prapambetura të shqyrtuara këto progresive si dhe të ndarë në vite për periudhën në auditim u konstatua se përgjithësisht ARRSH



nuk ka përcaktuar mekanizma të mirë organizuar dhe funksionale të procesit të menaxhimit të riskut, efekt që pasqyrohet edhe në rezultatet e treguesve të performancës së buxhetit dhe thesarit duke shfaqur mangësi gjatë lidhjes dhe zbatimit të kontratave, parashikimit të likuiditeteve që çojnë në rritjen e nivelit të detyrimeve të prapambetura. Kështu në vdo vit pasardhës ARRSH trashëgon pothuaj në mënyrë të njëjtë një borxh që varion, i detajuar në vijim :

-Detyrimet në fund të vitit 2017 janë në total **3,625,113,495 lekë**, të cilat përbëhet nga detyrimet për investime (Llogaria 230+231) në vlerën **2,457,660,336 lekë** si dhe Detyrimet për kontratat e mirëmbajtjes për katër drejtoritë (llogaria 602) në vlerën **1,167,453,159 lekë**.

- Detyrimet e krijuara në fund të 2018 janë në total **4,082,082,856 lekë**, nga të cilat **95,284,856 lekë** janë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore të mbartura nga viti 2017 e të pashlyera ende, detyrimet prej **2,452,394,882 lekë** janë për Investimet(230 +231) dhe **767,201,559 lekë** janë detyrime të Kontratave të Mirëmbajtjes për katër drejtoritë.

-Detyrime të mbartura nga viti 2018 që rezultojnë deri më 30.06.2019, janë 2,172,150,661 lekë për Investime, dhe likuiduar 1,118,182,188 lekë deri më 30.06.2019. Ndërsa për llogarinë 602 (Zbatimi I kontratave të mirëmbajtjes detyrime të mbartura prej 2018 janë 767,201,559 lekë, nga të cilat janë parashikuar për tu likuiduar 292,154,603 lekë dhe pjesa tjetër 373,811,185 lekë mbetet e pashlyer duke u kthyer në një borxh real dhe duke rënduar buxhetin e vitit 2020.

*Për problemet e trajtuara në projektraport dhe të trajtuara më sipër në këtë raport, subjekti i audituar me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacionet në të cilat ka bërë komente dhe shpjegime që në përmbajtje janë të njëjta me komente dhe shpjegimet e bëra për atkkoinsstatimin dhe të trajtuara hollësisht nga auditimi në projektraport. Këto observacione nuk qendrojnë dhe nuk merren në konsideratë në këtë raport ( për më hoolësi referou projektraportit në të cilin , janë trajtuar gjerësisht observacionet dhe qëndrimi me komentet e auditimit).*

### **1. ç) Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave dytësore**

ARRSH nuk realizon te ardhura nga veprimtaria e saj kryesore, apo veprimtari ekonomike dytësore.

Nga auditimi rezultoi se ARRSH në raportin periodike të monitorimit të buxhetit për periudhën 2017- 2018 , ka bërë një analizë të (mos) realizimit të zërave (artikujve) krahasuar me planin, si dhe një analizë të faktorëve që kanë ndikuar në mosrealizim, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 22, datë 18.11.2016 “Për procedurat standard të monitorimit të buxhetit në NJQQ.

Nga subjekti është bërë vlerësimi i performance, nga ku është realizuar krahasimi i treguesve faktikë të performancës me ata të planifikuar.

- Nga subjekti në raportet e monitorimit janë evidentuar nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin dhe nëse jo, duke propozuar veprimeve korigjuese, duke rialokuar burimet, etj., me qëllim evidentimin e impaktit potencial në performancën e objektivave të lidhura me to.



Kryerja e raporteve të monitorimit në vetvete është hallkë e rëndësishme e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

## **II. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare.**

*a. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet, bankës dhe arkës në lekë dhe në valutë.*

*b. Saktësia dhe rregullat i veprimeve të kryera në magazinë.*

Në zbatim të pikës nr. 2 të programit të auditimit “ nr. 363/1, datë 29.05.2019”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër-shpenzim.
- Transaksionet e llogarive bankare
- Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme:

### **- Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera përmes bankës**

- Nga auditimi me zgjedhje mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Sektorin e Financës të ARRSH-së, rezultoi se, veprimet janë kryer konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve shtetërore qendrore si dhe njërive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

Transaksionet janë kontabilizuar në mënyrë kronologjike dhe gjendja e llogarive bankare rakordon me ekstraktet e bankës në fund të çdo muaji, kjo pers a i përket veprimeve të kryera gjatë viteve 2017, 2018 dhe 30.06.2019.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.) dhe në çdo rast kanë nënshkrimin e personit të autorizuar në Degën e Thesarit.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2017 janë në vlerën totale 13,063,014 mijë lekë.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për vitin 2018 janë në vlerën totale 14,816,437 mijë lekë.

-Të gjitha Urdhër Shpenzimet e kontabilizuara në ditarin e bankës për 6 mujorin e parë të vitit 2019 janë në vlerën totale 4,334,443 mijë lekë.



Nga këto grupi i auditimit, me përzgjedhje auditori transaksionet sipas urdhër shpenzimeve paraqitur në Aneksin 1, bashkëngjitur këtij projekt-raporti për shpenzimet buxhetore.

Urdhër Shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

*Nga auditimi rezultoi:*

-Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit është bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim *Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.*

-Marrja në dorëzim e shërbimeve sipas kontratave të lidhura për mallra/shërbime përgjithësisht janë të konfirmuara dhe dokumentuara rregullisht nga një komision i ngritur nga Titullari i ARRSH-së, në përputhje me përcaktimet e dispozitave dhe kuadrit nënligjor mbi menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe kontabilitetit.

## **b. Saktësia dhe rregullat e veprimeve të kryera në magazinë**

*Ditari i magazinës* është mbajtur dhe veprimet hidheshin periodikisht.

-U audituan me të zgjedhur dokumentacioni i magazinës për vitin 2017, 2018 deri më 30.06.2019. Fletë daljet dhe fletë hyrjet e mallrave janë të hartuara sipas rendit kronologjik dhe pa korrigjime të plotësuara me adresën nga vjen malli dhe kujt i dërgohet malli.

Hyrja e mallrave në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletë-hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletë-hyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi është bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit, në përputhje me përcaktimet e paragrafit 37, kreu III, të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. Kontabilizimet e fletë-daljeve dhe fletë hyrjeve janë bërë në mbështetje të planit unik kontabël dhe në mënyrë kronologjike e sistematike në ditarët e magazinës. Dokumentacioni i magazinës përpilohet nga administratori i vlerave materiale, ndërsa kontabilizimi i veprimeve kryhet nga një specialiste e sektorit të financës.

Fletë-hyrja e plotësuar nga magazina për hyrjen e mallrave që qarkullojnë pa pagesë në njësi, ka të bashkëlidhur dokumentacionin përkatës si: fletëdaljen e nënshkruar nga përfaqësuesit e njësisë shpenzuese që ka bërë daljen e mallit; Shkresën e Njësisë për transferimin e aktiveve;

## **c. Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël**

Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Rrugor Shqiptar ka të dhëna mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim,





*përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...*

Komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 10257, datë 19.12.2017“Për ngritjen e komisionit për inventarizimin e asetëve të Autoriteti Rrugor Shqiptar për 2017” dhe nr.204, datë 17.12.2018 për vitin 2018 ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në përdorim të personelit dhe magazinës; krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit dhe së fundmi plotësimin e procesverbalit me listën e materialeve që vlerësohen pa vlerë dhe për nxjerrje jashtë përdorimit.

Në përfundim të inventarizimit komisioni ka hartuar relacionin mbi përfundimin e inventarizimit, ku nuk është konstatuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël.

Për vitin 2017, anëtarët e komisionit kanë qenë L. S., D., VP, A.Q, dhe V T.

Për vitin 2018, anëtarët e komisionit kanë qenë M. J, E. N, E. T., R. L.dhe T. P.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit, para fillimit të inventarit është fokusuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve, si dhe është mbajtur një proces verbal midis palëve. në përputhje me pikën 83 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011.

***Respektimi i rregullave kontabël për nxjerrjen jashtë përdorimi të vlerave materiale, kryerja e veprimeve kontabël për shkarkimin nga magazina.***

Për vitin 2017 ka pasur aktive të propozuar për jashtë përdorimi nga komisioni i inventarizimit. Drejtori i Përgjithshëm me urdhër nr.543, datë 19.01.2018 ka ngritur komisionin e vlerësimit të aktiveve(me të njëjtën përbërje si më lart të cituar) për nxjerrjen jashtë përdorimi, i cili ka mbajtur proces verbalin e vlerësimit, pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: Relacioni i bërë nga komisioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. U konstatua se gjatë viti 2017 ka vazhduar procesi për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa automjeteve që ndodhen në ruajtje pranë DR Qendror Tiranë. Është duke u zhvilluar procesi i shitjes së skrapit me procedurën e ankandit . Vlera e këtyre automjeteve është 21,447,227 lekë. Vlera e automjeteve në përdorim është 23,770,887 lekë , i automjeteve në ruajtje është 86,683,897 lekë dhe vlera e automjeteve për të cilat është refuzuar ankandi dhe do të kalojnë në rezervat materiale të shtetit është 13,394,804 lekë. Gjithsej vlera e inventarit të automjeteve është 141,695.815 lekë .

Për vitin 2018 ka pasur aktive të propozuar për jashtë përdorimi nga komisioni i inventarizimit. Drejtori i Përgjithshëm me urdhër nr.543, datë 19.01.2018 ka ngritur komisionin e vlerësimit të aktiveve(me të njëjtën përbërje si më lart të cituar) për nxjerrjen jashtë përdorimi, i cili ka mbajtur proces verbalin e vlerësimit, pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: Relacioni i bërë nga komisioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. U konstatua se edhe gjatë viti 2018 ka vazhduar procesi për nxjerrjen jashtë përdorimit të disa automjeteve që ndodhen në ruajtje pranë DR





Qendror Tiranë. Është duke u zhvilluar procesi i shitjes së skrapit me procedurën e ankandit . Vlera e automjeteve në përdorim është 42,433,126 lekë, i automjeteve në ruajtje është 87,162,318 lekë, vlera e automjeteve jashtë përdorimit për skrap është 21,447,227 lekë , dhe vlera e automjeteve të firmës B...., në ruajtje pranë DRQ Tiranë është 399, 000 lekë Gjithsej vlera e inventarit të automjeteve është 165,080,325 lekë, në fund të vitit 2018.

## TË TJERA:

I-Nga auditimi i kryer në ARRSH, *mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2017 dhe 2018 dhe 2019, u konstatua se për vitin 2018 në zërin “Transferta për Buxhetin. Familjar & Individ “ janë dhënë shpërblime punonjësve të ARRSH-së (Institucioni qendror dhe 4 DR në rrethe) në vlerën **51,238,754 lekë**, me arsyetimin e ndryshimit të statusit të tyre nga nëpunës civil sipas Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në punonjës marrëdhëniet juridike të të cilëve rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.*

- Dhënia e shpërblimit të punonjësve të ARRSH është mbështetur në:

1. VKM nr. 276, datë 16.5.2018 ”Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës, dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, pikën 6 kreut I, ku është përcaktuar se: Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit, në nivel qendror dhe rajonal, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Para kësaj date sipas **VKM nr. 142, datë 12.03.2014**, marrëdhëniet e punës së këtij Institucioni janë rregulluar nga Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Në VKM nr. 276, datë 16.5.2018 është përcaktuar ndër të tjera dhe numri i punonjësve të ARRSH-së 169 punonjës gjithsej, i njëjtë ky me numrin e punonjësve, para ndryshimit të statusit, **çka tregon se nuk kemi ristrukturim apo shkurtime të vendeve të punës.**

ARRSH mbështetur në VKM për ndryshimin e statusit të punonjësve nga nëpunës civil në marrëdhënie me kod pune, ka iniciuar zyrtarisht, procedurën e dhënies së shpërblimit për punonjësit e institucionit.

2. ARRSH në shkresën me nr.prot.4458, datë 24.5.2018 dërguar Departamentit të Administratës Publike (DAP), ka kërkuar ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit për shkak mbylljes apo ristrukturimi të institucionit”, njësisë përgjegjëse DAP.

ARRSH e ka mbështetur kërkesën në gërmën “g” pika 2 e nenit 7 dhe nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

3. Shkresa e DAP me nr. prot 4006, datë 30.5.2018 dërguar MIE dhe ARRSH-së me objekt ”Mbi ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit”, në të cilën është përcaktuar se :

Mbështetur në VKM nr. 276, datë 16.5.2018 gjeni bashkëlidhur urdhrin e njësisë përgjegjëse se (DAP) për krijimin e Komisionit të ristrukturimit të ARRSH-së.

Në urdhrin nr.50, datë 30.05.2018, bashkëlidhur kësaj shkrese është përcaktuar se :



*Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar dhe VKM nr. 276, datë 16.5.2018: Të krijohet Komisioni i Ristrukturimit për arsye të ndryshimit të mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës dhe statusit të ARRSH me përbërje z. B. B kryetar, z. G. K, anëtar dhe A.Q anëtar .*

**4.** Vendimi/vendimet e Komisionit të Ristrukturimit nxjerrë për të gjithë punonjësit e institucionit (169) , ku për secilin punonjës ka vendosur shprehimisht:

*-Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për z, znj.....; në pozicionin ....., në ARSH.*

*-Z, znj..., të trajtohet sipas dispozitave të neneve 50, pika 8, dhe 66, pika 1, germa a/1, dhe pika 4 e Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*-Ngarkohet njësia e burimeve njerëzore pranë ARRSH-së për zbatimin e kësaj vendimi.*

**5.** Shkresa me nr.prot.6182, datë 12.07.2018, e Drejtorisë së shërbimeve të brendshme dërguar Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit të Financës me lëndë :

Listat e punonjësve që përfitojnë paga nga përfundimi i shërbimit civil, ku gjithsej janë katër lista me një numër total punonjësish prej 129 dhe një vlerë shpërblimi prej **51,238,754 lekë** ku nga këto vlera e Tatimit mbi Të ardhurat Personale **TAP (15 %) është 7,685,813 lekë** .

**6.** Shkresa me nr. prot .6347, datë 18.07.2018, e DPBF (Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit të Financës) dërguar DAP me lëndë :

*Mbi konfirmimin e të drejtës për përfitim, të punonjësve të ARRSH-së , për të cilët ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil. Në këtë shkresë është kërkuar konfirmimi i të drejtës për përfitim, sipas dispozitës së mësipërme të sipërcituara , të gjithë punonjësve të ARRSH-së , për të cilët ka përfunduar marrëdhënia në shërbimin civil, sipas listës bashkëlidhur.*

**7.** Me shkresën me nr.prot.5513/1, datë 01.09.2018 DAP ka kthyer përgjigje ARRSH-së ku përcakton që të zbatohet pika 7 e nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ku Komisioni i Ristrukturimit i ngritur me Urdhrin nr.50, datë 30.05.2018, ka përcaktuar njësinë e burimeve njerëzore si njësi përgjegjëse për zbatimin e vendimit të lirimit.

Nga sa më sipër si dhe nga kronologjia e shkresave të cituara hollësisht nga ana jonë, mbështetur në ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pika 2 e nenit 7 citon se:

*DAP përgatit udhëzime të përgjithshme dhe manuale për të garantuar zbatimin e unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore ...*

Si dhe Nenin 50 “Transferimi në rastin e mbylljes dhe restrukturimit të institucionit”, citon se:

*1. Nëse për shkak të mbylljes apo restrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori.*



2. Transferimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet me precedencë, sipas kësaj renditjeje:
- a) në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar;
  - b) në institucionin, me të cilin institucioni është shkruar apo bashkuar, në një nga institucionet, në të cilat institucioni është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi;
  - c) në institucionet e varësisë së institucionit të ristrukturuar;
  - ç) në një institucion tjetër të shërbimit civil.
3. Në çdo rast mbylljeje apo ristrukturimi krijohet një komision ristrukturimi. Komisioni shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse, në bazë të propozimit të komisionit.
4. Nëpunësi mund ta refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në pikën 3 të nenit 48 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil.
5. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 2 të këtij neni, sipas rastit.
- "6. Përfundimi i marrëdhënieve në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së një institucioni, nuk lejohet, me përjashtim të rastit kur, si pasojë e këtyre procedurave, ka shkurtime të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe transferimi, sipas pikës 2 të këtij neni, është i pamundur."**
7. Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen **1 muaj** përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e këtij neni, **nëpunësi civil që largohet ka të drejtën e një dëmshpërblimi**, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë, sipas rasteve të mëposhtme:
- a) deri në një vit eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 1 muaji;
  - b) nga 1-3 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 3 muajve;
  - c) nga 3-6 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 6 muajve;
  - ç) nga 6-9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 9 muajve;
  - d) mbi 9 vjet eksperiencë pune si nëpunës civil, paga e 12 muajve.
8. Nëpunësit civilë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil, si pasojë e ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, kanë të drejtë që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:
- a) të konkurrojnë si nëpunës civilë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;



*b) të emërohen në mënyrë të përkohshme nga njësi përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione të shërbimit civil.*

*9. Këshilli i Ministrave miraton procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij neni.*

Ish-Titullari i Përgjithshëm ARRSH dhe DAP kanë vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar duke aprovuar dhe miratuar vendimin për dhënien e dëmshpërblimeve të punonjësve të pa larguar nga puna. Sikurse e kemi cituar në pikën 1 dhe 2 të këtij akt-konstatimi, VKM e re e miratuar nr 276, datë 16.5.2018 ”Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës, dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, pikën 6 e kreut I ka përcaktuar se: Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit, në nivel qendror dhe rajonal, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”, ku numri i punonjësve ka mbetur i pandryshuar (169) .

Nga verifikimi i njëpasnjëshëm i vendimeve konstatohet se nuk ka ndryshim të pozicioneve të punës për secilin punonjës dhe as ristrukturim pra shkurtim të vendeve të punës apo largim të punonjësve nga puna, **por vetëm ndryshim të marrëdhënieve të punës** (kalim nga nëpunës civil në marrëdhënie me kod pune), për pasojë vlera prej **51,238,754 lekë** e dhënë si shpërblim ndaj punonjësve të ARRSH-së, konsiderohet dëm ekonomik.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi ish-Titullari i Përgjithshëm i ARRSH-së, z.Afrim Qendro si dhe Departamenti i Administratës Publike që ka miratuar këtë veprim.

*Observacioni i paraqitur nga ish-punonjësi i bërë përgjegjës në aktkonstatim e mbajtur ( për projektraoprtin nuk jana paraqitur observacione), nuk qëndron dhe nuk merren ne konsiderate në këtë raport. Siç është thënë edhe vetë në këtë observacion KLSH ne zbatim të nenit 162 te Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, ka për mision në punën e tij te kryejë auditime me qëllim përdorimin me efektivitet, efecensë, dhe ekonomikitet të fondeve publike. Parë në këtë kënd vështrim dhe ne zbatim të kësaj baze ligjore, shpërblimi i punonjësve te ARRSH me tre page ne një kohe qe nuk janë shkurtuar vendet e punës si rezultat i ristrukturimit të institucionit , por njëkohësisht kane marre edhe pagën, përbën keq përdorim të këtyre fondeve në dëm të buxhetit të shtetit.*

**II-**Në zbatim të VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, I ndryshuar , Kreu III, pika 2 e VKM Nr.957 si dhe Urdhri I Ministrit të Punëve Publike dhe Transporteve nr.125, datë 26.12.2011”Për miratimin e hartave të azhurnuara të rrjetit rrugor kombëtar dhe distancë kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH”, Instituti I Transportit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të bëjnë përkatësisht përditësimin vjetor brenda 3 mujorit të parë të çdo viti pasardhës të “Hartave të rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë” dhe të tabelës “Distanca kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë”.

Nga auditimi i korrespondencave shkresore të sektorit të mirëmbajtjes së Rrugëve me institucione të ndryshme u konstatua se nuk ishte përditësuar për asnjë vit prej vitit 2012 e në



vazhdim Harta e rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe tabela e Distancës kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë”.

Për këtë mund të përmendim shkresën me nr.prot 1184 /1, datë 02.07.2019 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me lëndë “Kërkim informacioni për ndryshimin e distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë , të azhurnuara me qëllim përlllogaritjen e saktë të shpenzimeve të Transportit për trajtimin financiar të punonjësve “. Në kthim përgjigje të kësaj shkrese ARSH ka kthyer përgjigje me shkresë nr 6556/1 , datë 16.07.2019, ku konfirmon që Sistemi ËEB Gis akoma nuk është update-uar dhe për raste të veçanta të kontaktojnë në emailin: [sektori.mirëmbajtjes@arrsh.gov.al](mailto:sektori.mirëmbajtjes@arrsh.gov.al). Nga sa më sipër kjo është një situatë e papranueshme për të cilën ARRSH nuk ka kryer detyrën funksionale të saj pra përditësimin e këtyre hartave dhe distancave kilometrike . Nisur nga numri i madh i Institucioneve të administratës shqiptare që operojnë me këtë udhëzim dhe VKM, mos përditësimi i Hartës së rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe tabelës së Distancës kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë sjell abuzime me fondet e buxhetit të shtetit në trajtimin financiar për përlllogaritjen saktë të shpenzimeve të transportit.

Pra, sa më sipër, ARRSH nuk ka përditësuar hartën për të saktësuar distancat kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë,

*Nuk janë paraqitur observacione.*

**Shpronësimet dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik:**

**Për vitin 2017.**

Në lidhje me kërkesat për shpronësim, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për periudhën në auditim janë bërë 17 kërkesa për kryerjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për segmente rrugore të ndryshme, pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, duke i bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e duhur në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të “Rregullores të Autoritet Rrugor Shqiptar” po i pasqyrojmë me disa praktika të kontrolluara për kërkesat për shpronësim të segmenteve rrugore.

Nga këto 17 kërkesa për kryerjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për segmentet rrugore, u kontrolluan 7 kërkesa me dokumentet shoqëruese për shpronësim për segmentin rrugor si më poshtë:

1- Shpronësim i segmentit rrugor “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë.

***Në lidhje me kryerjen dhe realizimin e procedurave të kërkesës për shpronësim për segmentin rrugor të sipërcituar u konstatua se:***



**1-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve.

Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për tokë/truall, me vlerë 5,334,455.50 lekë.

**2-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për tokë/truall me sipërfaqe 92,66 m<sup>2</sup>, me vlerë 8,339,400 lekë.

**3-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për ndërtesë me sipërfaqe 71,9 m<sup>2</sup>, me vlerë 4,202,800 lekë.

**4-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për apartament me sipërfaqe 57,3 m<sup>2</sup>, me vlerë 6,303,000 lekë.

**5-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tirane miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet





është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për ndërtesë me sipërfaqe 71,9 m<sup>2</sup>, me vlerë 4,781,350 lekë.

**6-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë, miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për ndërtesë me sipërfaqe 133 m<sup>2</sup>, me vlerë 14,630,000 lekë.

**7-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në ndërtimin e objektit “Unaza Lindore Loti 3” Tiranë miratuar me vendimin e KM nr. 769 datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i objektit ‘Unaza Lindore Loti 3’ Tiranë, nga ARRSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga znj. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për ndërtesë me sipërfaqe 47,4 m<sup>2</sup>, me vlerë 5,214,000 lekë.

➤ **Për vitin 2018.**

Në lidhje me kërkesat për shpronësim, nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për periudhën 01.09.2008-31.12.2008 janë bërë 9 kërkesa për kryerjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për segmente rrugore të ndryshme, pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, duke i bashkëlidhur të gjithë dokumentacionin e duhur në zbatim të V.K.M-së nr.769, datë 20.12.2017 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i ‘Unazës Lindore Loti 3’ ” dhe të “Rregullores së Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve” po i pasqyrojmë me disa praktika të kontrolluara për kërkesat për shpronësim të segmenteve rrugore.

Nga këto 9 kërkesa për kryerjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit për segmentet rrugore, u kontrolluan të gjitha kërkesat me dokumentat shoqëruese për shpronësim për segmentet rrugore si më poshtë:

1- Shpronësim i segmentit rrugor “Unaza Lindore, Loti 3” Tiranë.

***Në lidhje me kryerjen dhe realizimin e procedurave të kërkesës për shpronësim për segmentet rrugore të sipërcituara u konstatua se:***

**1.1-Në** lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor “Unaza Lindore, loti 3” Tiranë, miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3”, nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me



tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga z. Besnik Hysaj, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Bashkëpronarët e pasurisë të paluajtshme, që shpronësohet janë kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 2582(m<sup>2</sup>), truell, me vlerë 16,003,366.50 lekë., nga ku bashkëpronari E.S është kompensuar me vlerën 10,668,911 lekë dhe bashkëpronari A.Q është kompensuar me vlerën 5,334,455.50 lekë.

**1.2-** Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor “**Unaza Lindore, loti 3**” **Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3. nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga z. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 300(m<sup>2</sup>) truell, me vlerë 9,863,400 lekë dhe për sipërfaqen 281,7(m<sup>2</sup>) ndërtese, me vlerën 25,353,000 lekë.

**1.3-**Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor “Unaza Lindore Tiranë, Loti3”, miratuar me vendimin miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3. nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga B.S., specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve.

Pagesa është kryer në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Udhëzimin e Ministrisë së financave nr.7, datë 07.05.2017 “ Për përdorimin e fondit të shpronësimeve” dhe shkresën e AESH-së të protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr.5225, datë 13.03.2018 “Dërgim liste pagesë” për pagesa nga llogaritja “Fondi i shpronësimeve” nga ku pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 58(m<sup>2</sup>) ndërtese, me vlerë 5,220,000 lekë.

**1.4-** Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor “**Unaza Lindore, loti 3**” **Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3. nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelën përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimit nga z. B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 99(m<sup>2</sup>) ndërtesë, me vlerë 10,890,000 lekë.

**1.5-**Në lidhje me kërkesën për c ‘ngurtësim pagese në segmentin rrugor “**Unaza Lindore, loti 3**” **Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3., nga ARSH-ja është bërë kërkesa për c ‘ngurtësim pagese e shoqëruar me tabelat përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimeve nga z.B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Për këtë segment rrugor siç përmendëm ka dalë V.M.K.Nr. 769, datë 20.12.2017për objektin truell me vlerë shpronësimi 1,971,036 lekë.

**1.6-**Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor “**Unaza Lindore, loti 3**” **Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të





pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3, nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelat përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimeve nga z.B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Paga është kryer në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Udhëzimin e Ministrisë së financave nr.7, ARSH-së të protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me nr.8325, datë 27.04.2018 “Dërgim listë pagesë” për pagesa nga llogaritja “Fondi i shpronësimeve” nga ku pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë 11,610,000 lekë, me objekt ndërtesë, me sipërfaqen 129(m<sup>2</sup>).

**1.7-Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor “Unaza Lindore, loti 3” Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3, nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelat përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimeve nga z.B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. . Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë 19,050,000lekë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 300(m<sup>2</sup>) truall, me vlerë 9,381,000 lekë dhe për sipërfaqen 87,9(m<sup>2</sup>) ndërtesë, me vlerën 9,669,000 lekë.

**1.8-Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor Unaza Lindore, loti 3” Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3, nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelat përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimeve nga z.B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. . Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 99(m<sup>2</sup>) ndërtesë, me vlerën 6,583,500 lekë.

**1.9-Në lidhje me kërkesën për shpronësim në segmentin rrugor Unaza Lindore, loti 3” Tiranë** miratuar me vendimin e nr.769, datë 20.12.2017, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë të paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë, Loti3, nga ARSH-ja është bërë kërkesa për shpronësim e shoqëruar me tabelat përkatëse për këtë qëllim, si dhe është përgatitur dosja e shpronësimeve nga z.B.H, specialist në Drejtorinë e Shpronësimeve. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet është kompensuar në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, për sipërfaqen 99(m<sup>2</sup>) ndërtesë, me vlerën 6,583,500 lekë.

### III. PROKURIMI I FONDEVE PUBLIKE

ARRSH gjatë vitit 2017 dhe 2018, në zbatim të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ka realizuar procedurat e prokurimi të hapura për punë si më poshtë:



## KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Në vitin 2017 ka realizuar 10 procedura prokurime të hapura me fond limit në vlerën 4,083,687,000 lekë, pa TVSH dhe ka lidhur 10 kontrata në vlerën 4,819,643, 000 lekë, me TVSH.

Në vitin 2018 ka realizuar 19 procedura prokurime me fond limit në vlerën 20,061,599,000 lekë pa TVSH dhe ka lidhur 19 kontrata në vlerën 20,839,746,000 lekë me TVSH

Nga auditimi, u krye me zgjedhje në disa procedura të hapura me vlera kontrate të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, u konstatua menaxhim jo i mirë i fondeve buxhetore dhe përdorim e tyre pa efektivitet gjatë realizimit të procedurave të prokurimit, si më poshtë:

#### **1. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500, rruga Milot - Skuraj”, të realizuar në vitin 2017:**

Të dhënat për procedurën e prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit M.SH A.Z Th. Xh	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave D. F E. H A.H
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 273,757,177 lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) 232,470,379 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 41,286,798 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data <b>20.10.2016</b>	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 13 OE, b) S’kualifikuar 12 OE, c) Kualifikuar 1 OE	10. Vlera e kontratës (me tvsh) 278,964,454 lekë

Nga auditimi u konstatua:

#### **- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të punëve janë hartuar nga projektuesi dhe janë miratuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### **-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij



tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret të veçanta kualifikuese.

### - Përzgjedhja e operatorit fitues:

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 13 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	V....	268 305 776	Kualifikuar	
2	V&V.....	232 470 379. <sup>58</sup>	Kualifikuar	Ne vend të I-të
3	A.....	217 450 999. <sup>5</sup>	S 'Kualifikuar	
4	A.....	190 560 731	S'kualifikuar	
5	A.....	244 081 110	S'kualifikuar	
6	B.....	223 778 008. <sup>1</sup>	S'kualifikuar	
7	C.....	246 211 192. <sup>5</sup>	S'kualifikuar	
8	G.....	215 783 596. <sup>88</sup>	S'kualifikuar	
9	Gj.....	245 160 273. <sup>8</sup>	S'kualifikuar	
10	B.....	235 591 650	S'kualifikuar	
11	V.....	268 305 776	S'kualifikuar	
12	V.....	273 435 726. <sup>38</sup>	S'kualifikuar	
13	V. H	205 557 713. <sup>2</sup>	S'kualifikuar	

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe nga 13 operatorët, ka kualifikuar vetëm operatorin V... vlerë oferte me ofertën ekonomike në vlerën 268 305 776lekë, pa TVSH dhe ka s'kualifikuar 12 operatorët e tjerë.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit të 13 operatorëve të mësipërm u konstatua se, KVO i ka skualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik 7 operatorë, sepse nuk plotësonin disa nga kriteret ligjore dhe të kriteret e veçanta, të vendosura në Dokumentet e tenderit, konkretisht: BOE “A.....”, BOE “B & R”, OE “Gj...”, OE “C...” dhe OE “V..” (për të parë arsyet e skualifikimeve më hollësisht referoju projektraportit). Ndërsa 5 operatorët e tjerë, i ka skualifikuar për këto arsye:

**1. Operatori ekonomik “A. T.”,** sipas KVO rezulton se nuk plotëson kriteret e mëposhtme të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

-Sipas vërtetimit nr.19615 datë 28.09.2016 lëshuar nga DR e Tatimeve, kompania ka një detyrim prej 1 670 176 lekë për taksën e rentës minerale. Kjo në kundërshtim me pikën 2, shtojca 10 - Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, ku përcaktohet se: “Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: “Një dokument që vërteton se (subjekti juaj): a) ka plotësuar detyrimet fiskale, b)ka



*paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore. Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2) duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës”.*

*-Nuk plotëson kriterin e vendosur në DST pika 2.3, Kapaciteti teknik, i cili përcakton: ”Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në vlerë jo më të vogël se 100 000 000 lekë që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Ose, b) punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 500 000 000 lekë. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”, pasi për objektin “Punime për ndërtimin e rrugës Shkodër – Hani i Hotit, pjesa urbane”, dokumentacioni është i pasaktë: situacioni përfundimtar nuk është në gjuhën shqipe. Kjo bie në kundërshtim me pikën 4.6, Seksioni 4 i dokumenteve të tenderit ku përcaktohet se gjuha e hartimit të ofertave është shqip. Në kriteret e vecanta të tenderit përcaktohet se: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”. Ndërsa objekti: “Mbrojtja dhe rehabilitimi i argjinaturës së Lumit Buna në zonën Dajç, loti 2” nuk plotëson vlerën e kërkuar sipas DST për një objekt të vetëm.*

*-Në kundërshtim me pikën 2 të shtojcës 10 të DST-Kriteret e vecanta të kualifikimit- operatori nuk ka paraqitur Vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.*

*Kjo në bazë të nenit 26/10 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i cili parashikon si më poshtë:*

*“Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuruar sipas LPP-së, operatorët ekonomikë që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit”.*

**Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit u konstatua:**

*Së pari, vërtetimi nr.19615 datë 28.09.2016 i lëshuar nga DR e Tatimeve vërteton se, kompania nuk ka detyrim për TVSH, për tatim fitimin, për kontributet e sigurimeve shoqërore shëndetësore, tatimin mbi të ardhura personale, por ka një detyrim për taksën e rentës minerale prej 1,670,176 lekë, për të cilën ndodhen në proces apleimi. Sic thotë edhe vete Drejtoria e Tatimeve në këtë vërtetim për detyrimin e rentës minerale prej 1,670,176 lekë ky operator*



është në proces apelimi (gjykimi) nga Drejtoria e Tatimeve. Dhe kuptohet qartë, përderisa nuk ka përfunduar procesi apelimit dhe nuk ka dalë Vendim i Formës së prerë për shlyerjen e këtij detyrimi, ky operator është i prezumuar nga ky detyrim.

Së dyti, për mos plotësimin e kriteri të e vendosur në DST pika 2.3, Kapaciteti teknik, sipas KVO ky operator, për objektin “*Punime për ndërtimin e rrugës Shkodër – Hani i Hotit, pjesa urbane*” nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë, pasi situacioni përfundimtar nuk është në gjuhën shqipe. Për këtë skualifikim KVO ka vepruar në kundërshtim me DT sepse, në këtë pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” të DT kërkohet që, në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektori publik, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, të paraqitet vërtetim i lëshuar nga një ent publik ku të shënohen vlera koha dhe natyra e punës së bërë, formulari i vlerësimit konform Shtojcës 8 ( pjesë e këtyre dokumenteve standarde të tenderit) si dhe kopje e kontratës së nënshkruar me autoritetin kontraktor për objektin e realizuar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, të paraqiten si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, shoqëruar me situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit dhe faturat tatimore.

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në sistem ky operator për plotësimin e këtij kriteri, ka paraqitur: vërtetim , (formularin e vlerësimit konform Shtojcës 8 të DST) të lëshuar nga vetë Autoriteti Kontraktor, (nënshkruar nga Drejtori I Përgjithshëm i ARRSH) ku është shënuar vlera prej 7,177,659.30 Euro, koha dhe natyra e punës së bërë, kopje e nënkontratës së nënshkruar me kontraktorin, për objektin e realizuar “*Punime për ndërtimin e rrugës Shkodër – Hani i Hotit, pjesa urbane*” me vlerë 7,177,659.30 Euro, aktkolaudimin dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim të punimeve të firmosur nga grupi i kolaudimit të ARRSH, si dhe situacionin e punimeve në gjuhën italiane të shoqëruar me faturat tatimore me TVSH në gjuhën shqipe. Mirëpo siç u tha më sipër, në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektori publik, duhej të paraqitej vetëm formulari i vlerësimit konform Shtojcës 8 të DST dhe kopje e kontratës së nënshkruar dhe nuk kërkohet paraqitja e situacionit. Kështu, kontrata e mësipërme është për punë publike dhe ky dokument (situacioni) edhe pse është hedhur në sistem nuk duhej të merrej fare në shqyrtim nga KVO sepse nuk kërkohet për punët publike, dhe jo më tej të bëhet shkak për skuailifikim. Megjthëatë edhe sikur u morë në shqyrtim nga KVO sepse këtë kontratë mundë ta këtë konsideruar punë në sektorin privat, përsëri nuk përbën shkak për skualifikim sepse mos përkthimi i zërave të situacionit i cili është shoqëruar me fatura tatimore në shqip, përbën devijim fare të vogël që nuk ndikon në ekzekutimin me sukses të kontratës.

Së treti, për mos paraqitjen e Vërtetimit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmohet se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, u konstatua se:

Për këtë skualifikim, KVO ka vepruar në kundërshtim me DT sepse, Operatori ekonomik në çastin e hapjes së ofertave nuk ka qenë fitues dhe nuk ka kontrata apo nënkontrata të lidhura a në proces për t'u lidhur, me ARRSH. Pra ky operator nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me ARRSH dhe njëherazi nuk i lind e drejta e kërkimit të vërtetimit pranë këtij Autoriteti Kontraktor. Duhet theksuar se, në zbatim të rregullave të prokurimit publik AKka të drejtën e





verifikimit, aq më tepër kur në rastin konkret kemi të bëjmë me vetë AK (ARSH) i cili ka të drejtën e lëshimit të këtij vërtetimi dhe njëherazi zhvillon këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim nëse AK do të kishte dyshime se operatori “A...” ka marrëdhënie me ARSSH, mjaftonte të bënte një verifikim të kontratave me subjektet përkatëse dhe nëse rezultonte se kishte kontrata të lidhura me këtë operatorë të cilat nuk ishin realizuar në masën 70% duhej t’ia ja bënte të ditur dhe ta skualifikonte nga procedura e prokurimit. Por ky operator në kohën e hapjes së ofertave nuk ka pasur kontrata të lidhura me ARSH

**2. Operatori ekonomik “V. H”** sipas KVO rezulton se, nuk plotëson kriteret e mëposhtme të përcaktuara në dokumentet e tenderit:

Në mbështetje të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të pikës 2 të shtojcës 10 të DST, Kriteret e veçanta të kualifikimit, operatori duhet të paraqesë *“Vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t’u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës”*.

Sipas vërtetimit nr.8472/1 datë 17.10.2016 që operatori ka paraqitur, ky i fundit ka lidhur me ARSSH kontratën nr.6121/4 datë 06.09.2016 me objekt: *“Riveshje dhe sistemim asfaltim Rruga Elbasan-Banjë loti 1, shtesë punimesh”*, punimet e së cilës nuk kanë filluar për arsye të mungesës së përcaktimit të mbikëqyrësit të punimeve. Vërtetimi i lëshuar nuk përkon me rastet përjashtimore të parashikuara në VKM nr.402, datë 13.05.2015 që janë shprehimisht: *vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si KUZ, OSHEE etj; dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike; vonesa në shpronësimin e subjekteve, të cilave u përket prona; ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim; rishpërndarje të fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit*

Gjithashtu, në bazë të grafikut të punimeve kjo kontratë ka kohëzgjatje 6 muaj dhe, nga momenti i lidhjes së kontratës deri në hapjen e ofertave datë 20.10.2016 gjithsesi operatori nuk do të kishte realizuar 70% të punimeve. Kjo në bazë të VKM-së nr.402 të sipërpërmendur ku përcaktohet se: *“Në çdo rast, një vërtetim i tillë nuk do të lëshohet për subjektet nëse, sipas grafikut të punimeve pjesë e kontratës, deri në periudhën në fjalë, ato nuk do të mund të kishin kryer më shumë se 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës”*.

-Nuk ka paraqitur dokumentacion provues për mjetin e kërkuar në DST: *“Ekskavator me zinxhir 2m<sup>3</sup> Tip Polipo”*.

-Në kundërshtim me përcaktimin në kriteret e veçanta të tenderit, sipas të cilit operatori duhet të deklarojë se *makineritë/mjetet nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi*, sipas shtojcës nr.9 të paraqitur më datë 20.10.2016, rezulton se disa nga mjetet janë paraqitur edhe në deklaratën e makinerive për procedurën e prokurimit me objekt: *“Ndërtim mbrojtja nga lumi km.16+200, aksi rrugor Elbasan - Librazhd”*.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit u konstatua:



Së pari, në lidhje me plotësimin e kriterit të veçantë se, operatori duhet të paraqesë “Vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës”, konstatua se:

Ky operatore ka paraqitur vërtetimit nr.8472/1 datë 17.10.2016 të lëshuar nga vetë ARRSH që vërteton se, ka lidhur me ARRSH kontratën nr.6121/4 datë 06.09.2016 me objekt: “Riveshje dhe sistemim asfaltim Rruga Elbasan-Banjë loti 1, shtesë punimesh”. Por, siç thotë edhe vetë vërtetimi këto punime punimet nuk kanë filluar për arsye të mungesës së përcaktimit të mbikëqyrësit të punimeve. Pra punimet nuk kanë filluar të zbatohen jo për arsye të operatorit, por për arsye të vetë ARSH që nuk ka përcaktuar mbikëqyrësin e punimeve. Ndërsa pretendimi I KVO se, në bazë të grafikut të punimeve kjo kontratë ka kohëzgjatje 6 muaj dhe, nga momenti i lidhjes së kontratës deri në hapjen e ofertave datë 20.10.2016 gjithsesi operatori nuk do të kishte realizuar 70% të punimeve, është pretendim hipotetik sepse KVO nuk mundë ta dinte nëse e realizonte apo jo 70% të punimeve nëse fillimi I zbatimit të kontratës do të fillonte brenda afateve të kontratës.

Së dyti, në lidhje me mos paraqitjen e dokumentacionit provues për mjetin e kërkuar “Ekskavator me zinxhir 2m<sup>3</sup> Tip Polipo” dhe mos deklarimin se makineritë/mjetet pasi disa nga mjetet janë paraqitur edhe në deklaratën e makinerive për procedurën tjetër të prokurimit me objekt: “Ndërtim mbrojtja nga lumi km.16+200, aksi rrugor Elbasan - Librazhd”, nuk bëjnë shkak për skualifikim sepse këto mangësi janë devijime fare të vogla që nuk ndikojn në ekzekutimin me sukses të kësaj kontrate.

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “G. . & F” sipas KVO rezulton se nuk plotëson kriteret e mëposhtme për kualifikim:**

Në kundërshtim me pikën 2 të shtojcës 10 të DST-Kriteret e veçanta të kualifikimit- operatori Florida nuk ka paraqitur Vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

Kjo në kundërshtim me nenin 26/10 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i cili parashikon si më poshtë:

“Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuruar sipas LPP-së, operatorët ekonomikë që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë



*publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit”.*

-Sipas përcaktimit në kriteret e veçanta të tenderit, çdo operator duhet të paraqesë deklaratë se: *“...makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt si dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi”.* Operatori G... mjetet e deklaruar në këtë procedurë i ka paraqitur edhe në projektin e *“Mirëmbajtjes së rrugëve me performancë”*, projekt që po prokuron ARRSH, për të cilin nuk është shpallur ende fituesi.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit u konstatua:

Së pari, për mos paraqitjen e Vërtetimit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të operatorit “Florida”, KVO ka vepruar në kundërshtim me DT sepse, Operatori ekonomik në çastin e hapjes së ofertave nuk ka qenë fitues dhe nuk ka kontrata apo nënkontrata të lidhura a në proces për t'u lidhur, me ARRSH. Pra ky operator nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me ARRSH dhe njëherazi nuk i lind e drejta e kërkimit të vërtetimit pranë këtij Autoriteti Kontraktor. Duhet theksuar se, në zbatim të rregullave të prokurimit publik AK ka të drejtën e verifikimit , aq më tepër kur në rastin konkret kemi të bëjmë me vetë AK (ARSH) i cili ka të drejtën e lëshimit të këtij vërtetimi dhe njëherazi zhvillon këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim nëse AK do të kishte dyshime se operatori “Alb Tiefbau” ka marrëdhënie me ARRSH, mjaftonte të bënte një verifikim të kontratave me subjektet përkatëse dhe nëse rezultonte se kishte kontrata të lidhura më këtë operatorë të cilat nuk ishin realizuar në masën 70% duhej t’ia ja bënte te ditur dhe ta skualifikonte nga procedura e prokurimit. Por ky operator në kohën e hapjes së ofertave nuk ka pasur kontrata të lidhura me ARSH

Së dyti, KVO ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse në lidhje që operatorit “G...”, mjetet e deklaruar në këtë procedurë i ka paraqitur edhe në projektin e *“Mirëmbajtjes së rrugëve me performancë”*, projekt që po prokuron ARRSH, për të cilin nuk është shpallur ende fituesi, nuk bëjnë shkak për skualifikim sepse nëse do të shpallej fitues në këtë procedurë prokurimi, nuk do të shpallej fitues në procedurën e prokurimit *“Mirëmbajtjes së rrugëve me performancë” se, hapja e kësaj procedurë do të bëhej mbas realizimit të procedurës së prokurimit në fjalë.* Megjithatë këto mangësi janë devijime fare të vogla që nuk ndikojnë në ekzekutimin me sukses të kësaj kontrate.

**4.Bashkimi i operatorëve ekonomikë “A. & A” sipas KVO rezulton se nuk plotëson kriteret e mëposhtme për kualifikim:**

-Në kundërshtim me pikën 2 të shtojcës 10 të DST, Kriteret e veçanta të kualifikimit, operatori A.....nuk ka paraqitur vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.





-Në kundërshtim me pikën 2 të shtojcës 10 të DST, Kriteret e veçanta të kualifikimit, operatori A.... nuk ka paraqitur *vërtetim* nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.

-Në kundërshtim me përcaktimin në kriteret e veçanta të tenderit, sipas të cilit operatori duhet të deklarojë se *makineritë/mjetet nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi*, sipas shtojcës nr.9 të paraqitur më datë 20.10.2016 rezulton se mjetet e A..... janë paraqitur edhe në deklaratën e makinerive për procedurën e prokurimit me objekt: “*Ndërtim mbrojtja nga lumi km.16+200, aksi rrugor Elbasan - Librazhd*”.

-Nuk ka dokumentacion provues për mjetin e kërkuar në DST: “*Ekskavator me zinxhir 2m<sup>3</sup> Tip Polipo*”.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit u konstatua:

Së pari, për mos paraqitjen e Vërtetimit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të BO “A....KVO ka vepruar në kundërshtim me DT sepse, ky operatori në çastin e hapjes së ofertave nuk ka qenë fitues dhe nuk ka kontrata apo nënkontrata të lidhura a në proces për t'u lidhur, me ARSSH. Pra ky operator nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me ARSSH dhe njëherazi nuk i lind e drejta e kërimit të vërtetimit pranë këtij Autoriteti Kontraktor. Duhet theksuar se, në zbatim të rregullave të prokurimit publik AK ka të drejtën e verifikimit, aq më tepër kur në rastin konkret kemi të bëjmë me vetë AK (ARSH) i cili ka të drejtën e lëshimit të këtij vërtetimi dhe njëherazi zhvillon këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim nëse AK do të kishte dyshime se operatori “A...” ka marrëdhënie me ARSSH, mjaftonte të bënte një verifikim të kontratave me subjektet përkatëse dhe nëse rezultonte se kishte kontrata të lidhura më këtë operatorë të cilat nuk ishin realizuar në masën 70% duhej t'ia ja bënte te ditur dhe ta skualifikonte nga procedura e prokurimit. Por ky operator në kohën e hapjes së ofertave nuk ka pasur kontrata të lidhura me ARSH

Së dyti, KVO ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik për skualifikimi e operatorit “Victoria Invest”, në lidhje se ka deklaruar që: “*...makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt*, por rezulton se mjetet e A..... janë paraqitur edhe në deklaratën e makinerive për procedurën e prokurimit me objekt: “*Ndërtim mbrojtja nga lumi km.16+200, aksi rrugor Elbasan - Librazhd*”. Po kështu ka vepruar kundërshtim me rregullat e prokurimit publik edhe për arsyen tjetër të skualifikimit se nuk ka dokumentacion provues për mjetin e kërkuar në DST: “*Ekskavator me zinxhir 2m<sup>3</sup> Tip Polipo*”. Të dy këto mangësi mund të konsiderohen devijime fare të vogla që nuk ndikojnë në ekzekutimin me sukses të kësaj kontrate.

**5. BOE “V& V”, sipas KVO rezulton se nuk plotëson kriteret e mëposhtme për kualifikim:**

-Nuk është paraqitur nga të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në bashkimin e operatorëve ekonomikë *vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmon se, nëse është fitues dhe/apo*



ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, por vetëm nga “V....”. Kjo në kundërshtim me kriterin e veçantë të përcaktuar në tender dhe me nenin 26/10 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i cili parashikon si më poshtë:

*“Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuruar sipas LPP-së, operatorët ekonomikë që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit”.*

-Për sa i përket kapaciteteve teknike mbi mjetet/makineritë, operatori V.... ka deklaruar se mjetet nuk janë deklaruar konform kriterit të përcaktuar në DST se: “...makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt si dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi”. Rezulton se, ndryshe nga sa ka deklaruar, ky operator më datë 20.10.2016 në sistem ka paraqitur dëshmi/dokumentacion/foto për mjetet: Ekskavator hitachi deklaratë doganore R 7894, Ekskavator hitachi deklaratë doganore R 6934, Autobot uji AA026MZ, edhe në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim mbrojtja nga lumi km.16+200, aksi rrugor Elbasan - Librazhd”.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit u konstatua:

Së pari, për mos paraqitjen e Vërtetimit nga Autoriteti Rrugor Shqiptar të të dy operatorëve, KVO ka vepruar në kundërshtim me DT sepse, të dy këta operator në çastin e hapjes së ofertave nuk ka qenë fitues dhe nuk kanë kontrata apo nënkontrata të lidhura a në proces për t'u lidhur, me ARSSH. Pra këta operatorë nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me ARSSH dhe njëherazi nuk i lind e drejta e kërimit të vërtetimit pranë këtij Autoriteti Kontraktor. Duhet theksuar se, në zbatim të rregullave të prokurimit publik AK ka të drejtën e verifikimit, aq më tepër kur në rastin konkret kemi të bëjmë me vetë AK (ARSH) i cili ka të drejtën e lëshimit të këtij vërtetimi dhe njëherazi zhvillon këtë procedurë prokurimi. Në këtë kuptim nëse AK do të kishte dyshime se operatori “A.....” ka marrëdhënie me ARSSH, mjaftonte të bënte një verifikim të kontratave me subjektet përkatëse dhe nëse rezultonte se kishte kontrata të lidhura më këtë operatorë të cilat nuk ishin realizuar në masën 70% duhej t'ia ja bënte te ditur dhe ta skualifikonte nga procedura e prokurimit. Por ky operator në kohën e hapjes së ofertave nuk ka pasur kontrata të lidhura me ARSH

Së dyti, KVO ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik për skualifikimi e operatorit “V.....”, në lidhje se ka deklaruar që: “...makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt”, por rezulton se, ndryshe nga sa ka



deklaruar, ky operator më datë 20.10.2016 në sistem ka paraqitur dëshmi/dokumentacion/foto për mjetet: Ekskavator hitachi deklaratë doganore R 7894, Ekskavator hitachi deklaratë doganore R 6934, Autobot uji AA026MZ, edhe në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim mbrojtja nga lumi km.16+200, aksi rrugor Elbasan - Librazhd”. Këto mangësi janë devijime fare të vogëla që nuk ndikojnë në ekzekutimin me sukses të kësaj kontrate.

Për sa më sipërm shikohet qartë se, të 5 (8-12) operatorët janë skualifikuar pothuajse për të njëjta arsye, për mos paraqitjen e vërtetimit që nuk kanë kontrata të lidhura me ARSH e cila është vetë në cilësinë e AK dhe për mangësi në deklaratat për angazhimin apo jo të makinerive dhe mjeteve ne kontratat të tjera, apo nuk kanë dokumentacion provues për 1 mjet.

Njëri nga të katër operatorët e skualifikuar, pikërisht, BO, “V.....” ka bërë ankesë pranë AK për skualifikim të pa drejtë të tij. AK ka marrë në shqyrtim ankesën duke ngarkuar edhe komisioni përkatës për shqyrtimin e saj dhe në përfundim komisioni i shqyrtimit ka njoftuar Titullarin e AK që të mos pranojë ankesën e këtij operatori.

Ky operator nuk ka qenë dakord me përgjigjen e AK dhe ka paraqitur ankesë pranë Komisioni Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si në ankesën që bëri pranë AK.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KPP me Vendimin nr.954/2016, date 13.12.2016, Vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “V...”
2. Autoriteti Kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “V...” duke kualifikuar këta operatorë.

Në arsyetimin e këtij vendimi, KPP ka bërë në thelb, të njëjtën arsyetim dhe interpretim ligjor si arsyetimet dhe interpretimet e mësipërme të bëra nga auditimi.

Nga këto veprime kemi menaxhim jo të mirë të fondeve publike, nga diferenca e vlerës së ofertës së operatorit “Victoria Invest International&Viktoria Invest” të shpallur fitues me vendim të KPP dhe vlerës së ofertës së 4 operatorëve të tjerë të s’kualifikuar në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Konkretisht, këta operatorë duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik sepse i plotësonin të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në DT, për më tepër duheshin kualifikuar në zbatim të vendimit të KPP nr.954/2016, date 13.12.2016, ashtu sic u kualifikua BO V....., dhe pas shqyrtimit të ofertave ekonomike, duhej të shpallej fitues operatori “A.” sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatori fitues dhe operatorët e tjerë që duhet të kualifikoheshin.

Nga këto veprime, nuk janë mirë menaxhuar fondet buxhetore, për pasojë, diferenca e vlerës së ofertës së operatorit fitues BO “V. ....” me vlerën e ofertës së operatorit “A...” përbën përdorim të fondeve pa efektivitet dhe ekonomikitet. Diferenca e këtyre ofertave ekonomike është **në vlerën 50,291,577 lekë**, me TVSH (232,470,379.<sup>58</sup> lekë -190 560 731 lekë x20%).



*Nga Autoriteti Kontraktor nuk janë paraqitur observacione për projektreportin, ndërsa për aktkonstatimin e mbajtur janë paraqitur observacione të cilat janë shqyrtuar dhe janë trajtuar në projektreport.*

## 2. Procedura e prokurimit me objekt “Plotësimi, rakordimi, masa mbrojtëse dhe siguria rrugore ne viaduktet e aksit Kukës - Morine” të realizuar në vitin 2018:

Të dhënat për procedurën e prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr.26 datë 28.05.2018 Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit L.S G.R M.SH	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave E.S DH.L L.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 208,304,496.26 lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) 207,331,536 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 972,960 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 16.07.2018	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 4 OE b) S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE	10. Vlera e kontratës (me tvsh) 248,797,843 lekë

Nga auditimi u konstatua:

### - Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të punëve janë hartuar janë hartuar nga projektuesi dhe janë miratuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### -Hartimi i dokumenteve të tenderit:

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

### - Përzgjedhja e operatorit fitues:



Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	V...	207.331.536	Kualifikuar	
2	C.....	176.424.704,12	S 'Kualifikuar	Ne vend të I-të
3	R.....	187.473.486,8	S 'Kualifikuar	
4	S.....	208.099.230	S'kualifikuar	

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe nga 4 operatorët, ka kualifikuar vetëm operatorin V..... me ofertën ekonomike në vlerën 207.331.536 lekë, pa TVSH dhe ka s'kualifikuar 3 operatorët e tjerë.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit të 3 operatorëve u konstatua se, operatorët ekonomik: “R.....” dhe “S..” ja në skualifikuar me të drejtë, në përputhje me rregullat e prokurimit publik, sepse nuk plotësonin disa nga kriteret ligjore dhe të kriteret e veçanta, të vendosura në Dokumentet e tenderit, (për të parë arsyet e skualifikimeve më hollësisht referoju projektraportit). Ndërsa operatorin tjetër “C.....” është skualifikuar për këto arsye:

Sipas KVO rezulton se nuk ka paraqitur dokumentet ne përputhje me kriteret e dhëna ne dokumentet e tenderit si me poshtë:

Ne lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik siç parashikohet ne piken 2.3.12, te kriterëve te dhëna ne dokumentet e tenderit, rezulton qe ky operator nuk ka paraqitur dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion si:

-Makineri vijëzimi termoplastike, në pronësi ose me qira, copë 1; është paraqitur kontrata e qerases me subjektin ”O. S.”, nënshkruar me date 29.06.2018, me objekt dhënie me qira e makinerisë vijëzimit, vërtetuar me deklaratën e ç’doganimit, nr. R7534 date 09.02.2015. Referuar kësaj deklarate rezulton qe makineria është thjeshte vijëzimi dhe jo makine vijëzimi termoplastike.

-Autobitumatriçe, në pronësi ose me qira, copë 1, rul vibrus gome-hekur me kapacitet mbi 16 ton në pronësi ose me qira, copë 1, rul vibrus gome – gome me kapacitet mbi 12 ton, në pronësi ose me qira, copë 1, rul vibrus hekur – hekur me mbi 8 ton, në pronësi ose me qira, copë 1, asfaltoshtrues, në pronësi ose me qira, copë 1; eshte paraqitur kontrata e qerases me subjektin ”ISPP sha”, nënshkruar me date 04.07.2018, me objekt dhënie me qira te kapaciteteve te mësipërme. Bazuar ne dokumentacionin argumentues, rezulton qe këto mjete janë prone e Raiffeisen Leasing, dhe jo e ISPP sha, nënshkruese e kontratës se qerases.

-Ruli tip ”Bomag bë 135 AD”, i deklaruar si rul me goma, rezulton te jete hekur – hekur. Ruli gome – hekur ”dynapac CA301, është me peshe operative 13 t, ne kundërshtim me kriteret e dhëna, ku kërkohet 16 t.



-Autovinc min 60 ton, në pronësi ose me qira, Copë 1; *eshte paraqitur kontrata e qerese me subjektin fizik "M.Gj", nënshkruar me date 10.10.2016, me objekt dhënie me qira te dy autovincave. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur, "lejeve te qarkullimit", rezulton qe masa maksimale e autorizuar për ta është përkatësisht 48 dhe 36 ton, ne kundërshtim me kriterin e dhënë.*

Nga auditimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik të këtij operatori rezultoi se:

- Në lidhje me makineritë e vijëzimit në DT janë kërkuar 2 makineri vijëzimi, 1 Makineri vijëzimi me boje bikomponente dhe tjetra makinë vijëzimi termoplastike. Operatori për të dy këto makineri ka paraqitur dy kontrata për marrjen me qira të tyre, respektivisht 1 kontratë për marrje me qira makineri vijëzimit me subjektin "O....", nënshkruar me date 29.06.2018 vertetuar kjo me deklaratën e ç 'doganimit, nr. R7534 date 09.02.2015 dhe një kontratë tjetër për marrje me qira makineri vijëzimit me subjektin A.I, vërtetuar dhe kjo me deklaraten e ç` doganimit, nr. R47150, datë 19.05.2016.

Sa më lartë, ky operatorë i ka paraqitur makineritë dhe i plotëson këtë kërkesë të kërkuar në DT.

- Në lidhje me, Autobitumatriçe, rul vibrus gome-hekur me kapacitet mbi 16 ton, rul vibrus gome – gome me kapacitet mbi 12 ton, rul vibrus hekur – hekur me mbi 8 ton, asfaltoshtrues copë 1; është paraqitur kontrata e qerese me subjektin "I..... sha", nënshkruar me date 04.07.2018, me objekt dhënie me qira te kapaciteteve te mësipërme, po bazuar ne dokumentacionin argumentues, rezulton qe këto mjete janë prone e Raiffeisen Leasing, dhe jo e I... sha, nënshkruese e kontratës se qerese.

Për këto makineri, Operatori ekonomik "C.." ka paraqitur kontratën e marrjes me qira nga subjekti "I...". Pronësia e këtyre makinerive nga shoqëri "I... sha", vërtetohet me dokumentacionin e paraqitur, si leje qarkullimi, certifikatat e kontrollit teknik, etj. Për të vërtetuar se këto makiniri i ka blerë me kredi nëpërmjet bankës ka paraqitur edhe kontratën e shtijes-blerjes me NR.KO-01-2008, QF22.01.2008 me nje kompani të huajm W....., të lidhur me Raiffeisen Leasing.

Pra vërteton qartësisht se këto makineri janë blerë me kredi ( Leasing) Raiffeisen Leasing dhe janë pronë e saj dhe jo e bankës dhe ky krit plotësohet në përputhje me kërkesat e TD.

- Në lidhje me, Ruli tip "Bomag bë 135 AD", i deklaruar si rul me goma, rezulton hekur – hekur. Ruli gome – hekur "dynapac CA301, eshte me peshe operative 13 t, ne kundërshtim me kriteret e dhena, ku kerkohet 16 t dhe për Autovincin min 60 ton, eshte paraqitur kontrata e qerese me subjektin fizik "M.Gj", nenshkruar me date 10.10.2016, me objekt dhenie me qera te dy autovincave. Referuar dokumentacionit bashkelidhur, "lejeve te qarkullimit", rezulton qe masa maksimale e autorizuar per ta eshte perkatesisht 48 dhe 36 ton, ne kundërshtim me kriterin e dhene.

Siç shikohet këto mangësi apo paqartësi në dokumentacionin e këtyre makinerive janë fare të vogla dhe KVO mundë ti trajtonte si devijime të vogla sepse nuk ndikojnë fare në ekzekutimin e kontratës.

Nga këto veprime nuk janë mirë menaxhuar fondet buxhetore, për pasojë diferenca prej **37,088,198 lekë** e vlerës së ofertës së operatorit "V...." të shpallur fitues me vlerën e ofertës së operatorit të s'kualifikuar "C...." përbën përdorim të fondeve pa efektivitet dhe economicitet.





*Nga Autoriteti Kontraktor nuk janë paraqitur observacione për projektreportin, ndërsa për aktkonstatimin e mbajtur janë paraqitur observacione të cilat janë shqyrtuar dhe janë trajtuar në projektreport.*

### 3. Procedura e prokurimit me objekt “Ndertim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 6, ” të realizuar në vitin 2018:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit me objekt:

1. Urdhër Prokurimi Nr.2.. datë Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A.K A.S E.S	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave M.SH L.M E.V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,388,910,889.26lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) 2,378,643,105lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 10,267,784 lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 03.09.2018	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar1 OE, c) Kualifikuar 2 OE	10. Vlera e kontratës (me tvsh) 2,854,371,726 lekë

Nga auditimi u konstatua:

#### **- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të punëve janë hartuar janë hartuar nga projektuesi dhe janë miratuar nga njësi e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### **-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësi e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kriterëve ligjore të përgjithshme të pranimit kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

#### **- Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH	Kualifikuar ose S'kualifikuar	Klasifikuar
1	A...	2,378,643,105.3	Kualifikuar	
2	G..	2,365,176,690.6	S 'Kualifikuar	Ne vend të I-të
3	G..	2,387,866,670	S 'Kualifikuar	

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe nga 3 operatorët, ka kualifikuar vetëm operatorin “A .” me ofertën ekonomike në vlerën 2,378,643,105.3 lekë, pa TVSH dhe ka s’kualifikuar 2 operatorët e tjerë.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit të 2 operatorëve u konstatua se, KVO i ka skualifikuar me të drejtë, në përputhje me rregullat e prokurimit publik operatorin **G...**, sepse nuk plotëson disa nga kriteret ligjore dhe të kriteret e veçanta, të vendosura në Dokumentet e tenderit, konkretisht, *(për të parë arsyet e skualifikimit të këtij operatori më hollësisht referoju projektraportit)*. Ndërsa operatorin “G...”, KVO e ka skualifikuar për këto arsye se, nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit si me poshtë:

Ne lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik siç parashikohet në piken 2.3.7, të kriterëve të dhëna në dokumentet e tenderit, rezultojnë që ky operator nuk ka paraqitur dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion si:

-fadrome me goma, në pronësi ose me qira, copë 1; graider, në pronësi ose me qira, copë 1, në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit nuk janë paraqitur *dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit lëshuar nga DPSHTRR (RSH), leje qarkullimi, certifikata e vlefshme e kontrollit teknik, figuracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.*

-koke terheqese + gjysem rimorkio, në pronësi ose me qira, copë 2; automjet bot uji, në pronësi ose me qira, copë 2; automjet autopompe betoni me krahe min.36 m, në pronësi ose me qira, copë 1; autobetoniere, në pronësi ose me qira, copë 3; automjet për vijëzim termoplastik spray, kapacitet mbajtës të bojës jo më pak se 4.5 ton, në pronësi ose me qira, copë 2; ekskavatorë lejlek me krahë min 18m, në pronësi ose me qira, copë 1; rrul ngjeshës me peshe operative mbi 15 ton në, pronësi ose me qira, copë 3; rrul asfalti gome-gome me peshe operative 20 ton, në pronësi ose me qira, copë 1; rrul asfalti gome-gome me peshe operative 12 ton, në pronësi ose me qira, copë 1; sonde shpimi ø 120, në pronësi ose me qira, copë 3; platforme ngritës me kosh për punime në lartësi, në pronësi ose me qira, copë 1; matrapik, në pronësi ose me qira, copë 2; freze asfalti, në pronësi ose me qira, copë 1; automjet batipal, në pronësi ose me qira, copë 1, në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit nuk është paraqitur asnjë dokumentacion nëse këto mjete janë ose mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

-Impiant asfalti në distance jo më lart se 70 km, në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi, Copë 1, rezultojnë që nga operatori ekonomik është paraqitur kontrata e qerases me subjektin B..., me 5387/4723. Sipas QKL-se rezultojnë që kjo fabrike ndodhet në fshatin Halil, Krujë, pra në distance më të madhe se 70 km, kjo në kundërshtim me kriterin e dhënë me sipër.



Nuk ka përmbushur piken 2.3.3 të dokumenteve tenderit pasi nuk disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, për *Arkitekt Peizazhi dhe Inxhinier Pyjore*, të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë noteriale pune edhe CV.

-Nuk ka përmbushur piken 2.3.9 të dokumenteve tenderit pasi nuk disponon certifikatën *ISO 5001 (Sistem I menaxhimit të Energjisë)*. *Organizmi certifikues të jete I akredituar për këto standarte nga organizmi kombëtar akreditimit (DPA) ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të operatorit Geci, konstatohet se, mangësitë apo paqartësi në dokumentacionin e këtyre makinerive të paraqitura janë të vogla dhe të pa përfillshme dhe KVO mundë ti trajtonte ato si, devijime të vogla, sepse nuk ndikojnë fare në ekzekutimin e kontratës.

Nga këto veprime nuk janë mirë menaxhuar fondeve buxhetore dhe për pasojë vlera prej 16,159,690 lekë, me TVSH e llogaritur si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “A....” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit “G....” të s’kualifikuar, është përdorur, pa efektivitet dhe ekonomikitet.

*Edhe për këto procedurë prokurimi, nga Autoriteti Kontraktor nuk janë paraqitur observacione për projekt raportin, ndërsa për aktkonstatimin e mbajtur janë paraqitur observacione të cilat janë shqyrtuar dhe janë trajtuar në projekt raport.*

#### **4. Procedura e prokurimit me objektin “Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja “**

##### **A. Procedura për hartimin e projektit të zbatimit:**

Me ligjin nr.109, datë 30.11.2017 “Për buxhetin të vitit 2018” ARRSH-si janë planifikuar fonde për investime në vlerën 15,150,041,000 lekë për ndërtime dhe përmirësime të infrastrukturës rrugore.

-Në zbatim të ligjit të buxhetit, Drejtorja e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës (DPBF) me shkresën e brendshme me nr.prot 14/1, datë 04.01.2018 i ka kërkuar Drejtorisë së Projekteve të Brendshme e të Huaja Teknike që të dërgojnë propozimet për detajimin e këtij buxheti për projektet që do të financohen gjatë vitit 2018.

-Me shkresë nr.prot.522/3, datë 25.01.2018, Drejtori i Përgjithshme i ARRSH-së i ka dërguar DPBF propozimin dhe listën e detajimit të buxhetit për objektet e reja që do të hapen dhe do të financohen gjatë vitit 2018 në vlerën **2,258,039,531**lekë, të paraqitur në tabelën në vijim:

Nr	NDËRTIME OBJEKTE TË REJA	Buxheti sipas PBA 2018-2020	Financimet 2018
----	-----------------------------	--------------------------------	-----------------



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

1	Plotësimi dhe përfundimi i punimeve të pakryera për segmentin rrugor Qukës –Qafë Pllocë , Loti I	370,000,000	0
2	Ndërtim nënkalimi hekurudhor Hd=10 m në Unazën Librazhd	42,039,531	42,039,531
3	Masa inxhinierike dhe plotësimi i rrugës Elbasan Gjinar	900,000,000	0
4	Ndërtim i rrugës Porto Romano Loti 3	1,200,000,000	0
5	<b>Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja</b>	<b>6,000,000,000</b>	<b>1,200,000,000</b>
	Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti I	2,400,000,000	480,000,000
	Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti II	2,400,000,000	480,000,000
	Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti III	1,200,000,000	240,000,000
6	<b>Korçë –Ersekë(Qafë Qarri-Ersekë Loti I &amp; Loti II)</b>	<b>4,800,000,000</b>	<b>0</b>
	Sistemim asfaltim aksi rrugor Qafë Qarri- Ersekë Loti I	2,400,000,000	0
	Sistemim asfaltim aksi rrugor Qafë Qarri- Ersekë Loti II	2,400,000,000	0
7	<b>By PASS-TEPELENË</b>	<b>3,650,000,000</b>	<b>576,000,000</b>
	Ndërtim By Pass Tepelenë Loti I	2,400,000,000	576,000,000
	Ndërtim By Pass Tepelenë Loti II	1,250,000,000	0
8	<b>Rikualifikim i akseve rrugore Unaza lindore Loti II dhe Loti III</b>	<b>2,200,000,000</b>	<b>440,000,000</b>
	Rikualifikim i akseve rrugore Unaza lindore Loti II	1,200,000,000	240,000,000
	Rikualifikim i akseve rrugore Unaza lindore Loti III	1,000,000,000	200,000,000
	<b>TOTALI</b>	<b>19,120,000,000</b>	<b>2,258,039,531</b>

Shkresa e sipërcituar me nr.prot.522/3, datë 25.01.2018 dhe lista e objekteve të reja është konceptuar nga Drejtori i Projekteve të Brendshme e të Huaja Teknike znj. Albana Ahmeti. Në këtë shkresë thuhet se: propozimet për këto objekte mbështeten edhe nga kërkesat e pushtetit vendor. Nga auditimi në lidhje me kërkesat e pushtetit rezultoi se, vetëm Bashkia e Tiranës ka shprehur një kërkesë për mundësinë e rehabilitimit të një projekti të segmentit rrugor “Mbikalimi i shkollës teknologjike- rrethrotullimi i Doganës” si pjesë e projektit të Unazës së madhe të Qytetit të financuar nga ARRSH. Konkretisht, shkresa e Bashkisë së Tiranës që i është dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH-së është firmosur nga z.T. T., Drejtor i Përgjithshëm i Punëve Publike të Bashkinë e Tiranës dhe mban nr. 3792, dhe datën 25.01.2018 që është edhe data e shkresës së sipërcituar për hapjen dhe financimin e objekteve të reja. Në këtë shkresë Bashkia e Tiranës shpreh edhe kërkesat specifike për rishikimin e projektit, dhe parametrat e rrugës duke propozuar ndërtimin e një rruge të tipit “A” Urbane. Por në këtë shkresë Bashkia nuk ka përcaktuar vlerën e përafërt të financimit buxhetor që duhet për ndërtimin e kësaj rruge, bazuar në terma reference apo të ndonjë studimi paraprak. Pra, pretendimi se, vlera e plotë e këtij objekti prej 6,000,000,000 lekë e parashikuar në buxhetin e ARRSH ka ardhur si propozim i pushtetit vendor nuk qëndron. Po kështu edhe nga ARRSH nuk janë hartuar terma reference apo të ndonjë studimi tjetër paraprak dhe nuk na u paraqit dokumentacion që të justifikonte mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e përafërt të këtij investimi si dhe kjo vlerë e konsiderueshme prej 6,000,000,000 lekë e parashikuar në buxhetin e ARRSH është e pa miratuar nga Këshilli Teknik i ARRSH. Pra kjo vlerë është planifikuar në buxhet në mënyrë apriori nga Drejtori i Projekteve të Brendshme e të Huaja Teknike znj. A. A. dhe më pas është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

-Sipas, listës së detajimit të buxhetit (shkresa nr.522/3, datë 25.01.2018), vlera e plote ë prej 6,000,000,000 lekë që i përket investimit për ndërtimin e 2.2 km rruge nga pallati me shigjeta deri te rrethrotullimi i Doganës është ndarë në tre Lote:Loti I - 2,400,000,000 lekë, Loti II- 2,400,000,000 lekë dhe Loti III -1,200,000,000 lekë. Mirëpo Bordi i Menaxhimit të ARSH, me Vendimin nr.2 datë 13.03.2018 ka miratuar detajimin e buxhetit për vitin 2018,2019 dhe 2020



ku përfshihen edhe financimet për ndërtimin e rrugës nga pallati me shigjeta deri te rrethrotullimi i Doganës. Konkretisht në lidhje me këtë projekt ka miratuar një buxhet të detajuar për të tre vitet 2018-2019-2020 , në vlerën totale prej **2,150,000,000 lekë**. Respektivisht për 2018 , janë parashikuar 1,200,000,000 lekë, për vitin 2019 janë parashikuar 470,000,000 lekë dhe për vitin 2019 janë parashikuar 480,000,000 lekë.

Nga sa më sipër rezulton se Bordi i Menaxhimit nuk ka miratuar vlerën prej 6,000,000,000 lekë të parashikuar apriori nga ARRSH, por ka miratuar vlerën e financimit për të tre objektet në shumën 2,150,000,000 lekë. Më pas, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën me nr. 3238/3, datë 23.03.2018, ka miratuar detajimin e buxhetit të ARRSH për vitet 2018, 2019 dhe 2020, konkretisht për vitin 2018 ka miratuar në shumën 1,200,000,000 lekë, për vitin 2019 në shumën 470,000,000 lekë dhe për vitin 2010 në shumën 480,000,000 lekë, pra në total vlera e plotë e financimit të këtij objekti (te tre Lotet) është miratuar edhe nga MIE në shumën 2,150,000,000 lekë, aq sa ka miratuar dhe Bordi I Menaxhimit të ARRSH.

Në vijim, mbas miratimit të buxhetit nga Bordi i Menaxhimit dhe MIE, Drejtori I Përgjithshëm ARRSH-së, me Urdhrin nr.51, datë 13.04.2018 ka ngritur një grup pune me 5 anëtarë për hartimin e termave të referencës dhe llogaritjen e fondit limit për hartimin e projektit të zbatimit për “Rehabilitim i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja”. Ne përfundim grupi i punës përgatiti termat e referencës për “Studim-projektim , në segmentin rrugor “Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja “dhe në zbatim të VKM nr .354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, llogariti vlerën e fondit limit për hartimin e projektit të zbatimit e cila ka dalë rreth 42,000,000 lekë me TVSH ( vlera e punës projektuese).Për hartimin e termave të referencave dhe llogaritjen e fondit limit të këtij i segmentit rrugor me gjatësi 2.2 km, me qëllim hartimin e projektit të zbatimit dhe financimin e tij, grupi i punës ka marrë për bazë dhe i është referuar objektit të përfunduar “Zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës, loti I”, pasi kjo rrugë është e tipit A dhe është e njëjtë me tipin e kësaj rruge që kërkohet të ndërtohet . Projekti i zbatimit të kësaj rruge është miratuar me Vendimin e ARRSH nr.51, date 11.10.2017. Sipas këtij projekti, kosto për 1km rrugë ka dalë 878,006,241 lekë/km dhe për gjatësinë 2.2 km të rrugës “Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja“ vlera totale e ndërtimit ka dalë 1,931,613,730 lekë dhe mbi këtë vlerë është llogaritur tarifa e projektimit që ka dalë rreth 42 milion lekë. Termat e referencës si dhe vlera e hartimit të projektit u miratuan në Këshillin Teknik, me Vendimin nr. 15, datë 20.04.2018.

Mbas miratimit të Termave të referencës për ndërtimin e rrugës “Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja” Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, me shkresë nr. 3625, datë 30.04.2018, i ka dërguar një “Ftesë për bashkëpunim” shoqërisë konsulentë “A...” ku i kërkon bashkëpunim për mundësinë e hartimit të një projekti teknik në përputhje me detyrën e projektimit të hartuar nga ARSH me , me VKT nr. 15, datë 20.04.2018 (Termt e Referncës të miratuar). Shoqëria konsulente “A.....” i përgjigjet ftesës për bashkëpunim me shkresën e protokolluar ne ARRSH me nr.prot 3625/1, datë 02.05.2018 në të cilën shprehet se: Pasi shqyrtuam kërkesën dhe detyrën e projektimit të hartuar nga Ju marrim përsipër realizimin e këtij projekti. Dhe në datën 25.05.2018 është lidhur kontrata e sponsorizimit me nr. 3625/2 ndërmjet A.... dhe ARRSH-së. Objekti I kësaj kontrate është njohja nga ana e Përfituesit (ARRSH) të shërbimit të



kryer nga Sponsorizuesi Shoqëria “A.” për hartimin e projektit Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja”, pa pagesë si sponsorizim në bazë të parashikimeve të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar. Vlera e punës sipas kontratës së sponsorizimit është përcaktuar nga ky projektues 27,275,742 lekë me TVSH, nga 42,000,000 lekë me TVSH që ishte llogaritur dhe miratuar nga ARRSH në termat e referencës.

Përzgjedhja e këtij projektuesi pa organizuar procedura prokurimi është në kundërshtim të hapur me nenin 10 Shërbimet e Konsulencë” të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin përcaktohet se:

*“Shërbimet e konsulencës shpallen në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj dhe në rregullat e prokurimit publik”.*

Po kështu edhe lidhja e kontratës së sponsorizimit bie ndesh me nenin 1 dhe nenin 2 të ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “për sponsorizimet” të cilat përcaktojnë se:

Neni 1: *“Ky ligj rregullon mbështetjen me ndihma financiare e materiale, të quajtura në vijim “sponsorizime”, të veprimtarive sociale e publike ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit. Sponsorizimi me qëllime të përfitimit ekonomik nga sponsorizuesi është i ndaluar”.*

Neni 2: *Sipas këtij ligji mund të sponsorizohen vetëm veprimtaritë e parashikuara në nenin 1, të cilat kryhen nga ente, institucione, shoqata dhe organizma që janë të njohur me ligj e që janë të regjistruara si subjekte juridike”.*

Siç tregohet, në nenin 1 nuk parashikohet që veprimtaritë e punëve publike të sponsorizohen nga subjektet fizike dhe juridik që kanë cilësinë e tregtarit. Megjithatë, nëse, shoqëria konsulente “A.....” iu përgjigj ftesës për bashkëpunim dhe mori përsipër realizimin e këtij projekti, falas, pa para, në formë sponsorizimi, duhet të arkëtonte më parë në arkën e shtetit (ARRSH) vlerën e punës projektuese prej 42 milion lekë që ARRSH e kishte llogaritur konform VKM nr.354, 11.05.2016, dhe pas përfitimit të kësaj shume, ARRSH detyrimisht duhet të organizonte procedura prokurimi në zbatim të nenit 10 dhe 34, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” sepse:

*Shërbimet e konsulencës janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese. Dhe në zbatim të nenit 37 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, konsulenti përzgjidhet në bazë të propozimeve teknike dhe vlerësimi i këtyre propozimeve, kryhet duke marrë parasysh këto kritere: përvojën e konsulentit; cilësinë e metodologjisë së propozuar; kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; transferimin e njohurive, etj.*

Sa sipër përzgjedhja e këtij konsulenti nuk ka kaluar më parë për tu vlerësuar për kriteret e mësipërme nga një komision konkurrimi, për pasojë përzgjedhja e tij çon në konflikt interesi dhe ndikon negativisht në cilësinë e projektit dhe në rritje fictive të kostos së objektit me efekte negative për buxhetin e shtetit.

Pas angazhimit të Shoqërisë konsulente “A.....” për realizimin e këtij projekti Drejtorit Përgjithshëm, me shkresë nr.3768, data 04.05.2018 ka dërguar në MIE Projekt buxhetin i investimeve rrugore për fazën e I të PBA për vitet 2019-2021 dhe për vlerën e projektit “Rehabilitim i rrugës mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja”, nga





2,150,000,000 lekë që ishte miratuar nga Bordi I menaxhimit dhe MIE dhe do të financohej në 3 vite 2018,2019 dhe 2020 e ka rritur përsëri në vlerën 6,000,000,000 lekë, sa është parashikuar në shkresën nr. prot.522/3, datë 25.01.2018.

Në vijim të punës për hartimin e projektit, Shoqëria “A.....”, pesë ditëpas lidhjes së kontratës së sponsorizimit (nr.prot. 3625/2dt 25.05.2018), ka dorëzuar projekt-ide për objektin “Rehabilitim i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiptarja”.Ky projekt –ide është miratuar në Këshillin Teknik me vendimin nr.33, datë 25.06.2018.

Mirëpo, në termave të referencës të hartuara nga vetë ARRSH të miratuara me VKT nr.15, datë 20.04.2018, në pikën IV.1 “Kërkesat për konsulentin dhe paraqitja e dokumentacionit” ndër të tjera kërkohet që: në studimin e këtij projekti, konsulenti duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante të projekt –idesë, por duke mos e kufizuar atë për të studiuar edhe variante dhe nënvariate të tjera që ai do të shohë të arsyeshme të paraqesë, si dhe duhet të llogarisë vlerën e kostos. Nga auditimi për respektimin e këtyre kërkesave rezultoi se, konsulenti ka paraqitur tre variante të projekt –idesë vetëm për Lotin I që është mbikalimi i rrethrotullimit dhe nuk ka paraqitur tre variante për dy lotet e tjera. Po kështu nuk ka paraqitur edhe koston paraprake për të tre lotet.

Me shkresë me nr.prot 3625/4, dt 17.07.2018 shoqëria konsulente A..... në përfundim ka hartuar dhe ka dorëzuar në ARRSH projekt-zbatimin për objektin “Rehabilitim I segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiptarja”. Me Vendim të Këshillit Teknik , nr 56, dt 04.09.2018, është miratuar propozimi për këtë projekt zbatim dhe vlera e plotë e financimit prej 7,200,000,000 lekë I ndarë në tre Lote , si më poshtë :

1. Vlera e preventivuar e lotit të I është 2,696 mld me TVSH
2. Vlera e preventivuar e lotit të II është 1,887 mld me TVSH
3. Vlera e preventivuar e lotit të III është 1,417 mld me TVSH
4. Vlera e preventivuar e lotit të IV është 1,2 mld me TVSH

Mbas miratimit të projektit të zbatimit nga KT, me shkresën nr.6393, datë 10.07.2018 ARRSH dërgon projektin e zbatimit së bashku me dokumentacionin përkatës në Institutin e Ndërtimit për realizimin e oponentës Teknike të projektit. Instituti i Ndërtimit pas realizimit të oponentës teknike e dërgon atë në ARRSH me shkresën nr.239/3, datë 27.07.2018 dhe doli në përfundimin se:

Në përgjithësi projekti i zbatimit është konceptuar drejt, por mungojnë llogaritjet konstruktive të mureve dhe të armuar. Të plotësohen nga konsulenti.

U konstatua se, bashkëlidhur projektit nuk ndodheshin llogaritjet konstruktive të mureve dhe të armuar dhe as tabelat e volume të betoneve, për të parë a janë të barabarta me volume e preventivit të zbatimit, në bazë të të cilit është llogaritur dhe vlera e plotë e investimit. Por më vonë mbas dorëzimit të aktkonstaimit të mbajtur nga auditimi, bashkëlidhur observacioneve janë paraqitur, llogaritjet konstruktive të mureve dhe të armuar dhe tabelat e volumeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

Në vijim, Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH, me shkresë nr. 7497/1, datë 06.09.2018i ka kërkuar MIE miratimin e prokurimit me vlerë të plotë për objektin “Rehabilitim i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja”. MIE me shkresë me nr. 8546/5, datë 06.09.2018 I ka dërguar ARRSH-së kthimin e përgjegjës dhe shprehen se, në parim është dakord që ARRSH të vazhdojë procedurat ligjore të prokurimit të objekteve me vlerat e mëposhtme:

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Vlera totale	Buxheti 2018	Buxheti 2019	Buxheti 2020
M064190	Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja <b>Loti 1</b>	2,696,000,000	529,000,000	160,000,000	180,000,000
M064191	Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja <b>Loti 2</b>	1,887,000,000	376,400,000	160,000,000	180,000,000
M064192	Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja <b>Loti 3</b>	1,417,000,000	294,800,000	150,000,000	120,000,000
M064210	Supervizion punimesh, Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja <b>Loti 1</b>	18,452,000	4,800,000	900,000	1,200,000
M064211	Supervizion punimesh, Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja <b>Loti 2</b>	12,830,000	4,800,000	800,000	1,200,000
M064212	Supervizion punimesh, Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja <b>Loti 3</b>	10,049,000	5,000,000	800,000	1,274,243

#### Për sa mësipër, përmbledhim:

-Nga ARRSH nuk janë hartuar terma reference apo ndonjë studim tjetër paraprak, në bazë të të cilave të llogaritej dhe të justifikohesh vlera e përafërt e objektit “Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja “prej 6, 000,000,000 lekë si dhe nuk ka kaluar dhe nuk është miratuar në Këshillin Teknik të ARRSH.

-Vlera e investimit të këtij objekti prej 6,000,000,000 leke nuk ka qenë e parashikuar në Projekt Buxhetin Afatmesem (PBA) të ARRSH në vitin 2017 apo vite më para, dhe as në projekt-buxhetin e vitit 2018, por është planifikuar mbas miratimit të buxhetit të vitit 2018, që me datimin e tij në muajin janar.

-Bordi i Menaxhimit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë miratuar vlerën prej 6,000,000,000 lekë të parashikuar apriori nga ARRSH, por kanë miratuar vlerën e financimit të objektit “Rehabilitim i segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja” të ndarë në tre objekte ë shumën 2,150,000,000 lekë.

-Sipas, Termave të referencës të hartuara nga vetë ARRSH, kosto për 1 km rrugë ka dalë 878,006,241 lekë/km dhe për gjatësinë 2.2 km të rrugës “Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja” ka dalë një vlerë ndërtimi e përafërt 1,931,613,730 lekë dhe mbi këtë vlerë është llogaritur edhe tarifa e projektimit që ka dalë rreth 42 milion lekë. Këto Terma reference janë miratuar me Vendimin nr. 15, datë 20.04.2018 të Këshillit Teknik të ARRSH.

-Përzgjedhja e shoqërisë konsulenti “A..... për të hartuar projekt zbatimin, pa organizuar procedura prokurimi është në kundërshtim të hapur me: ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, dhe me ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “për sponsorizimet” sepse përzgjedhja e këtij





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

konsulenti nuk ka kaluar më parë në konkurrim për tu vlerësuar për kriteret e mësipërme nga një komision konkurrimi përvojën e konsulentit; cilësinë e metodologjisë së propozuar; kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; transferimin e njohurive, etj.

**Si konkluzion:** Nga shqyrtimi dhe vlerësimi I dokumentacionit të cituar më sipër del qartë se, për përzgjedhja e shoqërisë konsulente “A.....”, pa konkurrim, ndikojnë negativisht në cilësinë e projektit, në shmangije të konkurrencës (*në procedurat e prokurimit për zbatimin e punimeve ka pjesëmarrje vetëm e një operator, trajtuar me poshtë*) dhe në rritje fiktive të kostos së objektit me efekte negative të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, çka tregohet qartë dhe nga vlera e investimit që ishte parashikuar apriori nga ARRSH që ne janar të vitit 2018 prej 6,000,000,000 lekë (pa studim paraprak) dhe *çuditërisht*, konsulenti në projekt zbatimin dhe në preventivin e zbatimit që është dorëzuar në shtator 2019 ka nxjerrë po të njëjtën vlerë prej 6,000,000,000 lekë. Pra vlera e nxjerrë nga projektuesi është disa herë më e lartë se, vlera e përafërt e nxjerrë sipas temave të referencës të miratuar në KT, dhe më pas të miratuara nga Bordi i Menaxhimit të ARRSH dhe MIE.

Në vijim të zbatimit të procedurave për prokurimin për zbatimin e kontratave, menjëherë dy ditë mbas kthimit të përgjegjës nga MIE me shkresën me nr. 8546/5, datë 06.09.2018 që në parim e ka lejuar ARRSH të vazhdojë procedurat ligjore të prokurimit të objekteve të mësipërme, ARRSH në datën 08.09.2019 ka bërë shpalljen e njoftimit të kontratave në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

#### **B. Zbatimin e procedurave të prokurimit:**

Siç u tha më sipër ky objekt është ndarë për tu prokuruar dhe zbatuar në 3 Lote, si me poshtë:

**1.** Objekti “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1” fillon në km ( 0÷ 0+760)km dhe përfshin, Nyja tek Sheshi Shqiponja + mbikalimi i rrugëve dytësore).

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr ..... Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit L. S A. A. M.SH	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave E.S L. T. L.M
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) <b>2,246,450,297.45</b> lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) 2,246,450,000,09lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 297.45 lekë
8. Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: 10.09.2018 9.Data e hapjes së tenderit <b>12.10.2018</b> , <b>Ora: 10.00</b>	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 .OE	11.Vlera e kontratës (me tvsh) 2,695,740,000 lekë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

2. Objekt, Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti II”, përfshin Nyjën te ura e Lanes si dhe nen kalimi ne km (1+500).

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr ..... Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A.K V. G. E.S	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave M.SH L.M E. V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,571,942,368lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) 1,568,794,185lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 3,148,183 lekë
8. Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: 08.09.2018 9. Data e hapjes së tenderit <b>12.10.2018</b> , <b>Ora: 11.00</b>	11. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE	12. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,882,553,022 lekë

Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë vetëm 1operatori ekonomik “S...” me ofertë ekonomike në vlerën 1,568,794,185lekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e këtij operator pjesëmarrës dhe e ka kualifikuar dhe shpallur fitues.

3. Objekti “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti III”. Qellimi i investimeshte ndertimi dhe perfundimi i plote i ketij aksi duke bere rehabilitimin e segmenteve rrugore nga mbikalimi i pallatit me shigjeta deri ne rrethrotullimi Shqiponja, loti 3 (1 + 600÷ 2+340).

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr ..... Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit G.R L.M S.P	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave E.S M.SH E. V
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) <b>1,180,297,580.3</b> lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) 1,170,134,219.66 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 10,163,360 lekë
8. Data e shpërndarjes së këtij njoftimi: 10.09.2018 9. Data e hapjes së tenderit 12.10.2018 Ora: 12.00	10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 1 OE b) S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE	11. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,404,161,063. lekë



Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë vetëm 1 operator ekonomik v.v, me ofertë ekonomike në vlerën 1,170,134,219.66 lekë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e këtij operator pjesëmarrës dhe e ka kualifikuar dhe shpallur fitues.

Si u trajtua më lartë, 3 këto 3 procedura janë zhvilluar në mungesë të theksuar të konkurrencës, pasi në tenderët respektiv është paraqitur vetëm 1 operatorë, të cilët janë kualifikuar dhe kanë dalë fituese dhe me ta janë lidhur kontratat e zbatimit. Por , punimet sipas këtyre kontratave deri në momentin e auditimit nuk kanë filluar sepse, për objektin “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja, Loti 1”, nisur nga shkrimet e botuara në mediat e shkruara dhe ato elektronike e vizive, dyshohet për shkelje të renda që lidhen me falsifikime të dokumenteve të operatorit fitues, ndërsa për dy lotet e tjera janë hasur problem të shumta me banorët në lidhje me shpronësimet e pronave të tyre (trojeve, banesave dhe dyqaneve). Për këto arsye për të 3 këto procedura prokuroria e rrethit gjyqësor Tirane, ka hapur hetimin penal dhe me shkresa nr.18095, datë 12.12.2018, ka sekuestruar te gjithë dokumentacionin e prokurimit të të 3 procedurave. Në këto kushte ARSSH ka zgjidhur kontratën e zbatimit për objektin “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1. Nisur nga këto shkelje, ARSH me shkresën nr. 11106, datë 11.12.2018 i ka kërkuar bashkimit të përkohshëm të kompanive të sigurimit “S...” konfiskimin e sigurimit të kontratës prej 10% në shumën 269,574,000 lekë. Kjo kompani nuk ka qenë dakord për kthimin e kësaj shume dhe në këto kushte ARSH ka bërë ankesë në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë Tiranë e cila me vendimin nr.2723, datë 23.07.2019 ka vendosur detyrimin bashkimit të përkohshëm të kompanive të sigurimit “S...” të pagojë shumën 269,574,000 lekë. Ky bashkimit i përkohshëm kompanive të sigurimit “S...” ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Aplet Tiranë. Procedura e konfiskimit të garancisë së Kontratës vazhdon të jetë ne proces gjykimi nga kjo Gjykatë.

Megjithatë, nga auditimi mbi përgatitjen dhe zbatimin e procedurave të prokurimit para njoftimit të kontratës u konstatua se:

Sipas nenit 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2019 për kontratat e punëve publike kufiri lartë monetare është përcaktuar 2,400,000,000 lekë dhe sipas pikës 3 të këtij neni, asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP.

Sipas nenit 33 të VKM nr.914, datë 29.12.2019, afati kohor për procedurën e hapur i parashikuar në nenin 43 të LPP është si vijon:

Autoriteti kontraktor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pacenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë nen dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

-Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 (pesëdhjetë e dy) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.



-Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 (tridhjetë) ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.

Ndarja në tre lote të një segmenti rrugor prej 2.2 km me vlerë 6000,000,000 lekë dhe realizimi i tre procedurave të mësipërme bie ndesh me bazën ligjore të sipërcituar sepse, nuk të lejojnë që asnjë kontratë publike të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP. Dhe konkretisht, vlerata monetare e të tre loteve janë ndarë pikërisht për shmangie e kufiri lartë monetare që është 2,400,000, 000 lekë dhe për shkurtrim e afateve për paraqitjen e ofertave. Sipas DT për loti e parë dhe të tretë shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik është bërë në datën 10.09.2018 ndërsa për lotin II është bërë në datën 08.09.2018 duke lënë dhe afatin për paraqitjes së ofertave 30 ditë kalendarike që i përket procedurës së hapur me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar. Ndërsa po të realizohej një procedurë prokurimi e vetme për të gjithë segmentin prej 2.2 km me vlerë kontrate prej 6,000,000,000 lekë ose të ndahej në dy lote , vlera e të cilave është mbi kufirin e lartë minimal , afati për paraqitjen e ofertave do të ishte 52 ditë kalendarike.

Për sa u trajtua më sipër, përgjegjësia bie mbi ish-Përgjegjësia e Sektorit të Projekteve të Brendshme e të Huaja Teknike znj. A. A dhe ish- Drejtorin e Përgjithshëm të ARRSH-së, z. A Q.

*Autoriteti Kontraktor nuk janë paraqitur observacione për projektreportin, ndërsa për aktkonstatimin e mbajtur janë paraqitur observacione të cilat janë shqyrtuar dhe janë trajtuar në projektreport.*

**5. “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Krrabës 2018”** me fond limit 98,180,000 lekë, i zhvilluar në vitin 2018 në Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH), disa të dhëna për të cilin janë:

Urdhri Prokurimit: 3, datë 26.2.2018

Tipi i Kontratës: shërbime

Lloji i Procedurës: procedurë e hapur

Fondi limit 98,180,000 lekë.

Për vitin 2018 janë në dispozicion 90,000,000 lekë.

Kohëzgjatja e Kontratës: 12 muaj

Data e Publikimit në BPP 27.2.2018

Afat i fundit për pranimin e ofertave 23.3.2018

Data e zhvillimit të tenderit 23.3.2018

Është paraqitur dhe ka paraqitur ofertë të vlefshme OE “4.... sh.p.k. , i cili është dhe fitues.

Pas auditimit të dosjes u konstatuan parregullsitë/mangësitë si vijon:

### **1. Ne lidhje me përlogaritjen e fondit limit.**



1.1. Nga ana formale, tabela “Përlllogaritja ... e fondit limit”, të shërbimit, si pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, nuk është në përshtatje me shërbimin e mirëmbajtjes rrugore në përgjithësi, dhe tuneleve në veçanti. Preventivi përmban vetëm pagat e punonjësve që do të kryejnë shërbimin, por nuk përcakton llojin e shërbimit që do të kryhet, specifikimet teknike etj. në kundërshtim me DST për shërbimet, pikën 2 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar etj.

### 1.2. Lidhur me llogaritjen e fondit limit (FL).

Llogaritja e fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” I ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... *Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet ... një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore ...*

*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*

Grupi i përlllogaritjes së TR (përfshirë fondin limit) është shprehur se “Përlllogaritja ... e fondit limit ” është bërë mbi bazën e realizimit të kontratave të ngjashme.

Nga verifikimi rezulton se grupi i hartimit të TR dhe FL, në hartimin e FL, nuk është mbështetur në analizat e çmimeve/njësi të shërbimeve të kryera, mbi bazën e të cilave del dhe vleftha gjithsej e kontratës, por në vijimësi i është referuar vetëm vlerës përfundimtare të kontratës, por kjo parë, jo si produkt i zërave të shërbimeve (e pa lidhur me to).

Nga dokumentacioni i paraqitur nga ARRSH, OE fitues ka kontratë “Mirëmbajtje ...” për tunelin e Kërrabës, prej vitit 2015 e në vazhdim.

Pjesë e dokumentacionit të kërkuar nga ARRSH dhe të paraqitur nga OE fitues çdo vit, janë dhe listë pagesat e punonjësve që kryejnë shërbimin e “Mirëmbajtjes ...” së tunelit të Kërrabës.

AK, për të gjithë elementët e tabelës “Përlllogaritja ... e fondit limit ” (18 gjithsej), në mungesë të çmimeve të miratuara, në asnjë rast nuk ka bërë analizën/llogaritjen se ku është bazuar në vendosjen e çmimeve njësi, veçanërisht për çmimet njësi të elementëve të tabelës me numër rendor 1 deri 14 që përbëjnë pagat.

Meqenëse tenderi “mirëmbajtje ...” është zhvilluar në vitin 2018, AK në llogaritjen e çmimeve njësi, të paktën për elementët e tabelës me numër rendor 1 deri 14 që përbëjnë pagat, duhet të ishte mbështetur në listë pagesat e punonjësve që punojnë në tunel, të sjellë nga OE fitues prej vitit 2015 dhe që janë gjendje në ARRSH.

Efektet jepen nga krahasimi i:

- pagave të punonjësve të parashikuara nga AK në llogaritjen e fondit limit 58,000,000 lekë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

- Pagave faktike mbështetur në listë pagesat që OE fitues ju ka paguar punonjësve të vet 36,705,835 lekë (28,593,780 x 16,7 për qind kontributi i punëdhënësit x 10 për qind fitim)
- Diferenca prej 21,294,165 lekë (58,000,000 – 36,705,835) përbën rritje të pa argumentuar të fondit limit.

Në tabelën në vijim, kolona nr. 2, paraqet emrin e punonjësve, i cili i korrespondon funksionit/profesionit që kryen (D. J i korrespondon funksionit *menaxher primar drejtues për operimet në tunel* të përcaktuar nga OE në “Propozime në lidhje me stafin” e me radhë për të gjithë punonjësit):

nr	Përshkrimi zërit	Koha/ muaj	Subjekti 4 –AM sipas listë pagesave		4 - AM sipas preventivit tender		Parashikimi AK gjithsej	Diferenca
			Çmim/listë	Gjithsej	Çmim/nj ësi	Gjithsej		
1	2	3	4	5	6	7	8	9
				<b>28,593,780</b>		<b>46,920,000</b>	<b>58,000,000</b>	<b>29,406,220</b>

1.3. Në zërat e parashikuar në llogaritjen e fondit limit për vitin 2017 me numër 16 gjendet zëri ”Totali i lejuar për mirëmbajtje tuneli, ambientet përreth tij si dhe shërbimet & pastrimi i qendrës së kontrollit, largimi i mjeteve në avari dhe transporti i stafit të operatorit të tunelit” i cili jepet me emërtim “*lump sum*” me vlerë 6.215.000 lekë. Kjo vlerë është dhe në preventivin fitues nga OE “4.... por në të dy rastet e pa shoqëruar me volumet e punës mbi bazën e të cilave është llogaritur kjo shumë.

AK, në llogaritjen e fondit limit për vitin 2018 zërin ”Totali i lejuar për mirëmbajtje tuneli, ambientet përreth tij si dhe shërbimet & pastrimi i qendrës së kontrollit, largimi i mjeteve në avari dhe transporti i stafit te operatorit te tunelit” i cili jepet me emërtim “*lump sum*” e ka parashikuar 8,500,000 lekë, ose 2,285,000 lekë më shumë se sa parashikimi/realizimi i vitit 2017, por këtë shtesë, nuk e ka arsyetuar/shoqëruar me dokumentacion justifikues/ose argument. Për më tepër padrejtësisht, këtë vlerë nuk e ka pasqyruar në pasqyrën (preventivin) pa çmime që hidhet në tender, megjithëse ky zë është i kushtëzuar tavan dhe që vendoset në përpunje me realizimin, por jo me shumë se shifra tavan, e përdorur nga AK për llogaritjen e fondit limit.

Grupi i hartimit të TR dhe FL në “Observacion” e ka argumentuar këtë shtesë fondi, kryesisht me shtimin e tre rojeve për ruajtjen e kabinës elektrike me pagë 1,440,000 lekë/vit.

Argumenti se është shtuar numri i rojeve për ruajtjen e kabinës elektrike etj, nuk qëndron me arsyetimin e thjeshtë se po ky grup për vitin 2017, 2018, 2019 dhe 2020, në TR në pasqyrën me emërtim “Numri total i stafit të nevojshëm” ka parashikuar numrin e punonjësve të njëjtë 37 (pra, nuk ka parashikuar shtesë punonjësish).

Në mbështetje të këtij argumenti, është edhe fakti që OE fitues, në dokumentin me emërtim “Propozimi teknik në lidhje me “Menaxhimin dhe mirëmbajtjen ...” për vitin 2018, është shprehur se ... referuar dokumenteve të tenderit, Termave të Referencës ... stafi përbërës sipas





profesioneve ... është 37 punonjës. Në vijim OE ka është dhënë listën emërore sipas profesioneve për 37 punonjës, në të cilën, nuk janë përfshirë tre roje.

Nën arsyetimet e mësipërme vlera shtesë e këtij zëri prej 2,285,000 lekë, e cila paraqitet si rritje e fondit limit e pa argumentuar.

1.4. AK për kryerjen e shërbimit i ka vendosur në dispozicion OE fitues falas, 10 automjete (tre makineritë e rënda: autovinç me kovë dhe karrotrec dhe shtatë makina pick-up, apo fuoristradë). AK në mbështetje të tyre, në TR dhe tabelën “Përlllogaritja e FL ...”, për objektin “Menaxhimi e mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i tunelit të Kërrabës”, ka parashikuar:

- Tre shoferë për makineritë e rënda (autovinç me kovë dhe karrotrec) dhe 8 shoferë për makinat pick-up, apo fuoristradë të instaluar në tunel me pagë 11,280 mijë lekë/vit (shuma e zërit me numër 11 dhe 12 të tabelës së “Përlllogaritjes së FL...”)

- “Kostot për operime shtesë dhe për mirëmbajtjen e makinave” (numër 14 të tabelën “Përlllogaritja e FL ...”, me vlerë 9,600 mijë lekë/vit.

Shuma për të tre zërat/elementët është 20,880 mijë lekë, ose 21.4 për qind të vlerës së kontratës gjithsej.

AK prej vitit 2017 e në vijim, për 10 automjetet dhe vlerën 20,880 mijë lekë, të vendosur në dispozicion OE fitues, në asnjë rast nuk është shprehur se mbi çfarë argumenti/argumente i janë vendosur në dispozicion si: puna konkrete që do të kryhet çdo mjet e shprehur në volume pune, të matshëm ose jo, të dhëna statistikore të shpenzimeve lidhur me punën e kryer dhe mirëmbajtjen e automjeteve prej vitesh, ose elementë të tjerë që AK ka gjykuar ose gjykon se kanë influencë në përcaktimin e masës së përdorimit të tyre.

Gjatë auditimit me zgjedhje të dokumentacionit shoqërues të situacioneve mujorë të likuiduar gjatë vitit 2018 dhe 2019, nuk u konstatua ndonjë punë e kryer veçanërisht me mjetet e rënda.

Pavarësisht sa më sipër, vlera e paraqitur likuidim nga OE për shërbim të kryer, ka qenë me strukturë dhe proporcionale, e njëjtë me tabelën “Përlllogaritja e FL ...” që është fituar tenderi dhe si e tillë është likuiduar dhe nga ARRSH.

Nga sa më sipër fondi limit në përgjithësi është llogaritur në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, dhe pikërisht nenit 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, ku thuhet: *Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.*

Në hartimin e TR dhe KVK, AK ka kërkuar mjete për realizimin e kontratës vetëm një autobot naftë minimumi me kapacitet 6,000 litra dhe një UPS (min 200 KVA).

Për realizimin e kontratës në këtë tender, kërkesat e AK ndaj OE është vetëm për punonjës inxhinier elektrik me eksperiencë, specialistë të ndryshëm etj.





Përkundrejt fuqisë punëtore që ka kërkuar nga OE, AK i ka vendosur në dispozicion të pa argumentuar dhe pa pagesë OE:  
- 7 mjete nga të cilat 4 mjete Pick up Mitsubishi L 200 dhe tre mjete të renda të përbërë nga një karrotrec mercedes, një autovinç kullë nisan dhe një furgon ford transit, të cilat nuk janë të inventarizuara në asetet e ARRSH.

- Në Godinën e Qendrës se Kontrollit të Tunelit, zyrat e saj (zyrë dhe garazh) të pajisura me komoditetin e nevojshëm.

- Çdo kosto për mirëmbajtje si karburant, pjesë ndërrimi, kosto për mjete shtesë etj. me vlerë rreth 40,000 mijë lekë, të cilat jepen më hollësisht në preventivin e llogaritjes së fondit

Parregullsitë e konstatuara/trajtuara, ngarkojnë me përgjegjësi grupin e hartimit të “Termave të referencës” dhe tabelës “Për përlllogaritjen ...e fondit limit”, të përbërë nga D. S ing IT, A.H me detyrë specialiste, A. Zi me detyrë përgjegjës sektori, z. S.T me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe A.Q në cilësinë e titullarit miratues të tyre.

*Për problemet e trajtuara në projektraport dhe të trajtuara më sipër në këtë raport, subjekti i audituar me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacionet në të cilat ka bërë komente dhe shpjegime që në kontekst janë të njëjta me komente dhe shpjegimet e bëra për aktkoinstatimin dhe të trajtuara hollësisht nga auditimi në projektraport ( për më hollësi referou projektraportit në të cilin, janë trajtuar gjerësisht observacionet dhe qëndrimi me komentet e auditimit).*

## 2. Parregullsi lidhur me vendosjen e kriterëve për kualifikim (njësia e prokurimit):

Objekti i tenderit paraqitet me natyrë shërbimi (preventivi i tij, përmban asnjë zë punimi), AK (njësia e prokurimit), në hartimin dokumentacionit standard (DS) të tenderit me objekt “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Krrabës 2018” ka vendosur kriterë të veçanta në kualifikimin (KVK) e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me:

- Frymën/thelbin e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi” i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ... Qëllimi i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.



- Nenin 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese*  
*Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.*

- Nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës...*

KVK e vendosura nga njësia e prokurimit, kanë ndikuar thelbësisht në pjesëmarrjen e OE në tender dhe në përcaktimin e OE fitues, oferta ekonomike e të cilit, është e barabartë me fondin limit.

*Argumentim:*

Maksimalisht vlera e shërbimeve që do të kryhet, për të cilën OE pjesëmarrës në tender, duhet të jenë të pajisur me kategori punimi në licencë është 15, 000 mijë lekë.

2.1. Njësia e prokurimit ka kërkuar kategoritë e punimeve dhe nivelin e tyre si më poshtë:

NP- 11/D (Ndërtime për n/stacione, kabinat e transformatorëve, linjave TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike) *Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloj tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore, **me vlerë të punimeve 101 – 200 milion lekë:***

NS - 5/B (Impiante të sinjalistikës ndriçuese) *Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave **me vlerë të punimeve 21- 50 milion lekë.***

NS - 12/D (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit) *Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet muraturë, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi **me vlerë të punimeve 101 – 200 milion lekë.***

NS - 13/D (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni) *Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të*



*lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme me vlerë te punimeve 101 – 200 milion lekë.*

NS - 14/B (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj) *Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme me vlerë te punimeve 21-50 milion lekë.*

Njësia e prokurimit ka gabuar në vendosjen e nivelit të zgjedhur për çdo kategori punimi. Maksimalisht ajo duhet të kërkonte/vendoste nivelin A, i cili i referohet vlerës deri 20 milion lekë.

Ndërkohë, niveli i kërkuar për këto kategori punimesh nga njësia e prokurimit, ka qenë më i madh dhe se vlera e vet tenderit gjithsej.

2.2. Certifikatë ISO 27001:2005 (vlen për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit) ndihmon institucionet ose *shoqëritë të mbajnë asetet e tyre informatike të sigurta*. Përdorimi i këtyre standardeve i ndihmon ato të menaxhojnë sigurinë e aseteve të tilla si informacionet financiare, pronat intelektuale, të dhënat e punonjësve apo informacione të tjera që i janë besuar institucionit nga pale të treta.

Nga sa më sipër, kërkimi i kësaj certifikate, ka **asnjë lidhje me objektin e prokurimit**.

(Mbështetur në tabelën e “Përlllogaritjes së FL...” i vetmi zë shërbimi që mund të ketë lidhje me këtë kategori punimesh është “Kontingjencë ...” me vlerë 15,000 mijë lekë/vit).

2.3. Numri mesatar i punonjësve të siguruar i kërkuar nga AK-ja, jo më pak se 50 punonjës për periudhën Janar 2016 – Janar 2018, është vendosur në kundërshtim me termat e referencës, sipas të cilave numri i nevojshëm për realizimin e kontratës është 37 punonjës.

**2.4. Kërkesa e AK që në stafin kyç në menaxhimin e tunelit , duhet të jetë një Menaxher Primar Drejtues, i cili ... të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve e aksidenteve rrugore, është e pambështetur në ndonjë dispozitë ligjore.**

**Në rastin e incidenteve dhe aksidenteve në rrugë, procedura që ndiqet, nuk ka lidhje fare me sa ka kërkuar AK.**

2.5. Procedura e prokurimit është parashikuar dhe kontrata është nënshkruar për 12 muaj, në tejkalim të vitit buxhetor përkatës, në kundërshtim me VKM-ne, Nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 76, “Kohëzgjatja e kontratës”, ku përcaktohet qe: *Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shumëvjeçare, në përputhje me shkronjën “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33 të LPP.*

2.6. Nuk është plotësuar kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë, me qëllim që OE të jenë të përgatitur në paraqitjen e dokumentacionit përkatës për qellim kualifikimi, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, neni 28, “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë



*zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

Të tjera:

Në hartimin e TR dhe KVK, AK ka kërkuar mjete për realizimin e kontratës vetëm një autobot naftë minimumi me kapacitet 6,000 litra dhe një UPS (min 200 KVA).

Për realizimin e kontratës në këtë tender, kërkesat e AK ndaj OE është vetëm për punonjës inxhinier elektrik me eksperiencë, specialistë të ndryshëm etj.

Përkundrejt fuqisë punëtore që ka kërkuar nga OE, AK i ka vendosur në dispozicion të pa argumentuar dhe pa pagesë OE:  
- 7 mjete nga të cilat 4 mjete Pick up Mitsubishi L 200 dhe tre mjete të rënda të përbërë nga një karrotrec mercedes, një autovinç kullë nissan dhe një furgon ford transit, të cilat nuk janë të inventarizuara në asetet e ARRSH.

**- Në Godinën e Qendrës së Kontrollit të Tunelit, zyrat e saj (zyrë dhe garazh) të pajisura me komoditetin e nevojshëm.**

**- Çdo kosto për mirëmbajtje si karburant, pjesë ndërrimi, kosto për mjete shtesë etj, të cilat jepen më hollësisht në preventivin e llogaritjes së fondit limit si më poshtë:**

Normalisht, hartuesit e TR duhet të kërkonin shërbime dhe jo sa janë pagat e punonjësve të OE. Parregullsitë e konstatuara, mbështetur në nenin 57/4 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, ngarkojnë me përgjegjësi znj. DH.L dhe znj. A.A me profesion inxhinier, në cilësinë e anëtareve të njësisë së prokurimit (Sa më sipër është trajtuar në akt konstatimin nr 1, datë 2.8.2019).

*Për problemet e trajtuara në projektreport dhe të trajtuara më sipër në këtë raport, subjekti i audituar me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacionet në të cilat ka bërë komente dhe shpjegime që në kontekst janë të njëjta me komente dhe shpjegimet e bëra për aktkoostatimin dhe të trajtuara hollësisht nga auditimi në projektreport ( për më hollësi referou projektreportit në të cilin, janë trajtuar gjerësisht observacionet dhe qëndrimi me komentet e auditimit).*

**6. “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës 2019-2020”**  
(Marrëveshje kuadër për dy vite) me fond limit 194,920,000 lekë, i zhvilluar në vitin 2019.

**Parregullsi të konstatuara:**

*2.1. Ne lidhje me përlllogaritjen e fondit limit.*

2.1.1. Nga ana formale, tabela “Përlllogaritja ... e fondit limit”, të shërbimit, si pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, nuk është në përshtatje me shërbimin e mirëmbajtjes rrugore në përgjithësi, dhe tuneleve në veçanti. Tabela përmban kryesisht pagat e punonjësve që do të kryejnë shërbimin, por nuk përcakton llojin e shërbimit që do të kryhet, specifikimet teknike etj.



në kundërshtim me DST për shërbimet, pikën 2 të nenit 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar etj (neni 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik” I ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... *Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet...*).

#### 2.1.2. Llogaritja e fondit limit.

Praktika e ndjekur nga AK për hartimin e termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për këtë tender, janë përgjithësisht të njëjta me ato të tenderit me objekt “*Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës 2018*”, për rrjedhojë, argumentet e përdorur për tenderin e vitit 2018, janë të vlefshëm edhe për tenderin e vitit 2019.

Pavarësisht sa më sipër, vlen të evidentohet/theksohet se grupi i punës për hartimin e TR dhe përlllogaritjen e fondit limit (FL) është shprehur se ... *llogaritja e fondit limit për zërat e përshkruar në preventiv me numër rendor nga 1 deri 14 është bërë duke u mbështetur në kontratat e realizuara në ARRSH për punë të së njëjtës natyrë të viteve 2015, 2016 dhe 2017 dhe në atë në proces përfundimi viti 2018. Bashkëngjitur tabela referuese e vlerave materiale të nxjerra nga kontratat e realizuara ...*

Në fakt, rezulton se grupi i punës, llogaritjen e FL e ka bërë duke marrë në konsideratë vetëm vlerën gjithsej të kontratës, mesatarizuar për tre vitet e mëparshëm.

Nga verifikimi rezulton se grupi i hartimit të TR dhe FL, në hartimin e FL, nuk është mbështetur në analizat e çmimeve/njësi të shërbimeve të kryera, mbi bazën e të cilave del dhe vleftha gjithsej e kontratës, por në vijimësi i është referuar vetëm vlerës përfundimtare të kontratës, por kjo parë, jo si produkt i zërave të shërbimeve.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga ARRSH, OE fitues ka kontratë “*Mirëmbajtje ...*” për tunelin e Kërrabës, prej vitit 2015 e në vazhdim.

Pjesë e dokumentacionit të kërkuar nga ARRSH dhe të paraqitur nga OE fitues për këtë tender, janë dhe listë pagesat e punonjësve që kryejnë shërbimin e “*Mirëmbajtjes ...*” së tunelit të Kërrabës për tre vitet e mëparshëm.

AK, për të gjithë elementët e tabelës “*Përlllogaritja ... e fondit limit*” (16 gjithsej), në mungesë të çmimeve të miratuara, në asnjë rast nuk ka bërë analizën/llogaritjen se ku është bazuar në vendosjen e çmimeve njësi, veçanërisht për çmimet njësi të elementëve të tabelës me numër rendor 1 deri 13 që përbëjnë pagat.

Meqenëse tenderi “*mirëmbajtje ...*” është zhvilluar në vitin 2019, AK në llogaritjen e çmimeve njësi, të paktën për elementët e tabelës me numër rendor 1 deri 13 që përbëjnë pagat, duhet të ishte mbështetur në listë pagesat e punonjësve që punojnë në tunel, të sjellë nga OE fitues prej vitit 2015 dhe që janë gjendje në ARRSH.

Efektet jepen krahasimi i:

- pagave të punonjësve të parashikuara nga AK në llogaritjen e fondit limit 53,460,000 lekë
- Pagave faktike mbështetur në listë pagesat që subjekti “4.....” sh.p.k. ju ka paguar punonjësve të vet 36,705,835 lekë (28,593,780 x 16,7 për qind kontributi i punëdhënësit x 1.1 fitim)





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

- Diferenca prej 16,754,165 lekë (53,460,000 – 36,705,835) përbën rritje të pa argumentuar të fondit limit për një vit, e cila përbën përdorim pa efektivitet i fondeve publike.

Në vijim tabela

Nr		Njësi matje	Pagat llogaritur			Diferenca		
			Sipas Listë pagesave	Preventivi fitues	Planifikuar nga AK			
1	2	3	4	5	6	7 (5-4)	8 (6-4)	9 (6-4)
	Pagat	000 L	<b>28,593,780</b>	<b>52,260,000</b>	<b>53,460,000</b>	<b>23,666,220</b>	<b>24,866,220</b>	<b>1,200.000</b>

2.1.3. Nga verifikimi i strukturës së tabelës me objekt “Përlllogaritja e FL ...” konstatohet se AK, ka mbajtur të pa ndryshuar vlerën e FL gjithsej, por ka ndryshuar strukturën e tij, në rritje për zërat tabelës që jepen vetëm në vlerë (me numër rendor 14, 15 dhe 16), pasi ato përfaqësojnë shpenzime të pamatshme dhe si të tilla, janë të mundshme për të abuzuar.

Në vijim jepen ndryshimet në tabelat e llogaritjes së fondit limit përmbledhur, nga AK për vitin 2018 dhe 2019.

nr		Njësi matje	viti		Dif 18/19
			2018	2019	
1	Pagat	000 L	58,180	53,460	- 4,720
2	Kosto për operime ... (nr.14 tabela)	“	9,600	12,000	+ 2,400
3	Totali lejuar (nr 15 në tabelë)	“	8,500	10,000	+ 1,500
4	Seksioni B3 i TR germa a dhe b (nr 16)	“	22,000	22,000	-
	Shuma		98,180	97,460	-720

#### Koment për të dhënat e tabelës.

Objekti i tenderit “Menaxhimi dhe mirëmbajtja ... e tunelit Krrabë”, nuk është tender ndërtimi, në të cilin zërat e punimeve dhe volumi i tyre, është i matshëm, por është me objekt “Menaxhim, mirëmbajtje ...”, për rrjedhojë, zërat e mirëmbajtjes me numër rendor nga 14 deri 16, nga AK parashikohen përafërsisht, me kushtin nëse ngjarja (zëri mirëmbajtjes) do të ndodhë.

Minimalisht llogaritja e pagave nga AK, ka qenë dhe është e mundur që të bëhet plotësisht e saktë në kushtet që numri i punonjësve është i përcaktuar dhe që AK zotëron listë pagesat e konfirmuara nga sigurimet shoqërore për vitet paraardhës.

Nën këtë arsyetim, ulja e fondit të pagave me vlerë 4,720 mijë lekë në vitin 2019 ndaj vitit 2018, duhet të ishte pasqyruar në vlerën gjithsej të tabelës “Përlllogaritja e fondit limit ...”. Në fakt në tabelën e llogaritjes së fondit limit, është pasqyruar vetëm 720 mijë lekë, për rrjedhojë, diferenca në rritje prej **3,900 mijë lekë/vit** (nga e cila 2,400 mijë në zërin “Kosto për operime ...” dhe + 1,500 mijë që ka mbuluar rritjen e zërit “Totali lejuar...”) përbën rritje të paargumentuar të FL dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e termave të referencës...

2.1.4. AK ka rritur me + 2,400 mijë lekë “Kostot për operime shtesë dhe mirëmbajtje të makinave” pa e argumentuar.

Nga verifikimi dokumentacionit të mëparshëm (viti 2018) rezulton se OE fitues e ka realizuar/respektuar vlerën prej 9,600 mijë lekë të parashikuar nga AK.



Në dosjen e tenderit, nuk gjendet ndonjë dokumentacion që të justifikojë nevojën për shtesë fondesh për këtë zë shërbimi, për rrjedhojë rritja e tij me 2,400 mijë lekë në vitin 2019 kundrejt vitit 2018, rezulton e paargumentuar, e cila përdorim pa efektivitet i fondeve publike.

*2.1.5. Lidhur me numrin e mjeteve të dhëna falas nga AK, OE.*

AK për kryerjen e shërbimit i ka vendosur në dispozicion OE fitues falas, 10 automjete (tre makineritë e rënda: autovinç me kovë dhe karrotrec dhe shtatë makina pick-up, apo fuoristradë). Mbështetur në TR dhe tabelën “Përlllogaritja e FL ...”, për objektin “Menaxhimi e mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i tunelit të Krrabës”, konstatohet se AK ka parashikuar:

- Tre shoferë për makineritë e rënda (automjet transporti, autovinç me kovë dhe karrotrec) dhe 8 shoferë për makinat pick-up, apo fuoristradë të instaluar në tunel me pagë 10,620 mijë lekë/vit (shuma e zërit me numër 11 dhe 12 të tabelës së “Përlllogaritjes së FL...”) dhe
- “Kostot për operime shtesë dhe për mirëmbajtjen e makinave” (numër 14 të tabelën “Përlllogaritja e FL ...”, me vlerë 12,000 mijë lekë/vit.

Shuma për të tre zërat/elementët është *22,620 mijë lekë, ose 23.2 për qind të vlerës së kontratës gjithsej.*

AK, në asnjë rast, nuk është shprehur në TR se çfarë pune konkrete do të kryejnë mjetet (punonjësit) dhe mbi çfarë argumenti/argumente i janë vendosur në dispozicion si: puna konkrete që do të kryhet çdo mjet e shprehur në volume pune, të matshëm ose jo, të dhëna statistikore të shpenzimeve lidhur me punën e kryer dhe mirëmbajtjen e automjeteve prej vitesh, ose elementë të tjerë që AK ka gjykuar ose gjykon se kanë influencë në përcaktimin e masës së përdorimit të tyre.

Gjatë auditimit me zgjedhje të dokumentacionit shoqëruar të situacioneve mujorë të likuiduar gjatë vitit 2018 dhe 2019, nuk u konstatua ndonjë punë e kryer veçanërisht me mjetet e rënda.

Pavarësisht sa më sipër, vlera e paraqitur likuidim nga OE për shërbim të kryer, ka qenë me strukturë dhe proporcionale, e njëjtë me tabelën “Përlllogaritja e FL ...” që është fituar tenderi dhe si e tillë është likuiduar dhe nga ARRSH.

Nga sa më sipër fondi limit në përgjithësi është llogaritur në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, dhe pikërisht nenit 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, ku thuhet: ***Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.***

Në hartimin e TR dhe KVK, AK ka kërkuar mjete për realizimin e kontratës vetëm një autobot naftë minimumi me kapacitet 6,000 litra dhe një UPS (min 200 KVA).

Për realizimin e kontratës në këtë tender, kërkesat e AK ndaj OE është vetëm për punonjës inxhinier elektrik me eksperiencë, specialistë të ndryshëm etj.

Përkundrejt fuqisë punëtore që ka kërkuar nga OE, AK i ka vendosur në dispozicion të pa argumentuar dhe pa pagesë OE:

- 7 mjete nga të cilat 4 mjete Pick up Mitsubishi L 200 dhe tre mjete të rënda të përbërë nga një karrotrec mercedes, një autovinç kullë nisan dhe një furgon ford transit, të cilat nuk janë të inventarizuara në asetet e ARRSH.

**- Në Godinën e Qendrës së Kontrollit të Tunelit, zyrat e saj (zyrë dhe garazh) të pajisura me komoditetin e nevojshëm.**





- Çdo kosto për mirëmbajtje si karburant, pjesë ndërrimi, kosto për mjete shtesë etj. me vlerë rreth 40,000 mijë lekë, të cilat jepen më hollësisht në preventivin e llogaritjes së fondit Nga tabela e “Përlllogaritjes ... të FL” konstatohet se AK disponon çdo gjë të nevojshme për kryerjen e “menaxhimit të tunelit ...” edhe në kushtet e kërkesës për rritje të fondeve përtej të parashikuarës, nga OE.

Nga sa më sipër fondi limit në përgjithësi është llogaritur ne kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, dhe pikërisht nenit 59, “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, pika 2, ku thuhet: *Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.* Specifikimet teknike në këtë rast nuk përputhen me përlllogaritjen e vlerës se kontratës.

2.1.6. Në zërat e parashikuar në llogaritjen e fondit limit për vitin 2019 me numër 15 gjendet zëri *”Totali i lejuar për mirëmbajtje tuneli, ambientet përreth tij si dhe shërbimet&pastrimi i qendrës se kontrollit, largimi i mjeteve ne avari dhe transporti i stafit te operatorit te tunelit”* i cili jepet me emërtim *”lump sum”* me vlerë 10,000 mijë lekë, ose 1,500 mijë lekë më tepër se sa në vitin 2018, por pa paraqitur ndonjë argument.

Nën arsyetimet e mësipërm vlera prej 3900 mijë lekë ((2,400 mijë + 1,500 mijë) që ka mbuluar rritjen e *”kosto për operime ..”* dhe *”totali lejuar...”*) përbën shpenzim të pajustificuar dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e termave të referencës.

Meqenëse tenderi /kontrata realizohet për dy vite 2019 dhe 2020, shpenzimi i pajustificuar shkon në 7,800 mijë lekë gjithsej, cili përbën përdorim jo efektiv të fondeve publike.

Për më tepër padrejtësisht, këto vlera nuk e ka pasqyruar në tabelën pa çmime që ka hedhur në tender, në veçanti që zëri *”Totali i lejuar për mirëmbajtje tuneli, ambientet përreth tij si dhe shërbimet&pastrimi i qendrës se kontrollit, largimi i mjeteve ne avari dhe transporti i stafit te operatorit te tunelit”* është kushtëzues tavan dhe që vendoset në përputhje me realizimin, por jo me shumë se shifra tavan, e përdorur nga AK për llogaritjen e fondit limit.

Vlen të theksohet se për të tre zërat e së njëjtës natyrë në tabelën e *”Përlllogaritjes ... fondit limit”* me nr. 14 *”Kosto për operime shtesë dhe për mirëmbajtjen e makinave”*, nr. 15 *”Totali i lejuar ...”* dhe nr. 16 *”Kontingjenca për parashikimet ...”*, AK dhe OE fitues, nuk kanë paraqitur asnjë argumentim/llogaritje se si dalin këto vlera.

Shënim:

Në argumentet sipas pikës *”2.1.6.”* të akt konstatimit, vlera prej 3,900 mijë lekë përbën rritje të paargumentuar të fondit limit vetëm një herë, por kjo rritje e pa justifikuar është argumentuar nga dy këndvështrime:

- AK ka gabuar, që me uljen e pagat ka mbuluar shpenzime të tjera (trajtuar në pikën 2. 4). Efekti i uljes së tyre duhet të ishte pasqyruar drejtpërdrejtë në uljen e fondit limit në të njëjtën masë.

- AK ka gabuar, që ka rritur vlerën e shpenzimeve trajtuar në pikën 2.1.6. pa justifikuar/argumentuar dhe njëkohësisht duke përballuar rritjen e tyre, nga një *”burim i gabuar”*, pagat.

Vlera e ofertës fituese për vitin 2018, 2019-2020, ka qenë e barabartë me fondin limit të hedhur në tender.



Parregullsitë e konstatuara/trajtuar, ngarkojnë me grupin e punës që ka hartuar TR i përbërë nga DH.L me detyrë përgjegjëse sektori, A. H. me profesion inxhinier ndërtimi, A. L., A.Z specialist dhe L.S (pranuar nga E. V me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes dhe zj. S. Q Drejtor i Përgjithshëm) si miratues i tyre (Sa më sipër është trajtuar në akt konstatim nr. 2, datë 2.8.2019 mbajtur me grupin e hartimit të TR dhe përlllogaritjes së FL).

## 2.2. Parregullsi lidhur me vendosjen e kriterëve për kualifikim:

Objekti i tenderit paraqitet me natyrë shërbimi (tabela e “Përlllogaritjes së fondit limit, nuk përmban asnjë zë punimi), AK (njësia e prokurimit), në hartimin dokumentacionit standard (DS) të tenderit me objekt “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Krrabës 2019 dhe 2020” në përgjithësi ka vendosur kriterë të veçanta për kualifikimin (KVK) e operatorëve ekonomikë në kundërshtim me frymën e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, nenin 26 dhe 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar etj.

*Argumentim:*

1. Numri mesatar i punonjësve të siguruar të kandidatit/ ofertuesit, duhet të jetë jo më pak se 60 punonjës për periudhën Janar 2018 – Dhjetor 2018. Për këtë të paraqiten deklaratat e listë pagesave në Drejtorinë Tatimore (me nënshkrim elektronik ose me vulë të institucionit).

Sa më sipër në kundërshtim me sa është përcaktuar në TR sipas të cilave ... numri i nevojshëm për realizimin e kontratës është 37 punonjës.

Zj. A.H me profesion juriste në cilësinë e anëtares njësisë së prokurimit ka bërë vërejtje datë 5.8.2019, në të cilat përmbledhur sqaron se mbështetur në nenin 57 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe njësia e prokurimit”, parregullsitë e konstatuara, nuk lidhen me atë, të cilat u pranuan dhe u reflektuar në projektraport.

Z. E. S. dhe A. Z. me profesion inxhinier në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit kanë bërë vërejtje datë 8.8.2019, të cilat përgjithësisht qëndrojnë, për rrjedhojë janë pranuar dhe reflektuar në projektraport.

## 3. Lidhur me vlerësim e ofertave nga KVO.

Disa të dhëna për tenderin janë:

Të dhëna për prokurimin	Komisioni i Vlerësimit Ofertave	Njësia e prokurimit
<b>a</b>	<b>b</b>	<b>c</b>
1.Urdhër prokur. nr. 47 datë 6.3.2019 2.Fondi limit lekë 194,920,000 lekë 3. Procedura e prok. “Hapur ” 4. Data e zhvillimit 5.6.2019 5.Kontraktuesi subjekti OE “4-AM” sh.p.k. Data e lidhjes kontratës 25.6.2019 Vlera e kontratës 233,784,000 lekë Diferenca ndaj FL 100,000 lekë Kohëzgjatja e Kontratës 24 muaj	A. P. A. N. N. M.	A.H E. S. A. Z.



Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik SEP, u konstatua se kanë paraqitur ofertë BOE/OE:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	BOE S..	lekë	155,572,000		skualifikuar
2	OE “4.....”	”	194,820,000		fitues

1. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka skualifikuar BOE ”S.....” sh.p.k. me argumentet si më poshtë:

*Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “S..... shpk”, rezulton se nuk plotëson kriteret për kualifikim pasi nuk ka paraqitur dokumentet në përputhje me DST. Konkretisht:*

1) *Operatori ekonomik “A.....” nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, në kundërshtim me pikën 1.a) të shtojcës 8 kriteret të përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet:*

a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.*

2) *Operatori ekonomik “A..... shpk” nuk ka paraqitur kontratë për shërbim punë të ngjashme (Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i Tunelit).*

3) *Operatori ekonomik “S... shpk” nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik të DST, sipas të cilit kandidati, në rastin e kontratave të ngjashme të realizuara në sektorin publik duhet të paraqesë: - Vërtetim i lëshuar nga një ent publik dhe Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Duke qenë në kushtet e një Konsorciumi duhej të paraqiste një vërtetim nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (Enti Publik) dhe faturat tatimore të shitjes për shërbimet e kryera. Gjithashtu faturat e paraqitura nuk mund të klasifikohen punë të ngjashme pasi nuk janë punime për mirëmbajtjen dhe operimin e tunelit por riparime dhe zëvendësime të pajisjeve të kryera para fillimit të kontratës së mirëmbajtjes (si mangësi të konstatuara në dorëzim).*

4) *Operatori ekonomik “A..... shpk” nuk plotëson kriterin e veçantë 2.3 Kapaciteti teknik pika a) pasi në Licensën e paraqitur nuk ka kategorinë NS - 12/A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit), në kundërshtim me kërkesat e DST.*

5) *Operatori ekonomik “S... shpk” nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik pika b) ku kërkohen certifikata të vlefshme:*

- *ISO 9001: 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)*

- *OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001 (Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit të Punonjësve)*

*Këto certifikata rezultojnë jashtë afatit pasi data e skadencës është 10.07.2018.*

6) *Operatori ekonomik “S... shpk” nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik pika e) ku kërkohen:*

e) *Në Stafin kryesor kërkohen:*

• *3 Operatorë primarë tuneli: të diplomuar në inxhinieri mekanike/elektrike, me eksperiencë të paktën 5 vite në zhvillim & shfrytëzim të operacioneve në tunele dhe në procedurat e mirëmbajtjes së tyre.*



- Jo më pak se 6 operatorë tuneli, të diplomuar në inxhinieri elektrike /elektronike/ mekanike.

*Eksperiencat e paraqitura nga operatori “S... shpk” nuk plotësohen në sasi dhe në kohë. Kështu:*

*-Operatorë tuneli kërkohen 6 persona, ka paraqitur vetëm 5 CV punonjësish.*

*- Operatorë Primarë tuneli kërkohen 3 persona me eksperiencë pune të paktën 5 vite në zhvillim & shfrytëzim të operacioneve në tunele dhe në procedurat e mirëmbajtjes së tyre. Kandidati ka paraqitur vetëm 2 CV që nuk e plotësojnë këtë eksperiencë.*

*7) Operatori A..... sh.p.k nuk e ka të rregullt vërtetimin e lëshuar nga OSSHE (tabela bashkëlidhur është e pa sigluar).*

**2. U verifikua saktësia** e vlerësimit të KVO për BOE ”S.....” krahasuar me dokumentacionin në SE dhe rezultoi se vlerësimi i KVO është i gabuar pasi përmbledhur, lidhur me:

2.1. Operatori ekonomik “A... shpk” nuk ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, në kundërshtim me pikën 1.a) të shtojcës 8 kritere të përgjithshme të kualifikimit ...

**Nga verifikimi rezulton se** e ka fushën e veprimtarisë me objektin e prokurimit. Sipas ekstraktit të Regjistrisë Tregtar ndër të tjera ... *”Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregtimit, importit eksportit me shumice dhe pakice të materialeve e pajisjeve elektrike, pajisjeve industriale e elektro shtëpiake, pajisje laboratorike, pajisjeve e sistemeve/impianeteve të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianeteve të tjera të çfarëdo lloji. Projektim dhe instalim i impianeteve e pajisjeve elektrike, elektroshtëpiake, pajisje laboratorike, industriale, sistemeve të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianeteve të tjera të çfarëdo lloji ne vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre ne objekte të ndryshme. Shërbime mirëmbajtje dhe servisi të ndryshëm për materiale e pajisje elektrike, pajisje industriale e elektro shtëpiake, pajisje laboratorike, pajisje dhe sisteme të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit) si dhe për impianete të tjera të çfarëdo lloji ne vendet e ushtrimit të aktivitetit dhe jashtë tyre ne objekte të ndryshme. Shërbime konsulence ne lidhje me materialet elektrike, pajisjet industriale e elektroshtëpiake, pajisje laboratorike, pajisjet dhe sistemet/impiantet e ftohjes dhe të ngrohjes (kondicionimit), impiantet e tjera të çfarëdo lloji si dhe supervizionin ne lidhje me instalimin e tyre. ... etj.*

2.2. Operatori ekonomik “A..... shpk” nuk ka paraqitur kontratë për shërbim punë të ngjashme (Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe operimi i Tunelit).

**Nga verifikimi rezulton se e ka plotësuar këtë kriter.** Për këtë qëllim ka paraqitur kontratën e nënshkruar nga Autoriteti Portual Durrës, me nr. 360, date 25.03.2013, me objekt “Kalim i shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës energjetike dhe asaj elektrike, operatoreve privat”, me afat zbatimi 5 vite dhe vlerë vjetore më të lartë se sa vlefata e prokuruar.

Duke pasur parasysh termat e referencës për këtë procedure prokurimi, licencat e shërbimit të kërkuar nga AK-ja, stafit teknik të kërkuar dhe zërave të shërbimeve të realizuar nga subjekti në kontratën e mësipërme, rezulton që ajo përmbush tërësisht kushtet për kontratë me shërbime të ngjashme.

2.3. Operatori ekonomik “S... shpk” nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik, sipas të cilit kandidati, në rastin e kontratave të ngjashme të realizuara në sektorin publik ... etj.



Nga verifikimi dokumentacionit rezulton se e ka plotësuar këtë kriter. Për plotësimin e këtij kriteri, rezulton qe subjekti “S.....” sh.p.k. ka paraqitur faturat tatimore në favor të subjektit “A..” sh.p.k. në të cilat është përcaktuar saktë menaxhimi i tunelit të Thirrës, tuneli më i gjatë në vendin tonë. Nëse do të kishte dyshime mbi te, KVO mund t'i drejtohej organit epror që është MIE për të kërkuar informacion (mbështetur në nenin 66/2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... *Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.*

Fatura tatimore është dokument i vlefshëm kualifikues kur veprimtaria kryhet ndërmjet dy subjekteve tregtare private, siç dhe përcaktohet në DST, pika 2.3. paragrafi i fundit *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat:-Faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.* Po i njëjti shërbim është paraqitur dhe nga Operatori tjetër (fitues), për vitet e mëparshëm dhe është pranuar nga KVO.

2.5. Operatori ekonomik “S..... shpk” nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik pika b) ku kërkohen certifikata të vlefshme:

- ISO 9001: 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

- OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001 (Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit të Punonjësve)

Këto certifikata rezultojnë jashtë afatit pasi data e skadencës është 10.07.2018.

Pas verifikimit të dokumentacionit rezulton se Operatori ekonomik “S.....” sh.p.k. i ka paraqitur certifikatat

*ISO 9001: 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) me nr certifikate SB.14.0219.01.QMS me date skadence 10.07.2020.*

*OHSAS 18001:2007 ose ISO 45001 (Menaxhimi i Sigurisë dhe Shëndetit të Punonjësve) me nr certifikate SB.14.0221.00.OHS me date skadence 10.07.2020.*

2.6. Operatori ekonomik “S..... shpk” nuk plotëson kriterin 2.3 Kapaciteti teknik pika e) ku kërkohen :e) Në Stafin kryesor kërkohen:

- 3 Operatorë primarë tuneli: të diplomuar në inxhinieri mekanike/elektrike, me eksperiencë të paktën 5 vite në zhvillim & shfrytëzim të operacioneve në tunele dhe në procedurat e mirëmbajtjes së tyre.

- Jo më pak se 6 operatorë tuneli, të diplomuar në inxhinieri elektrike /elektronike/ mekanike.

Eksperiencat e paraqitura nga operatori S... nuk plotësohen **në sasi dhe në kohë**. Kështu:

- operatorë tuneli kërkohen 6 persona ka paraqitur vetëm 5 CV punonjësish.

- Operatorë Primarë tuneli kërkohen 3 persona me eksperiencë pune të paktën 5 vite në zhvillim & shfrytëzim të operacioneve në tunele dhe në procedurat e mirëmbajtjes së tyre. Kandidati ka paraqitur vetëm 2 CV që nuk e plotësojnë këtë eksperiencë.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur nga ky subjekt pjesë BOE ofertues, rezulton që për plotësimin e këtij kriteri nga ana e tij janë paraqitur:

- *Jo më pak se 6 operatorë tuneli, të diplomuar në inxhinieri elektrike /elektronike/ mekanike.*

OE S... ka paraqitur:





1. T. Z. 36 vite exp si mekanik
2. E. A. 15 vite exp si mekanik
3. I. H. 14 vite exp si mekanik
4. A. Dr. 7 vite exp elektrikist
5. A. H. 5 vite exp elektrikist
6. F. M. 13 vite exp elektrikist
7. Y. D. 42 vite exp elektrikist

Argumenti qe ka paraqitur 5 CV nuk qëndron , pasi ne sistem ka paraqitur CV dhe kualifikimet për 7 punonjësit e mësipërm.

- *Operatorë Primarë tuneli kërkohen 3 persona:*

OE S... ka paraqitur:

1. F. C. 40 vite teknik mirëmbajtje pajisjesh
2. H. A. 25 vite teknik mirëmbajtje pajisjesh
3. O. S. 5 vite teknik mirëmbajtje pajisjesh
4. D. C. 27 vite teknik mirëmbajtje pajisjesh
5. Ç. Sh 26 vite teknik mirëmbajtje pajisjesh

Argumenti qe ka paraqitur 2 CV nuk qëndron, pasi në sistem ka paraqitur CV dhe kualifikimet për 5 punonjësit e mësipërm.

Skualifikimi dhe për këtë pike është kryer ne kundërshtim me kërkesat për kualifikim dhe rregullat e prokurimit publik.

*Operatori A..... shpk nuk e ka të rregullt vërtetimin e lëshuar nga OSSHE (tabela bashkëlidhur është e pa sigluar).*

Për plotësimin e këtij kriteri nga ky subjekt pjese e bashkimit te operatoreve ekonomik është paraqitur vërtetimi i debisë nr. 11100/1, date 23.05.2019, ku vërteton faktin qe Albaelectrica rezulton me 0 (zero) detyrime për faturat e energjisë deri me datë 22.05.2019, përfshirë dhe muajin prill 2019. Vërtetimi është i nënshkruar dhe vulosur rregullisht nga Drejtori i Divizionit Tregtar. Ky dokument është rigorozisht i vlefshëm dhe i pakontestueshëm (I njëjti tekst është edhe për vërtetimin e lëshuar nga OSHE për OE “S.....” sh.p.k. dhe “4..... sh.p.k.).

2.4. Operatori ekonomik “A....” sh.p.k nuk plotëson kriterin e veçantë 2.3 Kapaciteti teknik pika a) pasi në Licencën e paraqitur nuk ka kategorinë NS - 12/A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit), në kundërshtim me kërkesat e DST.

- Vlera e punimeve të parashikuar në TR (seksioni B/3) dhe përlllogaritjen e fondit limit (nr. 16/b kontingjencë sipas pikave ii, iii, iv, v, vi, vii të TR) është 15,000 ,000 lekë gjithsej/vit, në të cilën, pjesa takuese e subjektit “A.....” sh.p.k. është 2 për qind, ose 300,000 lekë/vit.

Për realizimin e kësaj vlere (zëri) për menaxhim dhe mirëmbajtje, ARRSH ka kërkuar 5 kategori punimi, që në vlerë, proporcionalisht secilës prej tyre i takon 60,000 lekë/vit (mungesës së kategorisë së punimit NP-12 A i korrespondon vlerës 60,000 lekë/vit. Kjo është vlera për të cilën është gjykuar, skualifikuar BOE “A.....” sh.p.k. “S....” sh.p.k. edhe kjo me kushtin/rezervën, nëse do të ndodh avaria).

Pjesa takuese e subjekti “S...” sh.p.k. është 98 për qind, ose 14,700,000 lekë), i cili zotëron në licencë kategorinë e punimeve NS-12 D me vlerë 101 milion deri 200 milion lekë, pra mbi



dyfishin e vlerës së tenderuar gjithsej dhe proporcionalisht mbi 10 fish të kategorisë të kërkuar nga AK.

Duke pasur në konsideratë sa më sipër si dhe:

- nenin 78/4 të VKM nr 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar, në të cilin është përcaktuar se ... Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

- OE “S...” sh.p.k. është i besueshëm pasi ka kryer me sukses në ARRSH kontrata pune me vlerë miliona euro.

- Oferta e ekonomike e paraqitur prej tij është rreth 20 për qind më e ulët ose rreth **39 milion lekë** më pak, se sa oferta e shpallur fituese.

AK jo vetëm është i garantuar për realizimin me sukses të kontratës, por gjithashtu, do të realizonte me sukses qëllimin e LPP, kursimin e fondeve buxhetore. Nën këtë arsyetim, vlera prej **39,248,000 lekë**, e cila paraqet diferencën midis ofertës fituese dhe asaj të skualifikuar përbën shpenzim pa efektivitet të fondeve publike.

BOE “S...” sh.p.k. & “A.....” sh.p.k. datë 14.06.2019 ka paraqitur formularin e ankesës.

Datë 18.06.2019, BOE ka paraqitur heqje dorë nga ankesa, e cila është pranuar nga AK dhe për rrjedhojë ankesa, nuk është marrë në shqyrtim.

Nga këto veprime nuk janë mirë menaxhuar fondet buxhetore, për pasojë diferenca prej 47,097,600 lekë me TVSH e vlerës së ofertës së operatorit “4.....” sh.p.k.” të shpallur fitues me vlerën e ofertës së operatorit të s’kualifikuar “S...” përbën përdorim të fondeve pa efektivitet dhe ekonomikitet.

*Për problemet e trajtuara në projektraport dhe të trajtuara më sipër në këtë raport për procedurën e prokurimit “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës për vitin 2018 dhe 2019-2020”, në lidhje me përlogaritjen e fondit limit, parregullsit në vendosjen e kriterëve për kualifikim, dhe me vlerësim e ofertave, Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacionet në të cilat ka bërë komente dhe shpjegime që në kontekst janë të njëjta me komente dhe shpjegimet e bëra për aktkoinstatimin dhe të trajtuara hollësisht nga auditimi në projektraport (referou projektraportit në të cilin, janë trajtuar gjerësisht observacionet dhe qëndrimi me komentet e auditimit).*

**7. “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes ne km 21+363 ÷21+468, ne segmentin Lin – Pogradec 2019”**, me fond limit 222,572,170 lekë, disa të dhëna për të cilin janë:

Tëdhënapërprokurimin	Komisioni i Vlerësimit Ofertave	Njësia e prokurimit
----------------------	------------------------------------	---------------------





## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

a	b	c
1.Urdhër prokur. nr. 61 datë 19.3.2019 2.Fondi limit lekë 222,572,170 lekë 3. Procedura e prok. “negocim pa shpallje emergjencë ” 4. Data e zhvillimit 21.3.2019 5.Kontraktuesi subjekti OE “ERGF” sh.p.k. Data e lidhjes kontratës 29.3.2019 Vlera e kontratës 186,187,785 lekë Diferenca ndaj FL 34,415,682 lekë Kohëzgjatja e Kontratës 2.5 muaj	S. P. A. N. A. H.	M. Sh Sh. L. A. L

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik të dosjes dhe në sistemin elektronik të APP, u konstatua se janë fuar dhe kanë paraqitur ofertë BOE/OE si më poshtë:

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/ skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	S.....	lekë	148.794.159		tërhequr
2	P...		171.949.367		skualifikuar
3	E....		188.156.488		fitues
	V Hysa shpk		206.143.431		kualifikuar

Nga tabela konstatohet se BOE “S.....” është tërhequr nga gara, BOE “P.....” sh.p.k. është skualifikuar, dy OE janë kualifikuar, nga të cilët OE “E...” sh.p.k. ka fituar.

U verifikua saktësia/rregullshmëria e vlerësimit të BOE/OE nga KVO dhe u konstatua se:

1. KVO ka gabuar në ”Pranimin e tërheqjes” të BOE ”S.....” sh.p.k:

*Argumentim:*

Duke ju referuar procesverbalit të KVO dhe Raportit përmbledhës të procedurës së tenderit, KVO është shprehur se ... *Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “V.....” është tërhequr nga gara, sipas shkresës nr. 15 prot i shoqërisë, date 25.03.2019 bërë në sistemin elektronik ...* KVO e ka pranuar ”tërheqjen” e BOE, megjithëse me ai ka ofertuar me vlerën më të ulët.

Pranimi dhe reflektimi i tij në procedurën e tenderit është në kundërshtim me:

1.1. Nenin 50/1 “Vlefshmëria, modifikimi dhe tërheqja e ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilën është përcaktuar se ... *Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentet e tenderit.*

Në DST e tenderit, pika 4.5 është ... *“Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 180 (e shprehur në ditë).*

1.2. nenin 51, “Ndalimi i modifikimit të ofertave”, pika 1 dhe 2 në të cilat është përcaktuar se ... *1. Pas paraqitjes së ofertës nuk duhet të kryhet asnjë bisedim ndërmjet autoritetit kontraktor dhe ofertuesit për ofertën, në përputhje me pikën 1 të nenit 53 të këtij ligji.*

*2. Një ofertuesi, si kusht për shpalljen fitues, nuk duhet t'i kërkohej që të ndërmarrë përgjegjësi të papërcaktuara në dokumentet e tenderit, të ndryshojë vlerën e ofertës së tij ose të modifikojë në çfarëdo mënyre ofertën.*



1.3. nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave” pika 1 e LPP në të cilën është përcaktuar se ... *Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*Pika 2. Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën.*

Mbështetur në sa më sipër, si dhe nenin 56, 58 etj. KVO-ja, duhet të vijonte punën për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti deri në hartimin e raportin përmbledhës për Titullarin e AK-se.

2. KVO ka skualifikuar padrejtësisht OE “P.....”

*Argumentim:*

KVO ka skualifikuar OE “P.....” sh.p.k. me argumentet se OE “P.....” shpk, nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e kriterëve të veçanta për kualifikim (KVK) si më poshtë:

2.1 *Aksionet e Operatorit “P..... shpk”, me Urdhrin Nr. 1303 Prot, datë 18.12.2017, “Për Vendosjen e sekuestros konservative”, të përmbauesit Gjqësor A.V, janë nën sekuestro konservative .*

*KVO sot me datën 26.03.2019 , bëri verifikimin në [eëë.qkb.gov.al](http://eëë.qkb.gov.al) , në ekstraktin historik të “PE VLA KU” shpk dhe konstaton se urdhri i sipërcituar është ende në fuqi dhe aktualisht në momentin e vlerësimit të ofertës nuk është hequr sekuestro konservative.*

*Të qenurit nën sekuestro e aksioneve të “P.....” shpk, për detyrime që ky subjekt mund të ketë ndaj të tretëve, sipas ligjit për përmbauesin privat i jep mundësinë këtij të fundit, të nxjerre në ankand çdo pasuri të operatorit qofshin këto makineri e pajisje apo sekuestrim të të ardhurave të tyre financiare .*

***Kjo situatë krijon risk, pasiguri dhe nuk i jep besueshmërinë dhe garancitë e duhura AK se, ky subjekt do të realizonte e përfundonte punimet e kontratës në rast të shpalljes fitues.***

*AK nuk mund dhe nuk ka asnjë arsye ligjore për ta marrë vete përsipër riskun duke ia besuar punët e kontratës objekt prokurimi një shoqërie që pasuritë e veta i ka nën sekuestro e që në çdo kohë mund të dalë në ankand .*

*Procedura objekt i këtij vlerësimi, është një procedure prokurimi me negociim pa shpallje paraprake të njoftimi kontratës e shkaktuar nga një situatë e pamundur të parashikohej nga AK , për shkak të rrëshqitjes masive, ku kërkohet përfundimi i punimeve në një kohë sa më të shkurtër për t’i dhënë mundësinë e vijimit të punimeve të kontratës bazë, tashmë të pezulluara përkohësisht. KVO nuk krijon besueshmërinë në këtë gjendje ligjore të kontraktorit të ftuar dhe AK nuk mund të kualifikojë atë në këto kushte, ndërkohë që ka ftuar si konkurrentë edhe operatore të tjerë pikërisht për t’u garantuar në shpalljen e shpejtë të një fituesi që plotëson kriteret për kualifikim , ka aftësitë , kapacitetet e duhura si dhe besueshmërinë për realizimin me sukses të punimeve objekt i kontratës.*



Ligji i Prokurimit ( neni 46/1 ) i jep mundësinë AK që në fazën e vlerësimit të ofertave të bëjë përzgjedhjen si fitues operatorin që ka...”*kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës...*”.

Për sa më sipër, Operatori “P.....” shpk duhet të skualifikohet sepse nuk ofron besueshmërinë e duhur ( neni 46/1 i LPP ) për te realizuar kontratën që prokurohet.

2.2. Në dokumentacionin ligjor-teknik te operatorit “P.....” shpk, ka mospërputhje te drejtuesit ligjor sipas QKR, me drejtuesin ligjor te licencës, në kundërshtim me përcaktimet e pika 2 Kreu I, “ VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”.

Sipas dokumentit të QKR së paraqitur, drejtues ligjor ( administrator ) i “P.....” shpk, është z. V. P., kurse sipas Licencës NZ 5147/13 drejtues ligjor është vetëm z K. A .

Në kreun I “*Qëllimi, fusha e veprimit të rregullores dhe përkufizime*” pika 2 të VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “parashikohet se: ”**Drejtues ligjor**”-personi fizik apo personat fizikë (administrator për sh.p.k., drejtor, presidenti për sh.a., personi fizik) **të përcaktuar si të tillë nga vendimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/ ose në gjykatë**

Në kreun III “*Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet*”, pika 2 dhe pika 3 germa ”a”, paragrafi 2 të VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “parashikohet se: ...2. Elementet e licencës: a) **Licenca përmban këto elemente: I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr. 2); II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr. 4); III. Numrin e identifikimit; IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni); V. Enrat e drejtuesve ligjorë e teknikë; VI. Selinë;VII. Afatin e vlefshmërisë; VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit; IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).** ”[...]

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm, KVO ( referuar edhe praktikës se vendimmarrjeve të KPP për rastet e mospërputhjes se drejtuesit ligjor të licencës me administratorin sipas QKR-se , si psh. KPP 55/2016 dhe KPP 203/2016, por edhe praktikës se vlerësimeve të bëra nga KVO te ndryshme ne ARRSH për raste te ngjashme ) gjykon se, licenca e lëshuar për shoqërinë “P..... shpk, megjithëse është lëshuar nga institucioni përgjegjës ( Ministria e Punëve Publike dhe Transportit), shfaq mangësi dhe nuk përmbush të gjithë detyrimet ligjore të parashikuara nga akti normativ në zbatim të ligjit , VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”.

Mbi sa më sipër, referuar edhe praktikës se vendimmarrjeve te KPP, oferta e “P..... shpk” nuk mund të kualifikohet .

2.3. Operatori “P.....” shpk, nuk ka arritur te paraqesë dokumentacion të saktë për te dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.7 te kriterëve të veçanta për kualifikim (Dëshmi për mjetet e pajisjet



teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës ).

Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri , operatori ka paraqitur deklaram me te dhëna jo të sakta dhe kontradiktore. Kështu , operatori ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 10 “Mbi disponimin e makinerive “.

Në shtojcën 10 ka deklaruar se, “...ve në dispozicion të kontratës objekt prokurimi automjetet vetëshkarkuese mbi 20 ton me targe TR 1902 T , TR 1862 T , kamionçinën AA 194 HJ...”. Por këto mjete i ka te deklaruar edhe në shtojcën 10 dhe faktikisht te angazhuara ne kontrata qe aktualisht ka duke zbatuar me ARRSH- në.

Pra, nga sa me sipër rezulton se, jo vetëm nuk i ka të disponueshme kapacitetet e kërkuara teknike të deklaruar në shtojcën 10 e DST por, ka paraqitur deklaram të pasaktë për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.7 të KVK.

Në shtojcën 7 e DST shprehimisht thuhet ;

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne nenin 53/3 të LPP-së , shprehimisht përcaktohet se: “...Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit...”

Mbi sa më sipër, oferta e “P.....” shpk nuk mund të kualifikohet .

**Subjekti “P.....” sh.p.k. ka bërë vërejte të shoqëruar me dokumentacionin përkatës për këtë përfundim/skualifikim nga KVO, në të cilin përmbledhur ka sqaron se:**

2.2.1. Lidhur me sekuestro konservative (sqsarim i subjektit):

*Ky pretendim nuk qëndron, pasi për këtë urdhër është marrë vendim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë datë 5.2.2018 me çështje 31131 -07700-80-2017 me palë paditëse shoqëria “P.....” sh.p.k. dhe i paditur përmbaruesi Gjyqësor “A.V” person fizik dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit . Me anë të këtij vendimi është vendosur pushimi i ekzekutimit të vendimit nr. 20 datë 25.9.2017 mbi vënien e sekuestro konservative (bashkëlidhur është vendimi i gjykatës).*

*Veç sa më sipër vërtetimi i statusit aktin në QKB konfirmon statusin aktiv të shoqërisë etj...*

Në gjykimin e audituesit argumentimi i OE qëndron.

**Qëndrimi i audituesit të KLSH<sup>-së</sup> :**

**Pavarësisht sa më sipër, nga auditimi i dokumentacionit në SEP u konstatua se:**

a. Lidhur me sekuestron konservative.

Veprimi i KVO është në kundërshtim me pikën 1/a të KPK Shtojca 10 e DST “Procedurë e hapur, Punë, në të cilën është përcaktuar se ... Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)...



Në QKB e paraqitur, OE ka “**status aktiv**”, që do të thotë se KVO ka **gabuar** duke skualifikuar OE “P...” sh.p.k.

b. Në pikën 2 të nenit 45, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar, janë përcaktuar Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë si më poshtë:

Pika 2. *Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur: a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit.* Në rastin konkret Operatori ekonomik “P...” sh.p.k. sipas dokumentacionit të paraqitur **nuk rezulton të jetë i falimentuar dhe kapitalet të jenë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit.** Detyrimi ndaj një përmbaruesi nuk parashikohet në asnjë rast si kusht për skualifikim nga një procedurë prokurimi, për rrjedhojë shkaku i skualifikimit (pika 2.1. e këtij akt konstatimi), nuk qëndron.

Lidhur me ... *riskun, pasigurinë, besueshmërinë e OE “P.....” sh.p.k. që paraqet OE sipas KVO, me arsyetimet e paraqitura nga audituesi në germën “a” dhe “b”, ato nuk qëndrojnë.*

Veç sa më sipër, vlen të evidentohet se ky OE ka fituar dhe realizuar në ARRSH punimet në tenderin me objekt:

- “Sistemim asfaltim rruga Qaf Thanë Lin – Pogradec” me vlerë 2,331,800 mijë lekë.

- “Sistemim asfaltim masa inxhinierike ... rruga Qaf Thanë Lin – Pogradec” me vlerë 1,312,785 mijë lekë.

- “Sistemim asfaltim masa inxhinierike ... rruga Qaf Thanë Lin – Pogradec” (shtesë kontrate) me vlerë 194,160 mijë lekë (**kontratë e lidhur në muajin korrik 2018**).

- “Ndërrhyrje emergjente sistemim asfaltim rruga Qaf Thanë Lin – Pogradec” me vlerë 166,504 mijë lekë (**kontratë e lidhur në muajin korrik 2018**).

Shuma e paguar për punime të kryera OE “P.....” sh.p.k. është rreth 4,004,000 mijë lekë... ose rreth 32 milion euro.

AK (ARRSH) ka kryer pagesa për punimet e kryera OE “P.....” sh.p.k. pa ndonjë pengesë përfshirë vitin 2018 (sekuestro është e vitit 2017).

Mbështetur në sa më sipër, edhe njëherë, arsyetimi i KVO lidhur me *riskun, pasigurinë, besueshmërinë e OE “P.....” sh.p.k. nuk qëndron.*

2.3.2. Lidhur me argumentin e KVO se ... *dokumentacioni ligjor-teknik se i operatorit “P.....” sh.p.k. ka mospërputhje të drejtuesit ligjor sipas QKR, me drejtuesin ligjor të licencës ...*

Vlerësimi i KVO, **nuk qëndron** pasi:

Bazuar në pikë 5 të Kreu-t të II, të VKM Nr. 42, datë 16.01.2008 “Rregullore për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, në të cilën është përcaktuar se ...

a) **Brenda 30 ditëve**, çdo subjekt i licencuar në zbatim ka detyrimin të depozitohet aplikimin për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim. I njëjti afat, me përjashtim të rastit kur përcaktohen afate të posaçme sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm dhe për aplikime të cilat sjellin ndryshime në klasifikimin e lejes. Aplikimet që nuk sjellin ndryshime në klasifikim së bashku me dokumentacionin provues shqyrtohen dhe miratohen nga sektori i licencimit.

b) Kur aplikimi është në mbështetje të kësaj rregulloreje, **brenda 10 ditëve**, subjektit i dërgohet njoftimi për pranimin e përditësimit për një ose më shumë elemente: I. **Ndryshim apo shtesë të drejtuesit /ve ligjor të shoqërisë**; II. **Ndryshim emërtim shoqërie**; III. **Zgjatjen e afatit të licencës**





së shoqërisë, kur aplikohet me të njëjtin staf inxhinierik; IV. Mbyllja e aktivitetit të shoqërisë (çregjistrim i tyre), bashkime apo përthithje (që nuk shoqërohen me ndryshimin e grupit të drejtuesve teknikë). Njoftimit për praninë bashkëlidhet leja e përditësuar, e nënshkruar nga kryetari i komisionit në detyrë..., rezultoi se **operatori ekonomik ka 40 dite kohë kalendarike për të ndërmarrë dhe ndryshuar drejtuesit ligjor në licencën e tij.**

Deri në datën e zhvillimit të tenderit (21.3.2019) ky afat nuk është konsumuar, licenca është e vlefshme në të gjithë elementët e saj, për rrjedhojë shkak i skualifikimit (pika 2.2. e këtij akt konstatimi), nuk qëndron.

Përgjithësisht sa më sipër është sqaruar/trajtuar edhe në ankesën e bërë nga OE.

2.3.3. Lidhur me argumentin e KVO se ... se mjetet me targë TR 1902 T , TR 1862 T , kamionçinën AA 194 HJ...”, që i ka paraqitur për këtë tender, i ka faktikisht të angazhuara në kontrata që aktualisht ka duke zbatuar me ARRSH- në.

Për sa më sipër subjekti ka sqaruar se ... mjetet me targë TR 1902 T , TR 1862 T , kamionçinën AA 194 HJ...”, janë të deklaruara në kontratën me objekt “Sistemim asfaltim e masa inxhinierike në km 21,050, në rrugën Qafë Thanë Lin – Pogradec” kontratë, e cila është situacionuar në masën 99 për qind të punimeve në objekt me investitor ARRSH etj. etj. të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

Veç sa më sipër audituesi shton gjithashtu se:

Subjekti “P.....” sh.p.k. gjatë vitit 2016 ka fituar një kontratë të dytë me vlerë rreth 973,000 mijë lekë me afat 24 muaj, ose deri datë 2.2.2018

Për efekt të këtij tenderi ka fituar një “shtesë kontrate” datë 2.7.2018 me vlerë rreth 161,800 mijë lekë me afat 4 muaj, pra deri datë 2.11.2018.

Në vijim ka fituar një kontratë emergjence datë 30.7.2018 me vlerë rreth 165,504 mijë lekë me afat 2.5 muaj pra deri datë 15.10.2018, ndërkohë që punimet e tenderit të emergjencës gjenden brenda gjatësisë rrugore ku ka kryer/përfunduar punimet e mëparshme subjekti “P.....” sh.p.k.

Mbështetur në sa më sipër, AK përsëri **ka gabuar** në skualifikimin e subjektit “P.....” sh.p.k. KVO duhet të kualifikonte dhe shpallte fitues këtë subjekt, i cili ka paraqitur ofertë me vlerë 171.949.367 lekë, ose 16,207,121 lekë, më të ulët se sa operatori ekonomik i shpallur fitues.

3. U verifikua dokumentacioni tekniko ligjor i subjektit “E....” sh.p.k. i shpallur fitues i tenderit dhe u konstatua se ai:

3.1. Nuk ka paraqitur dokumentacion që ka në pronësi ose me qira një autobot uji (mjetet e paraqitur janë autobote naftë).

3.2. Nuk ka paraqitur dy automjete vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës mbi 20 ton. Mjetet e paraqitur:

- Kamioni vetëshkarkues me targë AA211VS, nuk përmbush kriterin e kërkuar në dokumentet e tenderit, pasi nuk është me kapacitet mbi 20 ton. Sipas lejes qarkullimit të mjetit, kapaciteti i tij është 32 000 kg – 16 300 kg = 15 700 kg.

- Kamioni vetëshkarkues me targë AA367HC mbështetur në lejen e qarkullimit është me kapacitet 14 375 kg.

Parregullsitë e përshkruara në pikën 3 të akt konstatimit, janë në kundërshtim me pikën 2.3.7 (shtojca 10) të KVK, për rrjedhojë KVO duhet të kishte **skualifikuar subjektin “E.....” sh.p.k.**



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

4. U verifikua dokumentacioni i subjektit “V H” sh.p.k. dhe u konstatua se nuk kishin paraqitur 5 automjete vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton, në kundërshtim me pikën 2.3.7 (shtojca 10) të KVK.

KVO, ashtu si i ka vlerësuar ofertat ekonomike, ka përdorur standard të dyfishtë në vlerësimin e tyre.

Nga këto veprime nuk janë mirë menaxhuar fondet buxhetore, për pasojë diferenca prej **16,207,121 lekë** lekë e vlerës së është përdorur pa efektivitet dhe ekonomicitet. ofertës së operatorit të s’kualifik

*Për problemet e trajtuara në projektraport dhe të trajtuara më sipër në këtë raport për procedurën Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacionet në të cilat ka bërë komente dhe shpjegime që në kontekst janë të njëjta me komente dhe shpjegimet e bëra për aktkoinstatimin dhe të trajtuara hollësisht nga auditimi në projektraport (referou projektraportit në të cilin janë trajtuar gjerësisht observacionet dhe qëndrimi me komentet e auditimit).*

### 8. Procedura e prokurimit me objekt “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 7, ” të realizuar në vitin 2019:

Të dhënat për procedurën e prokurimit:

1. Urdhër Prokurimi Nr.2.. datë Datë	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit M.SH N.M A. P.	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave E. G A. N, (zv nga SP) E S...
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”, me mjete elektronike”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,332,573.946 lekë	6. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh) ..... lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) ..... lekë
8. Data e hapjes së tenderit Data 17.06.2019	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 2 OE	10. Vlera e kontratës (me tvsh) ..... lekë

Nga auditimi u konstatua:

#### - Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit të kontratave:

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të punëve janë hartuar janë hartuar nga projektuesi dhe janë miratuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të





kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

#### **-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret të veçanta kualifikuese.

#### **- Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

Nr.	Subjekti	Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH	Kualifikuar ose S’kualifikuar	Klasifikuar
1	“I.....”	2,299,327,253.75	Kualifikuar	
2	Gj.....”	1,789,598,000	S ‘Kualifikuar	Ne vend të I-të
3	“P.....”	1.889.384.779	S ‘Kualifikuar	
4	“F.....”	1.959.595.959	S’kualifikuar	
5	“G.....”	2.077.280.578,13		
6	“A.....”	2.295.400.000		

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe nga 6 operatorët, ka kualifikuar vetëm BO I.....’, me ofertën ekonomike në vlerën 2,299,327,253.75 lekë, pa TVSH dhe ka s’kualifikuar 5 operatorët e tjerë. Nga auditimi mbi ligjshmërinë e arsyeve të skualifikimit të 5 operatorëve u konstatua se, BOE “F.....”, BOE ‘A.....’, BOE “G.....” dhe BO “P.....”, janë skualifikuar me të drejtë, në përputhje me rregullat e prokurimit publik, sepse nuk plotësonin disa nga kriteret e kriteret të veçanta, të vendosura në Dokumentet e Tenderit, të cilat janë thelbësore për të realizuar me sukses kontratën dhe veçanërisht nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme, pasi nuk ka kryer punime për tunele tokësore (për të parë arsyet e skualifikimeve më hollësisht referoju projektraportit). Ndërsa BOE “GJ.....” është skualifikuar për këto arsye:

Sipas KVO, BOE “GJ.....” rezulton se, nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plote dhe të sakte për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kritereve për kualifikim dhe kërkesave të AK siç është kërkuar në DT, si më poshtë:

1. Oferta e paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik duhet të skualifikohet bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku thuhet “Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohej të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit



*publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.*

Operoret Gj..., pjese e ketij bashkimi me 98.5 % ( Gj..... 73.5 % dhe 25 & C.... ) te punëve te marra perisiper, rezultojnë te jene po se bashku si kontraktore me ARSSH-ne, per kontraten me objekt Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4, si bashkim i perkohshëm i operatoreve ekonomik C... shpk & Gj... sha, për te cilën nuk jane perfunduar 70 % e punimeve te kontraktuara.

Kete fakt e kane pranuar edhe vete operatori duke e deklaruar ne shtojca 11 si pune ne proces pikërisht kontratën e sipërpërmendur.

Mos përfundimi i 70 % punimeve është shkak skualifikimi jo vetëm i parashikuar ne VKM 42/2008 por edhe praktike e vendimmarrjes se ARSSH-se edhe ne procedura tjera te mëparshme prokurimi.

Skualifikimi për këtë arsye ne këtë procedure prokurimi është një fakt I njohur për operoret sepse AK , ne përgjigje te një kërkesë për sqarim ka botuar ne ëëë.app.gov. al përgjigjen se mos përfundimi i 70 % te fondit te prokuruar ne kontrata aktuale me ARSSH do te ishte arsye për skualifikim për çdo operator qe do te rezultonte me këtë problematike.

**2.** Kapacitetet teknike, profesionale e njerëzore te deklaruar nga BO Gj....., rezultojnë te deklaruar dhe te angazhuara edhe ne kontratën qe ky operator ka ne proces zbatimi , çka vjen ne kundërshtim dhe dëshmon mosplotësim te pikës 2.3.7/a te kriterëve te veçanta për kualifikim.

**3.** Operatori duhet te skuailfikohet ne zbatim te përcaktimeve te nenit 45 te LPP sepse një nga pjesëtarët e këtij bashkimi operatoresh , konkretisht operatori Gjoka sha , ka te papaguara detyrime te kontributeve te sigurimeve shoqërore qe sipas ligjit punëdhënësi paguan për punëmarrësit e tij.

Gj..... sha ka paraqitur vërtetimin T 01083283 datë 20.05.2019 te lëshuar nga Drejtoria tatimore ku dëshmohet se ka te papaguara detyrime e kontribute te sigurimeve shoqërore.

Po kështu edhe një nga pjesëtarët e tjerë te këtij bashkimi , G..... dege e shoqërisë se huaj ka detyrime te papaguara. G.....dege e shoqërisë se huaj ka paraqitur vërtetimin nr. T 01154361 datë 13.06.2019 te lëshuar nga drejtoria tatimore ku konfirmohet se ka te papaguara detyrime te kontributeve te sigurimeve shoqërore.

Për sa me sipër , mbështetur ;

Ne neni 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se ; Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”



Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”..

Për sa me sipër, Oferta e BO “GJ.....”, skualifikohet .

Auditimi u përqendrua kryesisht në ligjshmërinë e arsyeve të këtij operatori nisur për faktin se, ky operatori ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerë më të ulët kundrejt operatorit të kualifikuar dhe operatorëve të tjerë të skualifikuar. Nga auditimi, u konstatua:

**1. Në lidhje me arsyen se;** oferta e paraqitur nga ky bashkim operatoresh ekonomik duhet të skualifikohet bazuar në: VKM nr. 835, datë 15.07.2009 që ndryshon, Kreun III, pika 1, paragrafi II.b të VKM nr. 42, date 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi” ku përcaktohet: *“Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit, I ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk ka përfunduar punimet në 70% të fondit të prokuruar në Autoritetin Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtatin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”*, dolëm në konkluzionin se nuk qëndron sepse nuk mbështetet ligjërisht, si më poshtë:

**Së pari,** nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, në rubrikën “Kërkesa”, është paraqitur një kërkesë nga një operator ekonomik “S.....” në datën 14.06.2019 për sqarim të DT . Konkretisht operatori ekonomik ka kërkuar :

*‘Ne kriteret për kualifikim te shtojca 12 e DST nuk përmendet shprehimisht si kriter skualifikues por qe lehtësisht mund te deduktohet duke arsyetuar mbi kriteret e tjera dhe precedentit qe keni vendosur ne procedura te mëparshme siç është ai i Unazës Tirane loti3, për ne qe kemi aktualisht kontrate zbatim punimesh me ARSSH dhe nuk kemi përfunduar punimet ne masën 70 % te kontratës.*

*Por ndërkohe ne kriteret për kualifikim keni kërkuar deklaram mbi punët qe kemi aktualisht ne proces si dhe përmendet fakti se vlerësimet e operatoreve do te behën edhe mbi bazën e përcaktimeve te VKM 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe*



*Procedurat e dhënies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*

*Për te na shkurtuar shpenzimet e përgatitjes se ofertës te cilat nuk janë te pakta si dhe mos kemi paqartësi mbi ketë aplikim ju pyesim direkt ;*

*-A do te aplikohet si kriter skualifikues përcaktimi qe është ne pika 1 paragrafi II.b , KREU III, i VKM se nr. 42 /2008, i ndryshuar ku thuhet ; Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit, I ndryshuar, kontraktorë,, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk ka përfunduar punimet në 70% të fondit të prokuruar në Autoritetin Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtatin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.*

*Pyetja direktë qe bëjmë për sqarim është ; A mund kualifikohemi NE kompanitë qe për shkaqe te ndryshme qe varen apo nuk varen nga ne , nuk kemi përfunduar ende punimet 70% të fondit të prokuruar, te kontratës qe kemi aktualisht me ARSSH-ne ?*

*-A ndikon shkak i mos përfundimit te 70 % punimeve ( nqs nuk është për fajin tone ) ne vlerësimin qe do te behet nga KVO”.*

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese, autoriteti kontraktor ka publikuar sqarimin përkatës, po në datën 14.06.2019 si më poshtë :

Ne lidhje me sqarimet qe kërkoni ju bëjmë me dije se:

*ARRSH është e detyruar te zbatoje përcaktimet e VKM nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.*

*VKM e mësipërme përmban urdhërime detyruese për ARSSH ne cilësinë e AK lidhur me përfundimin mbi 70 % te punimeve te kontratave te lidhura . Gjithashtu , këto përcaktime nuk lenë vend për interpretime subjektive nga ana e ARSSH qofte edhe lidhur me shkakun e mos përfundimit te punimeve ne kontratat e lidhura .( ato konsiderohen te porealizuara ne masën 70 % cilido qofte shkak i mosrealizimit ). Për me tepër, qe kjo gjë është praktike e konsoliduar edhe ne procedura te mëparshme prokurimi qe ka zhvilluar ARSSH.*

Mirëpo, në sistemin e prokurimeve elektronike, për këtë procedurë prokurimi, AK nuk ka publikuar shtojcë të modifikimit të DT në lidhje me mos përfundimin e punimeve në masën 70%, sipas përcaktimeve të VKM nr. 42/2008 dhe pretendimeve të vetë ARSH. Po kështu kjo kërkesë nuk është vendosur në dokumentet e tenderit, që në momentin e hartimit të tyre dhe të publikimit të njoftimit të kontratës në sistemin e prokurimeve elektronike, pra nuk është përcaktuar asnjë kriter në lidhje me mos përfundimin e punimeve në masën 70% të fondit të prokuruar, sipas VKM nr. 42 date 16.01.2008.

Sa sipër, sqarimi i dhënë nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike, nuk mund të konsiderohet si një shtim kriteri/kërkesë për kualifikim, pasi nuk është publikuar si shtojcë



në dokumentet e tenderit dhe as nuk është shoqëruar me shtyrje të afatit të hapjes së ofertave sipas përcaktimeve të nenit 42 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".

***Pra, ky kriter nuk është kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit dhe nuk mund të përdoret si shkak për skualifikimin e operatorëve pjesëmarrës.***

**Së dyti**, deri në dhjetor të vitit 2017, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në nenin 26, pika 10, ka qenë përcaktuar se: "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike, të prokuruar sipas LPP-së, operatorët ekonomikë që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit". Me VKM Nr. 402 datë, 13.05.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKMN 914, datë 29.12.2014" ndryshuar, pika 10 e nenit 26 është modifikuar: "Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomikë janë kontraktorë/nëkontraktorë në një investim/investime dhe nuk i kanë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, për shkaqe të përlligjura, si vijon: i) vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si: KUZ, OSHEE etj.; ii) dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike; iii) vonesa në shpronësimin e subjekteve, të cilave u përket prona; iv) ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim; v) rishpërndarje të fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuar nga autoriteti kontraktor, sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit.

Pra, me këtë ndryshim është modifikuar kërkesa, duke mos e konsideruar më kusht automatikisht skualifikimi, mos përfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, dhe duke përcaktuar rastet e përjashtimeve për mos përfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës për shkaqe të përlligjura. Në thelb, është zbutur mënyra e aplikimit të kësaj kërkesë skualifikuese, pra skualifikuese bëhet vetëm për rastet kur mos përfundimi është në thelb mos përmbushje e kontratës nga ana e operatorit ekonomik, e duke lehtësuar në këtë mënyrë operatorët ekonomikë të interesuar për të konkurruar në procedura të tjera prokurimi.

Më pas, me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014", të ndryshuar", është shfuqizuar pika 10 e nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar dhe është shtuar germa "ç" në pikën 8 të nenit 26 si vijon: "Vetë deklarim nga operatori ekonomik që nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të





*punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit". Por, përsëri, mbas rreth 1 muaj e gjysmë, me VKM nr. 80, datë 14.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014”, i ndryshuar, germa "ç" e pikës 8 të nenit 26 është shfuqizuar.*

Për sa parashtruar më sipër, mos përfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës që ka shërbyer si shkak skualifikimi nuk ka mbështetje ligjore sepse nuk kërkohet nga rregullat e prokurimit publik të miratuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pasi sipas nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, vetëm rregullat e prokurimit publik, mund të rregullojnë, detajojnë dhe zbërthejnë çështje të lidhura me procedurat e prokurimit publik, përfshirë edhe kërkesat për kualifikim. Për pasojë referimit ligjor që i ka bërë KVO, Kreut III, pika 1, paragrafi II.b të VKM nr.42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, ka humbur fuqinë juridik, që nga momenti i hyrjes në fuqi të VKM nr. 80, datë 14.2.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar", dhe kriteri skualifikues i referuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me mos përfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës nuk mund të përdoret si shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

Ndërsa argumenti i AK, se operatorët ekonomikë janë njoftuar në pikën 2.3 të Shtojcës 12 të dokumenteve të tenderit për përdorimin si referencë për këtë qëllim të VKM nr.42, datë 16.01.2008, **nuk qëndron**, pasi e vetmja referencë e bërë në këtë VKM në Shtojcën 12 është pika 2.3.5, në lidhje me formatin e kërkuar të licencës, ku përcaktohet se: "Operatoret ekonomike duhet te disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet te paraqesin licencën përkatëse te shoqërisë, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Këshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008. Vetë Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 11 të Dokumenteve të Tenderit "Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ ose ne proces", ka sqaruar se "Kjo deklarate ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent".

Në këtë kontekst, në funksion edhe të parimit të transparencës të përcaktuar në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, theksojmë se, për sa kohë autoriteti kontraktor u ka bërë të njohur, si më sipër, qëllimin dhe funksionin e kësaj deklarate, nuk mundet që ta përdorë informacionin e përfutur prej saj për qëllime të tjera, të cilat nuk iu janë njoftuar paraprakisht operatorëve ekonomikë të interesuar.

**2 . Në lidhje me arsyen se:** “Kapacitetet teknike, profesionale e njerëzore te deklaruar nga BO “Gj...”, rezultojnë të deklaruar dhe të angazhuara edhe në kontraten që ky operator ka ne proces zbatimi, çka vjen ne kundërshtim dhe dëshmon mosplotësim te pikës 2.3.7/a te kriterëve te veçanta për kualifikim”, dolëm ne konkluzionin se nuk qëndron, si më poshtë:

**Së pari**, duke ju referuar arsyes së skualifikimit të sipërcituar, AK nuk ka përcaktuar apo vendosur në Dokumentet e Tenderit ndonjë kërkesë të veçantë në lidhje me deklarinimin për mos angazhimin e mjeteve në kontrata të tjera që operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë në proces zbatimi. Për pasojë, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi





duhet të plotësonin vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit dhe shqyrtimi dhe vlerësimi dokumentacionit të operatorëve duhej të bëhej vetëm në përputhje me këto kërkesa.

Në këtë rast, në kushtet kur nga ana e AK nuk është kërkuar dhe përcaktuar një kërkesë e tillë, përmbushja e kriterit në lidhje me pajisjet e mjetet provohet nëpërmjet plotësimit të kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit nga AK dhe në këtë rast, nëpërmjet pikës 2.3.7 të DT ku është përcaktuar se, *“operatori ekonomik duhet të disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik”*. Dhe për plotësimin e këtij kriter ky BO operatorësh dëshmon se, disponon mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, duke paraqitur edhe dokumentacion justifikues për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të kontratës.

Veprim ky që vjen në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe neni 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Së dyti**, AK në arsyen e skualifikimit (marrë nga sistemi elektronik i prokurimit publik), përveç faktit të mësipërm që ka bërë vlerësim mbi një kërkesë të pa kërkuar në DT, ka dhënë një arsye skualifikimi të përgjithshme, të pa pa detajuar se çfarë pike të kriterit 2.3.7/a nuk ka plotësuar operatori ekonomik (cilën makineri, pajisje apo mjete ka të angazhuar në kontrata të tjera), por përmend në mënyrë përgjithësuese pa dhënë detajet dhe arsyet përkatëse, se cili nga kapacitetet teknike, profesionale të deklaruara nga ky bashkim operatorësh ekonomikë nuk plotësohet.

Veprim ky që vjen në kundërshtim me nenin 55, pika 4 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku se: *“Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit”*.

**3. Në lidhje me arsyen se:** *“Operatori duhet të skualifikohet në zbatim të përcaktimeve të nenit 45 të LPP sepse një nga pjesëtarët e këtij bashkimi operatorësh, konkretisht operatori Gjoka sha, ka të papaguara detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore që sipas ligjit punedhenesi paguan për punëmarrësit e tij. Gjparaqitur vërtetimin T 01083283 dt 20.05.2019 të lëshuar nga Drejtoria tatimore ku deshohej se ka të papaguara detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Po kështu edhe një nga pjesëtarët e tjerë të këtij bashkimi, Gj.....l dege e shoqërisë se huaj ka detyrime të papaguara. Ge..... shoqërisë se huaj ka paraqitur vërtetimin nr. T 01154361 dt 13.06.2019 të lëshuar nga drejtoria tatimore ku konfirmohet se ka të papaguara detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore”*, dolëm në konkluzionin se arsye nuk qëndron, si më poshtë:

Operatori ekonomik “Gj....” për plotësim e kriterit për shlyerjen e detyrimeve tatimore ka paraqitur në sistemin elektronik, Shtojcën 8, ku ka deklaruar se, nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar si dhe ka paraqitur edhe Vërtetim (për pagim detyrimesh) me nr. T01028251, datë 02.05.2019, ku deklarohet se: *”Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 02.05.2019”*.



Për plotësimin e kriterit për vërtetimin e numrit të punonjësve, operatori ekonomik ka paraqitur, vërtetimin me nr. T01028239, datë 02.05.2019, që përmban të dhëna në lidhje me numrin e punonjësve deri në muajin Mars 2019 duke e përfshirë edhe këtë muaj, ku përsëri rezulton se ky operator ekonomik deri në datën 02.05.2019 nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar, si dhe vërtetimin me nr. T01083283, datë 20.05.2019, që përmban të dhëna në lidhje me numrin e punonjësve deri në muajin Prill 2019 duke e përfshirë edhe këtë muaj, ku rezulton se ky operator ekonomik deri në datën 20.05.2019 ka detyrim tatimor të papaguar vetëm Kontribute gjithsej në shumën 6,624,055 lekë. Vërtetimi me nr. T01083283, datë 20.05.2019, që përmban të dhëna në lidhje me numrin e punonjësve deri në muajin Prill 2019, vërteton se, operatori ekonomik ka vetëm detyrime të kontributeve në shumën 6,624,055 lekë, dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me kamat vonesat apo gjordat lidhur me kontributet. Këto të dhëna, pra detyrimet në kontribute deri në datën 02.05.2019 janë të gjitha në vlerën 0 lekë duke dëshmuar se ky operator ekonomik nuk ka detyrime të papaguara deri në datën 02.05.2019, por në datën 20.05.2019, pra brenda të njëjtit muaj, rezulton se ka detyrime në vlerën 6,624,055 lekë, detyrim ky që i korrespondon muajit prill 2019, ndërkohë që vetë AK në pikën 2.3.2 të DT ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, jo më pak se 130 punonjës, për periudhën Janar 2018 – Mars 2019. Pra këto detyrime janë detyrime koherente dhe kanë një afat të caktuar ligjor për t'u paguar e nuk është e detyrueshme të paguhen përpara datës së hapjes së ofertave që është data 27.05.2019 (njoftimi I shpalljes së kontratës është datë 24.04.2019), por sipas legjislacioni përkatës në fuqi, paguhen çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Po kështu edhe në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ”G.....” degë e shoqërisë së huaj, konstatohet se përveç deklaratës mbi përmbushjen e kriteve të përgjithshme, ka paraqitur edhe dokumentin e datës 12.06.2019, ku deri në datën 11.06.2019 ky operator ekonomik nuk ka asnjë detyrim të papaguar. Në lidhje me ”Vërtetim (Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a), me nr. T01154361, datë 13.06.2019”, ku deklarohet lista me numrin e punonjësve për periudhën Shtator 2016 – Maj 2019, i cili është paraqitur në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kriteve të veçanta për kualifikim, ashtu siç analizuam edhe më lart për operatorin “Gj....”, edhe për këtë operator, këto detyrime kanë të bëjë vetëm me detyrimet koherente të muajit maj 2019.

Për më tepër, duke ju referuar kriteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, vërtetimi në lidhje me pagimin e detyrimeve të tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, është përmbushur nëpërmjet dorëzimit të deklaratës përkatëse nga të dy operatorët, për të cilat autoriteti kontraktor në çdo kohë mund të bënte verifikimet e duhura pranë organeve përkatëse.

Skualifikimi i këtij bashkimi operatorësh për këtë arsye është në kundërshtim me nenin 45 dhe 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe neni 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



Për sa u trajtua më sipër, dolën në ë konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Gj... në këtë procedurë prokurimi, plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe kërkesat e veçanta të vendosura në DT dhe KVO duhej ta kualifikonte këtë bashkim operatorësh për fazën tjetër të shqyrtimit të ofertës ekonomike. Meqenëse, ky bashkim operatorësh kishte paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 1,789,598,000 lekë e cila është më e ulët se operatori tjetër i kualifikuar “L.....” që e ka në vlerën 2,299,327,253.75 lekë , KVO duhej ta klasifikonte i pari në renditje dhe duhej të shpallej fitues, pasi oferta ekonomike e tij ishte me vlerë më të ulët me diferenca **në vlerën 611,675,104 lekë** me TVSH ( 2,299,327,253.75 lekë-1,789,598,000 lekë x20%, TVSH)

Nisur nga skualifikimi në kundërshtim me rregullave e prokurimit publik, operatori ekonomik “Gj...” nkesë dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit.

Grupi i auditimi me përfundimin e fazës së vlerësimit nga KVO të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, menjëherë mbas njohjes së këtij vlerësimi nëpërmjet sistemit elektronik, i kërkojë Autoritetit Kontraktor vënien në dispozicion të dokumentacionit e këtij prokurimi të cilat nuk gjenerohen nga sistemi elektronik. Por AK nuk ju përgjigj kësaj kërkesë dhe grupi i auditimit me shkresë të protokolluar në ARRSH me datë 18.07.2019 i është drejtuar, Drejtorisë Juridike, Sektorit të Prokurimeve dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH dhe i ka kërkuar që të vihen në dispozicion të auditimit i gjithë dokumentacioni që nuk gjeneron sistemi elektronik dhe veçanërisht ankesat e operatorëve.

Përsëri strukturat drejtuese të ARRSH nuk i vunë në dispozicion këto dokumente dhe as nuk kthyen përgjigje shkresës sonë.

Ky veprim bie në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"

Përgjegjësia bie mbi Drejtoreshën e Përgjithshme të ARRSH znj. S. Q dhe mbi Përgjegjësin e Sektorit të Prokurimeve z. A. P.

Në kushtet e mosvënies në dispozicion të këtij dokumentacioni, auditimi u përqendrua vetëm në dokumentacionin e gjeneruar nga sistemi elektronik i prokurimeve publike. Por, siç u tha më lartë operatori ekonomik “Gj...” ka paraqitur fillimisht ankesë pranë ARRSH, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në përfundim të shqyrtimit në themel të ankesës, me Vendimin nr. 150, datë 09.07.2019 ka Vendosur:

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gj...” , për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-19520-04-24-2019, me objekt: “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7”, me fond limit 2.332.573.946 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gj...” dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.



Vlen të theksojmë se, në arsyetimin e këtij vendimi, KPP ka bërë në thelb, të njëjtën arsyetim dhe interpretim ligjor si arsyetimet dhe interpretimet e mësipërme të bëra nga auditimi.

Sa sipër për shkeljet e trajtuara në këtë raport përgjegjësia bie mbi Titullarin e Autoritetit Kontraktor znj. S. Q, Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: znj. E. G, z. S. P, z. E. S, si dhe për mos vënien në dispozicion të auditimit dokumentacionin e këtij tenderi, veçanërisht gjithë korrespondencën shkresore dhe dokumentacionin për shqyrtimin e ankesës ndërmjet, Operatorit ekonomik, ARRSH dhe KPP, përgjegjësia bie mbi përgjegjësin e sektorit të prokurimeve z. A.P.

Nuk janë paraqitur observacione për projektraportinin

**9. Gjithashtu,** nga auditimi u konstatua se edhe në tre procedura prokurimi të tjera ka pasur raste të skualifikimeve të operatorëve , të cilat janë skualifikuar për mos përmbushje të disa kraterëve të veçanta që Autoritetit Kontraktor, nuk i kanë dhënë siguri që këta operatorë i përfundojnë me sukses kontratat. Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike të disa operatorëve të skualifikuar që i kanë paraqitura më të ulëta se fituesit, KVO mundë të tregohet me tolerante dhe ti konsideronte mangësitë e konstatuara devijime të vogla. Kështu mundë të kishim edhe kursim apo menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve buxhetore. Konkretisht janë këto procedura:

**1. Procedura e prokurimeve me objekt: Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja me rrugën ekzistuese të objektit Sistemim Asfaltim rruga Korçë-Erseke Loti 1”,** me fond limit: 466,675,488.5 lekë me fitues operatorin “A...” me ofertë 466,373,334 lekë, të realizuar në vitin 2017. Në këtë procedurë nga 3 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik 2 operatore ekonomik. Një nga këta operatorë “A.....”, ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 20,123,397 lekë, me TVSH dhe është skualifikuar për disa mangësitë apo paqartësi në dokumentacionin paraqitur për përmbushjen e kraterëve të veçanta..

**2. Procedura e prokurimeve me objekt: “Përmirësimi i sigurisë rrugore në aksin Kashar-Rinas”** me fond limit 81,025,172 lekë, me operatorë fitues “B.....”, me ofertë 79,401,506 lekë, të realizuar në vitin 2017. Në këtë procedurë nga 6 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik 5 operatore ekonomik, pasi ka konstatuar në dokumentacionin e paraqitur disa mangësitë dhe paqartësi në lidhje me përmbushjen e kraterëve të veçanta. Tre nga të operatorë ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi, dhe më të ulët e ka paraqitur operatori “A.....” me diferencë nga fituesi në vlerën 16,835,772 lekë, me TVSH.

**3. Procedura e prokurimeve me objekt: “Ndërtim i aksit rrugor Skrapar – Permet, Loti 1”,** me fond limit, 1,016,355,449.90 lekë, me operatorë fitues S... me oferte 1,015,858,675 lekë, të realizuar në vitin 2017. Në këtë procedurë nga 3 operatorë pjesëmarrës janë skualifikuar në



## KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

përputhje me rregullat e prokurimit publik 2 operatore ekonomik. KVO i ka skualifikuar këta të dy operatorë sepse, ka konstatuar disa mangësitë dhe paqartësi në dokumentacionin e paraqitur për përmbushjen e kriterëve të veçanta, të cilat nuk të japin siguri se këta operatorë ekzekutojnë me sukses kontratën, por këta operatorë kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi, respektivisht operatori “E.....”, me diferencë në vlerën 172,231,791 leke dhe operatori “VH....” në vlerën 234,947,208 lekë.

### III.1. ZBATIMI I PUNIMEVE SIPAS KONTRATAVE TE LIDHURA

#### 1. Mbi zbatimin e kontratës “Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 2”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik dhe verifikimi në terren të kontratës “Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 2” u konstatua:

a.Zbatimi i Kontratës Punimeve				
<b>14.Lidhja e kontratës bazë</b> Nr.9604/7 datë 20.12.2008  midis ARRSH-së përfaqësuar nga z.A. T. dhe sipërmarrësit BOE “C.....” përfaqësuar nga z.Q. P.  Amendim kontrate Nr.585 datë 29.01.2010 për shtyrje afati me 10 muaj. Amendim kontrate Nr.3005/2 datë 29.04.2011 për shtyrje afati me 12 muaj. Amendim kontrate Nr.2194/2 datë 20.04.2012 për shtyrje afati me 12 muaj. Shtesë kontrate Nr 2104/2 datë 26.04.2013. Shtesë kontrate Nr.2123/1 datë 25.04.2014. Shtesë kontrate Nr.1268/1datë 17.02.2015, për shtyrje afati me 10 muaj.	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 586,984,555 lekë.		<b>16.Likuiduar deri dt</b> __. __.2019  <b>lekë me tvsh</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 390 ditë .  Fillimi punimeve: 05/01/2009  Përfundimi punimeve: 14.12.2015		<b>19.Leje ndërtimi për punimet e objektit.</b>	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b>  Kontratë mbikëqyrje midis DPRR përfaqësuar nga z.A. T dhe mbikëqyrësit “T.....” shpk, përfaqësuar nga znj.D. Q.	Licenca  Nr:  MK. 0919	Kontrata Nr. 9604/8 Prot.....datë 30.12.2008	Likuiduar  (.....lekë)	Pa likuiduar  (.....lekë)
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b>  Përfaqësuesit e ARRSH-së , A. Q, K. B dhe S.Pi	Licenca  Nr:	Kontrata Prot.....datë	Likuiduar  (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b>	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> dt		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë	



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në "Autoritetin Rrugor Shqiptar"

Datë 15.05.2017		(për mallrat)
-----------------	--	---------------

I. Autor i projektit është subjekti: "L....." P.K.S.

II. Janë bërë ndryshime në preventiv mbas miratimit në KT të datës 16.06.2009 dhe datës 02.11.2015, të cilat janë pasqyruar në tabelën e ndryshimit të volumeve dhe preventivin e rishikuar, ku vlera e tij nga mbetur sa vlera e preventivit të kontratës fillestare.

III. Është përdorur fondi rezervë në vlerën prej 14,251,070 lekë tvsh.

II. Nga verifikimi i dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit dhe verifikimit në terren u konstatua se nuk janë kryer punime të cilat rezultojnë të paguara në situacionin me vlerë **3,708,774 lekë pa tvsh (Tabela 1)**. Përkatësisht për:

	<i>Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 2</i>	Njësia	Çmimi	Sasia Situacion	Sasia Faktike	Diferanca	Diferenca
Zëri	<b>Emërtimi</b>		Lekë	Njësi	Njësi	Sasi	Lekë
I	<b>Punime ne trup te rrugës</b>						
	Shtrese zhavori t=20cm	m3	800	10994	9778.6	1215.41	972,326
	Shtrese stabilizanti t=20cm	m3	1600	10609	8898.7	1710.3	2,736,448
	DIFERENCA						<b>3,708,774</b>
	<b>T.V.SH</b>						<b>741,755</b>
	<b>SHUMA TOTALE</b>						<b>4,450,529</b>

Tabela 1. Tabela e diferencave të volumeve

**Zërin A.5 Shtresë stabilizanti t=20cm.** Volumi për shtresë stabilizanti t=20cm është paguar në situacion në sasinë 10,609 m<sup>3</sup>. Në librezën e masave volumi shtresë stabilizanti është pasqyruar 10,798m<sup>3</sup>. Nga verifikimi i projektit të rishikuar, librezës së masave dhe në terren, konstatohet se gjerësia e pjesës së asfaltuar pa përfshirë bankinat duke marrë në konsideratë dhe pjerrësinë, është b=10 m. Gjatësia e rrugës sipas piketave të projektit të rishikuar është L= 4399.36 m. Sipërfaqja e shtresës së stabilizantit me t=20 cm i cili ndodhet poshtë shtresave asfaltke është  $S_{st} = 4399.36m \times 10 m + 2 \times 250 m^2$  (shesh pushimet tek piketa S62-S65) = 44493.6 m<sup>2</sup>. Ndërsa volumi i stabilizantit është  $V_{st} = 44493.6 m^2 \times 0.2 = 8898.7 m^3$ . Diferenca në volum për "Shtresë stabilizanti t=20cm" është  $V = 10609 m^3 - 8898.7 m^3 = 1710.3 m^3$ . Vlera e diferencës prej 1710.3m<sup>3</sup>, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

**Zërin A.7 Shtresë zhavori t=20cm.** Volumi për shtresë zhavori t=20cm është paguar në situacion në sasinë 10,994 m<sup>3</sup>. Në librezën e masave volumi shtresë zhavori t=20cm është pasqyruar 10,798m<sup>3</sup>. Nga verifikimi i projektit të rishikuar (profilet tip dhe terthor), librezës së masave dhe situacionit përfundimtar konstatohet se gjerësia e shtresës së zhavorit pa përfshirë bankinat duke marrë në konsideratë dhe pjerrësinë është b=11 m. Gjatësia e rrugës sipas piketave të projektit të rishikuar është L= 4399.36 m. Sipërfaqja e shtresës së zhavorit me t=20 cm është





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

$Sst = 4399.36m \times 11 m + 2 \times 250 m^2$  (shesh pushimet tek piketa S62-S65) = 48892.96 m<sup>2</sup>. Ndërsa volumi i zhavorit është  $Vst = 48892.96 m^2 \times 0.2 = 9778.6 m^3$ . Diferenca në volum për “Shtresë zhavori  $t=20cm$ ” është  $V = 10,994 m^3 - 9778.6 m^3 = 1215.4 m^3$ . Vlera e diferencës prej 1215.4 m<sup>3</sup>, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” i ndryshuar dhe Nenin 7 të Ligjit 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve znj. D. Q., përfaqësuese e “T.....” shpk.

*Nuk janë paraqitur observacione për projektraportin nga Autoriteti Kontraktor.*

## 2. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rifreskimi Sinjalistikës Vertikale/Horizontale në Akset Kombëtare dhe Përmirësimi i Sigurisë Rrugore në Akset e Rajonit Verior, Loti”.

Në zbatim të autorizimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekti fillestar, projekt i rishikuar, situacion përfundimtar, librezë e masave etje.

### *Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:*

a.Zbatimi i Kontratës Punimeve				
<b>14.Lidhja e kontratës bazë</b> Nr.5795/3 datë 20/08/2018 midis ARRSH-së përfaqësuar nga z.A. Q. dhe sipërmarrësit “Jubica” shpk përfaqësuar nga z.E. C.	<b>15.Vlera e kontratës (me tvsh)</b> 246,000,002 lekë.		<b>16.Likuiduar deri dt</b> __.__.2019 <b>lekë me tvsh</b>	
<b>17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi</b>	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar: 240 ditë . Fillimi punimeve: 23.08.2018 Përfundimi punimeve: 24.11.2018 Realizimi: 3 muaj (90 ditë)		<b>19.Leje ndërtimi për punimet e objektit.</b>	
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> Kontratë mbikëqyrje me vlerë 1,541,400 lekë me tvsh, midis ARRSH-së përfaqësuar nga z.A.Q dhe mbikëqyrësit "C.." shpk, përfaqësuar nga z.Vangjush Mbricë. Në datë 27/08/2018 është emëruar mbikëqyrës punonjëse e ARRSH-së znj. DHL	<b>Licenca</b> Nr: MK 2049/4	<b>Kontrata</b> Nr. 9604/8 Prot.6494/9 datë 2.11.2018	<b>Likuiduar</b> (.....lekë)	<b>Pa likuiduar</b> (.....lekë)



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

	MK.0384/2	Shkresë Nr.7308 datë 27/08/2018		
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> Përfaqësuesit e ARRSH-së , A.B dhe A.H.	Licenca Nr:	Kontrata Prot.....datë	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b> Datë 18.12.2018	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> dt		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë (për mallrat)	

I. Autor i projektit është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II. Është përdorur fondi rezervë në vlerën prej 9,761,905 pa tvsh.

III. Nga verifikimi i dokumentacionit ndodhur në dosjen e zbatimit dhe verifikimit në terren u konstatua se nuk janë kryer punime të cilat rezultojnë të paguara në situacionin me **4,134,320 (Tabela 1)**. Përkatësisht për:

**Zërin 5. Bojë bikomponente (pastë).** Nga verifikimi në terren konstatohet se kalimet e këmbësorëve janë realizuar pjesërisht me bojë bikomponente e llojit pastë (*paraqitur në figurën Nr.1*). Më konkretisht evidentohet se gjysma e vijëzimit është realizuar me boje bikomponente pastë dhe gjysma e vijëzimit është realizuar me bojë termoplastike e llojit sprajt, e ngjashme me bojën termoplastike të përdorur për vijëzimet e ndërprera gjatësore në aksin e rrugës (*paraqitur në Figurën Nr.1*). Në disa raste pjesa me bojë bikomponentë pastë është realizuar pjesa me ngjyrë të kuqe e kalimit të këmbësorëve dhe në disa raste është realizuar pjesa me ngjyrë të bardhe. Si pasojë vijëzimi për kalimin e këmbësorëve konsiderohet i realizuar në gjysmën e sipërfaqes me boje bikomponente (pastë) dhe në gjysmën e sipërfaqes me bojë termoplastike (sprajt). Çmimi sipas Manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2015 (miratuar me VKM Nr.629 datë 15.07.2015), për **bojën termoplastike (sprajt)** është 1869 lekë/m<sup>2</sup>. Diferenca në çmimin është 6500 lekë/m<sup>2</sup> – 1869 lekë/m<sup>2</sup> = 4631 lekë/m<sup>2</sup>, Sasia prej 720 m<sup>2</sup> vijëzime duhet të llogaritet me çmimin 1869 lekë/m<sup>2</sup>. Ndërsa vlera 720m<sup>2</sup> x 4631 lekë/m<sup>2</sup> = **3,334,320 lekë pa tvsh** është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve. Në tabelën e mëposhte paraqitet e detajuar vlera sipas akseve:

	<i>Rifreskimi Sinjalistikës Vertikale/Horizontale në Akset Kombëtare dhe Përmirësimi i Sgurisë Rrugore në Akset e Rajonit Verior, Loti 1</i>	Njësia	Çmimi	Sasia Situacion	Sasia Faktike	çmimi sipas manualit 2015	Diferenca e çmimit	Diferenca
Zëri	<b>Emërtimi</b>		Lekë	Njësi	Njësi		Lekë	Lekë
II	<b>Segmenti Balldren - Barbullush - Bushat 21.8 km</b>							
5	Bojë bikomponente (pastë)	m2	6500	230	115	1869	4631	532,565
III	<b>Segmenti Laç - Patok 10.8 km</b>							



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

5	Bojë bikomponente (pastë)	m2	6500	220	110	1869	4631	509,410
IV	<b>Segmenti Fierzë-Bujan-Sopot- Q.Morinë, Bujan - Bajram Curri 31.6km</b>							
5	Bojë bikomponente (pastë)	m2	6500	500	250	1869	4631	1,157,750
V	<b>Segmenti Kukës-Krumë-Golaj-Qafe Prush 45.9 km</b>							
5	Bojë bikomponente (pastë)	m2	6500	450	225	1869	4631	1,041,975
I	<b>Segmenti Koplík - Dedaj - Bogë, Dedaj-Razëm 39.8 km</b>							
5	Bojë bikomponente (pastë)	m2	6500	40	20	1869	4631	92,620
II	<b>Segmenti Balldren - Barbullush - Bushat 21.8 km</b>						<b>Diferenca Sasi</b>	
4	Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15cm. Termplastike (sprajt)	ml	320	12388	9888		2500	800,000
	<b>DIFERENCA</b>							<b>4,134,320</b>
	<b>T.V.SH</b>							<b>826,864</b>
	<b>SHUMA TOTALE</b>							<b>4,961,184</b>

**Zërin 4. Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15cm. Termplastike (sprajt).** Për “Segmentin Balldren - Barbullush - Bushat ne L= 21.8 km” është paguar në situacion 12,388 ml vijëzim gjatësor i ndërprerë në aksin e rrugës. Nga verifikimi në terren rezultoi se në pjesën (km 6+000 deri në km 11+000) ku rruga nuk është me dy kalime normale, nuk është realizuar vijëzim në aksin e rrugës. Kjo gjatësi është 5 km. Si pasojë nuk është realizuar vijëzim i ndërprerë në aksin e rrugës ose “Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15cm. Termplastike (sprajt)” në gjatësinë 2500 ml. Si pasojë është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera 2500 ml x 320 lekë/ml = **800, 000 lekë pa tvsh**, paraqitur në Tabelën e mësipërme.

Gjithashtu konstatohet se në segmentin Fierzë-Bujan-Sopot- Q.Morinë, Bujan - Bajram Curri vijëzimet për kalimet e këmbësorëve janë fshirë pjesërisht, duke mos kryer funksionin e plotë të tyre (paraqitur në figurën 3). Ndërsa boja bikomponente (pastë) e përdorur për shigjeta dhe ishuj trafiku në qytetin e Krumës është fshirë pjesërisht, fakt i cili tregon se punimet nuk janë kryer me cilësinë e kërkuar.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”



Figura 1



Figura 2

Si përfundim është vepruar në kundërshtim pikën 5.1 të Udhëzimit të KM Nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve” i ndryshuar dhe Nenin 7 të Ligjit 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit” dhe ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. V. M, përfaqësues të “C...” shpk dhe mbikëqyrësja e punimeve e përcaktuar nga ARRSH, znj.DH.L.

*Për problemet e trajtuara në projekt raport dhe të trajtuara më sipër në këtë raport, subjekti i audituar me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacionet në të cilat ka bërë komente dhe shpjegime që në përmbajtje janë të njëjta me komente dhe shpjegimet e bëra për aktkoïnstatimin dhe të trajtuara hollësisht nga auditimi në projekt raport ( për më hollësi referou projekt raportit në të cilin, janë trajtuar gjerësisht observacionet dhe qëndrimi me komentet e auditimit).*

### **3. Zbatimi i kontratës me objekt: “Ndërtim i aksit rrugor Skrapar - Përmet, Loti 1”.**

Në zbatim të autorizimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i dosjes: Projekti fillestar, projekti i rishikuar, preventivi i rishikuar 1 dhe 2, Vendimet e Keshillit Teknik, situacion përfundimtar i kontratës bazë dhe kontratës shtesë, librezë e masave etje.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në "Autoritetin Rrugor Shqiptar"

a.Zbatimi i Kontratës Punimeve				
<p><b>14.Lidhja e kontratës bazë</b></p> <p>Nr.1969/5 datë 24.04.2017</p> <p>midis ARRSH-së përfaqësuar nga z.D. Xh dhe "S..." shpk përfaqësuar nga z.L.S... me vlerë 1,219,030,410 lekë me tvsh.</p> <p><b>Lidhja e kontratës shtesë</b></p> <p>Nr.4649/6 datë 19.07.2018</p> <p>midis ARRSH-së përfaqësuar nga z.A.Q dhe "S..." shpk përfaqësuar nga z.L.S... me vlerë 242,220,795.60 lekë me tvsh.</p>	<p><b>15.Vlera e kontratës bazë (me tvsh):</b> 1,219,030,410 lekë</p> <p>Vlera e kontratës shtesë (me tvsh): 242,220,795.60 lekë</p>		<p><b>16.Likuiduar deri dt</b></p>	
<p><b>17- Situacioni Përfundimtar/Faturë Mali/Shërbimi</b></p>	<p><b>18.Afati i kontratës bazë në dite</b></p> <p>Parashikuar 23 muaj .</p> <p>Fillimi punimeve: 24.04.2017</p> <p>Perfundimi punimeve: 22.03.2019</p> <p><b>Afati i kontrës shtesë: 8 muaj</b></p> <p>Fillimi i punimeve: 25.07.2018</p> <p>Perfundimi punimeve: 25.03.2019</p>		<p><b>19.Leje ndërtimi për punimet e objektit. Nuk ka</b></p>	
<p><b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b></p> <p><b>Kontrata bazë</b></p> <p>-Nikollaq Mihali dhe Klarita Konomi, punonjës të ARRSH-së të autorizuar nga Drejtori i ARRSH-së me shkresë Nr.3249 datë 25.04.2017, prej datës 24.04.2017 - 22.03.2018 (Situacion 1-8)</p> <p>-"Gjeokonsult &amp; Co" shpk përfaqësuar nga z.H.M në bazë të kontratës me ARRSH, përfaqësuar nga z.A.Q. Nr. 3357/9 datë 23.03.2018, me vlerë 1,959,077 lekë me tvsh, prej datës 23.03.2018 - 22.03.2019 (Situacion 9-Situacion përfundimtar).</p> <p>Për kontratën shtesë është caktuar mbikëqyrës përfaqësuesi i ARRSH-së z.A.K me shkresë Nr.4649/10 datë 25.07.2018.</p>	<p>Licenca</p> <p>Nr:</p> <p>MK.0514/1</p>	<p>Kontrata Nr. 3357/9 datë 23.03.2018</p>	<p>Likuiduar</p> <p>(.....lekë)</p>	<p>Pa likuiduar</p> <p>(.....lekë)</p>





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në "Autoritetin Rrugor Shqiptar"

	MK.0850/1  Licencat e tjera nuk ëshë të administruara ne dosje			
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b>  Përfaqësuesit e ARRSH-së , A.B dhe K. B.	Licenca  Nr:	Kontrata Prot.....datë	Likuiduar (.....lekë)	Pa likuiduar (..... lekë)
<b>22.Akt Kolaudimi</b>  Kontrata bazë: dt. 08.05.2019  Kontrata shtesë: dt. 08.05.2019	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim</b> Ska		<b>24. Fletë Hyrja</b> Nr.... datë .....lekë  (për mallrat)	

Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen e zbatimit dhe verifikimit në terren u konstatua:

- Autor i projektit është subjekti: "I..." shpk, realizuar në vitin 2015. Projektit të Lotit të I-rë të Segmentit Skrapar - Përmet, i është kryer oponencë teknike nga Instituti i Ndërtimit, dhe oponenca i është dërguar Autoritetit Rrugor me shkresë e cila mban datën Nr. 903/3 18.10.2016. II. Janë bërë ndryshime në projekt dhe në preventiv mbas miratimit në KT me Vendim Nr.56 datë 24.10.2017, ku janë miratuar propozimet për përmirësimin/saktësimin/plotësimin dhe modifikime në projekt, preventivit dhe punimeve shtesë. Gjithashtu janë miratuar përsëri ndryshime në projekt dhe preventiv me Vendim të KT Nr.67 datë 13.12.2018, ndryshimet e volumeve janë pasqyruar në tabelën e ndryshimit të volumeve dhe preventivet e rishikuar.

-Është përdorur fondi rezervë në vlerën prej 48,374,223 lekë pa tvsh

-Me shkresën Nr.8168/2 Prot. datë 18.10.2017, Drejtoria e Zhvillimit të Projekteve të Brendshme dhe të Huaja Teknike kanë dërguar materialin për diskutim në Këshill Teknik për përmirësim/saktësim/plotësim/modifikime dhe shtesë punimesh të projekt zbatimit "Ndërtimi i aksit rrugor Skrapar - Përmet" Loti 1.

Nga ana e kontraktorit "S... shpk" dhe mbikëqyrësve të punimeve Klarita Konomi dhe Nikollaq Mihali, gjatë zbatimit të punimeve janë evidentuar problematika, të cilat duku u nisur nga natyra e tyre dhe lloji i zgjidhjes teknike renditen si më poshtë: Ndryshime e modifikime të projektit, rishikim i volumeve të projektit (saktësime volumesh), marrja e shkresës për shqyrtimin e kërkesës së banorëve të fshatit Rog për të hartuar projektin e një gjurme të re të rrugës jashtë fshatit. Për problematikat e dala në objekt janë informuar ARRSH me shkresat Nr.300 datë 29.05.2017 dhe shkresa 305 datë 31.05.2017. Përsa i përket devijimit në fshatin Rog të kërkuar nga banorët janë hartuar 3 variante projektesh, Variant 1 me L=1886m, Variant 2 me L=1167m dhe Variant 3 me L=1120m. Ne përfundim të paraqitjes së 3 varianteve kontraktori dhe mbikëqyrësi konkludojnë se Varianti 3 është varianti më ekonomik dhe përmirëson planimetrinë



e rrugës. Për realizuar këtë variant do të përdoret fondi rezervë në masën 5% për segmentin e parë për përballimin e volumeve të llogaritura për këtë segment, dhe do të duhet dhe një shtesë kontrate me vlerë **201,851,119 lekë pa tvsh** në masën 19.8%. Për realizimin e punimeve për përfundimin e të gjithë kontratës propozohet që zërat e punimeve në bazë të radhës së punës teknologjike dhe terrenit të ndahen: Punime brenda vlerës së kontratës, punime që mbulohen nga fondi rezervë, punime për shtesë kontrate.

I. Propozimet e mësipërme janë Miratuar nga Këshilli Teknik me Vendimin Nr.56 datë 24.10.2017. Për shtesën e kontratës nuk është kryer opionencë teknike, në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, neni 6 ku citohet : "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 milionë lekë, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi Autoritetin Kontraktor, A.A (Drejtor i Projekteve të Brendshme dhe të Huaja Teknike) dhe A.Q (Drejtor i Përgjithshëm),

-Gjithashtu me shkresë Nr.10611/1 datë 04.12.2018 Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes sektori i menaxhimit të projekteve të brendshme ka përcjell për diskutim propozimet e kontraktorit "S... shpk" dhe projektuesit shoqërisë konsulente "InfraTransProject" shpk, të aprovuara nga mbikëqyrësi i punimeve "Gj..." shpk për saktëzime, plotësime e modifikime në projekt preventivin e objektit "Ndërtim aksit rrugor Skrapar - Përmet, Loti 1" kontratë bazë dhe shtesë punimesh. Ndër të tjera është kërkuar shtim në volum të zërit "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar".

II. Edhe pse preventivi dhe projekti i hedhur në tender, ka pësuar ndryshime, ku mbas propozimeve të mbikëqyrësve janë hequr dhe shtuar disa zëra punimesh, punimet më kryesore janë punimet e preventivit të **Kategorisë Nr.4 Viadukti** me vlerë punimesh 197,604,245 lekë me tvsh dhe punimet e **Kategorisë Nr.5 Mbushjet e Larta me Sistem Qelizor me vlerë preventivi 3,612,249 lekë me tvsh**, Punime sinjalistike, punime shtresash dhe punime struktura betoni.

Për punimet dhe volumet e Kategorisë Nr.5 "Mbushjet e larta me sistem qelizor ( të parashikuara nga projektuesi në projektin fillestar dhe sipas specifikimeve teknike sipas figurës 1) është sugjeruar nga kontraktori dhe mbikëqyrësi për tu hequr plotësisht si punimesh në Zonën 1 ( Km 2+860 - km 2+895) dhe janë zëvendësuar me punime gabionash në zonat shkarësë. Ky ndryshim është miratuar nga KT me Vendim Nr.56 datë 24.10.2017.

Megjithëse janë bërë rishikime dhe përmirësime të projektit dhe është përdorur fondi rezervë dhe është realizuar shtesë kontrate në vlerë, qëllimi kryesor i projektit për të realizuar Lotin 1 të Segmentit Skrapar- Përmet, më të gjitha karakteristikat e kërkuara në projektin fillestar nuk është përbushur plotësisht, ku mungon shtresa asfaltike, sinjalistika dhe punime të tjera të parashikuara.




Figura 3. Specifikimet teknike të mbushjes së lartë 1 qelizore sipas projektit fillestar Ndërkohë janë shtuar volumet për mbushje në trupin e rrugës, në gjatësitë Km: +3814, +3820 +3840m, +3860m, +3880m, +3900m, +3880m, +3900m, +4100m, +4120m, +4140m, +4160m, +4180m.



Figura 4. Mbushjet në trup të rrugës. Nga verifikimi në terren këto mbushje nuk janë realizuar në sistemin qelizor dhe janë mbushje në trup të rrugës pa masa mbrojtëse qelizore si ishte parashikuar në projektin fillestar. Ndërkohë që



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në "Autoritetin Rrugor Shqiptar"

volumet e zërit "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar" janë vendosur në preventivët e rishikuar 1-2 dhe miratuar me Vendimet e Këshillit Teknik Nr.56 dhe Nr.67, në pjesën e **Kategorisë 5 "Mbushje të larta"**, me çmimin e ofertuar nga kontraktori me vlerë 1200 lekë/m<sup>3</sup>. Kontraktori për mbushjen në trup të rrugës ka ofertuar në **Kategorinë 1: Punime dherash dhe prishjet** me zërin "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar" me çmim 350 lekë/m<sup>3</sup>.

Volumet për "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar" mund të ishin llogaritur me çmimin 350 lekë/m<sup>3</sup> dhe në Kategorinë 1: Punime dherash dhe prishjesh dhe jo me çmim 1200 lekë/m<sup>3</sup>.

Kontraktori ka situacionuar për zërin "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar" duke i llogaritur volumet në trupin e rrugës, në gjatësitë Km: +3814, +3820 +3840m, +3860m, +3880m, +3900m, +3880m, +3900m, +4100m, +4120m, +4140m, +4160m, +4180m, me një çmim 1200 lekë/m<sup>3</sup>. Diferenca në çmimin njësi është: 1200 lekë/m<sup>3</sup> - 350 lekë/m<sup>3</sup> = 850 lekë/m<sup>3</sup>. Diferenca paraqitet dhe në tabelën e mëposhtme:

		Njësia	Çmimi për mbushjet e larta qelizore Kategoria 5	Sasia Situacion	Çmimi për bushjet në trup të rrugës Kategoria 1	Diferenca e çmimit	Diferenca në Vlerë
Zëri	<b>Emërtimi</b>		Lekë	Njësi	Lekë	Lekë	Lekë
	<b>Situacioni i kontratës bazë</b>						
3	"Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar"	m <sup>3</sup>	1200	55729	350	850	47,369,650
	<b>Situacioni i kontratës shtesë</b>						
3	"Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar"	m <sup>3</sup>	1200	86108	350	850	73,191,800
	<b>DIFERENCA NE VLERE (PA TVSH)</b>						<b>120,561,450</b>

Si përfundim vlera prej 120,561,450 pa tvsh ( për 141,837 m<sup>3</sup>), që përfaqëson diferencën e çmimit të zërave të mbushjes, midis zërit të situacionuar "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në garanton sigurinë e përdorueseve 95% e AASHTO së modifikuar" me çmim 350 lekë/m<sup>3</sup> në Kapitullin 1. Punime



*dherash dhe prishjet, me zërin tjetër të situacionuar "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar" me çmim 1,200 lekë/m<sup>3</sup> në Kapitullin 5: "Mbushje të larta", nuk është e justifikuar me analiza teknike laboratorike, për përbërje të ndryshme granulometrike të materialit mbushës, teknologji të ndryshme të realizimit të mbushjeve të larta dhe cilësinë e materialeve mbushës. Nga kontraktori "S..." shpk dhe mbikëqyrësit si dhe nga ARRSH nuk janë administruar në dosje analizat teknike të materialeve që janë përdorur për mbushjen dhe proceset e punës për mbushjet e larta, që është i ndryshëm nga mbushjet e thjeshta në trup të rrugës. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim Udhëzimin të KM Nr.3 datë 15.2.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve" i ndryshuar dhe Nenin 7 të Ligjit 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".*

Për këtë ngarkohen me përgjegjësi mbikëqyrësi i kontratës bazë z.H.M, përfaqësues i "Gj..." shpk dhe mbikëqyrësi i shtesës së kontratës, z.A.K, përfaqësues i ARRSH-së.

*Nuk janë paraqitur observacione për problemet e trajtuara në projektreport.*

**4. Nga verifikimi në terren i disa akseve rrugore si: Rruga Gjirokastrë - Sarandë, Rruga Berat-Skrapar dhe Bypassi i Fierit i hapur së fundi, konstatohet se ka një mungesë të theksuar të sigurisë në këto akse. Konkretisht:**

**1. Aksi rrugor Gjirokastrë -Sarandë,** është një aks me një fluks të lartë të levizjes së automjeteve sidomos gjatë periudhës së verës dhe një pjesë e tij është në terren malor dhe me skarpata të konsiderueshme. Në këtë pjesë të rrugës mungojnë shumë elementë të sigurisë rrugore, ku më të rëndësishmit janë guardrailët, të cilët nuk janë të vendosur gjatë gjithë gjatësisë së rrugës dhe nëpër kthesa, ku trupi i rrugës ka disnivel të konsiderueshëm me fundin e skarpatës. Në këtë aks në vend të guardrailave, në disa vende të rrugës ka element betoni të vendosur kohë më parë dhe me hapësira midis tyre, të cilët nuk garantojnë plotësisht kryerjen e funksionit mbajtjes të mjeteve në aksin e rrugës në rast aksidentesh. Gjithashtu mungon sinjalistika e cila shërben për orientimin e mjeteve gjatë lëvizjes në periudhën kur nuk ka ndriçim natyror, sidomos në kthesa.

**2. Aksi rrugor Berat-Çorovodë** është një aks me një fluks relativisht të lartë në periudhën e pranverës dhe verës për shkak të lëvizjes së turistëve në zonën e kanionëve dhe është i vendosur në terren kodrinor dhe malor. Në pjesën më të madhe të aksit, në mënyrë të veçantë në segmentin Poliçan - Çorovodë mungojnë elementët e sigurisë, ku më të rëndësishmit janë guardrailët. Edhe sinjalistika e cila shërben për orientimin e mjeteve gjatë lëvizjes në periudhën kur nuk ka ndriçim natyror, sidomos në kthesa.

**3. Bypassi i Fierit** është një aks me një fluks shumë të lartë të lëvizjes së automjeteve, i *cili është hapur në mënyrë të pjesshme, me një karrexhatë me dy drejtime lëvizjeje.* Megjithatë është vendosur pjesërisht sinjalistika vertikale dhe horizontale sidomos në kalimet në nivel, dhe guardrail në disa pjesë të aksit, ky aks nuk garanton sigurinë e përdorueseve të tij, për shkak të kalimeve në nivel, , kantierëve ta hapura në afërsi të karrexhatës ku ka hyrje-dalje të mjeteve të rënda për ndërtimin e pjesës tjetër të karrexhatës, shpejtësisë së lartë të lëvizjes së automjeteve





dhe parakalimeve të shumta në disa pjesë ku aksi është i drejtë. Gjithashtu mungon sinjalistika e cila shërben për orientimin e mjeteve gjatë lëvizjes në periudhën kur nuk ka ndriçim natyror. Në mënyrë të veçantë vlen të theksohet se mungon dhe sinjalistika për orientimin e automjeteve në periudha me mjegull, duke qenë se aksi është vendosur në një zonë ku prania e mjegullës gjatë vjeshtës dhe dimrit është e lartë. ***Me gjithë masat paraprake që janë marrë nga ARRSH dhe firma zbatuese në lidhje me sinjalistikën, ku aks rrugor nuk i përmbush kërkesat për garantimin e sigurisë së përdorueseve të rrugës dhe paraqet risk të lartë për ndodhjen e aksidenteve. Në rast të ndodhjes së aksidenteve, përveç pasojave shëndetësore që mund të kenë të aksidentuarit, ARRSH-ja mund të përballlet me çështje gjyqësore të cilat mund të sjellin pasoja penale dhe financiare ndaj saj.***

*Për problemet e trajtuara në projektreport në lidhje me Bypassi i Fierit , AK me shkresën nr. 7644/52, datë 14.10.2019, ka paraqitur observacione të cilat nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, sepse mungesa e sinjalistikës rrugore për çfarë do lloj arsye nuk garanton sigurinë e përdorueseve.*

#### **4. Zbatimin e kontratës “Ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1” . Nga auditimi rezultoi se:**

Punimet e Kontratës nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, kanë përfunduar në datë 15.11.2017, dhjetë vjet pas fillimit të tyre. Për periudhën prej tre vitesh nga 30.06.2014 deri në 30.10.2017 nuk ka patur shtesë të afatit të punimeve dhe nuk janë zhvilluar punime. Lidhjes së shtesës së kontratës nga Autoriteti Kontraktor, nr. 6679/3 prot., datë 30.10.2017 për shtyrje të afatit të punimeve deri në datë 15.11.2017, në kundërshtim me nenin nr. 36 të kushteve të përgjithshme të kontratës, nuk i kanë paraprirë dëmet për vonesat prej më se tre vitesh të dështimit të dorëzimit të punës brenda afatit duke sjellë që nga ana e AK të miratohen e të paguhen ribërja e disa prej punimeve.

Kontrata nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1 midis drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, të përfaqësuar nga z. Andi Toma, përfaqësues i vetëm në rolin e investitorit dhe Autoritetit Kontraktues dhe Bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomik K..... përfaqësuar nga administrator i përgjithshëm i shoqërisë “K...” z. R.K. Vlera totale e kontratës, përfshirë edhe vlerën e TVSH është 597,032,478 lekë. Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, 24.12.2009. Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve është lidhur në datë 26.12.2007, nr. 10189 prot., midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori i përgjithshëm znj. L.S dhe personit fizik/juridik “I...” shpk, përfaqësuar nga z. K.Ç. Vlera e kësaj kontrate 6,230,000 lekë me tvsh. Projekti është hartuar nga i njëjti subjekt që është edhe mbikëqyrës i punimeve, I.....shpk. Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve shtesë Nr. 1733/6, datë 08.04.2011, mbajtur mes Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. A.T dhe kontraktuesit “I...” shpk, prfaqësuar nga z. E. C. Vlera e kontratës 1,048,206 lekë meTVSH.





Punimet kanë përfunduar në datë 15.11.2017, dhjetë vjet pas fillimit të kontratës. Kontratës së ndërtimit i janë bërë gjashtë shtesa, përkatësisht:

1. Shtesë kontrate për shtyrje afati për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1 deri në datë 25.12.2011, nr 4183/2 prot, datë 29.05.2009, me arsyetimin se: *Gjatë muajve Nëntor-Dhjetor 2008 dhe Janar-Shkurt 2009 ka pasur rreshje të mëdha shiu të cilat janë bërë pengesë për kryerjen e punimeve gjatë kësaj periudhe. Si pasojë e këtyre rreshjeve janë aktivizuar disa rrëshqitje të mëdha të cilat kërkojnë ndërhyrje në masat inxhinierike mbrojtëse, gjë e cila kërkon kohë për një studim të hollësishëm hidro-gjeologjik të këtyre zonave problematike.*

2. Shtesë kontrate për Masat Inxhinierike për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, nr 1733/4 prot, datë 01.04.2011, me vlerë 82,685,484 lekë me tvsh;

3. Shtesë kontrate për shtyrje afati për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1 deri në datë 30.06.2013, nr 7534/1 prot, datë 28.12.2011, me arsyetimin e: *Problemeve dhe vonesave në procedurat e shpronësimeve të cilat sjellin pengesa në kryerjen e punimeve; Aktivizimet e herë pas hershme të rrëshqitjeve të ndodhura kanë penguar fillimin e punimeve për masat inxhinierike mbrojtëse sipas projektit.*

4. Shtesë kontrate për shtyrje afati për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1 deri në datë 30.06.2014, nr 3110/2 prot, datë 20.06.2013, me arsyetimin e: *Problemeve dhe vonesave në procedurat e shpronësimeve të cilat sjellin pengesa në kryerjen e punimeve.*

5. Shtesë kontrate për shtyrje afati për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1 deri në datë 15.11.2017, nr 6679/3 prot, datë 30.10.2017, me arsyetimin e: *Problemeve teknike për shkak të punimeve të punimeve shtesë dhe ndërprerjes së punimeve që kërkojnë ndryshime në projekt preventiv.*

Në dosje mungojnë materialet që i bashkëngjiten vendimeve të Këshillit Teknik si ndryshime të projektit në trajtë elektronike, material fotografik që të pasqyrojë situatën në terren si edhe punimet e maskuara në kundërshtim me nenin 50 të kushteve të përgjithshme të kontratës si edhe me Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005.

Ndonëse në relacionin bashkëngjitur vendimit të këshillit teknik të datës 12.10.2009, citohet një studim gjeologjik për zonën e rrëshqitjes, ky studim nuk ndodhet në dosje.

Nga auditimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, rezulton se kontraktori ka vonuar përfundimin e punimeve për një periudhë nga 30.06.2014, deri në 30.10.2017. Në këtë rast Autoriteti Kontraktor bazuar në nenin nr. 36 të kushteve të përgjithshme të kontratës duhet të kërkonte dëmet për vonesën në zbatim, pasi kontraktori ka dështuar në dorëzimin e punës brenda afatit 30.06.2014.

Nga korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve, kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, citohet se kontraktori ka abandonuar punimet dhe objektin në muajin gusht 2013, për shkak të mospagimit të faturave dhe mungesës së fondeve.

Referuar nenit 37 të kushteve të përgjithshme të kontratës, për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së saj.



Autoriteti Kontraktor duhet të kishte kërkuar dëmet për vonesa në zbatim në formën e penaliteteve, në masën 177,617,161 lekë ( $149,258,119 * 1/1000 * 1190$  ditë), e cila është e ardhur e munguar me efekt negativ në buxhet.

Pavarësisht sa më sipër, në kundërshtim të përcaktimeve të kontratës dhe pa aplikuar asnjë nga penalitetet e parashikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktor, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A.Q në datë 30.10.2017, miraton Shtesë kontrate nr 6679/3 prot, për shtyrje afati për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1 deri në datë 15.11.2017.

Me Vendim të Këshillit Teknik të Autoriteti Rrugor Shqiptar nr. 58, datë 13.11.2017, firmosur nga Kryetari A.Q dhe Sekretari A.A, janë miratuar në parim të propozimeve për modifikime, plotësime e saktësime në projekt-preventivin e objektit: “Ndërtimi rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 1” brenda vlerës së kontratës bazë. Pasi në periudhën gjatë së cilës në objekt nuk janë kryer punime, ka patur dëmtime si rrëshqitje të skarpatave, dëmtime nga gërryerjet e ujërave sipërfaqësor si edhe dëmtime të shtresës së stabilizantit.

Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 dhe Kontratën nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi ish kryetari i Autoritetit Rrugor Shqiptar z.A.Q.***

*Nuk janë paraqitur observacione për projektraportin*

Për kontratën nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, nga mbikëqyrësi i punimeve si edhe nga Këshilli Teknik i ARSSH-së janë miratuar ndryshime dhe modifikime në projekt përmes përdorimit edhe të fondit rezervë, ndryshime të cilat nuk kanë ardhur si rrjedhojë e faktorëve të paparashikueshëm, pasi duke konsideruar faktin që projekti është bazuar në një raport gjeologjik, këto volume punimesh duhet të parashikoheshin në projekt. Sa më sipër ka sjellë justifikimin e punimeve masive si shumëfishim të volumeve të gërmimit dhe mbushjes në dëm të punimeve të cilësisë dhe sigurisë nëpërmjet heqjes së sinjalistikës vertikale e horizontale si dhe parmakët anësor mbrojtës. Autoriteti Kontraktor ka miratuar zëra të rinj punimesh në preventivin e rishikuar të punimeve në zbatim të Vendimit të Këshillit Teknik të Autoriteti Rrugor Shqiptar datë 12.10.2009 pa bërë paraprakisht negociimin e çmimeve të këtyre zërave.

Për zbatimin e kësaj kontrate punimesh janë marrë katër Venndime të Këshillit Teknik përkatësisht:

**1.** Vendim i Këshillit Teknik të D.P. Rrugëve, datë 02.09.2008 firmosur nga Kryetari A. T dhe sekretari L.K, për: *Miratimin në parim të propozimeve për modifikime dhe plotësime të projekt preventivin në objektin: Ndërtim rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 1, sipas materialit të paraqitur. Miratimit në parim të preventivit të ripunuar brenda vlerës së kontratës duke mos përfshirë punimet e sinjalistikës vertikale e horizontale si dhe parmakët anësorë mbrojtës.*



2. Vendim i Këshillit Teknik të D.P. Rrugëve, datë 12.10.2009, firmosur nga Kryetari A.T dhe sekretari L.K, për: *Miratimin në parim të propozimit për marrjen e masave mbrojtëse në zonën e rrëshkitjes S190÷~S218 (~Prog.4399÷~Prog.4505) sipas variantit me mur masiv betoni. Të miratojë në parim propozimin për ndërtimin e nyjes lidhëse me rrugën Nacionale Tepelenë-Gjirokastrë. Të mos miratojë propozimin për sistemimin e përroit ~S232 (~Prog. 4782), por në këtë zonë të zbatohet projekti.*

3. Vendim i Këshillit Teknik të D.P. Rrugëve, datë 12.10.2009 firmosur nga Kryetari A.T dhe sekretari L.K, për: *Miratimin në parim masat inxhinierike dhe preventivin e punimeve për zonat problematike ~Prog.3938÷~Prog.4090 dhe ~Prog.4399÷~Prog.4505 në Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 1, sipas propozimeve të kontraktorit dhe të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur si më sipër. Punimet për masat inxhinierike do të realizohen me kontratë shtesë. Në preventivin e punimeve të përfshihet dhe fondi rezervë. Mbi këtë bazë kontraktori të paraqesë në D.P.Rrugëve në tre kopje original preventivin e punimeve të masave inxhinierike në zonat problematike ~Prog.3938÷~Prog.4090 dhe ~Prog.4399÷~Prog.4505, vizatimet përkatëse shoqëruar me llogaritjet analitike të volumeve të punimeve.*

4. Vendim i Këshillit Teknik të D.P. Rrugëve, datë 12.10.2009 firmosur nga Kryetari A.T dhe sekretari L.K, për: *Miratimit në parim të propozimit për marrjen e masave mbrojtëse në zonën rrëshqitëse S190÷~S197 (~Prog.3938÷~Prog.4090) sipas variantit ndërtim muri me pilota b/a, Ø800. Miratimit në parim të propozimit për marrjen e masave mbrojtëse në zonën e rrëshkitëse në zonën S212÷~S218 (~Prog.4399÷~Prog.4505) sipas variantit me mur masiv betoni. Miratimin në parim të propozimit për ndërtimin e nyjes lidhëse me rrugën Nacionale Tepelenë-Gjirokastrë. Të mos miratojë propozimin për sistemimin e përroit ~S232 (~Prog. 4782), por në këtë zonë të zbatohet projekti.*

5. Vendim i Këshillit Teknik të Autoriteti Rrugor Shqiptar nr. 58, datë 13.11.2017, firmosur nga Kryetari A.Q dhe Sekretari A.A, për: *Miratimit në parim të propozimeve për modifikime, plotësime e saktësime në projekt-preventivin e objektit: "Ndërtimi rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 1" Brenda vlerës së kontratës bazë. Çmimet e zërave të rinj nëse ka, të negociohen. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit – sektori i zhvillimit të projekteve e Drejtoria PBH Teknike për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave të këtij vendimi si dhe vijimësinë e mëtjeshme të objektit. Mbi këtë bazë Mbikëqyrësi i punimeve të hartojë dhe të dorëzojë tre kopje hardcopy dhe CD dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e preventivit të ripunuar duke rivlerësuar edhe njëherë të gjitha volumet e punimeve, preventivn brenda vlerës së kontratës, projektin e ripunuar me të gjitha vizatimet e nevojshme për zbatim, llogaritjet teknike, etj.*

Nga analizmi i ndryshimeve të miratuara në mbledhjen e Këshillit Teknik të D.P. Rrugëve, datë 02.09.2008 firmosur nga Kryetari A.T dhe sekretari L.K, rezulton se me miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, nga kontraktori janë bërë rivlerësime të volumeve të gërmimeve të trasesë nga matjet faktike, modifikimet dhe plotësimet si dhe kategorizimin e formacioneve gjeologjike, nga ku kanë rezultuar në rritje 7 fish të volumit të zërit gërmim shkëmbi dhe 4 fish të volumit të zërit gërmim tokë e zakonshme. Nga ana tjetër është ulur volumi i zërit mbushje me material të dalë nga gërmimi dhe është 8 fishuar volumi i zërit mbushje me zhavorr (profilim) për trupin e rrugës. Nga preventivi janë hequr zërat e punimeve B/5 për kaskadën me gabiona, B/6 punime për muret me gabiona dhe të gjithë zërat për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.



Projekti i zbatimit të punimeve është bazuar në studim gjeologjik të hartuar nga “A....” shpk. Në kundërshtim me vendimin datë 12.10.2009 të Këshillit Teknik, nuk është ngritur një grup për negocimin e zërave të rinj të punimeve dhe Autoriteti Kontraktor ka miratuar preventivin e rishikuar të punimeve pa ansjë dokument që të dëshmojë negocimin e çmimeve për zërin gjeotkstil 300gr/m<sup>2</sup> me çmim 255 lekë sipas preventivit të ripunuar dhe për zërat e punimeve për pilotat, përkatësisht: *Shpim me UKS për pilota b/a me diametër d800mm me çmim sipas preventivit të ripunuar 13,254 lekë/ml, Beton M-300 për pilota b/a dhe traun në kokë të pilotave, me çmim 11,600 lekë/m<sup>3</sup> dhe FV hekur për armimin e pilotave dhe traur në kokë të pilotave, me çmim 95,000 lekë/ton.*

Rivlerësimi i projektit në volumet e mësipërme si edhe eliminimi i të gjithë zërave për sinjalistikën horizontale e vertikale, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i cili është njëkohësisht edhe projektuesi, është në kundërshtim me të Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 4 dhe 5.

*Punimet e ndërtimit, të përkufizuara në nenin 3, duhet të projektohen dhe të zbatohen në tërësi ose në pjesë të veçanta në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.*

*Projektuesit, bazuar në kërkesat themelore të përshkruara në kreun II të këtij ligji, kanë përgjegjësi për projektimin e objektit.*

Miratimi i zërave të rinj të punimeve pa bërë paraprakisht negocimin e çmimeve të këtyre zërave është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar datë 12.10.2009.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi projektuesi I.....shpk.***

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, përmes matjeve në projektin e zbatuar dhe rakordimit të tyre me situacionin përfundimtar nr. 13 të punimeve, librezat e masave dhe nga matjet e verifikimet në terren rezultojn se janë çertifikuar punime në vlerën 29,368,630 lekë me tvsh, në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu I, Pika 15. d dhe 17,

Nga matjet në projektin e zbatuar dhe rakordimit të tyre me situacionin përfundimtar nr. 13 të punimeve, librezat e masave dhe nga matjet e verifikimet në terren rezultojn se:

Për zërin e punimeve A1 Gërmim në tokë të fortë për hapje traseje + transport auto me çmim njësi 300 lekë/m<sup>3</sup>, për segmentin S1-140 nga matjet në seksionet e projektit të zbatuar dhe verifikimit me librezën e masave, rezultojn një diferencë punimesh prej 5,487 m<sup>3</sup> gërmim më shumë e çertifikuar dhe paguar në bazë të librezës së masave situacionit përfundimtar të punimeve nr. 13 krahasuar me matjet në projekt, paraqitur në tabelën nr. 1.



Vlera e kësaj difference është  $5,478.18 \text{ m}^3 \times 300 \text{ lekë/m}^3 = 1,646,154 \text{ lekë}$  (pa tvsh) + 20% tvsh = **1,975,385 lekë me tvsh.**

Për zërin e punimeve A2.Gërmim tokë e zakonshme S. lirë për nxjerrje jashtë traseje + transport auto me çmim njësi 270 lekë/m<sup>3</sup>, për segmentin S1-140 nga matjet në seksionet e projektit të zbatuar dhe verifikimit me librezën e masave, rezulton një diferencë punimesh prej 9,416.26 m<sup>3</sup> gërmim më shumë e çertifikuar dhe paguar në bazë të librezës së masave dhe situacionit përfundimtar të punimeve nr. 13 krahasuar me matjet në projektin e zbatuar, paraqitur në tabelën nr. 2.

Vlera e kësaj difference është  $9,416.26 \text{ m}^3 \times 270 \text{ lekë/m}^3 = 2,542,390.2 \text{ lekë}$  (pa tvsh) + 20% tvsh = **3,050,868.24 lekë me tvsh**

Për zërin e punimeve A3.Gërmim shkëmbi për hapje traseje S.lirë + transport auto me çmim njësi 1000 lekë/m<sup>3</sup>, për segmentin S1-140 nga matjet në seksionet e projektit të zbatuar dhe verifikimit me librezën e masave, rezulton një diferencë punimesh prej 1,874.96 m<sup>3</sup> gërmim më shumë i çertifikuar dhe paguar në bazë të librezës së masave dhe situacionit përfundimtar të punimeve nr. 13 krahasuar me matjet në projektin e zbatuar, paraqitur në tabelën nr. 3.

Vlera e kësaj difference është  $1,874.96 \text{ m}^3 \times 1000 \text{ lekë/m}^3 = 1,874,958 \text{ lekë}$  (pa tvsh) + 20% tvsh = **2,249,949 lekë me tvsh**

Për zërin e punimeve A4.Mbushje me material të dalë nga gërmimi + transport auto me çmim njësi 200 lekë/m<sup>3</sup>, për segmentin S1-140 nga matjet në seksionet e projektit të zbatuar dhe verifikimit me librezën e masave, rezulton një diferencë punimesh prej 2,348.21 m<sup>3</sup> gërmim më shumë i çertifikuar dhe paguar në bazë të librezës së masave dhe situacionit përfundimtar të punimeve nr. 13 krahasuar me matjet në projektin e zbatuar, paraqitur në tabelën nr. 4.

Vlera e kësaj difference është  $2,348.21 \text{ m}^3 \times 200 \text{ lekë/m}^3 = 469,642 \text{ lekë}$  (pa tvsh) + 20% tvsh = **563,570 lekë me tvsh.**

Për zërin e punimeve A8.Mbushje zhavorr (profilim) për trupin e rrugës me çmim njësi 500 lekë/m<sup>3</sup>, për segmentin S1-140 nga matjet në seksionet e projektit të zbatuar dhe verifikimit me librezën e masave, rezulton një diferencë punimesh prej 21,354.8 m<sup>3</sup> gërmim më shumë i çertifikuar dhe paguar në bazë të librezës së masave dhe situacionit përfundimtar të punimeve nr. 13, si pasojë e mospërputhjes së sipërfaqeve pjesore të seksioneve si edhe të dopjimit të volumit të mbushjes për seksionet S68 deri S73, volum i cili rezulton i mbushur me material të dalë nga gërmimi dhe nuk mund të jetë i mbushur i njëjti volum edhe me zhavorr. Matjet e sakta konform projektit të zbatuar janë paraqitur në tabelën nr. 5.

Vlera e kësaj difference është  $21,354.30 \text{ m}^3 \times 500 \text{ lekë/m}^3 = 10,377,150 \text{ lekë}$  (pa tvsh) + 20% tvsh = **12,512,580 lekë me.**

Për zërin e punimeve C6. Veshje me plisa bari e skarpatës, me sasi 20,550 m<sup>2</sup> sipas preventivit të rishikuar të punimeve dhe çmim 250 lekë/m<sup>2</sup> dhe vlerë të paguar punimesh 5,137,500 lekë pa tvsh, sipas situacionit përfundimtar të punimeve, nga auditimi auditimi në terren i datës 21.08.2019, në prani të mbikëqyrësit të punimeve, rezulton se ky zë punimesh në vlerën **6,165,000 lekë me tvsh** nuk është nuk është pasqyruar në librezën e masave.





Në datë 01.04.2011, me nr 1733/4 prot, është nënshkruar Shtesë kontrate për Masat Inxhinierike për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, me vlerë 82,685,484 lekë me tvsh. Në këtë shtesë janë parashikuar punime për një lidhëse me rrugën Nacionale Tepelenë-Gjirokastër. Konform vendimit të mbledhjes së Këshillit Teknik të D.P. rrugëve të datës 12.10.2009 është përcaktuar se kjo nyje është parashikuar në projektin e rehabilitimit të rrugës Tepelenë-Gjirokastër, prandaj nuk është përfshirë në projektin e rrugës Kardhiq-Delvinë, ndaj për ta bërë sa më funksionale këtë nyje, janë miratuar si të nevojshme disa punime për rakordimin e hyrje-daljeve, ndërtimin e një vendqëndrimi në anën e djathtë të rrugës për parkim, ndërtim i kuletës së betonit në të dy anët dhe ndërtimi i rrjetit të fibrës optike.

Nga auditimi i projektit të ndërhyrjeve në këtë nyje rezulton se nuk është hartuar një projekt nga i cili të kenë dalë volumet e zërave të punimeve.

Nga auditimi në terren i nyjës, si edhe nga fotografimi satelitor i vitit 2007 dhe 2015, rezulton se kjo nyje është në të njëjtën gjendje si në vitin 2007.



*Orthophoto 2007*



*Orthophoto 2015*

Për punimet e kësaj nyje nuk janë përgatitur librezat e masave dhe pagesa është bërë bazuar në situacionin përfundimtar të punimeve, pra nuk janë kryer punime gërmimi dhe shtresash, nuk është ndërtuar vendqëndrimi në anën e djathtë të rrugës për parkim, pasi parcelat e pronave në





këtë janë janë parcela private që shfrytëzohen nga objektet e ndërtuara në to, si dhe nuk janë ndërtuar kunetat e betonit në të dy anët.

Nga fotografimi ajror i viti 2007 dhe 2015 të nyjes lidhëse me rrugën nacionale Tepelenë Gjirokastër, si edhe nga vëzhgimet në terren në prani të mbikëqyrësit të punimeve, rezulton se në këtë segment nuk janë zhvilluar punime.

Vlera e këtyre punimeve konform situacionit pëfundimtar të punimeve shtesë nr. 5, është **2,851,278 lekë me tvsh.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu I, Pika 15. d dhe 17, si edhe në kundërshtim me vendimin e mbledhjes së Këshillit Teknik, datë 12.10.2009.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve “I.....” shpk.***

***Për miratim të preventivit të punimeve për nyjen lidhëse me rrugën Nacionale Tepelenë-Gjirokastër, të pabazuar në një projekt ngarkohet me përgjegjësi z. E.H ish-Drejtor në Drejtorinë e Zhvillimit.***

**Observacione:**

1. z. Th.Xh ish-Drejtor në Drejtorinë PBHT Teknike, me shkresën 363/6 Prot. datë 14/10/2019 ka bërë komente dhe shpjegime ku sqaron se:

Në materialin e auditimit ka një ngatërrim pasi unë Th. Xh nuk kam qenë në rolin e Drejtorit Teknik, bile prej më shumë se një viti para mbledhjes së K. Teknik të dt. 12.10.2009 (prej dt. 10.09.2008 deri sa kam dalë në pension në mars të 2017, nuk kam patur asnjë rol drejtues në DPRr. Apo ARrSh, mbas vitit 2012). Nëse unë do të isha në rolin e Drejtorit Teknik në mbledhje atëherë do të firmosja Vendimin e K. Teknik si sekretar, mbasi Drejtori Teknik ishte njëkohësisht edhe sekretar i K. Teknik.

**Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së**

*Pas komeneteve të bëra nga z. Th.Xh, lidhur me zbatimin e punimeve në projektin “Ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1”, si edhe pas shqyrtimit të materialit bashkëngjitur komenteve, grupi i auditimit sqaron se referuar vendimit të Këshillit Teknik të ARRSH të datës 12.10.2009, ju keni qenë përfaqësuesi i Drejtorisë Teknike në këtë mbledhje por jo Drejtor Teknik. Për sa më sipër komentet merren në konsideratë dhe reflektohen në këtë raport auditimi.*

2. Mbikëqyrësi i punimeve “I...” shpk., me shkresën 363/8 Prot. datë 15/10/2019 ka bërë komente dhe shpjegime ku sqaron se:



Shoqëria projektuese “I....” sh.p.k. ka realizuar projektin duke zbatuar në ç’do pikë Kontratën me autoritetin Rrugor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ky projekt është miratuar dhe kontrolluar në të gjitha hallkat dhe intucionet përkatëse siç e kërkon legjislacioni në fuqi, të gjitha këto përpara se objekti të hidhet në zbatim. Autoriteti vendimmarrës i ç’do vendimi të Këshillit Teknik nuk është në asnjë rast as projektuesi as mbikëqyrësi i punimeve, por Autoriteti Kontraktor. Ndryshimet e miratuara në VKT datë 02.09.2008 janë të gjitha të shoqëruara me argumentimin dhe arsyet që çuan autoritetin kontraktor të marrë këtë vendim pasi deri në atë moment nuk ishin kryer shpronësimet e nevojshme. Për këtë është e qartë se projektuesi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi.

Sa i përket çertifikimit të punimeve të pakryera, mbikëqyrësi i punimeve ka zbatuar kontratën dhe legjislacionin në fuqi dhe nuk është shkaktuar asnjë dëm ekonomik. Për ç’do punim të çertifikuar nga ana e mbikëqyrësit, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave në ARRSH bën kontrollet dhe verifikimet për saktësinë e materialeve të dorëzuara nga mbikëqyrësi dhe pasi verifikohet saktësia, procedon me pagesën.

Për diferencat e konstatuara nga ana juaj në zërat e gërmimit dhe të mbushjes, sqarjmë se nuk qëndrojnë pasi nuk është marrë në llogaritje sipërfaqja e gërmimit për heqjen e shtresës vegjetale, sipërfaqe të pasqyruara në seksionet tërthore të proejktit të zbatuar dhe pjesë të dosjes përfundimtare të objektit.

Në lidhje me pretendimin e mos realizimit të zërit të punimeve C6 Veshje me plisa bari e skarpatës si dhe se nuk janë kryer punimet në nyjen lidhëse të rrugës nacionale Tepelenë – Gjirokastrë, konstatojmë se ka patur një lapsus pasi këto zëra punimesh janë realizuar konform projektit dhe se mbikëqyrësi gjatë vizitës në terren është shprehur qartë dhe pastër dhe ka shpjeguar se ku ndodhen punimet e zbatuara. Fotografimet ajrore të projekt raportit nuk qëndrojnë pasi nuk janë të çertifikuara dhe të marra në mënyrë ligjore. Bashkëngjitur fotografimet ajrore që ne disponojmë si dhe llogaritjet e volumeve.

#### Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së

*Pas komeneteve të bëra nga mbikëqyrësi i punimeve “I....” shpk., lidhur me zbatimin e punimeve në projektin “Ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1”, si edhe pas shqyrtimit të materialit bashkëngjitur komenteve, grupi i auditimit sqaron se Miratimet e autoriteteve për projektin e hartuar nga “I....” shpk. nuk e përjashtojnë këtë të fundit nga përgjegjësia që i atribuon neni 4 dhe 5 i Ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Ndryshimet e volumeve të gërmimeve të trasesë, modifikimet dhe plotësimet si dhe kategorizimin e formacioneve gjeologjike, nga ku kanë rezultuar në rritje 7 fish të volumit të zërit gërmim shkëmbi dhe 4 fish të volumit të zërit gërmim tokë e zakonshme, si edhe 8 fishimi i volumit të zërit mbushje me zhavorr (profilim) për trupin e rrugës, kanë ndodhur në kushtet kur projekti është hartuar bazuar në një studim gjologjik. Sa më sipër rivlerësimi i volumeve të projektit nga ana juaj për një projekt të hartuar po nga ju me rezultat eliminimin e të gjithë zërave për sinjalistikën horizontale e vertikale, ju ngarkon me përgjegjësi.*



*Sa i përket diferencave të konstatuara në librezat e masave dhe situacionit perfundimtar të punimve për zërat e gërmimit dhe të mbushjes, si edhe për zërat e punimeve veshje me plisa bari e skarpatës dhe punimet në nyjen lidhëse të rrugës nacionale Tepelenë – Gjirokastër, referuar shqyrtimit të materialeve bashkëngjitur observacionit si dhe rishqyrtimit të materialeve të vëna në dispozicion grupit të auditimit nga subjekti i audituar rezulton se të dhënat nuk përputhen dhe diferencat janë paraqitur bazuar materialeve të shqyruara në subjektin e audituar. Fotografimet ajrore të projekt raportit janë marrë në faqen zyrtare të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor. Për sa më sipër komentet merren në konsideratë pjesërisht dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.*

## **5. Zbatimi i kontratës “Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan – Banjë, Loti 1” (16 085 ml).**

Nga auditimi rezultoi se:

Nga auditimi me zgjedhje i zbatimit të kontratës bazë të punimeve “Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan – Banjë, Loti 1”, rezulton se për zërat e punimeve të trotuarit, 5.2 Shtresë zhavorr lumi, t=20cm përhapur e ngjeshur me makineri, 5.3 Shtresë stabilizanti t=10cm, 5.4 Shtresë rëre nën pllaka, t=6cm dhe 5.5 Trotuar me pllaka vetështrënguese betoni, t=6cm, nga matjet në rilevimin e punimeve faktike, paraqitur në azhornimin dixhital të projektit, ka një sipërfaqe prej 1,689 m<sup>2</sup> më shumë të shtresave të mësipërme të pasqyruara në librezat e masave dhe në situacionin perfundimtar të punimeve, krahasuar me punimet faktike të realizuara, me një vlerë punimesh prej 3,187,022 lekë .

Projekti “Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan – Banjë, Loti 1” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3869/5 prot. datë 04.08.2015 të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfaqësuar nga ish-drejtori i përgjithshëm z. D.Xh dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “VH” sh.p.k & "V..." sh.p.k, përfaqësuar nga z. K.H dhe Shpëtim V..... Vlera e kontratës bazë është 1,042,182,583 lekë me TVSH me afat zbatimit 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës, sipas grafikut të punimeve. Ndërtimi i rrugës ka një gjatësi L=16,085 ml, ku Loti 1 fillon nga progresivi 0+000 km deri në 22+963 km, me gjerësi të shtresës asfaltike 7m. Data e fillimit të punimeve të kontratës bazë është 06.08.2015 dhe data e perfundimit të punimeve sipas njoftimit të mbikëqyrësit është 03.02.2017. Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës është nënshkruar kontrata e mbikëqyrjes nr. 3896/5 prot. datë 04.08.2015 të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfaqësuar nga ish-drejtori I përgjithshëm z. D.Xh dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Z...” sh.p.k, përfaqësuar nga z. R.T dhe I.K. Vlera e kontratës është 4,020,000 lekë me TVSH me afat zbatimit 18 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Me vendimin e Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar nr. 87, datë 22.12.2015, janë miratuar në parim propozimet për: Punime në bazën e trupit të rrugës dhe shtresat rrugore; Punime të domosdoshme për trupin e rrugës; Punime të kërkuara nga Bashkia Cërrik. Çmimet e zërave të rinj të punimeve janë negociuar në katër proces verbale negociimi, janë ofruar bazuar në



manualin e cmimeve VKM nr. 29, datë 15.07.2015 dhe janë vendosur çmime më të ulët ose të barabartë me ato të ofruar.

Preventivi i ripunuar pas negocimit parashikon zbritje nga punimet e shtresave rrugore si dhe heqje të punimeve për sinjalistikën rrugore.

Në datë 06.09.2016, me nr. 6121/4 është bërë Shtesë Kontrate lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfaqësuar nga ish-drejtori I përgjithshëm z. D.Xh dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “VH” sh.p.k & “V...” sh.p.k, përfaqësuar nga z. K.H dhe Sh.V, me vlerë kontrate 206,969,142 lekë me TVSH, e cila përbën 19.859 % të vlerës së kontratës bazë. Afati i shtesës së kontratës është 6 muaj nga data e nënshkrimit.

Në preventivin e shtesës së kontratës janë parashikuar punime për ndricimin rrugor dhe infrastrukturën nëntokësore, si dhe punimet për shtresat rrugore (kryesisht asfaltbetoni) dhe punimet për sinjalistikën rrugore. Pra punime të cilat janë zbritur nga preventivi i ripunuar dhe janë shtuar në shtesën e kontratës.

Nga auditimi me zgjedhje i zbatimit të zërave të punimeve për kontratën bazë, u verifikua situacioni përfundimtar i punimeve i datës 03.02.2017, librezat e masave (gusht 2015- shkurt 2017), si dhe projekti i azhornuar i punimeve në trajtë dixhitale, nga ku rezultoi se:

Për zërat e punimeve të trotuarit, 5.2 Shtresë zhavorr lumi, t=20cm përhapur e ngjeshur me makineri, 5.3 Shtresë stabilizanti t=10cm, 5.4 Shtresë rëre nën pllaka, t=6cm dhe 5.5 Trotuar me pllaka vetështrënguese betoni, t=6cm, nga matjet në rilevimin e punimeve faktike, paraqitur në azhornimin dixhital të projektit, ka një sipërfaqe prej 1,689 m<sup>2</sup> më shumë të shtresave të mësipërme të pasqyruara në librezat e masave dhe në situacionin përfundimtar të punimeve, krahasuar me punimet faktike të realizuara, pasi në total pas matjeve rezultojnë 21,061 m<sup>2</sup> të këtyre shtresave nga 22,750 m<sup>2</sup> të paguara sipas situacionit përfundimtar. Volumet dhe vlera e diferencës paraqitet në tabelën nr. 6.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu I, Pika 15. d dhe 17.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve bashkimi i operatorëve ekonomik “Z..6” sh.p.k .***

**Observacione: “Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elabasan – Banjë, Loti 1”**

*Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 16 datë 30/08/2019 dhe për këtë çështje mbikëqyrësi i punimeve “Z....” sh.p.k. përmes administratorit A.P, me shkresën 363/5 Prot. datë 11/10/2019 ka bërë komente dhe shpjegime ku sqaron se:*

*Për të saktësuar volumet e punimeve të trotuarëve si dhe rezultatet e konstatuara nga ana juaj, mbikëqyrësi i punimeve analizoi edhe një herë azhornimin topografik të trotuarëve (në format DĒG) që disponon nga dosja e zbatimit, të cilën po ju a paraqesim në trajtë dixhitale dhe në format të printuar A3 (bashkëngjitur Cd dhe materiali i printuar për punimet në trotuare) ku rezulton se sipërfaqja totale e trotuarëve (S1 – S69) është 22865 m<sup>2</sup> dhe pas zbritjes së shtyllave të ndricimit dhe pusëve të ndricimit është 22802.8 m<sup>2</sup>. Në situacionin përfundimtar të punimeve*



*kjo sipërfaqe rezulton 22750 m<sup>2</sup>. Si përfundim diferencat në volume për punime të pakryera nuk ka dhe sigurojmë që zbatimi dhe mbikëqyrja e punimeve është bërë me përpikmëri.*

*Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH<sup>-së</sup>*

*Pas komeneteve të bëra nga mbikëqyrësi i punimeve "Z... sh.p.k, lidhur me zbatimin e punimeve në projektin "Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elabasan – Banjë, Loti 1", si edhe pas shqyrtimit të materialit bashkëngjitur komenteve në hard copy dhe në trajtë elektronike (format DËG), grupi i auditimit sqaron se informacioni dhe matjet e dërguara në këtë material nuk përputhen me materialet e dosjes së zbatimit të vëna në dispozicion grupit të auditimit nga subjekti i audituar ARRSH. Për sa më sipër komentet merren në konsideratë pjesërisht dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.*

**5. Zbatimi i kontratës "Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në Km 21.050 deri 22.050, në Rrugën Lin-Pogradec".**

**5.1.** Kontrata e punimeve civile "Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në Km 21.050 deri 22.050, në Rrugën Lin-Pogradec" është nënshkruar me nr. 10066/5, datë 02.02.2016, ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe shoqërive ndërtuese JV "P....." dhe "G....." SHPK, me vlerë 972,642,132 lekë. Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve është nënshkruar me nr. 10792/9 datë 20.04.2016, me Shoqërinë "T...." SHPK.

Kontrata përfshin punime shtresash rrugore, gërmime, vepra arti, punime të sinjalistikës, masa inxhinierike etj. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 24 muaj.

Kontrata është shoqëruar më ndërprerje kryesisht për mos përcaktim të vend depozitimit të mbeturinave, por edhe për shkaqe të motit. Në dokumentet e paraqitura në observacione është administruar edhe shtesë e kontratës nr. 4658/5, datë 02.07.2018, me vlerë 194,160,196 lekë. Në këtë shtesë kontrate e cila është tenderuar më vehte (negocim pa shpallje të njoftimit të kontratës), janë përfshirë disa zëra të kontratës bazë, ndër të tjera edhe zëri i punimeve "Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 10 km" për sasinë 13,183 m<sup>3</sup>.

Bazuar në situacion përfundimtar të punimeve, volumet e gërmimeve dhe volumet e mbushjeve, rezulton se janë gërmuar 183990 m<sup>3</sup> dhera dhe shkëmb, janë mbushur me material të gërmuar më parë 19929 m<sup>3</sup>. Në këto kushte, dhera dhe shkëmbi i transportuar i përkët sasisë 164061 m<sup>3</sup>.

Bazuar në situacionin përfundimtar, është certifikuar për transport sasia 174287 m<sup>3</sup>, ose me diferencë 10226 m<sup>3</sup>. Pavarësisht se sasia 13183 m<sup>3</sup> është përfshirë në shtesën e kontratës, volumni i gërmimeve i përkët kontratës bazë të audituar, pasi në shtesën e kontratës nr. 4658/5, datë 02.07.2018, nuk ka të përfshirë volume gërmimi në vlerën 5,730,650 lekë (10226 m<sup>3</sup> x 467 lekë/m<sup>3</sup> + TVSH).

**5.2. Mos miratimi i vend depozitimit të dherave ka shkaktuar rritje të kostos së punimeve.**

Në lidhje me pagesën e realizuar shtesë transporti rezulton se zona "Përroi i shtogut është ngjitur me zonën "Luadhi i Celos" ku kontraktori ia hedhur dherat, në këto kushte distanca e transportit është përcaktuar e saktë. Gjithsesi nga verifikimet e realizuara në këtë zonë me datë 28.08.2019, me prezencë të përfaqësuesve të mbikëqyrësit të punimeve ndër të cilët edhe z. H.R, nuk rezultoi





të kishte përgjigje të dukshme të hedhjes së mbeturinave inerte, sidomos për faktin se kemi të bëjmë me një sasi të pretenduar të hedhur, e cila është shumë e konsiderueshme dhe do të ishte shumë e dukshme.

Bazuar në disa korrespondenca, Bashkia Pogradec nuk ka miratuar hedhjen e mbeturinave nga gërmimet në venddepozitimet sipas kontratave të mëparshme, por në zonën e Luadhit të Celos dhe Përroit të Shtogut, duke rritur distancën e transportit nga 5 kilometër në 15 kilometër. Edhe nga ana e ARRSH dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk janë marrë masat e duhura për zbatimin e përcaktimeve në projektzbatim i cili kishte të parashikuar hedhjen e mbeturinave nga gërmimet në distancë 5 km. Ndryshimi i distancës nga 5 në 15 kilometër ka rritur koston e punimeve të kësaj kontratë me vlerë 81,392,029 lekë ( $174287 \text{ m}^3 \times 467 \text{ lekë/m}^3$ ), vlerë e cila konsiderohet shpenzime pa efektivitet. Ngarkohet me përgjegjësi menaxheri i kontratës z. A.K.

### **5.3. Punime të cilat nuk justifikohen me dokumentacionin në disponim.**

Në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar është përshkruar i realizuar zëri i punimeve "Barriera me lartësi 2.5 m prej rrjetash dhe kavosh për mbrojtje nga rënia e gurëve, niveli i absorbimit të energjisë 250 kJ" në sasinë 100 ml. Nga verifikimi i punimeve në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve rezulton se punimet sipas këtij zëri nuk janë realizuar. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur observacioneve rezultojnë vetëm dy fotografi të realizimit të tyre. pretendohet se punimet si më sipër janë realizuar gjatë fazës së ndërtimit të rrugës provizore për mos ndërprerjen e trafikut dhe mbrojtjen e punonjësve gjatë punimeve nga rënia e shkëmbinjve. Në këto kushte nga ana e grupit të auditimit nuk mund të saktësohet realizimi ose jo i tyre si dhe respektimi i specifikimeve teknike për zbatimin e tyre.

#### ***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***

Mbikëqyrësi i Punimeve Shoqëria "T...." SHPK dhe z. A.K, në cilësinë e menaxherit të kontratës.

*Nuk janë paraqitur observacione për projektreportin*

## **IV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA AUDITIMET E MËPARSHME.**

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, është kryer ky auditim nga KLSH dhe sipas autorizimit me nr.prot.555/7, datë 07.05.2018.

## **V. OPINIONI I AUDITIMIT:**

**Për drejtimin të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH)**





Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Autoritetit Rrugor Shqiptar, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon investime në infrastrukturën e rrugore, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në të cilën janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

**Opinion i kualifikuar**

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë<sup>1</sup>, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin “Autoriteti Rrugor Shqiptar”, rezultuan devijime materiale sasiore dhe cilësore nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***<sup>2</sup>

**Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000<sup>3</sup>)**

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 ”Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

**Nga evidencat e marra për veprimtarinë e ARRSH**, rezultoi se, janë konstatuar mangësi dhe parregullsi të cilat kryesisht konsistojnë: në shkelje të ligjshmërisë në Prokurimit Publik dhe në shkelje të ligjshmërisë në Kontrollit dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit.

<sup>1</sup> Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

<sup>2</sup> ISSAI 4000 – Udhërrëfytyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

<sup>3</sup> Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*



## VI. GJETJE DHE REKOMANDIME:

### A. MASA ORGANIZATIVE:

**1.Gjetje nga auditimi:** Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, gjatë periudhës objekt auditimi, për vitin 2017, janë paguar nga buxheti i shtetit 305,034,921 lekë, për vitin 2018 , janë paguar 350,000,000 lekë, dhe për vitin 2019 deri në qershor, janë paguar 83,015,068 lekë. Nga auditimi u konstatua se edhe pse këto vendime gjyqësore kanë qenë të formës së prerë, të gjitha pagesat nuk janë kryer vullnetarisht nga ARRSH, por janë kryer në bazë të urdhër ekzekutimeve të lëshuara nga përmbaruesit privat duke rënduar buxhetin e shtetit për tarifatat përmbarimore me kosto shtesë në shumën prej 31,744,946 lekë.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria Juridike, për të eliminuar shpenzimet përmbarimore në dëm të buxhetit, për çdo proces gjyqësor i cili ka marrë formë të prerë, të informojë Sektorin e Financës, për të planifikuar buxhetin që në fazat e PBA-së, me qëllim që ekzekutimi i tyre të bëhet vullnetarisht,.

- Nga institucioni duhet te krijohen provizionet për detyrimet e shpenzime gjyqësore. Këto provizione duhet të njihen në kontabilitet dhe të pasqyrohen në pasqyrat financiare vjetore të njësisë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**2.Gjetje nga auditimi :** Nga auditimi i evidencave të detyrimeve të prapambetura të shqyrtuara këto progresive si dhe të ndarë në vite për periudhën e audituar u konstatua se, në përgjithësisht ARRSH nuk ka përcaktuar mekanizma të mirë organizuar dhe funksionale të procesit të menaxhimit të riskut, efekt që pasqyrohet edhe në rezultatet e treguesve të performancës së buxhetit dhe thesarit, pasi janë shfaqur mangësi gjatë lidhjes dhe zbatimit të kontratave, parashikimit të likuiditeteve që çojnë në rritjen e nivelit të detyrimeve të prapambetura. Kështu në çdo vit pasardhës ARRSH trashëgon pothuaj në mënyrë të njëjtë një borxh që varion, si më poshtë:

-Detyrimet në fund të vitit 2017 janë në total 3,625,113,495 lekë, të cilat përbëhet nga detyrimet për investime (Llogaria 230+231) në vlerën 2,457,660,336 lekë si dhe Detyrimet për kontratat e mirëmbajtës për katër drejtoritë (Llogaria 602) në vlerën 1,167,453,159 lekë.

- Detyrimet e krijuara në fund të 2018 janë në total 4,082,082,856 lekë, nga të cilat 95,284,856 lekë janë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore të mbartura nga viti 2017 e të pashlyera ende, detyrimet prej 2,452,394,882 lekë janë për Investimet(230 +231) dhe 767,201,559 lekë janë detyrime të Kontratave të Mirëmbajtjes për katër drejtoritë.

-Detyrime të mbartura nga viti 2018 që rezultojnë deri më 30.06.2019, janë 2,172,150,661 lekë për Investime, dhe likuiduar 1,118,182,188 lekë deri më 30.06.2019.Ndërsa për llogarinë 602 (Zbatimi I kontratave të mirëmbajtjes detyrime të mbartura prej 2018 janë 767,201,559 lekë, nga



të cilat janë parashikuar për tu likuiduar 292,154,603 lekë dhe pjesa tjetër 373,811,185 lekë mbetet e pashlyer duke u kthyer në një borxh real dhe duke rënduar buxhetin e vitit 2020, (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-52, të Raportit të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Financës të planifikojë dhe të analizojë në mënyrë korrekte, detyrimet e prapambetura që në fazat e PBA-së, në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera në ARRSH si dhe katër drejtoritë rajonale me qëllim shlyerjen e detyrimeve koherente brenda vitit buxhetor dhe minimizimin e mbartjes së tyre në vitin pasardhës, duke nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë e këtij veprimi të përsëritur çdo vit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në zbatim të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, i ndryshuar, Kreu III, pika 2 si dhe Urdhri i ish- Ministrisë të Punëve Publike dhe Transporteve nr.125, datë 26.12.2011 “Për miratimin e hartave të azhuruara të rrjetit rrugor kombëtar dhe distancë kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH”, Instituti i Transportit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar duhet të bëjnë përkatësisht përditësimin vjetor brenda 3 muajve të parë të çdo viti pasardhës të “Hartave të rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë” dhe të tabelës “Distanca kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë”.

Nga auditimi i korrespondencave shkresore të sektorit të mirëmbajtjes së Rrugëve me institucione të ndryshme u konstatua se nuk ishte përditësuar për asnjë vit prej vitit 2012 e në vazhdim Harta e rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe tabela e Distancës kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë”.

ARRSH konfirmon se Sistemi WEB Gis nuk është update-uar dhe institucionet të kontaktojnë me e-mail. Nga sa më sipër kjo është një situatë e papranueshme për të cilën ARRSH nuk ka kryer detyrën funksionale të saj pra përditësimin e këtyre hartave dhe distancave kilometrike. Nisur nga numri i madh i Institucioneve të administratës shqiptare që operojnë me këtë udhëzim dhe VKM, mos përditësimi i Hartës së rrjetit rrugor të Republikës së Shqipërisë si dhe tabelës së Distancës kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë sjell abuzime me fondet e buxhetit të shtetit në trajtimin financiar për përlogaritjen saktë të shpenzimeve të transportit, (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-60, të Raportit të Auditimit).

**3. Rekomandimi:** ARRSH në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të përditësojnë hartën si dhe të saktësojnë distancat kilometrike ndërmjet qyteteve të Shqipërisë, me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike dhe përdorimin e tyre me ekonomi, efikasitet dhe efektivitet.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Procedurat e prokurimit për “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja (Unaza e Re), të realizuar në vitin 2018:



Ky segment rrugor është me gjatësi prej 2.2 km dhe me vlerë kontrate 6000,000,000 lekë. Realizimi i këtij objekti është ndarë në tre lote dhe janë realizuar tre procedura prokurimi, si më poshtë:

Loti I. “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja, Loti 1”, me fondin limit 2.246.450.297, me fitues operatorin “B..... ” me vlerë oferte 2.246.450.000 lekë.

Loti II. “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrrrotullimi Shqiponja, Loti 2”, me fondin limit 1 571 942 368 lekë, me fitues operatorin S..., me ofertë 1 568 794, 185 lekë.

Loti III. Rehabilitim i segmentit rrugor, mbikalimi i “Pallatit me Shigjeta” - rreth rrotullimi “Shqiponja” Loti 3, me fond limit 1,180,297,580 lekë, me fitues V.... me ofertë në vlerën 1,170,134,219 lekë.

Në të 3 këto procedura është paraqitur vetëm 1 operatorë, të cilët janë kualifikuar dhe kanë dalë fituese. Mungesa e konkurrencës në këto procedura lidhet ngushtësisht me përzgjedhjen e projektuesit për hartimin e projektit të zbatimit, sepse kontratat për realizimin e projektit të zbatimit për te tre këto objekte nuk është lidhur me projektuesin nëpërmjet procedurave të prokurimit, por është lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me një projektues i cili ka marrë përsipër të hartojë projektin dhe preventivin e zbatimit në formë dhurimi, pra falas pa lekë, si më poshtë:

-Nga ARRSH nuk janë hartuar terma reference apo ndonjë studim tjetër paraprak, në bazë të të cilave të llogaritej dhe të justifikohesh vlera e përafërt e objektit “Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrrrotullimi Shqiponja” prej 6, 000,000,000 lekë si dhe nuk ka kaluar dhe nuk është miratuar në Këshillin Teknik të ARRSH.

-Vlera e investimit të këtij objekti prej 6,000,000,000 leke nuk ka qenë e parashikuar në Projekt Buxhetin Afatmesëm (PBA) të ARRSH në vitin 2017 apo vite më para, dhe as në projekt-buxhetin e vitit 2018, por është planifikuar mbas miratimit të buxhetit të vitit 2018, që me detajimin e tij në muajin janar.

-Bordi i Menaxhimit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nuk kanë miratuar vlerën prej 6,000,000,000 lekë të parashikuar apriori nga ARRSH , por kanë miratuar vlerën e financimit të objektit “Rehabilitim I segmentit rrugor "Mbikalimi pallati me shigjeta-rrethrrrotullimi Shqiponja” të ndarë në tre objekte ë shumën 2,150,000,000 lekë.

-Sipas, Termave të referencës të hartuara nga vetë ARRSH për këtë rrugë “Mbikalimi Pallati me shigjeta rrethrrrotullimi Shqiponja”, kosto për 1 km ka dalë 878,006,241 lekë/km dhe për gjatësinë 2.2 km të rrugës ka dalë një vlerë ndërtimi e përafërt 1,931,613,730 lekë dhe mbi këtë vlerë është llogaritur edhe tarifa e projektimit që ka dalë rreth 42 milion lekë. Këto Terma Reference janë miratuar me Vendimin nr. 15, datë 20.04.2018 të Këshillit Teknik të ARRSH.

-Përzgjedhja e shoqërisë konsulenti “A....” për të hartuar projekt zbatimin, pa organizuar procedura prokurimi është në kundërshtim të hapur me: ligjinNr.9643,datë20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”,dhe me ligjin nr.7892, datë 21.12.1994 “për sponsorizimet” sepse përzgjedhja e këtij konsulenti nuk ka kaluar më parë në konkurrim për tu vlerësuar për kriteret e mësipërme nga një



komision konkurrimi përvojën e konsulentit; cilësinë e metodologjisë së propozuar; kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; transferimin e njohurive, etj.

-Konsulenti, nuk ka hartuar dhe nuk ka dorëzuar së bashku me projekt zbatimin, llogaritjet konstruktive të mureve dhe të armuar të cilat shërbejnë për llogaritjen e volumet të betoneve, rekomandim ky i lënë edhe nga opoenca teknike dhe i pa zbatuar nga Projektuesi dhe nga ARRSH. Po kështu, Konsulenti, nuk ka hartuar dhe nuk ka dorëzuar sëbashku me projekt zbatimin dhe tabelën e llogaritjeve të volumeve të betoneve, për të parë a janë të barabarta me volumet e preventivit të zbatimit, në bazë të të cilit është llogaritur dhe vlera e plotë e investimit, prej 6,000,000,000 lekë.

Si konkluzion: Nga shqyrtimi dhe vlerësimi I dokumentacionit të cituar më sipër del qartë se, përzgjedhja e shoqërisë konsulente “A.....”, pa konkurrim, ndikon negativisht në cilësinë e projektit, në shmangie të konkurrencës (në procedurat e prokurimit për zbatimin e punimeve ka pjesëmarrje vetëm e një operator, trajtuar me poshtë) dhe në rritje fiktive të kostos së objektit me efekte negative të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, çka tregohet qartë dhe nga vlera e investimit që ishte parashikuar apriori nga ARRSH qenë janar të vitit 2018 prej 6,000,000,000 lekë(pa studim paraprak) dhe konsulenti në projekt zbatimin dhe në preventivin e zbatimit që është dorëzuar në shtator 2019 ka nxjerrë po të njëjtën vlerë prej 6,000,000,000 lekë. Pra vlera e nxjerrë nga projektuesi është disa herë më e lartë se, vlera e përafërt e nxjerrë sipas temave të referencës të miratuar në KT, dhe më pas të miratuara nga Bordi i Menaxhimit të ARRSH dhe MIE.

**4.1. Gjetje nga auditimi:** Në vijim të zbatimit të procedurave për prokurimin për zbatimin e kontratave, menjëherë dy ditë mbas kthimit të përgjegjës nga MIE me shkresën me nr. 8546/5, datë 06.09.2018 që në parim e ka lejuar ARRSH të vazhdojë procedurat ligjore të prokurimit të objekteve të mësipërme, ARRSH në datën 08.09.2019 ka bërë shpalljen e njoftimit të kontratave në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Pra duket qartë se AK ka nxituar për të realizuar tenderim e zbatimit dhe nuk ka bërë më parë kontrollin e preventivit dhe llogaritje e fondit limit.

Siç u tha më lartë, ky segment rrugor është me gjatësi prej 2.2 km dhe me vlerë kontrate 6000,000,000 lekë. Realizimi i këtij objekti është ndarë në tre lote, duke realizuar tre procedura prokurimi, si më poshtë:

Të 3 këto procedura janë zhvilluar në mungesë të theksuar të konkurrencës, pasi në tenderët respektiv është paraqitur vetëm 1 operatorë, të cilët janë kualifikuar dhe kanë dalë fituese dhe me ta janë lidhur kontratat e zbatimit. Por, punimet sipas këtyre kontratave deri në momentin e auditimit nuk kanë filluar sepse, për objektin “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1”, nisur nga shkrimet e botuara në mediat e shkruara dhe ato elektronike e vizive, dyshohet për shkelje të rënda që lidhen me falsifikime të dokumenteve të operatorit fitues, ndërsa për dy lotet e tjera janë hasur problem të shumta me banorët në lidhje me shpronësimet e pronave të tyre (trojeve, banesave dhe dyqaneve).Për këto arsye për të 3 këto procedura prokuroria e rrethit gjyqësor Tirane, ka hapur hetimin penal dhe me shkresa nr.18095, datë 12.12.2018, ka sekuestruar te gjithë dokumentacionin e prokurimit të të 3 procedurave. Në këto kushte ARRSH ka zgjidhur kontratën e zbatimit për objektin “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti 1.



Nisur nga këto shkelje, ARSH me shkresën nr. 11106, datë 11.12.2018 i ka kërkuar bashkimit të përkohshëm të kompanive të sigurimit “S.....” konfiskimin e sigurimit të kontratës prej 10% në shumën 269,574,000 lekë. Kjo kompani nuk ka qenë dakort për kthimin e kësaj shume dhe në këto kushte ARSH ka bërë ankesë në Gjykatën e Administrative të shkallës së parë Tiranë e cila me vendimin nr.2723, datë 23.07.2019 ka vendosur detyrimin bashkimit të përkohshëm të kompanive të sigurimit “S....” të pagojë shumën 269,574,000 lekë. Ky bashkimit i përkohshëm kompanive të sigurimit “S...” ka bërë rekurs në Gjykatën Administrative të Aplet Tiranë. Procedura e konfiskimit të garancisë së Kontratës vazhdon të jetë në proces gjykimi nga kjo Gjykatë.

Megjithatë, nga auditimi mbi përgatitjen dhe zbatimin e procedurave të prokurimit para njoftimit të kontratës u konstatua se:

Sipas nenit 8 të VKM nr.914, datë 29.12.2019 për kontratat e punëve publike kufiri lartë monetare është përcaktuar 2,400,000,000 lekë dhe sipas pikës 3 të këtij neni, asnjë kontratë publike nuk mund të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP.

Sipas nenit 33 të VKM nr.914, datë 29.12.2019, afati kohor për procedurën e hapur i parashikuar në nenin 43 të LPP është si vijon:

Autoriteti kontraktor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë nen dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

-Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 (pesëdhjetë e dy) ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.

-Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 (tridhjetë) ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të APP-së.

Ndarja në tre lote të një segmenti rrugor prej 2.2 km me vlerë 6000,000,000 lekë dhe realizimi i tre procedurave të mësipërme bie ndesh me bazën ligjore të sipërcituar sepse, nuk të lejojnë që asnjë kontratë publike të ndahet për shmangien e kufirit monetar apo të procedurave, të parashikuara nga LPP. Dhe konkretisht, vlerata monetare e të tre loteve janë ndarë pikërisht për shmangie e kufiri lartë monetare që është 2,400,000, 000 lekë dhe për shkurtim e afateve për paraqitjen e ofertave. Sipas DT për loti e parë dhe të tretë shpallja e njoftimit të kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik është bërë në datën 10.09.2018 ndërsa për lotin II është bërë në datën 08.09.2018 duke lënë dhe afatin për paraqitjes së ofertave 30 ditë kalendarike që i përket procedurës së hapur me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar. Ndërsa po të realizohej një procedurë prokurimi e vetme për të gjithë segmentin prej 2.2 km me vlerë kontrate prej 6,000,000,000 lekë ose të ndahej në dy lote , vlera e të cilave është mbi kufirin e lartë minimal , afati për paraqitjen e ofertave do të ishte 52 ditë kalendarike.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 81-90, të Raportit të Auditimit).*





**4.1. Rekomandimi:** Meqenëse, punimet në zbatim të Kontratave të lidhura për të tre lotët nuk kanë filluar për arsyen e mos shpronësimeve publike (shtëpi, dyqane, ndërtesa të ndryshme, trojeve, etj) dhe për këtë arsye, ende nuk është liruar sheshi i ndërtimit, projekti dhe preventivi i zbatimit, është hartuar me rezerva nga mungesa e studimeve gjeologjike apo edhe të investimeve në terren të infrastrukturës inxhinierike tokësore dhe nëntokësore, ARRSH, me qëllim, eliminimin e rritjes fiktive të kostos së investimi që mund të vijë për shkak të këtyre rezervave, ti kërkohet:

Sipërmarrësve të Punimeve dhe Mbikëqyrësve të Punimeve të secilit Lot dhe Projektuesit “A.....”, që menjëherë, me lirim të sheshit të ndërtimit, të paraqesin për miratim në ARRSH propozime, për korrigjime, plotësime apo përmirësime të projektit dhe preventivit të zbatimit, veçanërisht në lidhje me infrastrukturën inxhinierike tokësore dhe nëntokësore dhe në varësi të rezultatit të bëj rishikimin e vlerave të kontratave të zbatimit të të tre lotëve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**4.2. Rekomandimi:** ARSH, në rastet e realizimit të procedurave të tjera të prokurimit për punët publike me vlerë kontrate mbi kufirin e lartë monetare, të mos ndahet për shmangien e kufirit monetar, por procedurat e prokurimit të realizohen sipas parashikimeve të LPP.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**4.3. Rekomandimi:** ARSH të bashkëpunoi me Avokatin e Shtetit për të ndjekur dhe mbrojtur çështje në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe më pas në Gjykatën e Lartë, për të konfiskuar nga kompania e sigurimit “S.....” garancinë e kontratës në vlerën 269,574,000 lekë, me qëllim arkëtimin e kësaj vlere dhe shmangien e dëmit ekonomik që mund të shkaktohet buxhetit të shtetit, në raste të mos konfiskimit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës për vitin 2018”, me fond limit 98,180,000 lekë lekë, me operatorë fitues “4...” me oferte në vlerën 98,120,000 lekë dhe procedura e prokurimeve me objekt: “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës për vitet 2019-2020”, me fond limit 194,920,000 lekë, me operatorë fitues “4...” me oferte ofertë në vlerën 194, 820,000 lekë. Në të dy këto procedura u konstatua se llogaritja e fondit limit nuk është e mirë argumentuar sepse, nuk janë analizuar çmimet për njësi të shërbimeve të kryera në fakt të kontratave të shërbimeve që ka pasur në zbatim ARRSH të viteve të mëparshme, por i është referuar vetëm vlerës përfundimtare të këtyre kontratave, pra pa bërë më parë një analizë të çmimeve të zërave të shërbimeve të paguara në fakt dhe kryesisht të zërit të pagave të punonjësve të cilat zënë peshën më të madhe të vlerës së këtyre kontratave, *(rajtuar më hollësisht në faqet 90-107, të Raportit të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** ARSH, për vitet në vijim në rastet të realizimit të procedurave të tjera me objekt prokurimi “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tuneleve” nëse llogaritjen e fondit limit e bazon në çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë



ARRSH, duhet ti bëjë analizë të çmimeve të zërave të shërbimeve veçanërisht të pagave të punonjësve të paguara në fakt në kontratat e mëparshme të justifikuara këto më dokumente zyrtare të pagave dhe në bazë të tyre të llogarisë fondin limit.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me pagesën e realizuar shtesë transporti sipas kontratës "Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në Km 21.050 deri 22.050, në Rrugën Lin-Pogradec" rezultojnë se zona "Përroi i shtogut është ngjitur me zonën "Luadhi i Celos" ku kontraktori ia hedhur dherat, në këto kushte distanca e transportit është përcaktuar e saktë. Gjithsesi nga verifikimet e realizuara në këtë zonë me datë 28.08.2019, me prezencë të përfaqësuesve të mbikëqyrësit të punimeve ndër të cilët edhe z. H.R, nuk rezultoi të kishte përgjigje të dukshme të hedhjes së mbeturinave inerte, sidomos për faktin se kemi të bëjmë me një sasi të pretenduar të hedhur, e cila është shumë e konsiderueshme dhe do të ishte shumë e dukshme.

Bazuar në disa korrespondenca, Bashkia Pogradec nuk ka miratuar hedhjen e mbeturinave nga gërmimet në vend depozitimet sipas kontratave të mëparshme, por në zonën e Luadhit të Celos dhe Përroit të Shtogut, duke rritur distancën e transportit nga 5 kilometër në 15 kilometër. Edhe nga ana e ARRSH dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk janë marrë masat e duhura për zbatimin e përcaktimeve në projekt zbatim i cili kishte të parashikuar hedhjen e mbeturinave nga gërmimet në distancë 5 km. Ndryshimi i distancës nga 5 në 15 kilometër ka rritur koston e punimeve të kësaj kontratë me vlerë 81,392,029 lekë (174287 m<sup>3</sup> x 467 lekë/m<sup>3</sup>), vlerë e cila konsiderohet shpenzime pa efektivitet.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 107-114, të Raportit të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës dhe pajisjet përkatëse për verifikimin e sasisë së materialeve të depozituara nga kontraktori në zonën e miratuar. Bazuar në rezultatet faktike, të bëhen rregullimet në vlerat e likuiduara në situacionin përfundimtar të punimeve. Gjithashtu, Komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve në bashkëpunim me kolaudatorin dhe mbikëqyrësin e punimeve, të verifikojnë me përgjegjësi punimet e kësaj kontrate, me synim realizimin e pagesave për volume të realizuara realisht dhe zbatimin e specifikimeve teknike të kontratës.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar sipas kontratës "Sistemim, asfaltim e masa inxhinierike në Km 21.050 deri 22.050, në Rrugën Lin-Pogradec" është përshkruar i realizuar zëri i punimeve "Barriera me lartësi 2.5 m prej rrjetash dhe kavosh për mbrojtje nga rënia e gurëve, niveli i absorbimit të energjisë 250 kJ" në sasinë 100 ml. Nga verifikimi i punimeve në terren në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve rezultojnë se punimet sipas këtij zëri nuk janë realizuar. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur bashkëngjitur observacioneve rezultojnë vetëm dy fotografi të realizimit të tyre. pretendohet se punimet si më sipër janë realizuar gjatë fazës së ndërtimit të rrugës provizore për mos ndërprerjen e trafikut dhe mbrojtjen e punonjësve gjatë punimeve nga rënia e shkëmbinjve. Në këto kushte nga ana e grupit



të auditimit nuk mund të saktësohet realizimi ose jo i tyre si dhe respektimi i specifikimeve teknike për zbatimin e tyre. Veprim në kundërshtim me specifikimet teknike të kontratës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 150-151, të Raportit të Auditimit).*

**7. Rekomandimi: ARRSH,** të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me specialistë të fushës për verifikimin e zërit të punimeve "Barriera me lartësi 2.5 m prej rrjetash dhe kavosh për mbrojtje nga rënia e gurëve, niveli i absorbimit të energjisë 250 kJ", duke kërkuar nga kontraktori dokumentacion justifikues për materialet e furnizuara dhe dokumentacion tjetër të nevojshëm, për këtë zë punimi sipas të cilit janë shpenzuar fonde të konsiderueshme.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**8.Gjetje nga auditimi:** Për kontratën nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, nga mbikëqyrësi i punimeve si edhe nga Këshilli Teknik i ARRSH-së janë miratuar ndryshime dhe modifikime në projekt përmes përdorimit edhe të fondit rezervë, ndryshime të cilat nuk kanë ardhur si rrjedhojë e faktorëve të paparashikueshëm, pasi duke konsideruar faktin që projekti është bazuar në një raport gjeologjik, këto volume punimesh duhet të parashikoheshin në projekt. Sa më sipër ka sjellë justifikimin e punimeve masive si shumëfishim të volumeve të gërmimit dhe mbushjes në dëm të punimeve të cilësisë dhe sigurisë nëpërmjet heqjes së sinjalistikës vertikale e horizontale si dhe parrmakët anësor mbrojtës. Autoriteti Kontraktor ka miratuar zëra të rinj punimesh në preventivin e rishikuar të punimeve në zbatim të Vendimit të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar datë 12.10.2009 pa bërë paraprakisht negocimin e çmimeve të këtyre zërave.

Rivlerësimi i projektit në volumet e mësipërme si edhe eliminimi i të gjithë zërave për sinjalistikën horizontale e vertikale, miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i cili është njëkohësisht edhe projektuesi, është në kundërshtim me të Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, neni 4 dhe 5. Miratimi i zërave të rinj të punimeve pa bërë paraprakisht negocimin e çmimeve të këtyre zërave është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar datë 12.10.2009. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 138-148, të Raportit të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Autoriteti Rrugor Shqiptar, të marrë masa në vazhdimësi që të gjithë projektet e financuara dhe prokuruar prej tij, të jenë të projektuara në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**8.2. Rekomandimi:** Këshillit Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar të marrë masa për të bazuar e shoqëruar vendimet e marra prej tij me dokumentacionin mbështetës referues si edhe të marra masa për ngritjen e grupeve për negocimin e zërave të rinj të punimeve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në datë 01.04.2011, me nr.1733/4 është nënshkruar Shtesë kontrate për Masat Inxhinierike për punimet e ndërtimit të objektit ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1,



me vlerë 82,685,484 lekë me TVSH. Në këtë shtesë janë parashikuar punime për një lidhëse me rrugën Nacionale Tepelenë-Gjirokastrë. Konform vendimit të mbledhjes së Këshillit Teknik të D.P. rrugëve të datës 12.10.2009 është përcaktuar se kjo nyje është parashikuar në projektin e rehabilitimit të rrugës Tepelenë-Gjirokastrë, prandaj nuk është përfshirë në projektin e rrugës Kardhiq-Delvinë, ndaj për ta bërë sa më funksionale këtë nyje, janë miratuar si të nevojshme disa punime për rakordimin e hyrje-daljeve, ndërtimin e një vendqëndrimi në anën e djathtë të rrugës për parkim, ndërtim i kuretës së betonit në të dy anët dhe ndërtimi i rrjetit të fibrës optike. Nga auditimi i projektit të ndërhyrjeve në këtë nyje rezulton se nuk është hartuar një projekt nga i cili të kenë dalë volumet e zërave të punimeve. Sa më sipër është në kundërshtim me vendimin e mbledhjes së Këshillit Teknik, datë 12.10.2009.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 138-148, të Raportit të Auditimit).*

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Zhvillimit dhe Drejtoria PBHT Teknike e ARRSH-së të marrë masa që zërat dhe volumet e paraqitura në preventivat e punimeve të jenë të bazuara në projektet përkatëse.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Punimet e Kontratës nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, kanë përfunduar në datë 15.11.2017, dhjetë vjet pas fillimit të tyre. Për periudhën prej tre vitesh nga 30.06.2014 deri në 30.10.2017 nuk ka pasur shtesë të afatit të punimeve dhe nuk janë zhvilluar punime. Lidhjes së shtesës së kontratës nga Autoriteti Kontraktor, nr. 6679/3, datë 30.10.2017 për shtyrje të afatit të punimeve deri në datë 15.11.2017, në kundërshtim me nenin nr. 36 të kushteve të përgjithshme të kontratës, nuk i kanë paraprirë dëmet për vonesat prej më se tre vitesh të dështimit të dorëzimit të punës brenda afatit duke sjellë që nga ana e AK të miratohen e të paguhen ribërja e disa prej punimeve. Në kundërshtim me nenin 37 të kushteve të përgjithshme të kontratës, për kontratat me periudhë zbatim më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por jo më pak se 25% e vlerës së saj. Autoriteti Kontraktor duhet të kishte kërkuar dëmet për vonesa në zbatim në formën e penaliteteve, në masën 177,617,161 lekë (149,258,119 \* 1/1000 \* 1190 ditë), e cila është e ardhur e munguar me efekt negativ në buxhet. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 138-148 të Raportit të Auditimit).*

**10.1. Rekomandimi:** Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë masa për të siguruar zbatimin e kontratave të punimeve në përputhje me afatet e përcaktuara me qëllim arritjen e menaxhimit të mirë të projekteve dhe shmangien e kostove shtesë për realizimin e tyre, duke aplikuar sipas rastit dëmet për vonesat në zbatim.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdimësi**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës Nr.5795/3 datë 20/08/2018 me objekt “Rifreskimi Sinjalistikës Vertikale/Horizontale në Akset Kombëtare dhe Përmirësimi i Sigurisë Rrugore në Akset e Rajonit Verior, Loti”, realizuar nga sipërmarrësi “J....” u konstatua se në segmentin Fierzë-Bujan-Sopot- Q.Morinë,



Bujan - Bajram Curri, vijëzimet për kalimet e këmbësorëve janë fshirë pjesërisht, duke mos kryer funksionin e plotë të tyre (paraqitur në figurën 3). Ndërsa boja bikomponente (pastë) e përdorur për shigjeta dhe ishuj trafikuri në qytetin e Krumës është fshirë pjesërisht, fakt i cili tregon se punimet nuk janë kryer me cilësinë e kërkuar.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 127-131, të Raportit të Auditimit).*

**11.1. Rekomandim:** Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe sipërmarrësi "Jubica" shpk, në segmentet Fierzë-Bujan-Sopot- Q.Morinë, Bujan - Bajram Curri, të marrin masat brenda afatit të garancisë së kontratës, për realizimin e vijëzimeve për këmbësorët dhe ishujt e trafikurit, sipas zërit "Bojë bikomponente (pastë)" dhe sipas specifikimeve teknike për bojën bikomponente (pastë), ku të faktohen me foto dhe analiza laboratorike realizimi i tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës Nr.1969/5 datë 24.04.2017 dhe kontratë shtesë Nr.4649/6 datë 19.07.2018 me objekt "Ndërtim i aksit rrugor Skrapar - Përmet, Loti 1", realizuar nga sipërmarrësi "S..." u konstatua se mbushjet e larta nuk janë realizuar në sistemin qelizor dhe janë mbushje në trup të rrugës pa masa mbrojtëse qelizore si ishte parashikuar në projektin fillestar. Vlera 120,561,450 pa TVSH (për 141,837 m<sup>3</sup>), që përfaqëson diferencën e çmimit të zërave të mbushjes, midis zërit të situacionuar "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri" me çmim 350 lekë/m<sup>3</sup>, me zërin tjetër më të njëjtën përshkrim të situacionuar "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri", me çmim 1,200 lekë/m<sup>3</sup> në Kapitullin 5: "Mbushje të larta", nuk është e justifikuar me analiza teknike laboratorike, për përbërje të ndryshme grunulometrike të materialit mbushës, teknologji të ndryshme të realizimit të mbushjeve të larta dhe cilësinë e materialeve mbushës. Nga kontraktori "S..." dhe mbikëqyrësit si dhe nga ARRSH nuk janë administruar në dosje analizat teknike të materialeve që janë përdorur për mbushjen dhe proceset e punës për mbushjet e larta, që është i ndryshëm nga mbushjet e thjeshta në trup të rrugës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 131-138, të Raportit të Auditimit).*

**12.1. Rekomandim:** Autoriteti Rrugor Shqiptar, në praninë të mbikëqyrëseve të kontratës dhe kontraktorit "S..." s, në lidhje me volumin 141,837 m<sup>3</sup> të zërit "Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës, përhapur dhe ngjeshur me makineri (ngjeshur deri në 95% e AASHTO së modifikuar" të Kapitullit 5: "Mbushje të larta", të kryej verifikimin e këtyre mbushjeve dhe të bëjë analiza të plota laboratorike të materialeve të përdorur dhe të paraqesë metodologjitë e përdorura për realizimin e mbushjeve të larta.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Në aksin rrugor Gjirokastër -Sarandë, mungojnë shumë elementë të sigurisë rrugore, ku më të rëndësishmit janë guardrailët, të cilët nuk janë të vendosur gjatë gjithë gjatësisë së rrugës dhe nëpër kthesa, ku trupi i rrugës ka disnivele të konsiderueshëm me fundin e skarpatës. Në këtë aks në vend të guardrailave, në disa vende të rrugës ka element betoni të



vendosur kohë më parë dhe me hapësira midis tyre, të cilët nuk garantojnë plotësisht kryerjen e funksionit mbajtjes të mjeteve në aksin e rrugës në rast aksidentesh. Gjithashtu mungon sinjalistika e cila shërben për orientimin e mjeteve gjatë lëvizjes në periudhën kur nuk ka ndriçim natyror, sidomos në kthesa.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 138-138 të Raportit të Auditimit).*

**14 . Gjetje nga auditimi:** Në aksin rrugor Berat -Çorovodë në mënyrë të veçantë në segmentin Poliçan - Çorovodë mungojnë elementët e sigurisë, ku më të rëndësishmit janë guardrailët. Edhe sinjalistika e cila shërben për orientimin e mjeteve gjatë lëvizjes në periudhën kur nuk ka ndriçim natyror, sidomos në kthesa.

*(trajtuar më hollësisht në faqet 138-138 të Raportit të Auditimit).*

**14.1. Rekomandim (pika 13 dhe 14):** Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe kontraktori që kryen mirëmbajtjen e këtij aksi, të marrin të gjitha masat për rritjen e sigurisë të tij dhe vendosjen e sinjalistikës përkatëse. Në mënyrë të veçantë, të merren masat për vendosjen e guardrailëve në pjesët ku rruga është në disnivel me fundin e skarpatës dhe paraqet rrezikshmëri për rënien e automjeteve.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Bypassi i Fierit është një aks më një fluks shumë të lartë të lëvizjes së automjeteve, i cili është hapur në mënyrë të pjesshme, me një karrexhatë me dy drejtime lëvizjeje. Megjithëse është vendosur pjesërisht sinjalistika vertikale dhe horizontale sidomos në kalimet në nivel, dhe guardrail në disa pjesë të aksit, ky aks nuk garanton sigurinë e përdorueseve të tij, për shkak të kalimeve në nivel, , kantierëve ta hapura në afërsi të karexhatës ku ka hyrje-dalje të mjeteve të rënda për ndërtimin e pjesës tjetër të karrexhatës, shpejtësisë së lartë të lëvizjes së automjeteve dhe parakalimeve të shumta në disa pjesë ku aksi është i drejtë. Gjithashtu mungon sinjalistika e cila shërben për orientimin e mjeteve gjatë lëvizjes në periudhën kur nuk ka ndriçim natyror. Në mënyrë të veçantë vlen të theksohet se mungon dhe sinjalistika për orientimin e automjeteve në periudha me mjegull, duke qenë se aksi është vendosur në një zonë ku prania e mjegullës gjatë vjeshtës dhe dimrit është e lartë. Me gjithë masat paraprake që janë marrë nga ARRSH dhe firma zbatuese në lidhje me sinjalistikën, ku aks rrugor nuk i përmbush kërkesat për garantimin e sigurisë së përdorueseve të rrugës dhe paraqet risk të lartë për ndodhjen e aksidenteve. Në rast të ndodhjes së aksidenteve, përveç pasojave shëndetësore që mund të kenë të aksidentuarit, ARRSH-ja mund të përballet me çështje gjyqësore të cilat mund të sjellin pasoja penale dhe financiare ndaj këtij institucioni *(Trajtuar më hollësisht në faqet 137-138 të Raportit të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim:** Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe firma zbatuese e By-passit të Fierit, të marrin të gjitha masat për mbylljen e aksit të karrexhatës me dy drejtime lëvizjeje të hapur deri tani, deri në përfundimin e plotë të këtij aksi sipas punimeve të parashikuara në preventivin e kontratës, ku të jenë vendosur dhe të gjithë elementet e sigurisë të parashikuar në projekt.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**





## A.1. REKOMANDIME PËR MASA ZHDEMIMI

**1. Gjetje nga auditimi :** Nga auditimi i kryer në ARRSH, mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit për vitet 2017 dhe 2018 dhe 2019, u konstatua se për vitin 2018 në zërin “Transferta për Buxhetin Familjar & Individ “ janë dhënë shpërblime punonjësve të ARRSH-së në vlerën 51,238,754 lekë. Ky shpërblim është dhënë me arsyetimin e ndryshimit të statusit të punonjësve nga nëpunës civil që marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në punonjës që marrëdhëniet juridike të punës rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës. Ky ndryshim është bërë në zbatim të pikës 6, kreut I të VKM nr. 276, datë 16.5.2018 ”Për miratimin e mënyrës së organizimit, të strukturës, organikës, dhe statutit të Autoritetit Rrugor Shqiptar”, në të cilën është përcaktuar se: “Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm, nëpunësve të tjerë dhe punonjësve të Autoritetit, në nivel Qendror dhe Rajonal, rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës”. Mirëpo, ish-Titullari i Përgjithshëm ARRSH dhe Departamenti i Administratës Publike (DAP) kanë vepruar në kundërshtim me pikën 7 të nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, duke aprovuar dhe miratuar dhënien e dëmshpërblimeve të punonjësve të pa larguar nga puna. Nga verifikimi i njëpasnjëshëm i vendimeve konstatohet se, nuk ka ndryshim të pozicioneve të punës për secilin punonjës dhe as ristrukturim, pra shkurtrim të vendeve të punës apo largim të punonjësve nga puna, por vetëm ndryshim të marrëdhënieve të punës (kalim nga nëpunës civil në marrëdhënie me kod pune). Për pasojë vlera prej 51,238,754 lekë e dhënë si shpërblim ndaj punonjësve të ARRSH-së, konsiderohet dëm ekonomik.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 56-59, të Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** ARRSH ne bashkëpunim me MIE dhe me departamentin e Administratës Publike, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën **51,238,754 lekë** .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**1.2. Rekomandimi:** ARRSH në bashkëpunim me MIE dhe me Departamentin e Administratës Publike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë ndryshimin e statusit të punonjësve, nga punonjës që marrëdhëniet e punës u rregullohen me dispozitat e Kodit të Punës, në punonjës që marrëdhëniet e punës u rregullohen me Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”. Mbas përfitimit të statusit të nëpunësit civil, punonjësit të kthejnë në buxhetin e shtetit vlerën e shpërblimit të përfituar padrejtësisht që është në shumën totale **51,238,754 lekë**.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 7, me fondin limit 2,332,573,946 lekë pa TVSH, te realizuar në korrik 2019. Në këtë procedurë nga 6 operatorët pjesëmarrës, është kualifikuar vetëm BO I.....”, me ofertën ekonomike në vlerën 2,299,327,253.75 lekë, pa TVSH dhe janë s’ kualifikuar 5 operatorët e



tjerë. Të 5 këta operatorë kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se operatori i kualifikuar. Katër nga këta operatorë janë s`kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotësonin kriteret e veçanta të kërkuara në DT e veçanërisht nuk kishin përvojë të ngjashme në punimet e tuneleve tokësore. Ndërsa BO “Gj...” është s`kualifikuar nga KVO, kundërshtim me ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si më poshtë:

Grupi i auditimi me përfundimin e fazës së vlerësimit nga KVO të dokumentacionit të operatorëve pjesëmarrës, menjëherë mbas njohjes së këtij vlerësimi nëpërmjet sistemit elektronik, i kërkojë AK vënien në dispozicion të dokumentacionit e këtij prokurimi të cilat nuk gjenerohen nga sistemi elektronik. Por AK nuk ju përgjigj kësaj kërkesë dhe grupi i auditimit me shkresë të protokolluar në ARRSH me datë 18.07.2019 i është drejtuar, Drejtorisë Juridike, Sektorit të Prokurimeve dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ARRSH dhe i ka kërkuar që të vihen në dispozicion të auditimit i gjithë dokumentacioni që nuk gjeneron sistemi elektronik dhe veçanërisht ankesat e operatorëve ekonomik. Përsëri strukturat drejtuese të ARRSH nuk i vunë në dispozicion këto dokumente dhe as nuk kthyen përgjigje shkresës sonë, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit". Në kushtet e mosvënies në dispozicion të këtij dokumentacioni, auditimi u përqendrua vetëm në dokumentacionin e gjeneruar nga sistemi elektronik i prokurimeve dhe u konstatua se, dokumentacioni i paraqitur nga ky operator plotëson të gjitha kërkesat ligjore dhe kërkesat e veçanta të vendosura në DT. Për pasojë, KVO duhej ta kualifikonte këtë bashkim operatorësh për fazën tjetër të shqyrtimit të ofertës ekonomike. Dhe meqenëse, ky bashkim operatorësh kishte paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 1,789,598,000 lekë e cila është më e ulët se oferta e operatori tjetër i kualifikuar “I.....”, duhej të klasifikonte i pari në renditje dhe duhej ta shpallte fitues, pasi oferta ekonomike e tij ishte me vlerë më të ulët me diferenca në vlerën 611,675,104 lekë me TVSH. Kështu do të eliminohej dëmi ekonomik në vlerën 611,675,104 lekë me TVSH që mundë të vinte nga s`kualifikimi i pa drejtë i këtij bashkimi operatorësh ekonomik.

Për këtë s`kualifikim, ky bashkim operatorësh ka paraqitur fillimisht ankesë pranë ARRSH, e cila nuk e ka pranuar këtë ankesë (sipas arsytimit të vendimit të KPP), dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP në përfundim të shqyrtimi në themel të ankesës, me Vendimin nr. 150, datë 09.07.2019 ka Vendosur: të pranojë ankesën e paraqitur nga ky bashkimi i operatorëve ekonomikë; AK të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e BOE; të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e kualifikuar BOE “Gj...”.

Në arsyetimin e Vendimit nr. 150, datë 09.07.2019, KPP ka bërë në thelb, të njëjtën arsyetim dhe interpretim ligjor si arsyetimet dhe interpretimet e bëra nga auditimi si dhe ka dalë me të njëjtin konkluzion dhe vendimmarrje se, BO “Gj...” duhej të kualifikohej për në fazën e shqyrtimit ekonomik.

Mirëpo, deri në datën 31.08.2019, që përkon me përfundimin e auditimit në terren, AK në zbatim të vendimit të KPP, nuk ka bërë rikualifikimin dhe të rendiste në vend të parë BOE “Gj...”.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 114-124, të Raportit të Auditimit).*



**2. Rekomandimi:** Për parandalimin e shkakimit të dëmit ekonomik në vlerën **611,675,104 lekë** me TVSH në buxhetin e shtetit, ARSH në zbatim të Vendimit nr. 150, datë 09.07.2019 Komisionit të Prokurimit Publik, të kualifikoje dhe të rendisë në vend të parë BOE “Gj...”, ta shpalli fitues dhe të lidhe kontratën e zbatimit me këtë operatorë.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**2. 1. Rekomandimi:** Në rast se, ARRSH dhe MIE do të anulojnë këtë procedurë prokurimi dhe do ta zhvillojnë përsëri në vitet në vijim (çka nuk është e ligjshme), në llogaritjen e fondit limit të procedurës së re, duhet të merret në konsiderate vlera e ofertës BO “Gj....”, i cili është skualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Në vazhdim**

## **A.2. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Ndërtim mbrojtja nga lumi km 9+500, rruga Milot - Skuraj”, me fond limit, 273,757,177 lekë, me fitues operatorin ekonomik V..... me ofertë 232,470,379 lekë . Në këtë procedurë nga 14 operatorë pjesëmarrës, janë s` kualifikuar 12 operatore ekonomik. Nga 12 operatorët e s` kualifikuar 5 prej tyre kanë paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi. Vlerat e ofertave të këtyre dy operatorëve krahasuar me ofertën e fituesit janë më të ulta që, shkojnë nga 32 milion lekë deri në 50 milion lekë. KVO i ka s` kualifikuar këta 5 operatorët pothuajse për të njëjta arsye, për mos paraqitjen e vërtetimit të marrë nga ARRSH,(e cila është vetë në cilësinë e AK), nëpërmjet të cilit të konfirmojnë se, nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/ nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes së ofertave i ka përfunduar punimet fizike në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës si dhe për mangësi në deklaratat për angazhimin apo jo të makinerive dhe mjeteve në kontratat të tjera, apo nuk kanë dokumentacion provues për mjetet.

Njëri nga të katër operatorët e skulifikuar , pikërisht, BO, “V.....” ka bërë ankesë pranë AK e cila nuk e ka pranuar këtë ankesë. Më pas ky operator ka paraqitur ankësë pranë Komisioni Prokurimit Publik, e cila me Vendimin nr.954/2016, date 13.12.2016, ka vendosur , të pranojë ankesën e paraqitur dhe Autoriteti Kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi skualifikimin e BOE “V.....” duke kualifikuar këta operatorë.

Në arsyetimin e këtij vendimi, KPP ka bërë në thelb, të njëjtën arsyetim dhe interpretim ligjor si arsyetimet dhe interpretimet e me sipërme të bëra nga auditimi.

Nga këto veprime, janë keq menaxhuar fonde buxhetore të cilat llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “V.....” të shpallur fitues me vendim të KPP dhe vlerës së ofertës së 4 operatorëve të tjerë të s`kualifikuar. Konkretisht, këta operatorë duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik pasi, mangësitë e konstatuara dokumentacioni e paraqitur për përmbushjen e kriterëve të veçanta mund të konsideroheshin devijime të vogla dhe pas



shqyrtimit të ofertave ekonomike, duhej të shpallej fitues operatori “A...” sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatori fitues dhe operatorët e tjerë që duhet të kualifikoheshin. Për pasojë, diferenca e ofertës së operatorit fitues BO “V.....” me ofertën e operatorit “A...” që është në vlerën 50,291,577 lekë, me TVSH, përbën menaxhim të fondeve pa efektivitet dhe ekonomikitet.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-75 të Raportit të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 50,291,577 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Plotësimi, rakordimi, masa mbrojtëse dhe siguria rrugore në viaduktet e aksit Kukës - Morinë”, me fondin limit 208 304 496,26 lekë pa TVSH, me fitues operatorin V.... me ofertë 207.331.536 Lekë. Në këtë procedurë nga 4 operatorë pjesëmarrës, janë s`kualifikuar 3 operatore ekonomik. Dy nga këta operatorë janë e s`kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik, ndërsa operatori tjetër “C...” i cili ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi, është s`kualifikuar për mangësi në përmbushjen e kriterëve të veçanta të cilat mund të konsideroheshin devijime të vogla. Nga këto veprime, janë keq menaxhuar fonde buxhetore të cilat llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “V...” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar. Konkretisht, operatori “C....” duhet të ishin kualifikuar për fazën tjetër atë të shqyrtimit ekonomik sepse i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kërkuara në DT, dhe pas shqyrtimit të ofertave ekonomike, duhej të shpallej fitues sepse kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatori fitues. Për pasojë, diferenca e ofertës së operatorit fitues “V...” me ofertën e operatorit “C.....” të s`kualifikuar që është në vlerën 37, 088,198 lekë, me TVSH, përbën menaxhim të fondeve pa efektivitet dhe ekonomikitet.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 75-78 të Raportit të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 37, 088,198 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 6”, me fondin limit, 2,388,910,889, 26 lekë me fitues operatorin ekonomik, “A.....”, me ofertë në vlerën 2,378,643,105 lekë. Në këtë procedurë nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s`kualifikuar 2 operatore ekonomik, një nga këta operatorë “G...” ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi dhe është s`kualifikuar për disa mangësitë apo paqartësi në dokumentacionin e paraqitur për përmbushjen e kriterëve të veçanta të cilat që mund të trajtoheshin si, devijime të vogla, sepse nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës. Për pasojë diferenca e vlerës së ofertës së operatorit “A....” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit “G....” të s`kualifikuar që është në vlerën 16,159,690 lekë, me TVSH, përbën menaxhim të fondeve pa efektivitet dhe ekonomikitet.



*(Trajtuar më hollësisht në faqet 78-80, të Raportit të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 16,159,690 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: Plotësimi i punimeve të mbetura dhe lidhja me rrugën ekzistuese të objektit Sistemim Asfaltim rruga Korçë-Erseke Loti 1”, me fond limit: 466,675,488.5 lekë me fitues operatorin “A...” me ofertë 466 373 334 lekë. Në këtë procedurë nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s` kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik 2 operatore ekonomik. Një nga këta operatorë “A.....”, ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi dhe është skaulifikuar për disa mangësitë apo paqartësi në dokumentacionin paraqitura për përmbushjen e kriterëve të veçanta. Edhe pse KVO e ka s` kualifikuar këtë operator në përputhje me kërkesat e DT, por mangësitë e konstatuara mundë ti trajtonte edhe si devijime të vogla. Kështu do të kishim menaxhim më të mirë të fondeve buxhetore në vlerën 20,123,397 lekë, me TVSH, i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “A...” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar “A.....”.

*(Trajtuar më hollësisht në faqen 124 të Raportit të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 20,123,397 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Përmirësimi i sigurisë rrugore në aksin Kashar-Rinas” me fond limit 81 025 172 lekë, me operatorë fitues “B.....” me ofertë 79,401,506 lekë. Në këtë procedurë nga 6 operatorë pjesëmarrës janë s` kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik 5 operatore ekonomik, pasi ka konstatuar në dokumentacionin e paraqitur disa mangësitë dhe paqartësi në lidhje me përmbushjen e kriterëve të veçanta. Tre nga të operatorë ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi. Për këtë arsye, KVO mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e këtyre operatorëve mundë ti trajtonte edhe si devijime të vogla, sepse nuk ndikojnë në ekzekutimin e kontratës, dhe për pasojë do të kishim menaxhim më të mirë të fondeve buxhetore në vlerën 16,835,772 lekë, i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “B...” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar “A.....” që ka paraqitur ofertën më të ulët ekonomike *(Trajtuar më hollësisht në faqet 124-125, të Raportit të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për menaxhimin fondeve në shumën 16,835,772 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**





**6. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Ndërtim i aksit rrugor Skrapar – Përmet, Loti 1”, me fond limit: 1,016,355,449.90 lekë, me operatorë fitues “S...” me oferte 1,015,858,675 lekë. Në këtë procedurë nga 3 operatorë pjesëmarrës janë s` kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik 2 operatore ekonomik të cilët ka paraqitur ofertat ekonomike më të ulët se fituesi, që shkojnë nga 172,231,791 leke në vlerën 234,947,208 lekë. KVO i ka s` kualifikuara të dy operatorët sepse, ka konstatuar mangësi dhe paqartësi të shumta në dokumentacionin e paraqitur për përmbushjen e kriterëve të veçanta, të cilat nuk të japin siguri se ekzekutojnë me sukses kontratën, në përputhje me projektin dhe preventivin e zbatimit. Mirëpo, këto operatorë kanë paraqitur ofertat ekonomike me të ultë se fituesi, dhe për këtë arsye, KVO mundë të ishte treguar më tolerante dhe mund ti trajtonte mangësitë e konstatuara edhe si devijime të vogla, kështu do të kishim menaxhim më të mirë të fondeve buxhetore në vlerën 234,947,208 lekë, i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “S...” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar “VH” që ka paraqitur ofertën më të ulët ekonomike.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 125, të Raportit të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 234,947,208 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Menaxhimi e Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimi i Tunelit të Kërrabës për vitet 2019-2020”, me fond limit 194,920,000 lekë, me operatorë fitues “4...” me oferte ofertë pothuajse sa fondi limit në vlerën 194, 820,000 lekë. Në këtë procedurë nga 2 operatorë pjesëmarrës është s` kualifikuar 1 operator, operatori “S...” i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 39,248,000 lekë. KVO i ka s` kualifikuara këtë operatorë sepse, ka konstatuar disa mangësitë dhe paqartësi në dokumentacionin e paraqitur për përmbushjen e kriterëve të veçanta, të cilat nuk të japin siguri se ky operatorë ekzekuton me sukses kontratën. Për arsye se, ky operatorë i s` kualifikuar ka paraqitur ofertën ekonomike më të ultë se fituesi, KVO mundë të ishte më tolerante dhe mund ti trajtonte mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e tij edhe si devijime të vogla, kështu do të kishim menaxhim më të mirë të fondeve buxhetore në vlerën 47,097,600 lekë, i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit “4...” të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar “S...” i cili ka paraqitur ofertën më të ulët ekonomike.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 102-107, të Raportit të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 47,097,600 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Procedura e prokurimeve me objekt: “Masa inxhinierie për stabilizimin e rrëshqitjes ne km 21+363 ÷21+468, ne segmentin Lin – Pogradec 2019, me fond limit 222,572,170 lekë, me operatorë fitues “E..” në vlerën 188.156.488 lekë. Në këtë procedurë nga





3 operatorë pjesëmarrës janë s` kualifikuar 2 operatore ekonomik, një nga të cilët ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se fituesi në vlerën 16,207,121 lekë . KVO i ka s` kualifikuara këtë operatorë sepse, ka konstatuar disa mangësitë dhe paqartësi në dokumentacionin e paraqitur për përmbushjen e kriterëve të veçanta, të cilat nuk të japin siguri se këta operatorë ekzekutojnë me sukses kontratën. Ky operatorë i s` kualifikuar ka paraqitur ofertën ekonomike më të ultë se fituesi dhe KVO mundë të ishte më tolerante dhe mund ti trajtonte mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e tij edhe si devijime të vogla, kështu do të kishim menaxhim më të mirë të fondeve buxhetore në vlerën 19,448,545 lekë, i cili llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit "E...." të shpallur fitues dhe vlerës së ofertës së operatorit të s`kualifikuar "P...." që ka paraqitur ofertën më të ulët ekonomike.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 107-114, të Raportit të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** ARRSH, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e menaxhimit të fondeve në shumën 19,448,545 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet .

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**9.Gjetje nga auditimi:** Kontrata e punimeve civile "Sistemim, asfaltim e masa inxhinierie në Km 21.050 deri 22.050, në Rrugën Lin-Pogradec" është nënshkruar me nr. 10066/5, datë 02.02.2016, ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe shoqërive ndërtuese JV "P....." dhe "G...e" SHPK, me vlerë 972,642,132 lekë. Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve është nënshkruar me nr. 10792/9 datë 20.04.2016, me Shoqërinë "T..." SHPK.

Kontrata përfshin punime shtresash rrugore, gërmime, vepra arti, punime të sinjalistikës, masa inxhinierie etj. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 24 muaj.

Kontrata është shoqëruar më ndërprerje kryesisht për mos përcaktim të vend depozitimit të mbeturinave, por edhe për shkaqe të motit. Në dokumentet e paraqitura në observacione është administruar edhe shtesë e kontratës nr. 4658/5, datë 02.07.2018, me vlerë 194,160,196 lekë. Në këtë shtesë kontrate e cila është tenderuar më vete (negocim pa shpallje të njoftimit të kontratës), janë përfshirë disa zëra të kontratës bazë, ndër të tjera edhe zëri i punimeve "Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri në 10 km" për sasinë 13,183 m<sup>3</sup>.

Bazuar në situacion përfundimtar të punimeve, volumet e gërmimeve dhe volumet e mbushjeve, rezulton se janë gërmuar 183990 m<sup>3</sup> dhera dhe shkëmb, janë mbushur me material të gërmuar më parë 19929 m<sup>3</sup>. Në këto kushte, dhera dhe shkëmbi i transportuar i përket sasisë 164061 m<sup>3</sup>. Bazuar në situacionin përfundimtar, është certifikuar për transport sasia 174287 m<sup>3</sup>, ose me diferencë 10226 m<sup>3</sup>. Pavarësisht se sasia 13183 m<sup>3</sup> është përfshirë në shtesën e kontratës, volumi i gërmimeve i përket kontratës bazë të audituar, pasi në shtesën e kontratës nr. 4658/5, datë 02.07.2018, nuk ka të përfshirë volume gërmimi. Vlera 5,730,650 lekë (10226 m<sup>3</sup> x 467 lekë/m<sup>3</sup> + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik. Ky veprim është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Pika I.3.2 dhe 5.1.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 149-150, të Raportit të Auditimit).*



**9.1. Rekomandimi:** Autoriteti Rrugor Shqiptar, të analizojë me grup pune, shkaqet, arsyet, e mos rakordimeve të volumeve të gërmimeve që i përkiste kontratës bazë dhe që janë përfshirjes në shtesën e kontratës. Në varësi të kësaj analize, të marrën masa për zbritjen e vlerës 5,730,650 lekë, përfshirë në shtesën e kontratës nr. 4658/5, datë 02.07.2018, për transport e cila është certifikuar në kontratën bazë nr. 10066/5, datë 02.02.2016, ndaj bashkimit të operatorëve ekonomikë "P....." SHPK dhe "G....".

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të kontratës nr. 10110, datë 24.12.2007 me objekt ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë loti 1, përmes matjeve në projektin e zbatuar dhe rakordimit të tyre me situacionin përfundimtar të punimeve, librezat e masave dhe nga matjet e verifikimet në terren rezulton se, nga kontraktori bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë "K...." janë certifikuar punime të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues në vlerën 29,368,630 lekë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7 dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 138-147, të Raportit të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** ARRSH të analizojë, shkaqet dhe arsyet për punimet në vlerën 29,368,630 lekë, të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues, si: libeze masash, ditar punimesh, fatura etj., dhe në varësi të kësaj analize, të marrë masa dhe të nxjerri përgjegjësit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative ligjore

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës bazë të punimeve "Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan – Banjë, Loti 1", rezulton se për zërat e punimeve të trotuarit, 5.2 Shtresë zhavorr lumi, t=20cm përhapur e ngjeshur me makineri, 5.3 Shtresë stabilizanti t=10cm, 5.4 Shtresë rëre nën pllaka, t=6cm dhe 5.5 Trotuar me pllaka vetë shtrënguese betoni, t=6cm, nga matjet në rilevimin e punimeve faktike, paraqitur në azhornimin dixhital të projektit, ka një sipërfaqe prej 1,689 m<sup>2</sup> më shumë të shtresave të mësipërme të pasqyruara në librezat e masave dhe në situacionin përfundimtar të punimeve, krahasuar me punimet faktike të realizuara, me një vlerë punimesh prej 3,187,022 lekë, të certifikuara nga kontraktori bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë "VH..." & "V....". Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7 dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 147-148, të Raportit të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** ARRSH të analizojë, shkaqet dhe arsyet për punimet në vlerën 3,187,022 lekë, të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues, si: libeze masash, ditar punimesh,



fatura etj., dhe në varësi të kësaj analize, të marrë masa dhe të nxjerri përgjegjësit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative ligjore.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës Nr.5795/3 datë 20/08/2018 me objekt “Rifreskimi Sinjalistikës Vertikale/Horizontale në Akset Kombëtare dhe Përmirësimi i Sigurisë Rrugore në Akset e Rajonit Verior, Loti”, sipërmarrësi “J.....” ka certifikuar punime në vlerën 3,334,320 lekë, të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues. Po kështu edhe nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratës Nr.5795/3 datë 20/08/2018 me objekt “Rifreskimi Sinjalistikës Vertikale/Horizontale në Akset Kombëtare dhe Përmirësimi i Sigurisë Rrugore në Akset e Rajonit Verior, Loti”, ky sipërmarrësi ka certifikuar punime pa dokumentacion teknik justifikues në vlerën 800, 000 lekë. Veprimet këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 127-131, të Raportit të Auditimit).*

**12. Rekomandim:** ARRSH të analizojë, shkaqet dhe arsyet për punimet në vlerën totale 4,134,320 lekë, të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues, si: libreze masash, ditar punimesh, fatura etj., dhe në varësi të kësaj analize, të marrë masa dhe të nxjerri përgjegjësit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative ligjore.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës Nr.9604/7 datë 20.12.2008 me objekt “Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë, Loti 2”, sipërmarrësi BOE “C....” ka certifikuar punime të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues në vlerën 3,708,774 lekë. Ky veprim bie në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 dhe me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-127, të Raportit të Auditimit).*

**13.1. Rekomandim:** ARRSH të analizojë, shkaqet dhe arsyet për punimet në vlerën totale 3,708,774 lekë, të pa rakorduar me dokumentacion teknik justifikues, si: libreze masash, ditar punimesh, fatura etj., dhe në varësi të kësaj analize, të marrë masa dhe të nxjerri përgjegjësit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative ligjore.

Afati për zbatimin e rekomandimit:

**Menjëherë**

**Shënim:** Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë raport auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport për auditimin e ushtruar në “Autoritetin Rrugor Shqiptar”

dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë,

## KONTROLLI I LARTE I SHTETIT